

INSTITUT ZA NAUČNA ISTRAŽIVANJA I RAZVOJ
INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM
INSTITUTE FOR SCIENTIFIC RESEARCH AND DEVELOPMENT

NAUČNI BILTEN
BULETINI SHKENCOR
Međunarodni naučni časopis
Revista Shkencore ndërkombëtare
International Scientific Journals
Proceedings

X-TH INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE
KONFERENCA E X-të SHKENCORE NDËRKOMBTARE

“Innovation, education, research and science in function of global developments”

”

“Novacioni, arsimi, kërkimi dhe shkenca në funksion të zhvillimeve globale”

SESIONI I SHKENCAVE JURIDIKE

Br/Nr. 10-2

God- Viti X / 2018

Ulcinj-Ulqin

Montenegro

06.04.2018

REDAKSIA

Prof.Ass. Dr. Shefket Jakupi, (kryeredaktor)

Prof.Asc.Dr.Jetmire Zeqiri

Prof.Asc Dr.Azeta Tartaraj

Ma.Yllka R.Imeri

DREJTOR I REVISTËS

Prof.Ass.dr. Elez Osmani

CIP – Каталогизација у публикацији

Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње 330(905L)

NAUČNI bilten:ekonomska istraživanja

Buletin Shkencor:hulumtime ekonomike

E- ISSN 2337-0521

ISSN 1800-9794

COBISS.CG-ID 20586256

Shtëpia botuese Instituti përkërkime shkencore dhe zhvillim -Ulqin

Shtypëshkronja IDEA Graf Vranje-Serbi

Korrektori dhe punoi në kompjuter

Besard Jakupi

E drejta e autorit :

Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim

"Redaksia e Buletinit Shkencor"

Ulqin

Adresa e redaksisë :

Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim

"Redaksia e Buletinit Shkencor"

Ulqin ++38269265707

web.: www.ekonomskiinstitut.com

SCIENTIFIC COMMITTEE

- Prof.Dr. Adem Bekteshi (*Albaniai*) - President,
- Prof.Dr. Predrag Goranović, (*Montenegro*) – Co.President

Academician Slobodan Nešković, (*Serbia*)

Academician Konstantin Pochivalov, (*Russia*)

Academician Dragoljub Mirjanić, (*Serbian Rep.*)

Prof.Dr.Nevenka Žarkić-Joksimović, (*Serbia*)

Prof.Dr. Ramë Vata(*Kosovo*)

Prof.Dr. Slađana Benković FON (*Serbia*)

Prof.Dr. Armand Krasniqi(*Kosovo*)

Prof. Dr. Dragoljub Jankovic(*Montenegro*)

Prof.Dr. Ibish Mazreku(*Kosovo*)

Prof.Dr. Tonin Gjura(*Albania*)

Prof.Dr. Anatoly Avdenko(*Ukraine*)

Prof.Dr. Valentin Nedeff(*Romania*)

Prof.Dr. Fahrush Rexhepi (*Kosovo*)

Prof.Dr. Račo Ilarinov (*Bulgaria*)

Prof.Dr. Constantin Bungau(*Romania*)

Prof.Dr. Vladimir P. Sergienko(*Belorus*)

Prof.Dr. Predrag Dašić(*USA*)

Prof.Dr. Hidajet Shehu(*Albania*)

Prof.Asc.Dr. Halit Shabani(*Kosovo*)

Prof.Asc. Dr. Husnija Bibiljica (*Kosovo*)

Prof.Dr. Laszlo Karpati(*Hungary*)

Prof.Ass. Dr. Shefket Jakupi, (*Kosovo*)

Prof.Dr. Diana Shehu (*Albania*)

Prof.Dr. Shkëlqim Fortuзи(*Albania*)

Prof.Dr. Seadin Xhaferi(*Macedonia*)

Prof.Dr. Naser Raimi (*Macedonia*)

Prof.Dr. Astrit Mehmeti (*USA*)

Prof. Dr. Michael Minch (*USA*)

Prof.Dr. Armend Kadriu(*Macedonia*)

Prof.Asc.Dr. Blerta Dragusha(*Albania*)

Prof.Dr. Niké Wentholt(*Netherland*)

Prof.Dr. Drita Kruja(*Albania*)

Prof.Dr. Sulo Haderi(*Albania*)

Prof.Asc.Dr. Brilanda Bushati(*Albania*)

Prof.Dr. Besa Xhaferi(*Macedonia*)

Prof.Dr. Arta Bilalli(*Macedonia*)

Prof.Dr. Laszlo Karpati(*Hungary*)

Prof.Dr. Miodrag Brzaković(*Serbia*)

Prof.Asc.Dr. Darko Lacmanović(*MNE*)

Prof.Dr. Salvator Bushati (*Albania*)

Prof.Dr. Sofronija Miladinovski (*Macedonia*)

Prof.Dr. Daniel Dobrev, (*Bulgaria*)

Prof.Dr. Andrej Raspor (*Slovenia*)

Prof. Dr. Zoran Mastilo(*B&H*)

Prof.Ass.Dr. Halil Kukaj (*Kosovo*)

Prof.Dr. Mirsad Nuković (*Vojvodina-Serbia*)

Doc. Dr. Nazmije Merko Zabzun(*Maced.*)

Prof.Dr. Tibor Petres(*Hungary*)

Prof.Asc. Dr. Mirijam Dibra(*Albania*)

Prof.Dr. Heinrich Meister (*Switzerland*)

Prof.Ass. Dr. Kamber Kamberi(*Kosovo*)

Prof. Dr. Keles Gulbahar(*Turkey*)

Prof.Dr. Jusuf Mustafai(*Macedonia*)

Prof.Asc. Dr. Fatos Ukaj (*Kosovo*)

Prof.Dr. AzetaTartaraj (*Albania*)
Prof.Dr. Edmond Beqiri(*Kosovo*)
Prof.Dr. ArtanNimani(*Kosovo*)
Prof.Dr. Kerstin Bree Carlson (*Danska*)
Prof.Dr. Robert Dimitrejski(*Macedonia*)
Prof.Dr. Michael Minch (*USA*)
Ph.Dr. FitimMaçani(*Kosovo*)
Phd (c) Rexhep Suma (*Kosovo*)
Prof. Ass. (c) Dr. ZemaidaMozali(*Albania*)
Prof.Ass.Dr.VehbiRamaj(*Kosovo*)

Prof.Asc Dr. ElidianaBashi(*Albania*)
Prof.Dr. Radovan Stojanović(*MNE*)
Prof. Dr. BiljanaCiglovska(*Macedonia*)
Prof.Dr. Zoran Todoorović(*MNE*)
Doc.dr. sc. Dean Sinkovic, (*Croatia*)
Prof.Dr. Sonja Vitanova(*Macedonia*)
Prof.Asc.Dr.IlirBerhani(*Albania*)
Prof.Asc.Dr. ShaipBytyqi(*Kosovo*)
Prof.Asc.Dr.Alba Robert Dumi(*Albania*)
Dr. YlvijeBorici(*Albania*)
Prof.Asc.Dr.JetmireZeqiri(Macedonia)

PËRMBAJTJA

1. Doc. dr. Jetmire Zeqiri - Non-acting as a form of conduct capable of causing the criminal consequences.....	6
2. Prof.Dr. Armand Krasniq, PhD(c). Anita Cucović- Kontrata për menaxhmentin në biznesin bashkëkohor – natyra juridike e kontratës.....	16
3. Dr. Adrian LEKA MSc. Fran Kaçorri MSc. Tonin Vocaj- Aspektet juridike të legjislacionit penal në fushën e krimeve ekonomikenë kosovë dhe shqipëri.....	22
4. Berat Aqifi Ardian Emini- E Drejta Zakonore dhe Fenomeni i Gjakmarrjes.....	32
5. Armand Fezolli- Mjetet e se Drejtës se Konkurrencës, mbrojtja e saj dhe zbatimi ne sektorin e Turizmit ne vendet e Ballkanit Perendimor; Përvoja e krahasuar e Shqiperise me fqinjet e saj, jo-anëtare te BE.....	43
6. Ma. Haqif Arifi, PhD kandidat, Prof. Dr. Naser Raimi- Rëndësia e krijimit të sistemit të Sigurimeve Shëndetësore në Kosovë.....	52
7. Milot Blakaj, FatosHalitaj- Legjislacioni për konkurrencën në republikën e kosovës.....	59
8. Prof. Ass. Dr. Orhan M. Çeku MSc. Amet Shabani, PhD kandidat MSc. Kastriot Dermaku, PhD kandidat - Mbrojtja Juridike e të Drejtës së Autorit.....	74
9. Qani Nuhiu- “Adriatic charter” – the role and contribution for security and political stability in the western Balkan.....	83
10. Qani Nuhiu- Copenhagen criteria as conditions for membership in the European Union (EU).....	92
11. Dashmir Idrizi PhD- Media in Macedonia and privacy protection.....	102
12. Prof.dr. Sadije Bushati - Dhuna ndaj femijeve- si e mendojne te rinjte. rasti i studenteve te ekonomikut dhe te shkencave sociale ne USH.....	109

Doc. Dr. Jetmire Zeqiri

Universiteti i Tetovës, Maqedoni, jetmire.zeqiri@unite.edu.mk

NON-ACTING AS FORM OF CONDUCT CAPABLE OF CAUSING THE CRIMINAL CONSEQUENCES

Abstract

(From the point of view of the objective side, inaction is considered to be unlawful because it violates an obligation: to act in the case of regular carelessness, to stop acting in the case of disorderly negligence. In both cases, the criminal or extra-criminal rate to which it refers, requires the entity to be activated. The type of norm that determines the obligation to act and consequently makes unlawful inaction is of particular importance because it determines the circle of subjects that can not claim the lawlessness.). Criminal liability arises when a legal entity is protected by criminal law. From a linguistic point of view, the verb "violation" in itself suggests an active act but from a legal point of view, the violation of the criminal law can be committed both with action and with inaction. Here we can see how the criminal law consists of norms punishing active actions besides these, from the norms that punish the imperfect of compulsory actions to be performed. This duality also possesses the norms of the constitutional law which provide for the protection of positive rights through the conduct of active actions by special subjects and negative rights, which stipulate the obligation to abstain from interfering in the enjoyment of these rights.

Key words: Inaction, criminal consequences, causal connection, neglect etc.

Hyrje

Doktrina juridike e komenton çështjen e veprës penale të kryer me mosveprim në analogji të plotë, kur përcakton se për të sjellë përgjegjësi penale, mosveprimi i kundraligjshëm duhet të jetë i vullnetshëm dhe i kryer me vetëdije nga personi që me ligj apo me ndonjë detyrim tjetër juridik ishte i detyruar të vepronte e nuk ka vepruar. Ndër personat që kanë detyrimin për të vepruar për shkak të profesionit është individualizuar edhe figura e mjekut¹. KP përcakton se mosndalimi i ardhjes së një pasoje nga personi që ka pasur detyrimin për ta penguar ardhjen e saj, është i barazvlefshëm me shkaktimin e kësaj pasoje. Kjo dispozitë sjell përgjegjësi penale edhe në ato raste kur pasoja vjen si rrjedhojë e veprimeve të të tretëve apo rrethanave aksidentale të cilat do të ishin shmangur sikur subjekti të kishte vepruar për ta ndaluar atë². I tillë është rasti p.sh kur babai nuk vepron për të mbrojtur fëmijën nga goditja me armë e kryer nga një i tretë. Ky detyrim buron në thelb nga e drejta

¹ Elezi, I., Kaçupi, S., Haxhia, M., 2001, ff. 95-97.

² Crespi *et al*, 1994, *ibid*, f. 101.

prindërore. Ndërkohë për të ofruar një mbrojtje akoma më efektive, Kodit Penal përcakton shprehimisht mbi detyrimin e prindit për të vepruar në mbrojtje të jetës, integritetit fizik, lirisë personale dhe integritetit seksual të fëmijës së mitur apo sidoqoftë të paaftë. Pasoja penale e ardhur nga një mosveprim i pakujdesshëm paraqet interes të veçantë në kushtet e objektit të këtij studimi mbi përgjegjësinë penale të mjekut. Mbi këto premisa, mosveprimi i kundraligjshëm penalisht mund të shfaqet në dy forma:

- I përcaktuar shprehimisht si formë e vetme me anë të cilës konsumohet vepra penale, në kushtet e mospërmbyshjes së “detyrimit për të vepruar”. E tillë është vepra penale e “Moskallëzimit të krimit” parashikuar në KP.
- I nënkuptuar nga dispozita si një lloj sjelljeje e aftë, përkrah veprimit aktiv, për të cënuar objektin juridiko-penal. Këtu pasoja vjen si rezultat i shkeljes së një “detyrimi për të ndaluar”, për të mos kryer një veprim përse të vepruarit do të cënonte objektin juridiko-penal³. Përgjegjësia penale lind si rrjedhojë e mospengimit të ardhjes së pasojës dhe jo nga shkaktimi i saj materialisht. P.sh vrasja mund të kryhet duke i administruar në mbidozë një medikament një pacienti (veprim aktiv) apo duke mos administruar kurën farmakologjike të aftë për të neutralizuar efektet e një krize që e çon pacientin në vdekje (mosveprim që pengon pasojën).

Nga pikëpamja e anës objektive, mosveprimi konsiderohet i kundraligjshëm sepse shkel një detyrim: atë për të vepruar në rastin e pakujdesisë së rregullt, atë për të ndaluar së vepruari në rastin e pakujdesisë së çrregullt. Në të dy rastet, norma penale ose ajo ekstra-penale së cilës kjo i referohet, kërkon që subjekti të aktivizohet. Lloji i normës që përcakton detyrimin për veprim e që rrjedhimisht bën mosveprimin të kundraligjshëm ka rëndësi të veçantë sepse përcakton rrethin e subjekteve që nuk mund të pretendojnë padijeninë e ligjit. P.sh në rastin e mjekimit të pakujdesshëm, vetëm një rreth i ngushtë subjektsh të posaçme (mjeku, infermieri) mund të pretendojnë se nuk kishin dijeni për detyrimin për të vepruar në dhënien e ndihmës mjekësore për pacientin, ndërkohë që subjekti i cili sheh se ka një të aksidentuar në anën e rrugës e që nuk mobilizohet për t’i dhënë atij ndihmën (e cila mund të ezaurohet edhe thjesht në njoftimin e ambulancës përse ndërhyrja nga subjekte që nuk kanë përgatitjen e duhur mund të përkeqësojë gjendjen e personit me traumë) ka shkelur me mosveprimin e tij një detyrim që i drejtohet të gjithëve në përgjithësi. Ngrejme një rast hipotetik: një kalimtar që është njëkohësisht edhe mjek është dëshmitar i një aksidenti rrugor. Mosveprimi i mjekut që nuk ndërhyr për t’i ardhur në ndihmë të aksidentuarit, i cili më pas ka vdekur apo ka pësuar një dëmtim të rëndë të shëndetit si rrjedhojë e mosmarrjes së ndihmës nuk do të konsumonte veprën penale të Mjekimit të pakujdesshëm (neni 96 KP) por atë të Mosdhënies së ndihmës (neni 97 KP) gjithmonë nëse vërtetohet lidhja shkakësore. Arsyeja e kësaj gjendet në faktin se nëse vepra penale është kryer me mosveprim, duhet të përcaktohet fillimisht cila është norma që përcakton detyrimin e subjektit për të vepruar. Në rastin konkret, i aksidentuari nuk ishte pacient i marrë nën kujdes mjekësor nga mjeku prandaj detyrimi i mjekut për të dhënë ndihmën e parë, në këndvështrimin e së drejtës penale, buron nga një rregull i përgjithshëm i përcaktuar nga neni 97 KP dhe jo nga ai i nenit 96 KP “Mjekimi i pakujdesshëm”. Kjo nuk do të thotë sidoqoftë se veprimi i mjekut nuk ka shkelur parimet e përmbajtura në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore. Edhe një pjesë e doktrinës shqiptare i bën një trajtim të ngjashëm çështjes së mosveprimit si formë e sjelljes në konsumimin e veprës penale. Sipas Salihut, detyrimi për të vepruar mund të rrjedhë nga ligji, nga marrëdhënia e punës (p.sh mjekut që për shkak të profesionit dhe marrëdhënies së punës ka detyrimin që të japë ndihmë) apo nga

³Në veprat penale të kryera me pakujdesi, kjo do të kategorizohet nga doktrina si "Pakujdesi e çrregullt e kryer me mosveprim (*reato omissivo improprio*, it.). Gjithashtu Salihu, I., *ibid*, e cilëson si “Vepër penale jo e drejtë e kryer me mosveprim”, ff. 114-115.

një veprim i ndërmarrë më parë nga subjekti si dhe nga rrethana apo marrëdhënie të tjera juridike të ndryshme nga të sipërpërmendurat⁴. Çela et al.⁵ influencohen haptazi nga Kodi Penal kur shprehen se detyrimi për të vepruar, mospërbushja e së cilit sjell përgjegjësinë penale për mosveprim, mund të diktohet nga “ligje, rregullore të veçanta, detyra, pozita shoqërore, karakteri i punës apo nga detyrimet e marra përsipër nga personi”⁶. Subjekti ka përgjegjësi penale ose kur nuk ka vepruar dhe duhet të vepronte, ose kur nuk ka vepruar në kohën e duhur ose sipas mënyrës së duhur. Kriteria të mëtejshme që duhen përbushur për të pasur përgjegjësi penale për veprën penale të kryer me mosveprim, janë vlerësimi në mënyrë konkrete i domosdoshmërisë së ardhjes së pasojës nga mosveprimi dhe ekzistenca e qëndrimit të brendshëm psikik të subjektit. Gjithsesi, Çela et al. nuk orientojnë rreth instrumentave të mundshëm për përcaktimin e domosdoshmërisë së mosveprimit në ardhjen e pasojës. Sipas Muçit, “mosveprimi shërben si shkak i ardhjes së pasojës kur personi që ka qenë i detyruar të vepronte nuk e ka kryer veprimin ose nuk e ka kryer në kohën e duhur dhe vërtetohet se po të kishte vepruar, pasoja nuk do të kishte ardhur pavarësisht nga ndikimi i faktorëve të tjerë.”⁷. Nga ky pohim mund të deduktojmë dy karakteristika të rëndësishme mbi veprën penale të kryer me mosveprim që evokojnë interpretimin doktrinor dhe jurisprudencën italiane: 1) për të pasur përgjegjësi penale duhet që detyrimi për të vepruar i subjektit të ketë qenë i përcaktuar; 2) domosdoshmërinë e vërtetimit të lidhjes shkakësore mes mosveprimit dhe pasojës nëpërmjet një vlerësimi ex post i.e. - po të kishte vepruar, pasoja nuk do të kishte ardhur pavarësisht nga ndikimi i faktorëve të tjerë. Pa dashur ta shtjellojmë çështjen e pozitës së garantit si burim i detyrimit për të vepruar që të shmanget pasoja e dëmshme, objekt shqyrtimi në vijim të punimit, ndalemi shkurtimisht në këtë pikë për të nënvizuar faktin se ekuivalentimi i shkaktimit të pasojës penale me mospengimin e ardhjes së saj kur mbi subjektin ekzistonte ky detyrim, bazohet mbi solidaritetin politik, ekonomik dhe social të shpallur në nenin 2 të Kushtetutës italiane dhe mbi të drejtën e individit për shëndet, pra për integritet fizik si një e drejtë themelore, parësore e individit, parashikuar në nenin 32 të saj. Solidariteti social është parashikuar në Preambulën e Kushtetutës. Ndërkohë që detyrimi i shtetit për të realizuar objektivat sociale ku përfshihet edhe detyrimi për të ofruar kujdes shëndetësor dhe e drejta e individit për ta marrë këtë kujdes, parashikohen përkatësisht në nenet 59 dhe 55 të Kushtetutës.

Lidhja shkakësore te veprat penale të kryera me mosveprim

Faza e parë e vlerësimit të ekzistencës së lidhjes shkakësore tek veprat penale të kryera me mosveprim është i njëjtë me atë të veprave penale të kryera me veprim i.e: përcaktohen mbi bazën e ligjeve shkencore të gjithë ata faktorë pozitiv të mjaftueshëm secili veçmas dhe të gjithë së bashku, për të prodhuar pasojën (vlerësimi *ex ante*). Veçoria që shfaqet në vlerësimin e lidhjes shkakësore mes mosveprimit dhe pasojës, qëndron në nevojën për të përcaktuar se nga cila normë, penale apo extra-penale së cilës i referohet ajo penale, buron detyrimi juridik për të vepruar. Ky është një hap që pozicionohet midis vlerësimit *ex ante* dhe atij *ex post* të lidhjes shkakësore. Mandej, po ashtu si për lidhjen shkakësore mes veprimit aktiv dhe pasojës, duhet të vijohet me kundërprovën, por në rastin e veprës penale të kryer me mosveprim formulimi i përgjithshëm i kundërprovës do të ishte: A do të kishte qenë në gjendje veprimi i detyrueshëm dhe i parealizuar (d.m.th i munguar), të pengonte ardhjen e pasojës që në fakt ka ardhur (*ex post*)⁸? Në të njëjtën linjë qëndron edhe Salihu kur

⁴ Salihu, I., 2010, ibid, f. 213.

⁵ Çela, A. et al, 1982, ibid, f. 123.

⁶ Çela, A. et al, 1982, f. 123.

⁷ Muçi, Sh., 2007, ibid, f. 119.

⁸ Gallo, M., 2007, Vol. II, Parte I, ibid, f. 128

përcakton se për të pasur lidhje shkakësore duhet me domosdoshmëri që të ekzistojnë njëkohësisht në mënyrë kumulative tre kushte⁹:

- Të ekzistojë detyrimi për subjektin që të veprojë në një mënyrë të caktuar për të parandaluar pasojën
- Subjekti të ketë qenë në gjendje të parandalonte pasojën
- Të vërtetohet se me siguri, pasoja nuk do vinte ose do të ishte më pak e rëndë nëse do të ishte kryer veprimi që duhej të ishte kryer dhe nuk është kryer. (kundërprova, sh.a)

Dy janë pikat që duhen veçuar nga trajtimi që bën Salihu: a) subjekti që ka detyrimin për të vepruar duhet të ketë pasur mundësinë faktike për ta kryer veprimin, pra mosveprimi mos të ketë qenë i diktuar nga rrethana të pakontrollueshme nga vullneti i tij. b) përfundimi mbi ekzistencën apo mungesën e lidhjes shkakësore duhet të jetë pohuar me bindje të sigurtë. Edhe pse Salihu nuk e përpunon më tej konceptin e “sigurisë” në vlerësimin e ekzistencës së lidhjes shkakësore, për sa u përshtrua më sipër, “siguria” duhet kuptuar si e ndryshme nga çdo konkluzion i bazuar mbi terma probabilistike statistikore. Mund të konkludojmë se pohimi i Salihut është plotësisht në linjë me përcaktimet e jurisprudencës dhe doktrinës aktuale italiane mbi *probabilitetin logjik*, antagonist me *probabilitetin statistikor*. Duke theksuar se faza e parë e vlerësimit të lidhjes shkakësore të veprës penale të kryer me mosveprim (*ex ante*) mbetet e njëjtë me atë të lidhjes shkakësore në veprat penale të kryera me veprim, pra përcaktimi bazuar mbi ligjet shkencore se cila ka qenë sjellja që ka shkaktuar ardhjen e pasojës, Fiandaca-Musco e përkufizojnë lidhjen shkakësore në veprat e kryera me mosveprim, si *lidhje shkakësore hipotetike* apo *lidhje shkakësore normative*, për sa sipas tyre, nga një vlerësim *ex post* lidhja shkakësore do të konsiderohej e vërtetuar nëse, duke supozuar të kryer veprimin (që nuk u krye, sh.a) pasoja (që në fakt ka ardhur) do të ishte shmangur¹⁰. E thënë ndryshe, bëhet eliminimi imagjinar i mosveprimit, pra supozohet i kryer veprimi që ishte i detyrueshëm për t’u kryer, për të parë nëse pasoja do të ishte shmangur apo jo. Sipas këtyre autorëve, është e mjaftueshme që lidhja shkakësore të jetë “e mundshme, gati e sigurtë” meqë për shkak të karakterit hipotetik të procesit të vlerësimit të kësaj lidhjeje shkakësore, është e pamundur të zbatohet i njëjti rigorozitet që kërkohet për lidhjen shkakësore *reale* mes veprimit aktiv dhe pasojës¹¹. Fiandaca-Musco shprehen për një procedurë të ngjashme edhe për vërtetimin e lidhjes shkakësore për pakujdesinë e çrregullt të kryer me mosveprim: gjyqtari duhet të evidentojë mbi bazën e ligjeve shkencore se cilat janë ato sjellje që kanë munguar dhe që duhet të ishin ndërmarrë në rastin konkret për të shmangur ardhjen e pasojës. Mandej, si veçori e posaçme e kësaj lloji pakujdesie, duhet të përcaktohet cila ishte norma penale apo ekstra-penale që përcaktonte detyrimin për të vepruar të subjektit¹². Sa u përshtrua më lart nga vendimi unifikues “Franzese” i Gjykatës mbi vlerësimin e lidhjes shkakësore, gjen zbatim si për veprën penale të kryer me veprim ashtu edhe për atë të kryer me mosveprim. Mbi këtë kategori të fundit, Gjykata përcakton se nuk është i pranueshëm qëndrimi se, ekzistenca e lidhjesshkakësore pasive (në veprat penale të kryera me mosveprim) mund të shprehet bazuar mbi një bindje të një niveli më të ulët, pra më pak të sigurtë, sesa ajo mbi të cilën bazohemi kur vlerësojmë lidhjen shkakësore aktive (në veprat penale të kryera me veprim). Në dallim nga sa përshtruar më lart nga Fiandaca-Musco, Gjykata shprehet se vlerësimi *ex post*, pra kundërprova, ka në fakt karakter hipotetik në të dyja llojet e sjelljes, si kur vepra penale është kryer me veprim ashtu edhe kur është kryer me mosveprim. Për rrjedhojë, nuk ka asnjë dallim mes të dyjave nga pikëpamja e kriterëve

⁹ Salihu, I., 2010, ibid, ff. 220-221.

¹⁰ Fiandaca, G., Musco, 2004, ibid, ff. 554-555.

¹¹ Fiandaca, G., Musco, 2004, ibid, f. 556.

¹² Fiandaca, G., Musco, 2004, ibid, f. 548.

vlerësuese të lidhjes shkakësore. Vështirësia e vërtetimit të lidhjes shkakësore pasive qëndron në provueshmërinë gjatë shqyrtimit gjyqësor, të aftësisë që veprimi i munguar kishte për të shmangur pasojën e ardhur. Kjo sepse të provuarit e ekzistencës së lidhjes shkakësore bëhet me anë të arsyetimit induktiv, pra nga më specifikja tek ajo më e përgjithshmja; nga veprimi i subjektit, duke përjashtuar ekzistencën e shkaqeve të tjera alternative, tek ardhja e pasojës, duke u bazuar në ligjet statistikore konkrete dhe në ato universale. Mbi këtë pikë, Gjykata shprehet se në lidhjen shkakësore pasive, nuk mund të përdoret arsyetimi deduktiv, përse është e pamundur që të njihen të gjitha shkaqet që mund të sillnin ardhjen e pasojës penale konkrete. Pra edhe në vlerësimin e lidhjes shkakësore në veprat penale të kryera me mosveprim, duhet përdorur arsyetimi induktiv i çmuarjes së provave dhe indicieve në dispozicion dhe pse bindja nuk është “e afërt me sigurinë” apo me probabilitet “pranë 100%”, çka është një mundësi reale për këtë kategori veprash. Në këtë rast, në zbatim të parimit *in dubio pro reo*, gjyqtari duhet të shpallë pafajësinë sepse nuk vërtetohet lidhja shkakësore përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Gjykata po në vendimin “Franzese”, evidenton se zakonisht pasoja penale nga mjekimi i pakujdesshëm shfaqet në kuadrin e dy llojeve situatash:

- a) kur mjeku ka bërë një diagnozë apo ka përcaktuar një terapi të gabuar me pakujdesi të rëndë (i.e. me papërvojë, sh.a.)
- b) si rezultat i një sjelljeje të përbërë: mjeku kryen veprime aktive të pakujdesshme dhe mosveprime, të cilat mund të konsistojnë në shkelje të detyrimit për të kryer një veprim të detyrueshëm për t’u kryer apo në detyrimin për të ndaluar ardhjen e pasojës.

Për të vërtetuar lidhjen shkakësore në veprat penale të kryera me mosveprim, nuk është i mjaftueshëm të shprehurit mbi bazën e një koeficienti probabiliteti statistikor, por lipset të bëhet një vlerësim mbi bazën e një probabiliteti logjik të lartë, i cili përftohet atëherë kur pasi supozohet si i kryer veprimi i detyrueshëm dhe pasi të jenë përjashtuar shkaqet alternative, arrihet në bindjen me një gradë të lartë mendimi racional, se pasoja e dëmshme do të ishte shmangur ose të paktën do shfaqej shumë më vonë ose me një intensitet më të ulët¹³. Gjithashtu, për vërtetimin e lidhjes shkakësore të veprës penale të kryer me mosveprim nuk është e mjaftueshme shkelja e një norme të përgjithshme kujdesi e as frekuenca e lartë me të cilën është vërejtur se ai mosveprim është kthyer në shkak të aftë për ardhjen e asaj lloji pasojë penale që ka ardhur konkretisht. Kërkohej që vlerësimi *ex post* i lidhjes shkakësore mes veprimit të munguar (që duhet të ishte kryer) dhe pasojës që ka ardhur, të ketë dhënë rezultat pozitiv. Kështu anashkalohen pritshmëri utopike bazuar në kriterin e bindjes me siguri që rrjedh nga ligjet absolute të statistikës¹⁴. Në një rast konkret, edhe pse gjykata në shkallën e parë të gjykimit ishte shprehur se mungonte lidhja shkakësore mes vdekjes prej infarkti kardiak të një të burgosuri dhe moskërkimit nga ana e infermieres së institucionit për shtrimin urgjent të këtij në spital, Gjykata e Kasacionit vlerësoi se nuk ishte kryer kundërprova e bazuar në probabilitetin logjik, nga e cila vlerësohej nëse vdekja e të burgosurit do kishte ardhur sidoqoftë sikur infermierja të kishte dhënë ndihmën e shpejtë, të cilën ajo duhej dhe ishte e kualifikuar të jepte, e pastaj të njoftonte mjekun e urgjencës pranë institucionit të vuajtjes së dënimit. Vlerësimi mbi lidhjen shkakësore paraqiste mangësira përse nuk ishte ezauruar vlerësimi *ex post* i saj, ndaj lidhja shkakësore nuk mund të quhej e provuar dhe vendimi i pafajësisë i marrë mbi këtë ishte i pavlefshëm. Kështu Gjykata kishte vendosur për anulimin e vendimit të Gjykatës së Faktit, sepse në atë vendim nuk ishte analizuar fakti nëse pasoja do të kishte ardhur sidoqoftë apo jo sikur subjekti të kishte kryer veprimin që në fakt nuk kishte ndërmarrë, në shkelje të *lege artis*. Pra, edhe pse ishte ezauruar vlerësimi *ex ante* i lidhjes

¹³ Stella, F., Causalità omissiva, probabilità, giudizio contrafattuali. L’attività medico-chirurgica in *Cassazione Penale*, Vol. III, Milano, 2005, ff. 1062 e vijim siç është cituar nga De Ferrari, F., Palmieri, L., 2007, ibid, f. 129.

¹⁴ Cass. Pen. Sez. Sentenza n. 2126/06.

shkakësore, nuk ishte vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm nëse do të ishte arritur të shmangej pasoja e ardhur, sikur subjekti të kishte kryer veprimin e munguar. Edhe Lattanzi-Lupo vërejnë se vërtetimi i lidhjes shkakësore nuk ndryshon në varësi të faktit nëse pasoja penale ka ardhur nga një veprim (lidhje shkakësore aktive) apo mosveprim (lidhje shkakësore pasive)¹⁵. Konkretisht, konfigurohet si vepër penale e kryer me mosveprim, dëmtimi i shëndetit të pacientit që ka ardhur si rrjedhojë e një diagnoze të gabuar, të cilën mjeku kishte detyrimin dhe mundësinë të jepte mbi bazën e rregullave të përvojës, kujdesit dhe maturisë. Bazuar mbi këtë arsyetim, Gjykata e Kasacionit ka ngarkuar me përgjegjësi penale për pakujdesi mjekun i cili pasi kishte shqyrtuar rezultatin e mamografisë së një pacienteje që prezantonte një patologji neoplastike, kishte bërë një diagnozë të gabuar dhe nuk kishte rekomanduar që pacientja të kryente një ekzaminim histopatologjik por që kjo të kryente pas një viti një mamografi tjetër, gjë që kishte kontribuar në avancimin e sëmundjes¹⁶. Duke qëndruar në linjë me vendimin unifikuës “Franzese”, mund të deduktohet se në vlerësimin e lidhjes shkakësore mes mosveprimit të mjekut dhe ardhjes së vdekjes së pacientit, ligjet statistikore përbëjnë vetëm njërin prej elementëve që janë vënë në dispozicion të gjyqtarit. Këto duhet të merren parasysh së bashku me rrethanat e tjera, përse lidhja shkakësore nuk mund të quhet e vërtetuar mbi një përllogaritje statistikore¹⁷, por duhet të jetë bazuar me vlerësimin e të gjithë faktorëve specifikë të çështjes konkrete. Gjykata e Kasacionit në një vendim të sajën, saktëson se pasi të ketë përcaktuar ligjet statistikore, gjyqtari duhet të vlerësojë nëse këto janë të aplikueshme rastit konkret¹⁸, duke marrë parasysh të gjithë faktorët që mund të zerojnë aftësinë shpjeguese të këtyre ligjeve (mbulimin e çështjes nga këto ligje, sh.a.) të dinamikave të rastit konkret. Gjyqtari duhet të verifikojë që ato të përputhen me moshën, seksin, gjendjen e përgjithshme të pacientit, duke pasur parasysh fenomenet e tjera patologjike që janë shfaqur tek pacienti, si dhe duke konsideruar ndjeshmërinë që çdo individ ka ndaj një trajtimi farmakologjik të caktuar. Vlerësimi i të gjithë këtyre rrethanave bëhet mbi bazën e ligjeve statistikore, atyre shkencore si dhe rregullave praktike. Pra duhet bërë një vlerësim i rrugës që ndjek patologjia zakonisht, sa të efektshme janë terapitë, cilët janë faktorët që influencojnë suksesin e trajtimit terapeutik, në ç’mënyrë shfaqen këto faktorë në rastin konkret, në cilin stad ndodhet patologjia që ka pasur qëllim të trajtonte mjeku që ka kryer mosveprimin. Lidhja shkakësore do të quhet e provuar nëse përgjigjet e këtyre pyetjeve jepen mbi bazën e informacioneve shkencore dhe faktike në dispozicion siç mund të jenë rezultati nga autopsia, kartela klinike etj. Ashtu si për lidhjen shkakësore aktive, duhet të vërtetohet se norma e shkelur do të kishte qenë e përshtatshme për të shmangur pasojën, nëse do të ishte respektuar nga subjekti i.e. në veprën penale të kryer me veprim duhej të vërtetohej se po të mos ishte kryer ai veprim aktiv, pasoja nuk do të kishte ardhur; në rastin e veprës penale të kryer me mosveprim, duhet të vërtetohet se nëse subjekti do të kishte kryer veprimin që në fakt nuk ka kryer, pasoja nuk do kishte ardhur ose do kishte ardhur në një kohë më të vonët. Nëse rezultati i këtij vërtetimi nuk është i sigurtë ose shumë pranë të qenurit i sigurtë, afërsisht 100% probabël, atëherë nuk mund të themi se lidhja shkakësore ekziston me probabilitet racional, ndaj në funksion të parimit *in dubio pro reo* nuk mund të themi se ajo ekziston.

Eksptimi mjeko-ligjor dhe vlerësimi i lidhjes shkakësore pasive

Mjekut ligjor i duhet të vlerësojë me anë të ekspertimit se si ndikojnë në lidhjen mes veprimit dhe pasojës, faktorë të ndryshëm natyrorë që karakterizojnë një patologji konkrete. Këto faktorë janë konkurrues me veprimin dhe për nga natyra mund të shkaktojnë lindjen e sëmundjeve iatrogjene, të

¹⁵ Lattanzi, G., Lupo, E., *Codice Penale. Rassegna di giurisprudenza e di dottrina*. Volume XI, Libro II - Tomo I Artt. 556-599, Giuffrè, Milano, 2010, f. 548.

¹⁶ Cass. Pen. Sentenza n. 3380/05; Sentenza n. 233237/07 cituar nga Lattanzi, G., Lupo, E., *Codice Penale*, 2010, *ibid.* f. 548.

¹⁷ Probabiliteti *ex ante* i përgjithshëm.

¹⁸ Probabiliteti *ex post* i posaçëm, konkret.

cilat konsistojnë në dëmtime në shëndet të shkaktuara nga një medikament i administruar pacientit apo edhe me trajtimin mjekësor-kirurgjikal, duke u gërrshetur kështu të gjithë bashkë në rrjedhën e sëmundjes, duke e përqësuar shëndetin e pacientit përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, madje duke shkaktuar edhe vdekjen e tij. Në dukje të parë, një situatë e tillë do ta ekspozonte mjekun që ia administroi këto medikamente pacientit ndaj përgjegjësisë penale. Gjithsesi gabimi në përcaktimin e terapisë që ka shkaktuar një dëmtim të shëndetit nuk sjell automatikisht përgjegjësi për mjekim të pakujdesshëm. Që një sëmundje iatrogjene të bëhet shkas për lindjen e përgjegjësisë penale të mjekut, duhet të përcaktohet se gabimi në administrimin e medikamentit apo në veprimin apo mosveprimin e mjekut, është kryer duke gabuar, pra me pakujdesi. Sipas Palmieri gabimi mund të jetë “i falshëm” ose “i pafalshëm” dhe është vetëm ky i fundit që zakonisht përbën shkak për lindjen e përgjegjësisë penale¹⁹. Po aty, Palmieri thekson që duhet të përmbushet edhe kushti që nga gabimi i pafalshëm, pacientit t’i jetë shkaktuar një dëm në shëndet, rreziku për jetën ose vdekja. Kjo në thelb përputhet plotësisht me përmbajtjen e dispozitës së “Mjekimit të pakujdesshëm”. Mjeku ligjor mund të shprehet vetëm mbi baza probabilistike. Akoma më shumë e vështirëson punën e tij fakti që jo gjithmonë mund të kryejë eksperimente të drejtpërdrejta klinike, instrumentale apo laboratorike për të vërtetuar në mënyrë shkencore ndikimin e faktorit në ardhjen e pasojës. Të rralla janë edhe mundësitë që ai të shprehet mbi bazën e vëzhgimeve empirike, përderisa shpesh i duhet të shprehet mbi bazë dokumentacioni të prodhuar nga subjekte të tjera. Fillimisht jurisprudenca, i konsideronte si të vlefshme e të mjaftueshme për ta quajtur të vërtetuar lidhjen shkakësore rezultatet që buronin nga përgjithësime të botëkuptimit të zakonshëm, përse kohë gjyqtari orientonte procesin e vlerësimit të lidhjes shkakësore drejt një shpjegimi sa më shkencor ose të paktën drejt një shpjegimi shkencor statistikor²⁰. Në këtë sens, lidhja shkakësore konsiderohej se ekzistonte edhe kur mungonte *siguria* (bindja e sigurtë) se jeta e pacientit do të ishte shpëtuar sikur mjeku të ishte sjellë në mënyrën e duhur, në atë moment konkret, por ekzistonte një *probabilitet serioz dhe i vlerësueshëm për sukses* në shpëtimin e jetës së tij²¹. Meqenëse jeta e njeriut, ashtu si edhe shëndeti, janë të drejta absolute me rëndësi primare, në përpjekje për t’i ofruar një mbrojtje sa më të plotë, jurisprudenca italiane u largua *de facto* nga formulimi origjinal në negativ se “ekziston lidhje shkakësore kur nuk është rrethanë e jashtëzakonshme që veprimi të ketë shkaktuar në atë moment atë pasojë penale” në favor të një formulimi pozitiv sipas së cilit “ka lidhje shkakësore kur ka probabilitet që veprimi në atë moment të ketë shkaktuar atë pasojë”. Është shumë e vështirë përcaktimi me bindje të sigurtë se një veprim i munguar (pra mosveprimi) do të kishte shmangur ardhjen e pasojës që në fakt ka ardhur. P.sh nëse një pacient prezantohet me një plagë të kontaminuar me dhë, procedura më e zakonshme profilaktike do të ishte administrimi i serumit anti-tetanoz, paçka se nuk ka ndonjë garanci se marrja e këtij serumi do të shmangë me siguri shfaqjen e sëmundjes e anasjelltas, se mosmarrja e serumit do të shkaktojë me siguri shfaqjen e sëmundjes. Është një shembull që sillet në traktate të ndryshme dhe që dëshmon për qëndrimin e shkencës mbi një argument të caktuar, por që nuk i arrin ato nivele bindjeje të sigurtë, pra përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, me të cilën duhet të shprehet mjeku ligjor që kryen një ekspertim për mjekim të pakujdesshëm, si ai që shqyrtohet në rastin e mjekut që nuk ka administruar serumin anti-tetanoz. Analiza e sjelljes së pakujdesshme të mjekut që është nën vlerësimin e një eksperti mjekoligjor duhet së pari t’i referohet karakteristikave të rastit konkret, motivacionit nga i cili është shtyrë mjeku kur ka zgjedhur të kryejë apo moskryejë një veprim të caktuar si dhe pohimin me bindje të sigurtë se rezultati përfundimtar do të kishte qenë i ndryshëm, sikur sjellja e mjekut të kishte qenë e ndryshme. Kështu, mbi bazën e ligjeve shkencore, dhënia e serumit anti-tetanoz ofron një mundësi të lartë të shmangies së sëmundjes për pacientin. Nëse pacientit të plagosur nuk i është dhënë ky serum

¹⁹ De Ferrari, F., Palmieri, L., 2007, ibid, f.558.

²⁰ Crespi et al., 1994, ibid, f. 104.

²¹ Crespi et al., 1994, ibid, f. 104 § 7 dhe ff. 105-106.

dhe më pas ai ka vdekur si rrjedhojë e tetanozit, mjeku që ka neglizhuar në dhënien e këtij trajtimi profilaktik, është përgjegjës për shkaktimin e vdekjes së pacientit²². Sipas Barnit²³, përcaktimi i një diagnoze apo terapie të gabuar, duhet inkadruar si shkelje e bindjeve shkencore që karakterizojnë një trajtim efektiv ideal, të sigurtë dhe të dobishëm në referim të të cilit do të na duhej të konkludonim përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se pasoja fatkeqe nuk do të kishte ardhur (ose anasjelltas do të kishte ardhur sidoqoftë, çka do të ndërpriste lidhjen shkakësore) nëse do të ishte zbatuar një trajtim terapeutik konform *legibus artis*. I tillë do të ishte rasti kur mjeku gabon në dozimin e një bari duke e administruar atë në tepriçë apo me pakicë dhe paralelisht pacienti pëson një përkeqësim të shëndetit apo akoma më keq, vdes. Për të vërtetuar ekzistencën e lidhjes shkakësore mes këtij veprimi dhe pasojës penale nuk mjafton që të konkludohet se është gabuar në dozimin e barit. Kërkohej që nëpërmjet ekspertimit të përcaktohet me saktësi se cila ishte doza e duhur, të bëhet dallimi i saj nga doza që nuk ka asnjë efekt ndikues dhe nga doza me efekt toksik e mbi të gjitha të krahasohen zhvillimet e zakonshme të patologjisë së pacientit me rrethanat përshpejtuese të patologjisë që mund të kenë ndodhur konkretisht. Ekzistenca e lidhjes shkakësore është e pamundur të pohohet me siguri absolute, por do të ishte e pranueshme si nga pikëpamja shkencore ashtu edhe nga ajo juridike, nëse mbështetet mbi të dhëna konvergjente të mjaftueshme, të cilat si të tilla, ofrojnë besueshmëri. Për këtë duhet me *doemos* t'i referohemi të dhënave epidemiologjike-statistikore duke e vënë mosveprimin në një analizë vlerësuese *ex post*. Në këtë analizë nevojitet:

- a. përcaktimi i hallkës që mungon në zinxhirin e ngjarjeve (mosveprimi), ekzistenca e së cilës do të kishte sjellë një pasojë tjetër më të favorshme.
- b. përcaktimi i diagnozës dhe/apo terapisë që nuk u dha si rrjedhojë e mosveprimit të pakujdesshëm të mjekut.
- c. përcaktimi i zhvillimit klinik që besohet se do të kishte pasur patologjia nëse pacientit do t'i ishte administruar një diagnozë/terapi e saktë.
- d. vlerësimi i probabilitetit që një pasojë e ndryshme e më e favorshme do të kishte ardhur²⁴.

Prandaj sipas Barnit lidhja shkakësore në patologjitë iatrogjene, nuk mund të quhet e vërtetuar bazuar thjesht në faktin se sjellja e mjekut ka qenë e përshtatshme për të shkaktuar atë lloj pasoje, por sepse vërtetohet se kjo sjellje ka ndikuar në ardhjen e kësaj pasoje, pra e ka shkaktuar atë. Për të arritur në këtë vlerësim, sipas Barnit nevojiten tre lloje dokumentacionesh, të cilat në vetvete trupëzojnë ligjet shkencore të mbulimit (kuptuar si norma që gjejnë zbatim në rastin konkret) e që konkretisht konsistojnë në:

- a. udhëzues që përcaktojnë në mënyrë të përgjithshme dhe bindëse diagnozën apo terapinë e saktë për rastin konkret.
- b. dokumentacion shkencor që provon nivelin e efektivitetit të diagnozës apo terapisë së saktë.
- c. kuadrot e referimit mbi zhvillimin e zakonshëm të patologjisë së diagnostifikuar në mënyrë të saktë për atë rast konkret apo të trajtuar siç duhet. Përfshihen këtu edhe kuadrot e referimit të mundësisë së pacientit për t'i mbijetuar patologjisë të bazuar në prognozë²⁵

²² De Ferrari, F., Palmieri, L., 2007, *ibid*, ff. 563-564.

²³ Barni, M., *Consulenza medico-legale e responsabilità medica - Impiego etico-scientifico in divenire*, Giuffrè, Milano, 2002, ff. 62 e vijim.

²⁴ Barni, M., 2002, *ibid*

²⁵ Barni, M., *La causalità materiale in medicina legale* siç është cituar nga Cannavò, G., Liguori, M., Orrico, M., *La responsabilità medica. Dalla teoria alla pratica processuale*, Maggioli, Rimini, 2011, f. 70.

Lidhja shkakësore në veprimtaritë e rrezikshme

Ushtrimi i profesionit mjekësor shpesh nënkupton ndërhyrje që çenojnë integritetin fizik dhe psikik të pacientit, sidomos në rastin e ndërhyrjeve kirurgjikale, të cilat legjitimohen përsa të prirura nga qëllimi i përmirësimit të gjendjes shëndetësore të pacientit apo lehtësimit të vuajtjeve të tij. Detyrimi për të marrë masa parandaluese gjatë ushtrimit të veprimtarive të rrezikshme të ligjshme parashikohet nga neni 622 i Kodit Civil, ku përcaktohet përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar të tretëve gjatë kryerjes së veprimtarive të rrezikshme ku rast përjashtimor është “kur (subjekti) provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit”²⁶.

Lidhja shkakësore te veprat penale të kryera nga pakujdesia

Sa parashtruar deri më tani mbi vërtetimin e lidhjes shkakësore është e përbashkët për veprat penale të kryera me të dy format e fajit, por në këtë seksion do të përqendrohemi posaçërisht në trajtimin e çështjes së vlerësimit të lidhjes shkakësore në veprat penale të kryera me pakujdesi, si një argument që paraqet interes të veçantë në kuadrin e përgjegjësisë penale të mjekut për mjekim të pakujdesshëm. Aftësia e një kushti për të qenë *conditio sine qua non* në ardhjen e pasojës është e kushtëzuar nga forma e fajit me të cilin kryhet veprimi apo mosveprimi: është e qartë në veprat e kryera me dashje, e vagët tek veprat e kryera me pakujdesi. Problemi me lidhjen shkakësore në veprat e kryera me pakujdesi në formën e neglizhencës, ashtu si edhe në ato të kryera me mosveprim, është vështirësia e përcaktimit se cili është shkak kryesor determinant. Lidhja shkakësore në veprat penale të kryera me pakujdesi vërtetohet kur sjellja (veprimi apo mosveprimi) nuk është shkak për ardhjen e pasojës, por thjesht një mundësi për shfaqjen e saj, atëherë kur pasoja penale është absolutisht e dukshme dhe si rrjedhojë është plotësisht e perceptueshme dhe e kuptueshme në tërë aspektet e saja dhe e evitueshme nga çdokush që tregon një kujdes normal (*diligenza*, it). Për të përjashtuar ekzistencën e lidhjes shkakësore mes sjelljes dhe pasojës duhet përcaktuar nëse pasoja do kishte ardhur pavarësisht nëse subjekti do të kishte vepruar me kujdes, maturi dhe përvojë (përkatesisht *diligenza*, *prudenza*, *perizia*, it.), të cilat janë norma të kujdesit parandalues të dëmtimit që duhet të ekzistojnë në një sjellje. Nuk është i mjaftueshëm vërtetimi i në lidhjeje shkakësore materiale mes sjelljes dhe pasojës, por është e nevojshme që të provohet një lidhje shkakësore juridike: pra jo vetëm pasoja të ketë ardhur si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të kryer nga subjekti, por edhe që norma e kujdesit që nuk është zbatuar ka qenë e përshtatshme për të shmangur ardhjen e asaj pasoje të padëshiruar. Kjo ka rëndësi sidomos në rastet kur pasoja prodhohet në një moment shumë më të vonshëm përkundrajt momentit të kryerjes së veprimit apo mosveprimit të mjekut, p.sh. pacienti vdes pas një muaji nga ndërhyrja mjekësore. *Teoria e kushtit (condizionalistica, it)* aplikohet edhe në rastin e veprës penale të kryer me pakujdesi, me veçorinë se këtu kërkohet që pasoja që rrjedh nga veprimi apo mosveprimi të jetë një konkretizim i atij rreziku që norma e kujdesit që është shkelur synonte të parandalonte²⁷. Kështu evitohet zbatimi i përgjegjësisë penale objektive që do të rezultonte nga vlerësimi i një lidhjeje thjesht materiale mes sjelljes dhe pasojës. Në vlerësimin e lidhjes shkakësore të veprave penale të kryera me pakujdesi, sistemi italian i referohet sërish kriterit të shmangies së pasojës: a do të ishte shmangur pasoja po të ishte zbatuar norma e kujdesit apo pasoja do të kishte ardhur gjithsesi? Fiandaca - Musco japin shembullin e një mjeku anestezist i cili gabon në administrimin e kokainës në vend të novokainës një pacienti gjatë një ndërhyrjeje kirurgjikale, pacient i cili vdes gjatë kësaj kohe. Më vonë vërtetohet se pacienti kishte një hipersensibilitet ndaj çdo substance narkotike dhe se do të kishte vdekur sidoqoftë,

²⁶ Barni, M., *La causalità materiale in medicina legale* siç është cituar nga Cannavò, G., Liguori, M., Orrico, M., *La responsabilità medica. Dalla teoria alla pratica processuale*, Maggioli, Rimini, 2011, f. 70.

²⁷ Fiandaca, G., Musco, 2004, ibid, f. 516.

pra edhe sikur t'i ishte administruar novokainë nga mjeku. Autorët hipotizojnë se përgjegjësia penale e veprimit të mjekut-anestezist mund të vlerësohet në dy shkallë²⁸: Vlerësimi *in abstracto* i mundësisë për ta shmangur pasojën do të ofronte një qartësi më të madhe sepse në thelb do konfirmonte se, sikundër ekziston një rregull sjelljeje me karakter shoqëror apo normativ që synon të parandalojë ardhjen e një dëmi, respektimi i kësaj norme do të kishte shmangur ardhjen e pasojës së dëmshme. Kjo zgjidhje do na çonte në fakt në përgjegjësinë objektive që konsiderohet si një teori e tejkaluar për kushtet e sotme. Vlerësimi konkret i mundësisë së shmangies së pasojës së dëmshme në vetvete nuk arrin të shpjegojë se për ç'arsye duhet të mungojë përgjegjësia penale për pasojën penale që do të kishte ardhur sidoqoftë.

Perfundim

Nga pikëpamja gjuhësore, folja “cënim” në vetvete sygjeron një veprim aktiv por nga pikëpamja juridike, cënimi i objektit juridiko-penal mund të kryhet si me veprim ashtu edhe me mosveprim. Këtu vihet re sesi e drejta penale përbëhet nga norma që ndëshkojnë veprime aktive e përpos këtyre, nga norma që ndëshkojnë të moskryerit e veprimeve të detyrueshme për t'u kryer. Këtë dualitet e zotërojnë edhe normat e së drejtës kushtetuese ku parashikohet mbrojtja e të drejtave pozitive, nëpërmjet kryerjes së veprimeve aktive nga subjektet e posaçme dhe të drejta negative, të cilat përcaktojnë detyrimin për të mosvepruar në ndërhyrje të gëzimit në liri të këtyre të drejtave. Vlerësimi i lidhjes shkakësore mes sjelljes së mjekut dhe ardhjes së dëmtimit në shëndetin e pacientit paraqet karakteristika të veçanta sepse në këto rrethana është tipike që të konkurrojnë shkaqe në fragmente kohe të ndryshme apo të njëkohshme, qofshin ato me karakter natyror apo veprime njerëzore. Kjo vështirësi amplifikohet sidomos në rastin e veprimit të mjekut psikiatër sepse është akoma më e paqartë mundësia për të përcaktuar nëse psikiatri duhej dhe kishte pasur mundësinë të parashikonte se pacienti i tij mund të kryente veprime lënduese ndaj vetes apo ndaj të tretëve. Kodi Penal ka përcaktuar shprehimisht *vetëdijen* dhe *vullnetin* si kriteret bazë për përcaktimin e fajit qoftë ai në formën e dashjes, qoftë në formën e pakujdesisë. Meqënëse në rastin e pakujdesisë përjashtohet të dëshiruarit e pasojës, duke analizuar dy kriteret e fajit deduktohen kriteret mbi bazën e të cilave do të vlerësohet nëse veprimi ka qenë i kujdesshëm apo jo, që konkretisht janë *parashikueshmëria* dhe *mundësia për shmangien e pasojës*. Po ashtu duhet që të harmonizohet e drejta materiale me atë procedurale penale përse i përket çështjes së detyrimit të mjekut për të raportuar një vepër penale.

References

- Elezi, I., *E drejta penale, Pjesa e posaçme*, Botime Erik, 2007.
Fiandaca, G., Musco, 2004
Marinucci, G., Dolcini, E., *Manuale di Diritto Penale (parte generale)*, Giuffrè, Torino
Stella, F., *Leggi scientifiche e spiegazione causale in diritto penale*, Giuffrè, Milano, 2000.
Crespi, A., Stella, F., Zuccalà, G., *Commentario breve al Codice Penale*, Padova, 1994
Kambovski Vllado, *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Furkan, 2010.
Romano-Grasso, *Commentario sistematico del codice penale*, 2004.
F. Mantovani, *Diritto Penale, parte generale*, Padova, 2007, fq.100
Rampioni, *Contributo alla teoria del reato permanente*, Padova 1988.
Muci, Sh., *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Botime Ora 2006.

²⁸ Fiandaca, G., Musco, 2004, ibid, ff. 516-518.

KONTRATATA PËR MENAXHMENTIN NË BIZNESIN BASHKOHOR-NATYRA JURIDIKE E KONTRATËS

1. **Prof.Dr. Armand Krasniqi**

Fakulteti Ekonomik - Universiteti "Hasan Prishtina" Prishtinë

armand.krasniqi@uni-pr.edu

2. ***PhD(c). Anita Cucović**

Universitet "Goce Delcev" Štip

anitacucovic@hotmail.com

ABSTRAKTI

Pjesa më e madhe e veprimtarive për bashkëpunim biznesor vendor e ndërkombëtar rregullohen me kontrata të menaxhmentit. Qëllimi i këtij punimi është të theksojë rëndësinë dhe natyrën juridike që ka kjo kontratë për rregullimin e transferimit të kompetencave për drejtimin e ndërmarrjeve biznesore nga pronari në profesionistë të cilat kanë njohuritë, përvojën dhe shkathtësitë e nevojshme, jo vetëm t'i sfidojnë vështirësitë e caktuara biznesore por ndërmarrjen ta shndërrojnë në një sistem të aftë konkurrues dhe mirë të pozicionuar në treg. Pavarësisht se në planin juridik kemi të bëjmë me një kontratë tipike jo formale me elemente komplekse, gjatë stuipimit të saj. Palët kontraktuale marrëveshjen e tyre jo vetëm që duhet të mbështeten në sistemin juridik të vendit, legjislacionin e zbatueshëm primar, por mbi të gjitha kanë detyrim të arrin një formë dhe përmbajtje e cila shpreh qartë dhe saktë qëllimin e kontratës kompatible me aktet të ndërmarrjes, vizionin dhe strategjinë që rregullojnë veprimtarisë e saj.

Fjalët kyçe: Kontratë, menaxhim, juridike, ligj, klauzolë.

Hyrje

Rishikimit të literaturës punim është mbështetur në tri burime. Në legjislacionin vendore; në të dhëna historike dhe në punime dhe kontribute të autorëve të njohur që temën e kontratave menaxheriale e kanë trajtuar dhe publikuar në revistat të rëndësishme profesionale e shkencore.

Metodat e hulumtimit: Në masë të vogël janë përdorur të dhëna historike sa për të sqaruar kohën kur janë faktorizuar kontrata menaxheriale. Metoda e analizës sistematike për t'i identifikuar llojshmërinë e burimeve juridike (jurisprudenca, akte ligjore, artikuj shkencor, libra universitar,) të gjitha këto për të nxjerrë përfundime të nevojshme. Metodën e analizës logjike për të nxjerrë përfundime duke u bazuar në rregullat e logjikës. Metodën e analizës teleologjike për t'i interpretuar klauzolat kontraktuale si dhe burimet e bazuara në qëllimin e tyre; Metodën e analizës komparative për t'i krahasuar qëndrimet e autorëve, dhe krahasimin e normave vendore me ato ndërkombëtare. Metodën e analizës filozofike për të interpretuar burimet juridike në frymën e filozofisë së drejtës. Metodën e analizës teorike e cila është përdorur për të interpretuar burimet juridike kontraktuale, si p.sh për të sqaruar përmbajtjet terminologjike të termave juridikë të kontrata e menaxhmentit.

Fjala menaxher në fjalor dhe në përkthim në gjuhën shqipe do të thotë eksperti dhe organizatori i cili me kreativitetin dhe idetë e tij menaxhon kompaninë, organizatën, klubin sportiv, etj (Bjetja, 1988). Drejtimi profesional i ndërmarrjes nga ana e menaxherit, subjektit i cili posedon njohuri dhe shkathtësi nga fusha të ndryshme të biznesit konsiderohet si njëri ndër faktorët me kritik që në realitet e determinon suksesin e të bërit biznes posaçërisht në kushtet e ndryshmeve, thelbësore më mjedisin biznesor, (në vendin tonë edhe në kushte e ndryshmeve pronësore dhe konceptin e ndërmarrësisë në kompani), rritje të konkurrencës në treg dhe pasigurisë.

Sipas konceptit klasik pronari e drejton ndërmarrjen dhe nga kjo pozitë është i pavarur të qeverisë me të gjithë segmente e biznesit. Në këtë mënyrë vihet në pozitë të krijoj fitim vetëm për vete në bazë të posedimit të njohurive dhe shkathtësive që ka. Rëndësia e menaxhmentit në mënyrë më të theksuar u paraqitet në kohën kur shfaqen mospajtimet në mes të funksionit të kontrollit dhe pronësisë (*“divorce of control and ownership”*), kryesisht kur prona në ndërmarrje korporatave ndahet në një numër të madh aksionarësh ndërsa kontrolli (drejtimi i veprimtarisë biznesore) u transferohet menaxherëve (Hilt, 2008).

Ndonjëri nga aksionarët për shkak të përqindjes të vogël të kapitalit aksionar, rrjedhimisht kishin edhe të drejta të vogla në votim në mënyrë që të ndikojnë në ndryshimin e menaxhmentit. Sipas modelit Gjerman – Japan, si rregull, kapitalin më të madh aksionar e mbajnë shoqëritë e sigurimeve, fondet e pensionale, investitorët institucional dhe bankat. Nga kjo pozitë aksionarët tipik janë të detyruar të pranojnë pozitë pasive të anëtarit në shoqëri (Brian L, 2010). Në këtë mënyrë formohet kategoria e menaxherëve, profesionistëve të paguar që të drejtojnë dhe zhvillojnë ndërmarrjen të cilët kanë mundësi që edhe t'i involvojnë qëllimet e veta (p.sh. rritjen e shitjeve ose krijimin e fitimit) për ndryshim nga qëllimet e aksionarëve që janë maksimalizimi i fitimit.

Kontrata e menaxhmentit

Me kontratën e menaxhimit nënkuptohet transferi i një pako dijes integrale (*operating know how*) nga pronari i ndërmarrjes në një subjekt të caktuar fizik – menaxher apo në grup menaxheresh ose ndërmarrjes menaxhere (menxhment operatorit). Kjo për shkak se në drejtimin e ndërmarrjes paraqiten një seri problemesh komplekse të natyrave afatgjata të cilat duhet kanë vështirësi të gjejnë zgjedhje me intervenime të vogla (ndryshimin e drejtuesve, angazhimin e konsulentëve ekonomik ose teknik, etj.). Në situata të tilla kur ndërmarrja ballafaqohet me probleme serioze të natyrave institucionale, organizative, kadrovike, të karakterit teknik – teknologjik financiar, njëri nga opsionet me risk të ulët për t'i shmangur këto efekte është angazhimi i të besuarve (me pagesë) të drejtojnë me biznesin dhe zhvillimin biznesor, në bazë të kontratës për menaxhmentin me subjekte të specializuara fizike ose juridike nën të drejtën udhëheqjes së politikave të përgjithshme nga këshilli drejtues i ndërmarrjes. Në anën tjetër, edhe operatori menaxherial si rregull siguron jo vetëm ofrim të njohurive dhe shkathtësive në mënyrë që t'u përgjigjet me sukses çështjeve specifike problematike në ndërmarrje (Goodrich, 2013). Në këtë aspekt operatori i menaxhmentit ofron edhe “kulturën” e vet korporatave, sistemin dhe metodat e veta drejtuese, teknikat e planifikimit, një stil unik menaxherial dhe filozofi të caktuar biznesore. Thelbi i asaj që “shitet” ka të bëjë me drejtimin e ndërmarrjes (*ability to run bussnes*) të kombinuara me njohuri të avancuara (*advanced knowlwdge*) në fusha të caktuara. Në realitet, këto shkathtësi të përgjithshme të drejtimit dhe përvojat në qeverisjen biznesore janë të rëndësishme vendimtare (*leis at the heart*) për zgjedhje e menaxherëve gjegjësisht ndërmarrjes menaxheriale dhe lidhje së kontratës menaxheriale (<http://smallbusiness.chron.com/differences-between-operating-agreement-franchise-agreement-25768.html>).

Në dyzet vitet e fundit në shumë vende të zhvilluara në planin ekonomik kontrata për menaxhmentin është shndërruar në një formë specifike të pranueshme të bashkëpunimit biznesor. Kjo kontratë zbatim të gjëra ka gjetur në veprimtaritë restorateske e hoteliere (Bader, 2007), transport, bujqësi, veprimtari të caktuara industriale dhe në përgjithësi në veprimtari të cilave ju duhet zhvillim e depërtim i shpejt biznesor (<https://www.agroparistech.fr/IMG/pdf/syn08-eng-Michel.pdf>, 2008). Institucionet qeveritare të vendeve në zhvillim dhe më pikëpamje për zhvillim të përsheptuar industrial i shfrytëzojnë kontratat për menaxhmentin me qëllim të “lirohen” nga drejtimi me problemet e caktuara të ndërmarrjeve publike duke arritur që të ruajtjen e pronësinë dhe ndikimit në ndërmarrje. Në këtë mënyrë kontrata për menxhmentin shndërrohet në instrument për reformimin e ndërmarrjeve publike (Hafees Shaikh., 1995). Në vendet e Evropës Qendrore dhe Jug-lindore me

qëllim të mbarëvajtjes së procesit të privatizimit pronësor kontrata për menaxhmentin është shfrytëzuar si instrument juridik efikas për transformimin e ndërmarrjeve sidomos kur ndërmarrjet e caktuara kanë kaluar në proces të strukturimit.

Kuptimi dhe natyra juridike e kontratës për menaxhmentin

Bashkëpunimi biznesor për shkak të favorëve që ofron kontrata për menaxhmentin është fenomen relativisht kuptim gjerë. Nga pikëpamja juridike kjo materie nuk është e rregulluar ligjërisht dhe e tërë kjo problematikë në mes të palëve rregullohet me kontratë. Edhe me tipizimin e praktikave biznesore (klauzole kontraktuale) këto kontrata paraqiten në masë të caktuar me përmbajtje të ndryshme në varësi të veprimtarisë (fushës) biznesore në kuadër të së cilave zbatohet. Prandaj, te këto kontrata pronari i ndërmarrjes operatorit të menaxhmentit ua beson kontrollin menaxheria për një periudhë të caktuar kohore në bazë të një kompensimi adekuat.

Kjo kontratë në literaturën juridike përcaktohet si marrëveshje me të cilën menaxhimi i një pune ose i funksioneve tjetër, që normalisht kryhen nga administrata, me kontratë transferohet në një subjekt juridik të pavarur që ka shkathtësitë dhe aftësitë të drejtë biznesin e një kompanie të caktuar për shpërblim. Përgjegjësitë e menaxherëve (menaxhimit) janë për të drejtuar biznesin e të gjithë ndërmarrjes ose një prej seksioneve të saj në të cilat ai merr vendime biznesore e financiare, kryen punët e përfaqësimit, çështjet e personelit, planifikimin dhe çështjet e marketingut. Varësisht nga natyra e aktiviteteve të saj, mund të jetë me natyrë komerciale ose teknike, por është çështje e menaxhimit aktual të biznesit dhe transferimit të (know – how) njohurive të menaxhimit të biznesit. (https://www.cips.org/documents/CIPS_KI_Contract%20Management%20Guidev2.pdf)

Një detyrim tipik i dhënësit të menaxhmentit gjithashtu është trajnimi i personelit në kompaninë e cila është marrë në menaxhim. Menaxheri e drejton biznesin në emër dhe në llogari të operatorit tij. Por kontrata përjashton rregullisht përgjegjësinë për rrezikun ndërmarrës ose rrezikun e biznesit, humbjen ose falimentimin. Menaxheri i marrësit (operatorit) të menaxhimit mbetet përgjegjës për operacionet financiare dhe kështu me radhë në atë masë sa është në gjendje të kryejë mbikëqyrje efektive.

Duhet nënvizuar se marrëveshjet e menaxhimit zbatohen edhe në praktikën e biznesit të transferimi i njohurive dhe përvojës për menaxhim të biznesit nga vendet e zhvilluara në vendet e pazhvilluara. Në praktikën e sotme të biznesit, transferimi i menaxhimit tek operatorët menaxherial të hoteleve dhe aktiviteteve të tjera të shërbimeve është zhvilluar në masë të madhe. Menaxherët rezidentë janë në përgjithësi ndërmarrje të mëdha shtetërore në prodhim ose aktivitete të shërbimit publik ose kompani private më të mëdha dhe më të pasura.

Marrëveshja e Menaxhimit është një kontratë me natyrë të vazhdueshme sepse zakonisht lidhet për një periudhë prej pesë deri në shtatë vjet dhe në kontratat e menaxhimit të hoteleve deri në njëzet vjet ose për një periudhë të pacaktuar kohe. *Daval Manager* merr përsipër të veprojë në përputhje me standardet më të mira profesionale, me vëmendjen e pronarit të ndërgjegjshëm dhe në interes të marrësit të menaxhmentit. Kontratat e këtij lloji përfshijnë kufizime të shumta dhe të gjera të përgjegjësisë për dëmshpërblimin e menaxherit.

Lidhur me natyrën juridike të kësaj kontrate mund të konstatojmë se, fillimisht kemi të bëjmë me një kontratë joformale sepse si e tillë nuk rregullohet nga dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve as nga ndonjë bazë tjetër ligjore. Kjo kontratë është një akt akordi në mes të palëve i bazuar në një partneritet të caktuar ku njëra nga ato ka vizion të qartë biznesi dhe gatishmërinë të për investuar para, dhe palës tjetër – menaxherit i cili pranon sfidën profesionale të të bërit biznes dhe vë në jetë vizionin e palës tjetër. Shikuar në kuptimin e pastër klasik kontratat menaxheriale janë kontrata *sui generis* në kuadër të marrëdhënieve të detyrimeve (Hegstad, 1987).

Kur në përdorim është një kontratë klasik ose e pastër e menaxhimit, atëherë nënkuptojmë një marrëveshje menaxhimi e konstituuar nga klauzola dhe dispozita me elemente të detyrueshme që duhet të dallohen nga kontratat e përziera kur ajo krijohet nga elemente të llojeve të shumta të kontratave. Kontratat me elemente të përziera menaxheriale në praktikë janë të shpeshta, mbase shumë më të shpeshta se sa ato të pastra. Shpesh hasim në kontrata të tilla me elemente të kontratave për veprën, kontratën për punën dhe nga një herë edhe elementet e kontratës për urdhrin.

Duhet theksuar se koncepti themelor i kësaj kontrate reflekton përcaktimin e transferim të kontrollit dhe kompetencave të plota menaxheriale të cilat më parë i ka pasur vet ndërmarrja e caktuar. Në anën tjetër, pronari mban në tërësi pronën, siguron mjete për biznesin e ndërmarrjes dhe paguan operatorin menaxherial (*menagment fee*) (Hsuan-Chu Lin., 2006). Përgjegjësia për veprimtarinë biznesore është në barrë të operatorit menaxherial (*operating responsibility*) ndërsa, si rregull, përgjegjësia financiare në barrë të pronarit.

Lidhja e kontratës për menaxhmentin

Klauzolat kontraktore zakonisht përcaktojnë se “Pronari, vetëm dhe ekskluzivisht (*“solo and exclusive”*), i lejon operatorit menaxherial të drejtën për kontroll dhe drejtim të veprimtarisë biznesore në ndërmarrje”. Qëllimi i klauzolave të tilla është që me përmbajtje të saktë terminologjike të rregullojë marrëdhëniet me kontratën e menaxhmentit në të cilën, si rregull, pronari paraqet anën pasive të kontratës ndërsa operatori menaxherial anën aktive të saj.

Operatori menaxherial merr përgjegjësi të plotë menaxheriale për drejtimin e veprimtarisë biznesore, si rregull nën rolin pasiv të pronarit, që kanë të bëjnë me politikat aktuale, procedurale, teknike – menaxheriale, etj.. Në fakt, besimi për kontrollin e biznesit dhe autorizimet për drejtimin e ndërmarrjes e bëjnë të dallueshme këtë kontratë nga kontrata për konsultingun e cila lëndë të rregullimit ka disa shërbime menaxheriale dhe ofrimin e ndihmës së caktuar teknike. Duhet theksuar se të kontrata për konsultingun, në tërësinë e saj, e rëndësishme është këshillëdhënia për mënyrën të arritjes të rezultateve të caktuara dhe kjo në varësi të cilësisë së këshillave dhe pranimit të tyre nga ana e atyre të cilët kanë kontrollin menaxherial.

Me kontratën e menaxhmentit krijohet marrëdhënie banesore (*business relationship*) në të cilat, sipas rregullit (Ray, <http://smallbusiness.chron.com/advantages-contract-management-service-24422.html> /), përfshihen tre subjekte:

1. Pronari i ndërmarrjes e cila është në “vështirësi”;
2. Operatori menaxherial i cili mund të jetë individ ose grup, gjegjësit në rastet me të shpeshta, një ndërmarrje e specializuar për këtë lloj veprimtarie; dhe
3. Vet ndërmarrja.

Kontrata për menaxhmentin mund të lidhet nga operatori menaxherial me pronarin e ndërmarrjes ose me vet ndërmarrjen. Nëse ndërmarrja “në vështirësi” është publike, atëherë ajo vet është palë në kontratë. Edhe ndërmarrja menaxheriale, në një kuptim të caktuar, paraqitet në marrëdhënie biznesore më shtetin i cili në këtë rast përfaqësohet nga këshilli drejtues i ndërmarrjes publike. Në këtë marrëdhënie kontraktuale – juridike janë dy palë kontraktuese të cilët rregullojnë alokimin e përgjegjësi (Trevor L. Brown., 2003) . Në këtë mënyrë, të kontratat menaxheriale të karakterit ndërkombëtar, roli i këshillit drejtues kufizohet në sferën e politikave të përgjithshme nën të drejtën për dhënien e lejeve për 0.

e mjeteve të ndërmarrjes, etj., Andaj, operatori menaxherial është përgjegjës biznesin aktual në kuadër të politikave të dhëna.

Çështja e natyrës juridike të kontratës së menaxhmentit varet edhe lidhur me faktin se operatori menaxherial a është agent i cili kontraktin për llogari të huaj, në mënyrë që përgjegjësia të konstituohet në parimet e agjencisë (agency) apo është kontraktor i pavarur (independent contractors) në mënyrë që përgjegjësia e palëve të përcaktohet sipas të drejtës kontraktore. Në mbështetje të të dhënave nga literatura dhe nga kontratat formulare mund të përfundohet se nuk kemi pikëpamje unike lidhur me këto koncepte dhe se nga praktika pranohen zgjedhje të ndryshme.

Harmonizimi i kontratës menaxheriale me aktet juridike të ndërmarrjes

Sikurse kontratat tjetra edhe kontrata për menaxhmentin, në varësi të rregullimit të marrëdhënieve dhe veprimtarive të caktuara biznesore, detyrimisht duhet të mbështetet edhe në sistemin juridik të vendit e në veçanti në aktet juridike të ndërmarrjes së caktuar. Nga ky kontekst del se të kontrata të menaxhmentit identifikohet në dy këndvështrime. E para, në element që precizojnë kompetencat dhe detyrimet e menaxherit dhe e dyta, dispozitat kontraktuale që rregullojnë çështjet e pagës dhe kompensimeve tjera të mundshme të menaxherit.

Kontratat e menaxhmentit lidhet në bazë të marrëdhënies ligjore të detyrueshme dhe përmbajtja e tyre duhet të bazohet në aktet e kompanisë. Kjo është veçanërisht e vërtetë për çështjet që lidhen me

shpërblimet e performancës, primeve të sigurimit, komisioneve, miratimit të kredisë, e kështu me radhë. Forma e kontratës nuk është e përcaktuar me ligj, që në mënyrë teorike nënkupton se një kontratë menaxheriale mund të jetë edhe verbale, por për shkak të kompleksitetit të përmbajtjes së asaj rëndësie e të drejtave dhe detyrimeve që ajo nënkupton, është e arsyeshme që të gjitha elementet e kontratës së menaxhimit të specifikohen në formë të shkruar.

Në kuptimin e punës – juridike pozita e menaxherit, kryetarit ose anëtar të bordit të një kompanie është e ngjashme me gjendjen e personave të zgjedhur ose të emëruar që kryejnë funksione në organet e pushtetit ekzekutiv. Është krejtësisht e natyrshme që statusi ligjor i menaxherëve që drejojnë ndërmarrjen, në një pjesë të saj të rregullohet edhe nga një kornizë ligjore detyruese të punësimit (Ligjit të Punës). Mirëpo, nuk është e mundshme që menaxherët në njëjtën kohë të kenë një kontratë pune dhe një kontratë të menaxhimit si vendin e punës. Kjo është çështje statutare dhe kjo pozitë rregullohet me vullnetin e lirë të palëve gjë që kontrata e menaxhimit në vet vete duhet të përcaktojë me saktësi elementet e marrëdhënies së punës.

Kontrata e menaxhimit është një lloj i sinteze e menaxhimit të energjisë dhe menaxhimit të pushtetit, apo dokument që është i bazuar në një partneritet në mes të atyre që kanë një vizion të veçantë të biznesit dhe një gatishmëri për të investuar para dhe menaxherë profesionistë, të cilët pranojnë sfidën e këtij vizioni të biznesit realizuar. Në parim, mund të thuhet se kontrata e menaxhimit e kontratës në fakt është një marrëveshje partneriteti në mes të atyre që zotërojnë një ide të biznesit dhe atyre që besojnë se ata janë në gjendje për të vënë këtë ide në një rezultat të mirë të biznesit.

Prandaj, kontrata e menaxhmentit rregullon përputhjen e vullnetit të të dyja palëve. Si i tillë është dokument që arrin të konstruktojë një sintezë të pushtetit profesionale të parave, fuqinë e dijes dhe fuqisë së partneritetit. Kontrata menaxhimit duhet të përcaktojë rregulla të biznesit midis palëve të përfshira dhe të parashikojnë skenarin e përgjithshme për çdo rezultat të mundshëm të bashkëpunimit të biznesit, duke përfshirë edhe mundësinë e ndërprerjes.

Përfundimi

Kontrata e menaxhmentit është marrëveshje specifike e të drejtës kontraktore që fare pak shfrytëzohet në praktikën tonë juridike – biznese. Si e tillë vlerësohet si akt marrëveshje jo formale dhe sui generis. Kjo kontratë është institucioni juridik mbi bazën e së cilës qeverisja, drejtimi dhe udhëheqja e një subjekti juridik, respektivisht ndërmarrja e caktuar, i besohet një subjekti tjetër juridik, respektivisht ndërmarrjes operatore (menaxhere). Me anë të kësaj kontrate subjektit të caktuar i besohet organizimi, udhëheqja dhe drejtimi i aktiviteteve të caktuara duke përfshirë këtu detyrime specifike për qëllimin dhe kriteret e menaxhimit dhe të kompensimit për punën e kryer. Kontrata për menaxhmentin bartë në vete autorizime të caktuara për drejtimin dhe qeverisjen e ndërmarrjes – subjektit juridik. Në këtë kontekst një ndërmarrjeje ose një subjekti të caktuar i bartet një ndërmarrje ose një subjekt tjetër juridik (menaxherin) nën menaxhim gjë e cila rrjedhimisht ka ndikim edhe në statusin e ndërmarrjes e cila qeveriset. Nga këto shkaqe, kontrata për menaxhmentin është e kreacioni i botës biznese moderne gjë që në vete përfshinë në një masë të caktuar të elementeve të kontratës mbi ofrimin e shërbimeve, elemente të kontratës për rregullimin statusor si dhe elemente të caktuara e të kombinuara të kontratave tjera siç janë ato të ekskluzivitetit, ligjit për të drejtat e autorit, të pronës, etj.,. Fusha e zbatimit të kësaj kontrate është e gjerë. Ato zbatohet në të gjitha degët e së drejtës por më së shumti në të drejtën biznese.

Në kushtet e ekonomisë globale dhe nën ndikimin e efekteve të konkurrencës, ndërmarrjet e ndryshme në vështirësi çdo herë e më shumë orientohen të angazhojnë operatorë të specializuar të cilat brenda vetës kanë burime njerëzore me aftësi, dije, informata, rrjete bashkëpunimi, shkadhitësh dhe përgatitje superiore nga sfera e menaxhmentit. Andaj, marrëdhëniet në mes të palës në vështirësi dhe atyre të specializuara, si në planin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar, më së miri rregullohen me kontratën e menaxhimit. Në Kosovë numri i këtyre kontratave është i vogël. Kjo për shkak të zhvillimit të dobët ekonomik, mungesës së kulturës së bashkëpunimit dhe angazhimit profesional dhe mbi të gjitha për shkak të dominimit të logjikës që pronari i ndërmarrjes të jetë edhe menaxher i saj pavarësisht nga fakti se a i posedon ose jo kapacitetin e nevojshme për një veprimtari të këtillë.

Pavarësisht se kemi të bëjmë me një kontratë tipike jo formale me elemente komplekse, gjatë lidhjes së saj, palët kontraktuale detyrimisht duhet mbështetën në sistemin juridik të vendit, legjislacionin e zbatueshëm primar e mbi të gjitha të arrin që formën dhe përmbajtjen e saj ta shprehin qëllimin e

kontratës i cili duhet të jetë kompatibil me aktet të ndërmarrjes, vizionin dhe strategjinë që rregullojnë veprimtarisë e saj.

Referencat

- Bader, E. (2007). Hotel management contracts in Europe. *Retail and Leisure property* , 171-179.
- Bjetja. (1988). *Fjalor i fjalëve të huaja*. Prishtinë.
- Brian L, C. R. (2010). Certo ownership as a form of Corporate Governance. *Management Studies*, 47-58.
- Goodrich, R. (2013). <https://www.businessnewsdaily.com/4813-contract-management.html>. Retrieved 2018, from <https://www.businessnewsdaily.com/4813-contract-management.html>
- Hafees Shaikh., M. M. (1995). *Management Contracts: a review of international experience* . Washington D.C.: World Bank.
- Hegstad, S. O. (1987, July 1). Management Contracts: main features & design issues. *Contract Management Guide* .
- Hilt, E. (2008, September). When did ownership separate from control? Corporate Governance in the early Nineteenth Century. *Economic History* .
- Hsuan-Chu Lin., T. -K.-G. (2006). Capital structure and managerial compensation contract design: theory and evidence. <http://smallbusiness.chron.com/differences-between-operating-agreement-franchise-agreement-25768.html> (n.d.). Retrieved 02 10, 2018, from <http://smallbusiness.chron.com/differences-between-operating-agreement-franchise-agreement-25768.html>.
- <https://www.agroparistech.fr/IMG/pdf/syn08-eng-Michel.pdf> (2008). Retrieved February 15, 2018, from <https://www.agroparistech.fr/IMG/pdf/syn08-eng-Michel.pdf> .
- https://www.cips.org/documents/CIPS_KI_Contract%20Management%20Guidev2.pdf. (n.d.). Retrieved February 16, 2018, from https://www.cips.org/documents/CIPS_KI_Contract%20Management%20Guidev2.pdf .
- Ray, L. (n.d.). <http://smallbusiness.chron.com/advantages-contract-management-service-24422.html> /. Retrieved February 02, 2018, from <http://smallbusiness.chron.com/advantages-contract-management-service-24422.html> /.
- Ray, L. (n.d.). *The advantage of the contract management service*. Retrieved February 02, 2018, from <http://smallbusiness.chron.com/advantages-contract-management-service-24422.html> /.
- Trevor L. Brown., M. P. (2003). Control management capacity in municipal and country government. *Public administration review*, 153-164.

ASPEKTET JURIDIKE TË LEGJISLACIONIT PENAL NË FUSHËN E KRIMEVE EKONOMIK NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

Dr. Adrian LEKA MSc-Universiteti "Luigj Gurakuqi,, Shkodër
leka-ad@live.com

. Fran Kaçorri -Fakulteti i Drejtësisë Akademia e Sigurisë
fkacorri@hotmail.com

MSc. Tonin Vocaj-Fakulteti i Drejtësisë Akademia e Sigurisë
vocajtonin@yahoo.com

ABSTRAKT

Arsyeja për përcaktimin e kësaj teme është më me rëndësi të veçantë, për shfaqjen e kriminalitetit ekonomik me këtë aktualitet, kur flitet për këtë anomali dhe qasja e krimit në shoqëri, Kosovë dhe Shqipëri jam munduar të detajizoj më në thellësi kontributin e ndërkombëtarëve (EULEX-it,) si dhe atyre vendorë. Rëndësia tjetër qëndron mbi luftën që është bërë dhe që është duke u bërë që kjo sëmundje e cila po e infekton vendin tonë dhe misionet e shumta që janë duke u ndërmarrë për ta parandaluar që të mos vë më tepër rrënjë në shtetin tonë. Rëndësia praktike e temës ka të bëjë me të kuptuarit sa më afër rëndësinë dhe rolin, kontributin që janë duke u munduar ta japin institucionet për kriminalitetin ekonomik. Në këtë hulumtim shkencor kam bërë përpjekje që sa më qartë që të studjojmë qështjet thelbësore rreth kriminalitetit ekonomik në Kosovë dhe Shqipëri. Në lidhje me këtë punim kam dashur të paraqes problematiken e kriminalitet ekonomik. Ndaj jam përpjekur në mënyrë më të qartë të bëjë një analizë dhe hulumtim në lidhje me aktualitetin dhe peshën që ka pasur dhe ka sot kriminaliteti ekonomik. Sepse kriminaliteti ekonomik është prezente në Kosovë dhe Shqipëri, dhe nuk po e lejon edhe aq sa duhet të zhvillohet shteti dhe të funksionoj në mënyrë që të progresohet dhe të jetë shtet funksional. Kosova dhe Shqipëria kanë shumë nevojë të kenë një përkrahje nga BE – për parandalimin e kriminalitetit ekonomik dhe krimit të organizuar që ka marr përmasa të larta dhe çdo ditë e më shumë po rritet dhe nuk po luftohet aq sa duhet nga institucionet tona vendore për arsye se nuk janë edhe aq mirë të pregatitur që të parandalohet ky fenomen negativ në shoqërinë tonë. Kjo temë jepë një përshkrim të rolit të institucioneve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare që çdo herë e më shumë po mundohen të luftonin dhe të kenë një efektë pozitiv mbi luftimin e këtij kriminaliteti. Një hulumtim i këtij lloji i jep një pasqyrim më në detaje institucioneve në Kosovë dhe Shqipëri.

Key Words: Legjislacioni penal, krimi ekonomik, institucionet, BE-ja, roli i Nderkombetareve dhe Kombetareve.

1. Panorama historike e lindjes dhe zhvillimit të kriminaliteti ekonomik

Shoqëria e Kosovës që nga viti 1999, ka hasur në tranzicione të ndryshme të të gjitha sferave, si në atë të shëndetësisë, kulturës, e më shumë në atë të ekonimisë, ku krimi i organizuar ishte i pranishëm. Pastrimi i parave, korrupsioni, kontrabanda ishin një ndër format më të popullizuara, të cilat kishin mbjell frikë dhe pasiguri tek qytetaret, prandaj interesimi i opinionit për krimin ka qenë permanent

ngaqe shoqërite njerëzore janë kacafytur me këtë dukuri të rrezikshme dhe përherë kanë bërë përpjekje ta pengojnë¹,edhe pse kishin filluar të themeloheshin institucionet vendore dhe ndërkombëtare siç është OSBE –ja, e cila u themelua në qershor të vitit 1999, pas përfundimit të luftës dhe heqjes së forcave Serbe nga territori i Kosovës nga këshilli i Përkoheshëm i OSBE- së, i cili vendosi që OSBE- ja brenda shtyllës së tretë të UNMIK-ut, të marrë rolin udhëheqës me çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e instucioneve dhe demokracisë, ky mision kishte sfida ndër më të rëndat në misionet e saja në një vend si Kosova, para dhe pas luftës, drejt ndërtimit të tij nga themelimi si politikisht dhe ekonomikisht, në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit të brishtë.² Këshilli i Sigurimit i Kombëve të Bashkuara me të parë këtë gjendje me 10 qershor 1999, miratoi (Rezoluten 1244) për vendosjen e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar – europian për të rivendosur stabilitetin dhe sigurinë për gjithë banorët e Kosovës pas përfundimit të luftës³. Dhe një prej planeve strategjike dhe si objektiv e tij ishte ekonomia, në bashkëpunim me Institucionet shtetërore Gjysmë Qeveritare.⁴Me finalizimin e shtetit me të pavarur, me 17 shkurt 2008, Kosova filloi të marrë kompetenca në të gjitha instucionet vendore, dhe në bashkpunim me EULEX-in hartuanstratëgjinë për parandalimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit i cili është bërë edhe temë e ditës, dhe e hasim kudo si në Kosovëpo ashtu edhe në Shqipëri.Tranzicioni shqiptar i gjatë dhe i vështirë u përball me sfida të shumta të medha dhe një ç’thurje të skajshme të një pjese të shoqërisë⁵.

Që prej fillimit të viteve 90’ dhe gjatë viteve të tranzicionit nga diktatura në një sistem demokratik, Shqipëria është përballuar me sfida të shumta, disa prej të cilave kanë qenë edhe lufta kundër krimit të organizuar, krimi ekonomik dhe financiar.⁶Grupet kriminale shqiptare në bashkpunim me organizatat ndërkombetare në vitin 1997, organizuan trazira, anarki deri në shpërbërjen e shtetit⁷. Kriminaliteti është dukuri shumë komplekse dhe dinamike që u përshtatet ndryshimeve shoqërore. Prandaj për luftimin me sukses dhe për parandalimin e kriminalitetit, përveç tjerash është e domosdoshme njohja e fushave të caktuara shkencore të cilat mundësojnë pasqyrim më të mirë të këtij fenomeni në të gjitha format e ndryshme dhe komplekse të shfaqjes se tij si dhe veprimi i suksesshëm në kuptimin e parandalimit dhe luftës së tij. Shkenca e së drejtës penale ka rol të jashtëzakonshëm në luftimin e kriminalitetit, pa të nuk do të mund të arriheshin rezultate të kënaqshme në luftimin e krimit të organizuar dhe kriminelëve të përgatitur e të paisur mirë, të cilët i shfrytëzojnë arritjet shkencore e teknike për kryerjen e veprave penale.

2. Fshehtësia e krimit ekonomik

Kjo karakteristikë e kriminaliteti ekonomik është e lidhur me pasojën e shkaktuar, kur kryhet vepra penale të ashtuquajturit të kriminaliteti klasik, pasojat janë me vetë kryerjen apo mos kryerjen e veprimit si psh te vrasja vet kufoma apo mungesa e viktimës (personit të vrarë) është evidente për familjen e tij, për mjedisin ku jeton, prandaj mund të thuhet se veprat penale e kriminaliteti ekonomik pasoja dhe kryesi janë të fshehta⁸.

Mirpo në luftimin e kriminaliteti ekonomik, për dallim prej atij klasik, fshehtësinë e kriminaliteti ekonomik e kushtëzon edhe personave të caktuar të ndërrmarjes punuse për zbulimin e saj. E kjo ndodhë në rastet kurë veprën penale e kryenin në bashkëpunimin disa persona të cilet ushtronin funksionet të caktuara nën ndërrmarjen.

2.1. Ndryshshmëria e formave të kriminaliteti ekonomik.

Pasi krimi ekonomik paraqitet mbi bazën e mardhënieve ekonomike – shoqërore, të cilat paraqesin një kategori mjaft dinamike, çdo ndryshim i shkaktuar në sistemin dinamik përcillet edhe me transformime gjegjëse në kuadër të kriminaliteti ekonomik i cili iu përshtatet formave të reja mardhënieve shoqërore dhe kushteve të reja që paraqiten në sistemin ekonomik⁹.

¹Dr Ragip Halili Kriminologji, Prishtinë, fq. 10, 2008.

²Roli i Bashkimit Europian në Kosovë para dhe pas statusit, tezë magjistature, Halim Bajraktari, fq. 19, 2009.

³Po aty, fq. 19.

⁴Po aty, fq. 31.

⁵www.juridiksi.e-monsite.com

⁶(<http://www.mbumk.gov.al/doc/VKM%20AKU.pdf>)

⁷http://www.kohajone.com/html/artikull_12602.html)

Kryersit potencial në menyre sistematike i kërkojnë zbrastit juridike në dispozita, akte të reja pastaj në masat dhe instrumentet ekonomike si dhe në situatat e posakrijuara. Kështu p.sh., në periudhën e menjëhershme të pasluftës kur kapacitet prodhuese nuk mundin t'i përmbushin nevojat e konsumit të gjërë, respektivisht kur kishte mungesë të mallrave në treg, ndër format më të shprehura të kriminalitetit ekonomik ishte ekonomia e palejuar.

3. Pluralizmi i formave të kriminalitetit ekonomik në Kosovë dhe Shqipëri.

Krimi i organizuar është një nga format më të ashpëra të kriminalitetit me të cilin po përballet shoqëria shqiptare.¹⁰

Krimi i oraganizuar përbën një rrezik madhor për demokracinë, rendin e së drejtës, të drejta e njeriut si dhe për progresin ekonomik dhe shoqëror ne Europë, viteve të fundit Kosova dhe Shqipëria jan pushtuar nga krimi ekonomik si dhe pushteti ekonomik, lidhje ndërkombëtare, metodat dhe taktikat e sofistikuara, si dhe impakti korruptiv që shoqëron këto krime.¹¹

Përveç Kosovës dhe Shqipëris, edhe vendet e rajonit u përballen me format e reja të krimit të organizuar që kishin lidhje me privatizimin dhe me sektorët bankarë dhe financiarë, të sapokrijuar, të ndjekur nga evazioni fiskal, mashtrimet në fushën e doganav, mashtrime në fushën e falimentimit, mashtrime në fushën e kredive financiare, korrupsion dhe pastrim parash¹².

Krimi i organizuar konsiderohet si kërcënim ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky kërcënim mund të manifestohet në forma të ndryshme, në varësi me zhvillimin e jetës ekonomike dhe shoqërore sidomos në kushtet e globalizmit.¹³

⁸ Dr. Haki Demolli, Kriminaliteti ekonomik në Kosovën e viteve të tetëdhjeta, Prishtinë, shtator 2009, fq. 63.

⁹ Dr. Dragolub Dorinavi, vepra e cituar, fq. 22; Dr. Haki Demolli, Prishtinë, 2008, fq. 22.

¹⁰ Dr.V.Hysi, Kriminologji, vepër e cituar, fq. 171.

¹¹ Nga projekti mbi raportin e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Europën Juglindore.

¹² Raportet mbi gjendjen e krimit të borganizuar krimit ekonomik në Europën Juglindore, 2006, fq. 52.

¹³ Strategjia shtetërore e Kosovës për luftën kundër krimit të organizuar, 2009 – 2012, fq. 6.

Krimi i organizuar mund të fus në dorë insitucionet bankare dhe në këto raste rreziku për ekonomin është i madhe, ky është edhe qëllimi i krimit të organizuar¹⁴. Kriminaliteti si veprimtari ekonomike është një formë e vaçant e kriminaliteti, e cila ka për qëllim përfitimin material ose të mirat të tjera, pavarësisht prej formës dhe vlerës së tyre. Tiparet kryesore të këtij kriminaliteti janë “shifra të errëta” dinamika dhe përshtatja me të gjitha ndryshimet ekonomike dhe normative. Pra, nocioni i kriminaliteti ekonomik i përfshin të gjitha format e aktiviteteve kriminale, të cilat janë orientuar kundër sistemit ekonomik kombëtar dhe funksionit të tij.¹⁵

3.1.Format dhe Vecorit e Kriminaliteti Ekonomik

Autor të krimeve ekonomike dhe krimeve të organizuar në ekonomi në shoqërinë bashkëhore rëndom nuk janë tipa asocialë ose nuk duken si të tillë, ata nuk përdorin dhunë fizike, siç përdorin rëndom kriminelet e dhunës klasike¹⁶. Esenca të këto veprime kriminale është fakti se kryesi i krimit shfrytëzon gjendjen e rëndë dhe kritike në të cilën ndodhen viktimat¹⁷. Ky kriminalitet në pjesën më të madhe është i ndërlidhur me njerëz në pushtet, pra me ata të cilët sipas pozitës obligimit ligjore janë të thirrur të luftojnë krimin¹⁸.

Ndër format më të avancuara të kriminalitetit ekonomik janë:

a) Korrupsioni

Format e vjedhes nëpërmjet mashtrimit të konsumatorëve

Kotrabanda dhe vepra penale në fushën e hetimeve

3.1.1. Korrupsioni

Ndoshta është tema më e perfolur në kohët e fundit në Kosovë dhe Shqipëri, flitet mjaft në opinion, bëhen sondazhe për të shkruar nëpër gazeta e bëhen komente edhe në mediumet e komunikimit masiv, bëhen debate ekspertësh për këtë temë nga ekspertet ku është angazhuar edhe shoqëria civile, të gjitha këto debate për korrupsionin që në Kosovë po vazhdon të rritet¹⁹.

¹⁴http://www.kohajone.com/html/artikull_12602.html.

¹⁵Dr. Mersida Sucëska, “Bazat e kriminalitetit ekonomik”, Prishtinë, 2006, fq. 16.

¹⁶Dr.Ragip Halili. Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq. 201..

Nga arkiva e lajemeve prej viteve 2006, 2007, 2010, Dervina, Korrupsioni mund të paraqitet në forma të ndryshme. Forma kryesore e korrupsionit të ne, siç e kemi përceptuar është mitoja (ryshfeti), që marrin pushtetarët për favorizimet që u bëjnë firmave private dhe individëve në shërbimet shtetërore. E veçanta e të gjithë korrupsioneve është se ato realizohen duke thyer normat, procedurat dhe ligjet e atij shteti, me qëllim përfitimi nga ana e kryesit të shërbimeve. Elementi i përbashkët i të gjitha korrupsioneve është se ato janë të ndërlidhura me pushtetin qeverisës, me njerëzit në pushtet, që kanë ndikim në vendimmarrje. Në të shumtën e rasteve përfitues nga korrupsioni janë kryesit e shërbimeve të pushtetit, që janë të obliguar të kryejnë punët, për të cilat paguhen me pagë shtetërore. Në disa raste nga korrupsioni kanë dobi edhe ata që u japin mito pushtetarëve për të realizuar qëllimet e tyre përfituese, që e bëjnë më të komplikuar këtë fenomen, dhe më të

vështirë për ta luftuar, sepse sipas ligjit në fuqi përgjegjësi juridike mban si marrësi ashtu edhe dhënësi i mitos (ryshfeti)

3.1.2.Karakteristikat themelore të korrupsionit

Dallojmë dy lloje të korrupsionit: korrupsioni aktiv dhe korrupsioni pasiv.

a. Korrupsioni aktiv

Ekziston kur dikush duke afruar ose duke dhënë ndonjë shpërblim, fiton privilegje për realizimin e ndonjë të drejte, kryen ndonje vepër penale ose ndonjë shtytje të ndonjë forme tjetër²⁰. Ky lloj i kriminalitetit penalizohet edhe me Kodin penal të Republikës së Shqipërisë neni 164/a; premtimi, propozimi ose dhënia drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të pa rregullt, për vete ose për persona të tjerë personit që ushtron funksionin drejtues në shoqri tregtare ose punon në çdo pozicion në sektorin private për të kryer ose moskryer një veprim në kundërshtim me detyren ose funksionin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet dhe me nga dyqind mijë deri në një million lekë ejt.Edhe në kodin penal socialist i Shqipërisë i viti 1977. Neni 106 – shpërdorimi i detyrës – kryerja me dashje e veprave që janë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës shtetërore a shoqërore ose moskryerja me dashje e detyrës, kur kanë sjellë pse dihej se mund t'u sillnin pasoja të rënda interesave shtetërore, shoqërore ose të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve dënohet; me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjerë në dhjetë vjet²¹. Neni 109 – Marrja e mitës në sajë të detyrës dënohet: me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet. Dhënia e mitës denohet me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në tre vjet²².

b. Korrupsioni pasiv

Ekziston kur dikush është në pozitë (zyrtare ose private) pranon ofertën, shpërblimin, interesin ose premtimin e dhuratave ose interesit me çka kryen vepër penale të mitos keqpordorimin të pozitës ose autorizimeve, bënë marrveshje të dëmshme bënë ndikim të dëmshëm kundërligjore ose ndërmjetesimin etj²³.Edhe sektorin pasiv e penalizon Kodi penal i Shqipërisë në nenin 164/b: kërkimi a marrja drejtëpërdrejtë ose tërthorazi i çdo lloj përfitimi të pa rregullt a i një premtimi të tillë për vete ose për persona të tjerë ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksionin drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose moskryer një veprim në kundërshtim me detyrën a funksionin e tij denohet me burgim nga 6 muaj deri në tre vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në tre million lekë.Përveç ndarjes, llojeve të aspektit juridik të korrupsionit, zakonisht bëhet edhe dallime kriminologjike të korrupsionit në: sektorin publik dhe privat.

3.2.Format e mashtrimit të konsumatorve

Format më të shpeshta të krimit, të mashtrimit të konsumatorëve kanë të bëjnë me kualitetet e artikujve ushqimorë përmbajtjen dhe cilësinë e tyre, në distribuimin e barnave dhe medikamenteve të rrezikshme, të cilëve ju ka kaluar koha, shitja e mallrave dhe artikujve pa garancion. Konsumatorët shpesh bëhen viktimë e krimeve të llojllojshme të mashtrimit dhelajthimit që ndaj tyre realizohen me anë të reklamave nëpërmjet informimit e veçmas në shtyp dhe televizion²⁴.

Konsumatorët janë të mashtruar më shumë në sektorin e ofrimit se sa në sektorin e prodhimit. Mashtrimi i konsumatorëve me anë të reklamave. Me datën 1 Prill zyra për mbrojtjen e konsumatorëve organizojnë një protestë kundër mashtrimit që ju bëhet konsumatorëve me anë të reklamave. Organizatorët e protestës jo pa qëllim zgjedhën datën 1 Prill, datën që simbolizon “gënjeshtrën”, për organizimin e protestës ku binin në sy tabelat të tilla si: Ujë 50 % zbritje, likuidim total etj. Që shpesh bie në ndeshje me realitetin ekzistues²⁵.

4. Masat për ndalimin dhe pengimin e krimeve ekonomike në Kosovë dhe Shqipëri.

Prania e kriminalitetit në shoqërin shtron nevoja për gjetjen dhe përcaktimin e masave për parandalimin dhe luftimin e tij.²⁶ Është fakt se nga kriminaliteti, si dukuri shoqërore negative nuk ka qenë dhe aktualisht nuk është immune asnjë shoqëri pa marrë parasysh kohën e veprimit të saj dhe pa marrë parasysh rregullimin shoqëror – politik të saj. Edhe sot çdo shoqëri njerzore e organizuar në shtet nëpërmjet institucioneve të ndryshme, ndërmerr masa preventive me të cilat synon të pengojë kryerjen e veprave penale. Në këtë drejtim është domosdoshmëri që shteti të angazhohet edhe në aspektin tjetër ‘represiv’ të reagimit të kriminalitetit.²⁷ Sa i përket veprave penale të cilat kanë dominuar d.m.th. numri më i madh i veprave ka qenë të falsifikimit të dokumentave zyrtare, shpërdorimi i detyrës zyrtare, dhënja e ryshfetit, shmangia nga tatimi, pengimi i personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, raste posaçme të falsifikimit si dhe legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë, ndërsa sa i përket veprave tjera të keqpordorimeve dhe shpërdorimeve të parasë publike përvetësimi gjatë detyrës zyrtare etj.²⁸

	<i>Vepra penale</i>	<i>Raste nen hetime</i>	<i>Rastetë dërguara në prokurori me kryes të njohur</i>	<i>Rastetë dërguara në prokurori me raport të veçanta nga hetuesi</i>	<i>Total raste</i>	<i>arrestime</i>	<i>Kallzim i v.p.te ngriturandaj personave</i>
1	Falsifikimi i dokumentit	5	2		7	1	3
2	Falsifikimi i parasë	15	18	24	57	5	22
3	Keqpërdorimi i besimit		2		1		
4	Kontrabandim		2		2	1	4
5	Kontraktim i përfitimit jo proporcional		1		2		1
6	Lidhja e kontrates së dëmshme	1			1		
7	Marrja e mitos			1	1		
8	Mashtrim	2	2		4		3
9	Mos lajmerimi i vepres penale	1			1		
10	Shpërdorim		1		1		1
11	Shpërdorim i detyrës zyrtare		2		2	1	2
12							
	Total	25	31	27	83	9	42

Statistika e rasteve (korrik – dhjetor 2008)
Gjashtë mujori i dytë 2008.

Kriminaliteti ekonomik sidomos pas luftës në Kosovë s ka qenë shumë i theksuar dhe i

përhapur në forma të ndryshme në mungesë të organeve dhe efikasiteti të tyre.

Për luftimin e këtij lloji të kriminaliteti nevojiten të mërrën dy lloje masash: preventive dhe represive.

4.1. *Masat preventive:* Me shprehjen e masave preventive kuptohet tërsia e veprimeve të cilat ndërmerren nga një rreth i gjerë i subjekteve shoqërore dhe qëllimi i përgjithshëm i tyre është pengimi i shfaqjes së kriminaliteti si dukuri socio – patologjike, ndërmjet eliminimit dhe luftimit të shkaqeve dhe kushteve që detirminojnë sjelljet kriminale.²⁹ Masat preventive që ndërmerren për të penguar kryerjen e krimeve janë të shumta dhe të llojllojshme dhe ato, në radhë të parë, duhet të ushtrohen nga vet shoqëria ndërmjet formave të emancipimit dhe të vetëmbrojtjes së vet.³⁰ Masat preventive si tërësi e veprimeve të cilat ndërmerren nga shteti dhe shoqëria kanë karakter te caktur.³¹

4. 1. 2. Llojet e masave preventive për luftimin e kriminalitetit të organizuar:

Masat preventive të cilat i dedikohen kriminalitetit janë të shumta dhe llojllojshme, ato kanë të bëjnë parasegjithash me eliminimin e faktorëve të kriminalitetit përfshirë atë të karakterit ekonomik – social, politikë, sociologjik etj. Si të tilla mund të klasifikohen në dy grupe:

- Masat me karakter të përgjithshëm – masa të parandalimit parësore dhe
- Masa me karakter të posaçëm – masa të parandalimit dytësorë.³²

Përveç këtyre masave preventive, sipas prokuroris nevojiten edhe këto lloj masa preventive për luftimin e krimit ekonomik: kualifikimi i kuadreve të reja dhe të afta, dhe të pa kompromentuar përforcimi i këtyre organeve me numër adekuat të prokurorve, gjyqtarëve, policëve etj.

Vetëdijësimi popullatës për lajmërimin e këtyre veprave e sidomos marrjes së ryshfetit, hartimin i infrastruktures ligjore sidomos ligji për konfiskimin e pasurisë të përfitur me anë të këtyre veprave. Vetëdijësimin e klasës udhëheqëse të Kosovës etj.³³ Masat preventive të cilat i referohen parandalimit të kriminalitetit të organizuar, janë të shumta dhe të llojllojshme, për parandalim e sukseshëm të këtij lloji të kriminalitetit, rëndësi të madhe ka njohja e shkaqeve dhe kushteve favorizuese të tij, si dhe roli i shtetit dhe shoqërisë në realizimin e reformave shoqërore – ekonomike e politike ndikojnë në menjanimin e këtyre shkaqeve dhe në parandalimin e kriminalitetit.

4.2. *Masat represive* - Represioni është forma tjetër e reagimit të shoqërisë ndaj kriminalitetit, kjo punë u është besuar kryesisht organeve dhe organizatave në radhë të parë atyre shtetërore (policisë, prokurorive publike, gjykatav, organeve të ekzekutimit të dënimeve)³⁴

Masat represive si tërësi e veprimeve të cilat ndërrmerren nga ana e subjekteve konkrete kanë karakter të caktuar, karakteri i këtyre masave është represiv i dhunshëm në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi dhe të kriminalitetit të organizuar në veçanti. Masat represive janë të parashikuara me ligj dhe si të tilla kanë për qëllim mbrojtjen e vlerave të njeriut dhe shoqërisë nga veprimet ose mos veprimet kriminale.³⁵

4. 2. 1. Masat represive dhe roli i tyre në luftimin e kriminalitetit të organizuar:

Masat represive të cilat ndikojnë në çrrënjosjen e kriminalitetit janë të shumta, ato kanë të bëjnë parasegjithash me procesin e inkriminimit të sjelljeve të caktuara, me zbulimin e krimeve dhe të kryerësve të tyre dhe me ekzekutimin e sanksioneve penale.³⁶

Shqyrtohen dhe elaborohen vetëm këto dy lloje të masave:

- Politika e zbulimit dhe e ndjekjes penale të kryerësve të kriminalitetit të organizuar.
- Politika e aplikimit të dënimeve ndaj kryerësve të kriminalitetit të organizuar.³⁷
-
-

Konkluzionet

Krimi ekonomik në Kosovë është prezent e sidomos ai korrupsionit është shumë real, dhe po e pengon zhvillimin dhe progresimin e Kosovës, e po i ndalon investimet e huaja që të bëjnë investime në vendin tonë, gjë që është shumë e rëndësishme për zhvillimin dhe krijimin e vendeve të reja të të punës për rinin tonë. Korrupsioni është më shumë i theksuar dhe me i vrazhdë në ato vende dhe institucione publike ku edhe të ardhurat janë më të medha dhe keqpërdorimet janë më të lehta. Në shumë raporte, deklaratat dhe në intervista të opinionit të gjërë, korrupsioni është më shumë i theksuar në atë të shëndesishë. Pavarësisht që janë duke u bërë shume përpjekje nga ana e agjensionit kundër korrupsionit dhe policisë por gjuqtori nuk është duke bërë punë edhe aq për parandalimin e këtij fenomeni në Kosovë, sepse është më tepër i varur nga politika. Në Kosovë duhet të ketë më tepër denime më të ashpra në krahasim me ato që janë aktualisht, për personat që keqpërdorin pozitën e tyre. Për personat që janë të kyqyr në segmente politike të shqyrtohen denime apo suspendime me qëllim mos lejimin, apo mos dhënjën e hapesirës për t'i përsëritur të njëjta krime apo të njëjta keqpërdorime. Mos t'iu jepet hapesirë që me kurrizin e taksapagësve të arrijnë qëllimet dhe përfitimet e caktuara personale. Ligji për deklarimin e pasurisë, për personat zyrtar mendoj që duhet të ekzistoj edhe lidhi për në rast deklarimi i pasurisë së rremë, të penalizohen dhe të jetë vepër penale krahas këtyre ligjeve duhet të ekzistojë dhe të jetë në fuqi edhe ligji për sekustrimin e pasurisë. Pra krimi ekonomik është

dhe vashdon të jëtë prezent. Arsye e vetme e kësaj është neglizhenca dhe papërgjegjësia institucionale në ato vende ku edhe korrupsioni është më tëpër i pranishëm. Në këtë temë me shqyrtimet teorike dhe praktike, nga mendimet e shumë autorëve dhe nga mendimet e mija mundë t'i nxjerrim këto konkluzione, që do ta paraqesim në vijimë.

E para - Kriminaliteti ekonomik ka të bëjë pikërisht me lindjen e krimit dhe zhvillimit të tij, ku njerëzimi çdo herë ka qenë i frikësuar se një gjë e keqe mundë të ju ndodhë, dhe t'iu shkaktohet shumë dëme materiale me të cilat varet edhe vet jeta e njeriut. Tmerri dhe frika që kan pasur çdo herë populli si në epokën tonë dhe në kohërat e lashta ka qenë krimi i organizuar i cili është manifestuar në forma të ndryshme. Lindja e krimit ka pasur këtë qëllim, që të zhvillohet dhe të depërtoj në vendet më të ndishme ku edhe funksionon shteti.

E dyta - Krimin ekonomik, çdo kod dhe ëdo legjislacion është munduar në mënyrë më të përsosur që të penalizoj kryesit e krimeve ekonomike, si Kodi i Kosovës edhe ai i Shqipëris, kanë kaptina në vete ku kryesit e krimeve ekonomike janë të kufizuar në veprimet e tyre, mirpo sipas mendimit tim dhe një analize të gjerë që kam bërë, e kam vënë re se nuk është duke u zbatuar edhe aq sa duhet, nuk është duke u përfilluar aq sa duhet, ligji në punët praktike. Sepse, ka aq shumë kryes të krimeve ekonomike si Kosovë dhe Shqipëri, sa të gjitha krimet po mbeten si numer i 'errët' për policinë e vendit tonë.

Unë mendoj se për të qen me efikas zbatim i i ligjit, si në Kosovë dhe Shqipëri, duhet të vëhen sa me shumë kontroll dhe mbikqyrje në ato vende, institucione, administrata, në sektoret private, në dogana, pikërisht në ato vende ku edhe depërton krimi ekonomik pa asnjë vështirësi dhe është shumë prezent. Edhe pse në dy vjete e fundit janë duke punuar më tepër në zbardhjen e mistereve 'të pasurive' të pa fund të shumë udhëheqësve tonë, që janë në krye të pushtetit dhe udhëheqin shtetin tonë, por kjo nuk mjafton për ta penguar kriminalitetin ekonomik.

E treta - Krimi i organizuar dhe kriminaliteti ekonomik në Kosovë dhe Shqipëri është çdo ditë e më shumë në rritje dhe qëllimi i krimeveve profesional është përvetësimi i mjeteve me qëllim të përfitimeve. Për parandalimin e krimit të organizuar nuk është punuar aq sa duhet, nuk janë ndërmarr aq shumë tentime për ndalimin e këtij fenomeni negativ që ka qenë prezente dhe është në shoqërinë tonë, krimi i organizuar ka marr një hovë të madhë të lulezoi që nga viti 1999 në Kosovë kurse në Shqipëri 1997, dhe unë mendoj se një shtet funksional nuk duhet të lejoj që krimi të ecë paralel me shoqërinë civile, sepse nuk do të ketë shoqëri të shëndosh nëse krimi është udhëheqës. Shumë pak janë dukë u marrë më këtë lëmi institucionet tona vendore, ka shumë debate, emisione dhe hulumtime shkencore, me të cilat mundohen ta bindin shoqërinë; se krimi nuk është dominant në vendin tonë, por përkundrazi sa më shumë sondazhe dhe raporte që janë bërë e kanë treguar të kundërtën se krimi është prezente në shoqërinë civile dhe në institucionet tona.

E katërta - Krimi ekonomik në vështrim të posaçëm është kategorizuar në format e veçanta dhe nuk dallon shumë nga kapitulli i mëparshëm. Te krimi i organizuar dhe ai ekonomik çdo herë ka ekzistuar dhe ekziston një hierarki, ku në krye të organizates e kanë bossin e tyre dhe ushtaret zakonisht janë në shërbim të tyre, qëllimi i tyre dhe krejt punën që e bajnë kriminelet e organizuar është se aktivitetet e tyre të pista, t'i kthejnë në mënyrë të pastertë, përfitimet që i kanë fituar në mënyrë legale t'i bëjnë që të qarkullojnë në mënyrë legale siq janë: pastrimi i parave dhe falsifikimi i tyre.

Unë i kam cekur edhe gjatë punimit, se shteti është ai i cili nuk po ju vë kufi aq sa duhet krimeveve, nuk po jua mbyll duert sa duhet krimit, prandaj edhe ai po ecën qetë në vendin tonë dhe nuk ka një ndonjë frikë se do të pengohet, kurse qytetaret e vendit tonë po jetojnë me këtë tmerr dhe pasiguri.

E pesta - Krimin ekonomik, ndihmë të madhe i kanë dhënë edhe instrumentet ndokombëtare, aktet, dokumentat, konferencat të cilat janë miratuar dhe janë mbajtur vetëm e vetëm për një qëllim luftimin dhe pengimin e deportimit të kryesve të kriminalitetit ekonomik në sektoret private dhe ato publike, si pasë Konventave Ndërkombëtare dhe OKB-së nuk lejohen asnjë keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe privilegj në detyrën zyrtare ku edhe pikërisht krimi është në rritje. Ku qëllimi i tyre është pengimi i këtij realizimi. Qëllim tjetër i ndërkombëtarve është që vendi mos të vuaj nga kjo anomali, të jetë një shtet i pastër dhe sa me shpejt të ju hapen edhe dyert drejt Bashkimit Europian (BE), sepse Kosova nuk mundë të futet në BE nëse, shteti ka probleme ekonomike.

E gjashta - Element kryesorë si në praktikë dhe në teori, është me karakteristik te krimi ekonomik, është koha në të cilën kryhet krimi dhe vendi në të cilin kryhet. E veçant tjetër e këtij krimi është edhe gjendja sociale në të cilën kryhet krimi, ndikon shumë gjendja sociale që t'i nxitë kryesit të kryejnë dhe të pajtohen me aktivitetet kriminale. Por jo vetëm gjendja sociale është

arsye e kryerjes së krimit sepse persoant që janë të kyçur ne segmente e jetës politike, ata me tepër janë të prirur të kryjnë krime ekonomike, sepse i nxitë lakmija, i joshë shumë ngritja në pushtet. Për këtë arsye, udhëheqesit tonë, nuk kontribojnë edhe aq sa duhet për shtetin tone, sepse primare e tyre është ngritja në poste të ndryshme, e pastaj e mira e popullit. Kjo dukuri i lë pasoja të medha ngritjes dhe ecjes përpara vendit tonë, ky fenomen nuk e le të rimokëmbet shtetin.

E shtata - Masat për parandalimin e krimit ekonomik, në Kosovë dhe Shqipëri luajnë një rolë të rëndësishem, nëse funksionojn ashtu si duhet për të funksionuar, masat represive dhe preventive janë shumë të rëndësishme që krimi mos të ketë mundësi të zhvillohet dhe të futet në segmentet e jetës shoqërore të qytetarëve të Kosovës dhe Shqipërisë.

Burimet dhe Literatura

1. Dr Ragip Halili Kriminologji, Prishtinë, fq. 10, 2008.
2. Roli i Bashkimit European në Kosovë para dhe pas statusit, tezë magjistature, Halim Bajraktari, fq. 19, 2009.
3. Po aty, fq. 19.
4. Po aty, fq. 31.
5. www.juridiksi.e-monsite.com)
6. (<http://www.mbumk.gov.al/doc/VKM%20AKU.pdf>)
7. http://www.kohajone.com/html/artikull_12602.html)
8. Dr. Haki Demolli, Kriminaliteti ekonomik në Kosovën e viteve të tetëdhjeta, Prishtinë, shtator 2009, fq. 63.
9. Dr. Dragolub Dorinavi, vepra e cituar, fq. 22; Dr. Haki Demolli, Prishtinë, 2008, fq. 22.
10. Dr. V. Hysi, Kriminologji, vepër e cituar, fq. 171.
11. Nga projekti mbi raportin e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Europën Juglindore.
12. Raportet mbi gjendjen e krimit të borganizuar krimit ekonomik në Europën Juglindore, 2006, fq. 52.
13. Strategjia shtetërore e Kosovës për luftën kundër krimit të organizuar, 2009 – 2012, fq. 6.
14. http://www.kohajone.com/html/artikull_12602.html.
15. Dr. Mersida Sucëska, “Bazat e kriminaliteti ekonomik”, Prishtinë, 2006, fq. 16.
16. Dr. Ragip Halili. Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq. 201.
17. Po aty, fq. 198.
18. Po aty, fq. 201.
19. Nga arkiva e lajemve prej viteve 2006, 2007, 2010,
20. Dr. Mersida Sucëska, Bazat e kriminalitetit ekonomik, Sr – Pr, 2006, fq. 135.
21. KPSH, viti 1977, fq. 52.
22. Po aty, fq. 52.
23. Dr. Mersida Sucëska, bazat e kriminaliteti ekonomik, fq. 136.
24. Dr. Ragip Halili, Kriminologji, Prishtinë, 2005, fq. 13.
25. <http://onworldwse.org/sq/nade/14741>.
26. Dr. Ali Bajgora, Disa karakteristika të kriminalitetit dhe politikës ndëshkimore në Kosovë, Prishtinë, 2001, fq. 20.
27. Dr. Ejup S & Ismail Z. E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonis, Tetovë, fq. 1.
28. Prokuroria Publike e Komunës Ferizaj 13.10.2010

E DREJTA ZAKONORE DHE FENOMENI I GJAKMARRJES

Prof..ass.Berat Aqifi

University "KADRI ZEKA", Gjiilan

Senior Lecture PhD Ardian Emini²⁹

College Universum Pristina

Abstract:

Ky punim përmban një përmbledhje, kronologji dhe analizë të një procesi specifik të cilin e ka pasë në përgjithësi shqiptaria siç është specifika e gjakmarrjes e cila është njëri prej problemeve tipike dhe mjaft aktuale të popullit shqiptar. Fokusi kryesor i analizës është zhvillimet e pajtimeve të gajqeve në Kosovë në periudhën kohore 1990-1991, implikimin e palëve të dyta dhe të treat në këto zhvillime të pajtimeve të gajqeve dhe efekti i kanunit të Lekë Dukagjinit dhe implikimet tjera socio kulturore për zberthimin e konflikteve ndërnjerezore që mbështetje gjenë të drejta zakonore. Specifikisht theks të veçanë vejet me sensibilizimin e shoqërisë me fenomenin e pajtimit të specifikisht e gjithë kjo arrihet mbi iniciativën e rinisë studentore intelektualeve shqiptare dhe klerit fetar në Kosovë. Njëherë vërehet edhe ndjenja kombëtare e veçanërisht ndjesja patriotike të të gjithë faktori shqiptarë, e cila pasqyrohet specifikisht në masovizimin e levizjes për pajtim si një mjet unifikues i çështjes shqiptare.

Fjalët çelës: Kanuni, e drejta zakonore, pajtimi, gjakmarrja.

1. Gjakmarrja tek Shqiptarët

Në vitin 1909, Edith Durham pohonte se "Gjëja më e rëndësishme në Shqipërinë e Veriut është gjakmarrja, e cila, në fakt, ka të bëjë me idenë e vjetër të vetëpastrimit të gjakut...Gjithçka tjetër i nënshtrohet asaj"³⁰. Në fakt, edhe pse rregullat e gjakmarrjes përbënin vetëm një pjesë të vogël të së drejtës zakonore, ose të Kanunit të Lekë Dukagjinit, siç e njohim sot atë përmes veprës së Shtjefën Gjeçovit, thjesht një kapitull (Kreu 22), ato dominonin krejt jetën e malësorëve të veriut, për shkak se, siç shkruante Durham, në filozofinë jetësore të malësorëve "gjithçka kthehet në gjak". Pjesa tjetër, e cila kishte të bënte me jetën e përditshme dhe nuk ishte e lyer në gjak, ishte e lidhur pazgjidhshmërisht me pjesën e gjakut në një mënyrë të tillë që, siç shkruan Ismail Kadare, është e vështirë të thuhet se ku mbaronte një pjesë dhe ku fillonte tjetra. Sipas Kadaresë. "Gjithçka ishte krijuar në një mënyrë të tillë që ato të pillnin njëra-tjetrën, e papërgjakura të lindte të përgjakurën dhe

²⁹ Senior Lecture PhD in College Universum Pristina, ardian.emini@yahoo.com

e përgjakura të papërgjakurën e kështu gjithmonë, nga koha në kohë e nga brezi në brez”³¹. Kanunet shqiptare janë pak a shumë të njëkohshëm, krijimi i tyre nuk mund të lidhet me një datë të caktuar. Kanunet janë produkt i një shoqërie parashtetërore, kur e drejta kanunore ishte e vetmja e drejtë që rregullonte jetën. Jeta bëhet e ashpër jo vetëm me kuptimin e përballjes me natyrën, por edhe të njerëzve me njëri tjetrin e cila karakterizohet nga një konkurrencë e vazhdueshme, të cilës një i vetëm nuk mund t’i bënte ballë. Kështu lindi për herë të parë grup-fisi që mbrohet bashkë, punon bashkë dhe i bën ballë i bashkuar jetës. Në këtë mënyrë ata mbronin pasurinë interesat e tyre. Në këtë kohë fillon ekzistencën dhe jetën e saj një shoqëri pa autoritet shtetëror, që e rregullon jetën duke zbatuar traditën, duke saksionuar rregulla dhe ligje të caktuara që kufizojnë lirinë e njeriut si individ sepse një individ i fortë do të privonte të tjerët nga liria³². “Le të bashkohemi për të mbrojtur të dobtin nga shtypja, të ndalojmë dhe të kufizojmë ambiciozët dhe t’i sigurojmë çdokujt pronën që i takon; le të bashkojmë forcat në një fuqi të epërme, e cila mund të na qeverisë me ligje të urta, të mbrojë të gjithë anëtarët e shoqërisë, të zbrapsë armiqët e përbashkët dhe të ruajë harmoni të përvetshme mes nesh”³³. Shoqëria pa autoritet shtetëror nuk është një shoqëri arkaike, që zhduket shpejt e shpejt nga faqja e dheut, por një shoqëri me një sistem vlerash të përcaktuara e të vetëpërvetësuar, qënësish ekuivalente por edhe në antitezë me sistemin e vlerave të një shoqërie me autoritet shtetëror³⁴. Kur formësohet një pushtet i shëndoshë shtetëror, me autoritetin e duhur, i cili është i aftë për të imponuar vendime gjyqsore e për të ndëshkuar fyesin apo dhunuesin, atëherë njerëzit kanë vullnetin dhe janë të gatshëm t’ia delegojnë të drejtat e hakmarrjes një pushteti apo autoriteti të tillë. Sa herë që dobësohet apo venitet ky autoritet, njerëzit janë të prirur e të etur të marrin në dorë të drejtat e hakmarrjes e cila çon në rilindjen e sistemit të vlerave të një shoqërie pa autoritet shtetëror³⁵. Kur thuhet se kanuni ka evoluar, nuk kemi parasysh vetëm evoluimin e zgjidhjeve që pasuronin fondin e të drejtës, por edhe krijimin e vazhdueshëm të institucioneve të reja dhe përsosjen e atyre ekzistueseve. Sigurimi i jetës së njeriut është problemi i parë me të cilin është marrë kanuni. Instituti i parë i kanunit është gjakmarrja që kishte të bënte me sigurinë e jetës³⁶. Gjakmarrja është pjesa më e rëndësishme e kanunit pasi kemi të bëjmë me jetën e njeriut. Gjakmarrja është një fenomen kulturor. Ndërsa hakmarrja është një pulsion i egër human³⁷. Në dorëshkrimet e Nopçës që përgjithësisht shkrimet e tij kanë vlera shkencore gjakmarrja me hakmarrjen ngatërrohen rregullisht. “Gati gjysma e vrasjeve të përvitshme në Shqipëri bëheshin për hakmarrje dhe megjithatë këtë duhet që hakmarrja të cilësohet si një institucion mirëbërës në këtë vënd pa autoritet”³⁸. Përmbi këtë pikë kanë qenë të një mendimi kompetentët në çështjet e Shqipërisë. Clarisa de Waal shkruan “Një shembull i qartë i largimit nga synimi fillestar i kanunit për ta kufizuar gjakmarrjen është paafësia që vihet kohët e fundit për të dalluar hakmarrjen nga gjakmarrja. Gjakmarrje do të thotë të marrësh gjak, kurse hak të lash një borxh. Kanuni thotë se “gjaku për faj nuk jet, pra një krim nuk mund të shlyhet me gjak”³⁹. Përkufizimi i saj për gjakmarrjen është i gabuar “Gjakmarrje do të thotë të marrësh gjak, kurse hak të lash një borxh”⁴⁰. Gjakmarrja në Shqipëri vazhdoi më gjatë për shkaqe historike, shoqërore, ekonomike, arsimore e psikologjike. Kjo dha shkas që të merren me këtë temë shumë studiues e shkrimtarë, duke e trajtuar në mënyra të ndryshme deri haptazi antishqiptare, duke e shpjeguar si “tipar biologjik të shqiptarëve”. Këto opinione u hodhën

³¹<http://www.mapo.al/2015/02/simbolika-e-gjakut-kujtesa-kolektive-dhe-e-kaluara-si-invadim-i-se-tashmes/1>
“Simbolika e gjakut, kujtesa kolektive, dhe e kaluara si “invadim” i së tashmes” Fatos Tarifa, PhD.

³²<http://www.mapo.al/2015/02/simbolika-e-gjakut-kujtesa-kolektive-dhe-e-kaluara-si-invadim-i-se-tashmes/1>

³³Xhaferr Martini “Kanuni I Dibrës” Tiranë- Emal 2007, fq 187,188.

³⁴Kazuhiko Yamamoto “Struktura etike e të drejtës zakonore shqiptare “Shkodër : Qendra "Drejtësi dhe Paqe", 2001,fq 172 .

³⁵Xhaferr Martini “Kanuni I Dibrës” Tiranë- Emal 2007 “,fq ,191.

³⁶“Gjakmarrja si “veçori” kombëtare, dhe ngatërresa që i bëhet me hakmarrjen” Mustafa Nano gazeta “Shqip”, 21 Shtator, 2012.fq.4.

³⁷Gjakmarrja si “veçori” kombëtare, dhe ngatërresa që i bëhet me hakmarrjen” Mustafa Nano,gazeta, Shqip, 21 Shtator, 2012.

³⁸Gjakmarrja si “veçori” kombëtare, dhe ngatërresa që i bëhet me hakmarrjen” Mustafa Nano, gazeta, Shqip, 21 Shtator, 2012.fq.4.

³⁹Kanuni i Lekë Dukagjinit, Parathanie, Bot. 2001, fq.27,30.

⁴⁰Kanuni i Lekë Dukagjinit, Parathanie, Bot. 2001, fq.27,30

poshtë me argumente bindëse nga poeti, shkrimtari kombëtar At Gjergj Fishta, në parathënien e Kanunit të Lekë Dukagjinit, duke sqaruar se gjakmarrja në Shqipëri ka qenë mjet i vetëmbrojtjes në kushtet kur nuk kishte shtet e ligj që ta mbronin njeriun⁴¹. Në mbrojtje të kulturës juridike shqiptare, për gjakmarrjen ka shkruar edhe shkrimtari i shquar Ismail Kadare. Duke iu referuar trilogjisë “Orestia” të Eskilit ai shkruan, se: “Trilogjia e Eskilit Orestia, vepra më e plotë dhe më e bukur në tragjedinë antike, është ndoshta dëshmia më bindëse për ekzistencën e nënshtrimit kulturor iliro – shqiptaro – grek⁴². Në atë vepër të rrallë motivi i gjakut dhe i gjyqësisë zhvillohet në atë kohezion si në të drejtën zakonore shqiptare, e cila ruajti origjinalitetin e saj”⁴³. Me këtë argument Ismail Kadare theksonte se gjakmarrja nuk është vetëm fenomen shqiptar, por ai ka ekzistuar në lashtësi edhe në Greqinë e vjetër dhe në vende të tjera⁴⁴. Për sa i përket simbolikës universale të gjakut, roli qendror i gjakut, si simbol, gjen paralele shumë të ngjashme në shoqëri të ndryshme që kanë praktikuar gjakmarrjen, siç e gjejmë të shprehur këtë në proverba të tilla, si: “Gjaku nuk bëhet ujë” (në Shqipëri); “Gjaku nuk është ujë” (në Malin e Zi), ose “Gjaku nuk shitet” (në Korsikë). Në malësitë e Shqipërisë së Veriut, në ato familje që kishin gjak për të marrë, zakoni e kërkonte që në katin e sipërm të shtëpisë, ose në një prej kulmeve të kullës, të varnin një këmishë me gjakun e viktimës, të cilën nuk e hiqnin derisa gjaku i tij të qe marrë⁴⁵. Në romanin “Prilli i thyer”, Ismail Kadare thotë se, “Kur njollat e gjakut fillonin të zverdheshin, kjo kuptohej si një shenjë që do të thoshte se i vdekuri nuk prehej i qetë në varr dhe kërkonte hakmarrje”. Kadare shkruan: “E merr me mend se ç’krusmë e tmerrshme është kjo? Fantazma e babait iu shfaq Hamletit dy-tri herë, në mesnatë, dhe vetëm për pak çaste, kurse këmisha që kërkon gjakmarrje, në kullat tona rri aty ditë e net, muaj dhe stinë të tëra dhe gjaku ndërron ngjyrë në të, dhe njerëzit thonë: ja, të vdekurit s’po i durohet sa të merret haku i tij”⁴⁶. Duke shkruar për fiset indiane të Amerikës, rreth një shekull e gjysmë më parë, James Adair dëshmonte se: “Ata besojnë fort se, nëse gjaku i atyre që vriten nga armiku mbetet pa u marrë, shpirtrat e tyre nuk gjejnë prehje dhe, gjatë natës, kthehen në shtëpitë e fisit të cilit i përkisnin. Kur ky detyrim familjar ose fisnor i gjakmarrjes kryhej siç duhej, atëherë shpirtrat e të vdekurve preheshin dhe gjenin forcë të largoheshin”⁴⁷. Në Malin e Zi, siç dëshmon antropologu amerikan Christopher Boehm, një nënë “Vazhdimisht u tregonte djemve të saj një enë me gjakun e burrit të saj të vdekur, për t’u kujtuar atyre, ndërkohë që ata rriteshin, se ngaqë askush tjetër nuk mund ta merrte gjakun e tij, kjo detyrë u mbetej atyre që ta kryer”⁴⁸. E njëjta dukuri vihej re edhe në Kretë, siç dëshmon Aris Tsantropoulos me këtë episod: “Gruaja e një burri të vrarë për gjakmarrje kishte një djalë të sapolindur me të”⁴⁹. Ajo e ruajti këmishën e gjakosur të burrit të vdekur ndërkohë që i biri, duke u rritur, e pyeste vazhdimisht për të atin. Nëna i thoshte se ai do ta mësonte të vërtetën vetëm kur të rritej, kur djali u rrit dhe u bë burrë, nëna i dha teshat e gjakosura të të atit dhe emrin e vrasësit të tij, djali i veshi menjëherë ato tesha dhe u hakmor për vrasjen e babait të tij”⁵⁰. Po kështu, Nikos Aggelis, në librin e tij “Vajtime popullore kretase”, sjell këtë dëshmi nga Kreta, e cila e ilustron më së miri pohimin e mësipërm: Një grua shtatzënë vajton pranë kufomës së të shoqit, të vrarë për gjakmarrje, duke mallkuar vrasësin dhe fisin e tij⁵¹. Ajo i flet burrit të vdekur dhe i premton atij si vijon: “Mos u shqetëso, i dashuri im, ai që

⁴¹ <http://konika.al/2017/04/fishta-gjakmarrja-dhe-kanuni/>

⁴² Eskili, Orestia, Përkthimi dhe Parathënia nga Ismail Kadare, Onufri Tiranë, 2015, fq.15.

⁴³ Ismail Kadare “Eskili, ky humbës i madh”, Tiranë 1990, fq. 45.

⁴⁴ Po aty...fq.45.

⁴⁵ Prof. Fatos Tarifa, PhD, “Simbolika e gjakut, kujtesa kolektive, dhe e kaluara si “invadim” i së tashmes”, 28 Shkurt 2015 Gazeta Mapo.al. Tirane, fq.9

⁴⁶ Andrea Stefani, GJAKMARRJA, KRIMI DHE TURPI YNË I PËRBASHKËT, Gazeta Shqip 23, Qershor, 2012 Tirane. Fq.5.

⁴⁷ Po aty...fq.9.

⁴⁸ Po aty...fq.9.

⁴⁹ Po aty...fq.9.

⁵⁰ Fatos Tarifa Hakmarrja është imja: morfologjia sociale dhe gramatika morale e gjakmarrjes, Univrsiteti i New Yorkut, Tirane, 2014 fq.54.

⁵¹ Prof. Fatos Tarifa, PhD, “Simbolika e gjakut, kujtesa kolektive, dhe e kaluara si “invadim” i së tashmes”, Gazeta Mapo Tirane 28 Shkurt 2015, fq.9.

do ta marrë gjakun për ty, është tashmë në barkun tim”⁵². Keith Brown, nga ana e tij, dëshmon për rëndësinë që kishte simbolizmi i gjakut në Skocinë feudale të shekullit të 16-të, pjesërisht për shkak se gjaku kishte të bënte me jetën e njeriut dhe pjesërisht, për shkak se ai shprehte lidhjet fisnore⁵³. Ky autor pohon se, shpeshherë, teshat e gjakosura merreshin me vete edhe në sallën e gjyqit-kaq i madh ishte “impakti vizual i gjakut në një shoqëri, në të cilën simboli dhe rituali ishin mjete të fuqishme komunikimi”⁵⁴. Për shkak se gjaku ishte elementi qendror i kozmogonisë së malësorit në Shqipërinë e Veriut dhe i së drejtës zakonore të tyre, normat që rregullonin gjakmarrjen u imponoheshin malësorëve rreptësisht dhe zbatoheshin prej tyre me rigorozitetin më të madh. Rregulli i hekurt i kanunit kërkonte mbrojtjen e nderit dhe shlyerjen e gjakut të derdhur me gjak. Ky rregull ishte i pacenueshëm, veçanërisht në ato raste kur cenohej nderi i familjes, madje edhe nderi i fisit dhe i të parëve. Një fyerje e tillë, pothuajse gjithnjë, çonte në deklarimin e një gjakmarrjeje, për shkak se e vetmja mënyrë për të vënë nderin në vend ishte vrasja. Kanuni sanksiononte: “Për një fyerje të nderit nuk paguhet gjobë”⁵⁵. Një fyerje e nderit nuk harrohet kurrë. “Të marrunit e gjakut buron prej mndorjeve të jashtme e prej t’metave t’organizimit shoqruer t’nji kombi”⁵⁶. Në Konferencën e Paqes në Paris, në fund të Luftës së Parë Botërore, kur luftohej për të siguruar pavarësinë e Shqipërisë, nëpër gojë të Imzot Bumçit, kryetar i delegacionit tonë, tha: “Gjakmarrja nuk përcakton barbarinë e popullit tonë, por është rrjedhojë e kushteve të veçanta objektive”⁵⁷. Autorja amerikane Rose Wilder Lane, në librin “Peaks of Shala”, një përmbledhje e shënimeve të udhëtimeve të saj në malësitë tona të Veriut dhe të Shqipërisë së Mesme, në vitin 1921, na e ka dëshmuar këtë trajtim ashtu siç ia ka shpieguar asaj në mënyrë të saktë Ipeshkvi i Pultit⁵⁸. Ja si shkruan ajo: “Gjakmarrja është e keqe, shumë e keqe, por është e vetmja mënyrë që imponon ligjet, të cilat janë përgjithësisht të admirueshme, thotë prelati - Gjakmarrja nuk është një gjë jashtë ligji, siç mendojnë shumë të huaj, dhe nuk ka të bëjë aspak me konflikte e urrejtje personale. Ajo është një formë dënimi kapital, ashtu si e ka çdo vend dhe që rregullohet prej ligjeve shumë strikte”⁵⁹. Autori tjetër amerikan, Ian Whitaker, në studimin e tij “Tribal Structure and National Politics in Albania, 1910- 1950”, e ka quajtur gjakmarrjen “Një mekanizëm publik i kontrollit shoqëror”⁶⁰. Për një rend shoqëror siç qe shoqëria kanunore, gjakmarrja është thjesht akt drejtësie i domosdoshëm për ruajtjen dhe funksionimin e shoqërisë; por për shoqëritë e sotme ku ekziston shteti dhe funksionon rendi gjyqësor, gjakmarrja është një akt i shëmtuar, i egër dhe barbar⁶¹. Domosdoshmëria për të ruajtur nderin dhe prestigjin e familjes bënin që gjakmarrja të mos ndërpritej kurrë. Ian Whitaker vinte në dukje se malësorët e Shqipërisë së Veriut ishin “Gjithnjë të gatshëm të mbronin nderin e tyre, dhe në mbrojtje të tij qëllonin me provokimin më të vogël”⁶². Fakti që një burrë i çnderuar konsiderohej i vdekur e bënte të jashtëzakonshëm presionin shoqëror mbi individin e çnderuar për të marrë gjak ndaj atij që e kishte fyer dhe për të vënë në vend nderin e tij e të familjes së tij. Nderi i palës së dëmtuar mbetej i cënuar derisa ai ta vriste personin që e kishte çnderuar, ose një anëtar mashkull të familjes së tij. Siç vë në dukje antropologu i njohur danez, Rolf Kuschel, mbështetur në studimin e gjakmarrjes në fiset primitive të ishujve Solomon, në oqeanin Paqësor, “Shoqëria jo vetëm e pranon gjakmarrjen, si një instrument për të rivendosur balancën e

⁵² Po aty...fq.9.

⁵³Prof. Fatos Tarifa,PhD,“Simbolika e gjakut, kujtesa kolektive, dhe e kaluara si “invadim” i së tashmes”, Gazeta Mapo Tirane 28 Shkurt 2015, fq.9.

⁵⁴ Po aty...fq.9.

⁵⁵ Shtjefen Gjeçovi, Kanuni I Leke Dukagjinit, Shtepia Botuese Reklama, Tirane, 2014, fq, 80.

⁵⁶ Shtjefen Gjeçovi, Kanuni I Leke Dukagjinit, Shtepia Botuese Reklama, Tirane, 2014, fq, 39.

⁵⁷Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë: “E drejta zakonore shqiptare 1 – Kanuni i Lekë Dukagjinit”, Tiranë 1999, përgatitur dhe pajisur me shënime nga Koço Nova, f. 189.

⁵⁸Prof. Fatos Tarifa,PhD,“Simbolika e gjakut, kujtesa kolektive, dhe e kaluara si “invadim” i së tashmes”, Gazeta Mapo Tirane 28 Shkurt 2015, fq.9.

⁵⁹ Po aty...fq.9.

⁶⁰Ian Whitaker: “Tribal Structure and National Politics in Albania, 1910-1950” in History and Social Anthropology,edited by I.M. Lewis (New York,1968),253-93.

⁶¹Syrja Popovci: “Gjakmarrja ndër shqiptarët dhe historiku i saj”, “Përparimi”Prishtine, nr. 11 / 9 / 1, f. 916.

⁶²Ian Whitaker: “Tribal Structure and National Politics in Albania, 1910-1950” in History and Social Anthropology,edited by I.M. Lewis (New York,1968),253-93.

prishur të nderit e të pushtetit, por, për më tepër, e kërkon atë, duke i stigmatizuar ata që presin për një kohë të gjatë për t'u hakmarrë⁶³. Gjakmarrja nuk ishte dënimi me vdekje, por ndëshkimi me burgim të përjetshëm në kushtet e shtëpisë. Në atë kohë liria ishte gjëja më e shenjtë, siç është edhe sot dhe siç do të jetë gjithmonë. Gjakmarrja nuk ishte kurdoherë dhe patjetër dënimi me vdekje për vrasësin, mbase ai mund të ngujohet gjatë gjithë jetës. Ndue Dedaj shkruan: “Nuk ndodhte kurrë që kulla të sulmohej nga gjakmarrësi dhe pse gjaksi ishte aty i ngujuar, por pritej që të dilte⁶⁴. Çabej thotë se parimi i mbrojtjes ishte kryesori në ndërtimin e një kulle shqiptare. Komoditeti i ndejtjes dhe plotësimi i nevojave të tjera kalonin në plan të dytë. Dedaj shton “Frengjitë nuk ishin asnjëherë për të vrarë dikë të fisit, fshatit bajrakut por vetëm për t'u mbrojtur nga agresorët e huaj apo dhe nga grabitësit e hajdutët ordinerë”⁶⁵. Kanuni është shumë i hollë, nganjëherë veprimi kundër kanunor është kryer edhe nga mosvlerësimi sa duhet i situatës dhe rrethanave. Kanuni quhet i shkelur kur nuk respektoheshin këto kushte: Nuk respektohej vendi i marrjes së gjakut “ky vend nuk mund të ishte kurrë shtëpia e atij që kishte me dhënë gjak”⁶⁶. Arma e përdorur për marrjen e gjakut (pushka dhe revolva) duke u përjashtuar çdo armë tjetër sidomos arma e vrasjes massive, edhe përdorimi i armëve të bardha si thika dhe sopata nuk shikohej si veprim burrnor⁶⁷. Mënyra e marrjes së gjakut (vrasja në distancë), kur dorësin e dallon mirë dhe bindesh që është edhe ai dhe vetëm ai. Në gjakmarrje nuk shtihet në tym, në kushtet e shikimit të kufizuar ose pengimit të plotë të shikimit⁶⁸. Njëri nga këto kushte sikur të shkelet kemi të bëjmë me vrasje mbi kanun, që hynin në radhët e bidateve (gjërave të padëgjuesha). Prej një veprimi të tillë nuk mund të shpëtoje nga vdekja por në një gjakmarrje normale, kjo mund të ekzistonte. Ai që nuk mbante armë, nuk vritej për gjak. Këta burra martoheshin, krijonin familje dhe bënë jetë si gjithë burrat e tjerë, vetëm se statusin burror e kishin më të ulët. Binte në sy sepse këta kishin një mos pëlqim të heshtur të pashpallur nga shoqëria⁶⁹. Atyre nuk u mohohet e drejta për t'i trokitur në drerë cilitdo, por në morte dhe në dasma këta bënë më shumë punë jashtë sesa qëndronin në mexhelis. Ata binin dru me kuaj nga mali, çanin dru, mbushnin ujë shkonin për të hapur varrin, shkonin fjalëtor me lajmërue njerëzit për mort ose me i grish.

1.1 Gjakmarrja sipas kanunit të Lekë Dukagjinit

Nice, thotë se natyra njerëzore është tepër komplekse se nuk është e lehtë për t'a kuptuar dhe për t'a motivuar lehtë sjelljen e tij për shkak të natyrës së vet njeriut “Për çdo specie njerëzore, shkruan ai, që është mbajtur e fort pranë natyrës, dashuria dhe urrejtja, mirënjohja dhe hakmarrja, mirësia dhe zemërimi, veprimi pozitiv dhe veprimi negativ janë të pandara”⁷⁰. “Spektri i brendshëm i njeriut është i madh gati pakufishëm, ai është i aftë për krimet më të neveritshme dhe për flijimet më të larta”⁷¹. “Sipas filozofisë islame e tërë ligësia dhe mirësia janë brenda njeriut ... Të pohosh se njeriu është rezultat i rrethanave të jashtme... njeriun e degradon në send, në përçues të fuqishëm të forcave të jashtme mekanike e të pavetëdijshme”⁷². Kanuni ka katër parime themelore të cilat janë barazia dhe pabarazia njerëzore, mikpritja, nderi dhe besa. Kanuni i Lekë Dukagjinit ka parimin kryesor dhe themelor për sa i përket jetës njerëzore “Çmimi i jetës se njerit asht një, si për të mirin, si për të keqin”⁷³. Kanuni ka gjashtë vlera kryesore, të cilat e përshkojnë atë nga fillimi deri në fund. Ato janë

⁶³Prof. Fatos Tarifa, PhD, “Simbolika e gjakut, kujtesa kolektive, dhe e kaluara si “invadim” i së tashmes”, Gazeta Mapo Tirane 28 Shkurt 2015, fq.9.

⁶⁴ Ndue Dedaj, “NJË SHPJEGIM PËR KULLAT, MIQVE TË MEDIAVE”, Gazeta Shqip, Tirane 19.12.2012, Opinion fq.5

⁶⁵ Po aty...fq.5

⁶⁶Syrja Popovci: “Gjakmarrja ndër shqiptarët dhe historiku i saj”, “Përparimi”Prishtine, nr. 11 / 9 / 1, f. 916.

⁶⁷ Po aty.fq.916.

⁶⁸Xhaferr Martini “Kanuni I Maleve të Dibrës”,Arbëria, Tiranë 2003,fq 138.

⁶⁹ Po aty. fq 140 .

⁷⁰ Po aty.fq.140.

⁷¹Xhaferr Martini “Kanuni I Maleve të Dibrës”,Arbëria, Tiranë 2003,fq 138..

⁷²Xhaferr Martini “Kanuni I Maleve të Dibrës”,Arbëria, Tiranë 2003,fq 138.

⁷³Shtjefen Gjeçovi, Kanuni I Leke Dukagjinit, Shtëpia Botuese Reklama, Tirane, 2014, fq, 80.

fjala e dhënë, nderi, mikpritja, afërsia fisnore, mëshira dhe gjakmarrja. Të gjitha këto pika kanë të bëjnë me një fe pagane, pasi ata i japin rëndësi natyrës së thellë njerëzore, pemëve, liqeneve etj, pra çdo gjëje jetike. Për sa i përket tolerancës, e thashë që më parë që kanuni nuk mbështet luftën, por tolerancën, kështu që ai padyshim ka të bëjë me tolerancën fetare ... Kanuni siç u përmend ka katër parime themelore parime bazë mbi të cilat ngrihet krejt struktura e tij. Këto parime janë barazia dhe pabarazia njerëzore, mikpritja, nderi dhe besa. Kanuni kishte rregulla të sakta; gruaja nuk duhej të prekej; fajtori nuk duhej të fshihej dhe as të fshinte krimin e tij, mosvrasja e fëmijëve meshkuj deri në moshë madhore (15 vjeç sipas kanunit), janë lënë pas dore. Rikthimi i gjakmarrjes shoqërohet me një praktikë mohuese të rregullave themeltare të saj të kodifikuara në kanunin shqiptar të Lek Dukagjinit. Si rrjedhojë, i vetmi rregull që respektohet është marrja e “gjakut” me çdo kusht edhe pse në vend të një personi mund të vriten tre. Kanuni kishte rregulla të sakta:

- “Personi që ka bërë vrasjen mund të largohet dhe të fshihet brenda 24 orëve. Fisi dhe familja e tij nëse kanë vendbanim pranë shtëpisë së të vrarit, pasi të kalojë 24 orë nga vrasja nuk ka më arsye të ruhet nga gjakmarrja (neni 122 rreshti 869-870).
- Ligji mbi gjakmarrjen shprehet qartë, duke pohuar që të gjithë meshkujt e familjes së atij që ka kryer vrasjen edhe nëse janë shumë të vegjël, kushërinj, nipër, të afërm rrezikojnë të vriten brenda 24 orëve të para pas vrasjes. Pasi kalojnë 24 orë familja e të vrarit duhet të japë garancinë e armëpushimit.
- Familja e të vrarit nuk mund të marrë gjak mbi gratë e familjes së vrasësit”⁷⁴.

Po të analizojmë Kanunin e Lek Dukagjinit, po të shqyrtojmë të gjitha nenet me rrallë, do të mund të kuptojmë se në thelb Kanuni nuk e promovon gjakmarrjen, përkundrazi, përderisa parashtrohet dhe një kapitull për pajtimin, rregullat e pajtimit, e mbi të gjitha kur ky i fundit vetë në Kanun konsiderohet si akti më fisnik i një mashkulli, do të thotë që rëndësia e gjakmarrjes zhvendoset. Gjithashtu, nenet e Kanunit e bëjnë shumë të vështirë marrjen e gjakut, kjo do të thotë se akti i vrasjes në emër të saj mund të jetë edhe i pamundur. Kjo për disa arsye: Së pari, duhet të vritet vetëm dorasi, pra personi që ka kryer vrasjen. Nuk mund të preken as familjarët pasi të kalojnë 24 orë, as fëmijët e as gratë. Së dyti Nëse dorasi është i shoqëruar me grua e me fëmijë, ai nuk mund të vritet. Së treti Dorasi nuk mund të vritet brenda oborrit të shtëpisë së tij. Të gjitha këto rregulla, të parashikuara në nenet e Kanunit e bëjnë shumë të vështirë marrjen e gjakut. Mund të kalojnë dhe 100 vjet dhe dorasi të mos vritet. Kanuni ka qenë mjaft efektiv në ditët kur është krijuar e zbatuar, shumë vite më parë, pa ju shtrembëruar nenet e tij sipas interesave vetjake.

1.2 Gjakmarrja si fenomen

Gjakmarrja nuk është vetëm një fenomen i dëmshëm për shoqërinë, por njëherësh është fenomen me pasoja sociale të jashtëzakonshme, me kosto të lartë morale, psikologjike dhe financiare. Gjakmarrja tek shqiptarët nuk është fenomen i ri shoqëror, por që në këto vite, për shkakë problemeve socio-ekonomike, është shfaqur. Nga pikëpamja sociale e kulturore, si fenomen zakonor është i lidhur me traditën, e cila, për fat të keq, konsiderohet si e shenjtë dhe e trashëguar nga etërit tanë.

Në analizën e shkaqeve dhe pasojave sociale, meriton të vlerësohet fakti që në dendurinë aktuale të fenomenit të gjakmarrjes, ka ndikim jo të vogël kalimi i një periudhe të ndërlikuar të tranzicionit e shkaqeve tradicionale u shtohen edhe ato që janë të lidhura me pronën, me çështje morale të familjes, si trajtimi për qëllime prostitucioni, me ndarjen e tokës, të pasurive etj.

Nuk është e vështirë të renditësh një numër pasojash sociale, që burojnë nga gjakmarrja, si dukuri shoqërore me nuanca primitiviteti, që marginalizon familjen, e izolon atë, duke ndërprerë lidhjet sociale, që traumatizon personalitetin e grave dhe fëmijëve, duke kultivuar në familje kulturën e krimit, të urrejtjes, të dëshpërimit dhe të përbuzjes së shoqërisë, që e bën familjen ekonomikisht vulnerable, që e bunkerizon familjen e ngujuar përballë interferencave sociale e kulturore, që rëndon situatën sociale të njerëzve, që kërkojnë kujdes të veçantë etj. Ka fenomene, që në shoqëri shpesh, duke qenë paradoksale, sjellin bashkëshoqërim të tyre me pasoja të licensuara me njëra-tjetrën. E tillë është lidhja midis gjakmarrjes, si dukuri sociale dhe varfërisë, si fenomen ekonomik, shoqëror, e

⁷⁴ Po aty...fq,79.

natyrisht, edhe me probleme të marginalizimit të deformimit social të mjedisit familjar, sidomos i zhvillimit të deformuar të personalitetit të pjestarëve të tjerë të familjes, sidomos të fëmijëve, të moshuarve, të grave dhe posaçërisht të pjestarëve të familjes, siç janë njerëzit e sëmure apo fëmijët me probleme të zhvillimit mendor apo fizik. Në vend të shoqërisë së dikurshme kanunore, sot kemi disa grupe relativisht të mëdha shoqërore që kanë zbritur nga zonat kanunore në kërkim të një jete më të mirë, kanë rënë në qytete rurale ose në periferi të qyteteve të mëdha etj. Në vendbanimet e reja shumica e këtyre banorëve ruajtën portretin e njeriut të ndershëm që do të jetojnë me djersën e ballit siç pati dhe shumë syresh që u paraqitën si “pushtues dhe xhagadurrë”⁷⁵. E përbashkëta e tyre qëndron në faktin se këta njerëz, të shkukur nga vendi i vet, kanë mbetur të zhveshur pa mjedisin që i rrethonte pa moralin që i mbronte, pa shoqërinë që i kuptonte, pa ato ëndrra dhe shpresa që përpiqeshin t’i ndërtonte dhe që kishin lidhje me ëndrrat dhe shpresat e shumë brezave që kishin jetuar në ato troje. Këta njerëz janë në kërkim të një identiteti të ri që ishte i vështirë për t’u krijuar. Këta njerëz kanë nevojë të njihen, të duan dhe t’i duan, t’i pranojnë e t’u japin mirëseardhjen. Asnjëra prej këtyre nuk ka ndodhur. Këta njerëz përpiqen të krijojnë mikrokomunitet sipas vendeve nga kanë ardhur. Shpesh ia kanë arritur, megjithatë ky mikrokomunitet është i brishtë dhe lehtësisht i shpërbëshëm. Sot nuk ka as mik tradicional, as besë, as ndërmjetësi, as ndore, as be. Çdo fëmijë e ka të garantuar me kushtetutë të drejtën për të ndjekur shkollën. Shteti duhet ta garantojë jetën dhe shëndetin e secilit prej tyre. “Kështu të huajt e miqtë, njeriu që është i uruar/ i prit kraharor hapët e i përcjell gëzuar”⁷⁶. Studiuesi Shaban Sinani, duke iu referuar poezisë së Naimit shkruan se: “Naimi e krijoi Shqipërinë kulturore para se të krijohej Shqipëria politike”⁷⁷. Në nenin 135 të Kanunit të Pukës sanksionohet “Miku, asht ndera e shpisë”, ndërsa në librin e 8°, kreu 18, nyja 97, paragrafi 602 i Kanunit të Lekë Dukagjinit sanksionohet: “Shpija e Shqyptarit është e Zotit dhe e mikut”. Në asnjë popull tjetër europian nuk e gjejmë këtë njësim të fjalës bujtës me fjalën “mik”, përkundrazi janë të ndara e me kuptime të ndryshme, ndërsa populli ynë fjalën “mik” e ka hyjnizuar dhe e ka lartësuar deri në krijimin e kultit të mikut, e ka bërë një disiplinë një ligj dhe normë shoqërore. Miku në shtëpinë e shqiptarit, rrethohet me nderime, me respekte, i rezervohet pritje e ngrohtë e fisnike dhe trajtim special. Ardhja e mikut është festë për malësorin shqiptar. Ky qëndrim kanunor shpreh qartë ndjenjat e larta humane, fisnike, kavalereske, kulturën mikëpritese të realizuara me dashamirësi, me zemërgjeresi e madhështinë e shpirtit shqiptar, që në kompleks përbejnë normat universale etiko-morale dhe ligjore të mikpritjes shqiptare, që aplikohen pa dallim për çdo mik, që bujt e nderon shtëpinë e tij. Në të gjitha kanunet shqiptare janë të pranishme sentenca unikale, ndër të cilat rendisim disa më tipiket, e përfshira në librin e 8, kreu 18, nyja 96 në paragrafet në vazhdim të Kanunit të Lekë Dukagjinit :

- 608. Mikut do t’i bahet nderë me bukë e kripë e zemer.
- 613. Mikut të zëmres i lshohet shpija.
- 615. E mbajtmja e armës se mikut, është shëj burrnije e nderje.
- 616. Mikut i lshohet kryet e vendit.
- 620. Po të hîni miku në shpi, gjak me të pasë, do t’i thuejsh: “Mirë sè erdhe!”
- 621. Miku do të perciellet deri kû të lypë ai me e percjellë⁷⁸.

Pra për shqiptarin miku është i shenjtë, ç’ka shprehet qartë e bukur në kanun: “Shtëpia qe e pret është e mikut dhe e Zotit”, jo vetëm kaq, por miku njësohet me Zotin, prandaj në të gjitha kanunet sanksionohet miku – Zot. Kjo mikpritje dhe ky respekt janë me të vërtetë sa hyjnore aq dhe humane, prandaj studiuesit e huaj i kanë quajtur mrekullitë unikale të kulturës shqiptare, madje studiuesit e huaj mikpritjen shqiptare e kanë krahasuar me festat dhe banketet që shtroheshin nga perënditë e Olimp (eposi i lashtë grek). Kulti i mikut dhe kultura e mikpritjes rregullohen me ligje dhe norma etikomorale, të formuluar që në lashtësi dhe të transmetuara gojarisht e të pandryshuara nga tradita popullore, si rekomandime-ligje, që respektojnë ligjin themelor të gjithë kanuneve shqiptare: “keshtu e thotë Kanuni, ligji i të pareve tanë”⁷⁹. Kulti i mikut sanksionohet në disa paragrafe të nyjeve 96, 97, 98 të librit të 8°, ndër të cilët veçojmë dy me tipiket: “Shpija e Shqyptarit është e Zotit dhe e mikut”.

⁷⁵Xhaferr Martini “Kanuni I Maleve të Dibrës”, Arbëria, Tiranë 2003, fq 170.

⁷⁶Frashëri, S. Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’dë të bëhet (1889), fq.89.

⁷⁷Po aty...89

⁷⁸Shtjefen Gjeçovi, Kanuni I Leke Dukagjinit, Shtëpia Botuese Reklama, Tirane, 2014, fq, 15.

⁷⁹Lutfi Alia: “Kanuni - Kodi i së drejtës zakonore shqiptare” 16.01.2013 www Zemra shqiptare.

“Porta e shtëpisë hapet për këdo që troket, qofte ai mik apo lypës”⁸⁰. Duke analizuar vetëm keto dy ligje, që janë të shenjta për shqiptarët, zbulohet se ato shprehin një mentalitet dhe një kulturë antike, nuk e teproj kur them biblike e parakristiane, pra e kanë origjinën në lashtësinë e largët kur profetët dhe shenjtorët shfaqeshin para dyerve të besimtarëve, të veshur si një udhëtar i varfër, ose si lypës. Ky zakon i lashtë dhe respektit për profetët dhe shenjtorët, u ruajtën të mishëruar në shenjtërimin e mikut, udhëtarit që troket në derë si mik, pritët si mik, ashtu si është sanksionuar në ligjet kanunore. Në një ligj tjetër hyjnor: “Mikut do t’i bahet nderë me bukë e krypë e zemer”, do të thotë se i zoti i shtëpisë, qoftë i kamun, ose i varfër, duke bujtur mikun dhe pse mund të jetë i panjohur, do t’i ofrojë gjithçka shtëpia e tij, madje, do t’i vejë përpara buke, krypë dhe zemberbardhësine e mikpritjes fisnike. Këto virtyte etikomorale dhe kulturore janë të mirënjohura e të pergjithësuara në historitë proverbiale të mikrpritjes shqiptare, duke evidencuar pasterinë shpirtërore, sinqeritetin, sjelljen e ngrohtë dhe festive të krijuar nga malësori, për të mirëpritur e për të garantuar konfort dhe siguri për jetën e mikut bujtës. Mikpritja asht kategori kanunore në rangun e mirëbesimit, prandaj kodi i mikut është i shkruar dhe në dimensionet e reciprocitetit në raportet e zotit të shtëpisë me mikun dhe anasjelltas. Mungesa e këtij reciprociteti, do ta vinte në krize tërë sistemin organizativ të familjes malësore, të fisit, të lagjes, të fshatit, të krahinës e të shoqërisë malësore shqiptare. Principi kanunor i mikrpritjes, vishet me norma të forta etike e morale, që e lartësojnë dhe e shenjtërojnë këtë zakon shqiptar dhe e kundërta, kur miku nuk pritët mirë, ose kur mikut i mbyllet dera, atëherë kryefamiljari çburrnohet, i nxihet faqja para mikut e katundit, shtëpia e tij turpërohet, ose më saktë sipas kanunit humb nderin. Jo vetëm kaq, por me këtë sjellje jonormale dhunohen ligjet e shenjta të mikrpritjes të sanksionuara në kanune, për pasojë rrezikojnë kohezionin social, prandaj ky qëndrim jodinjtoz ndëshkohet. Sipas kulturës shqiptare, miku që troket në portë, duhet të pranohet e të pritët me të gjitha nderet që meriton dhe “të trajtohet në të njëjtën mënyrë si lypësi, si i kamuri, si profeti ashtu dhe i shenjtë”. Sipas tradites popullore shqiptare, miku nuk duhet vlerësuar sipas veshjes, sepse nën veshjen e një lypësi, mund të jetë dhe një profet, ose një shenjtëtor. Pasi hynë në shtëpi, miku vihet në krye të vendit dhe i bëhen nderimet sipas një rituali mikpritjeje të mirpërcaktuar, që janë parashikuar në librin e 8, kreun 18, në nyjen 96 të Kanunit të Lekë Dukagjinit:

- 602. Shpija e Shqypitarit është e Zotit e e mikut.
- 604. Si të bajë za miku, i zoti i shpis a kush i shpis i pergjegjet e i del perpara.
- 605. Falet me mik, armen i a merr, e i prîn në shpi.
- 606. Armen i a varë në krrabë, edhë e çon në krye të vendit ké votra.
- 608. Mikut do t’i bahet nderë: “Bukë e krypë e zerner”.
- 609. Buka, krypa e zëmra, zjarmi e trungu e do firi shtrojë, do të gjindet gadi për mik në çdo kohë të natës e të ditës.
- 610. Mikut të lodhun do ti vîhet rreth me të pritun me nderë.
- 611. Per çdo mik, duhet buka si hàn vetë.
- 613. Per mik zemret duhet duhâni, kafja e ambel, rakija e bukë e mish. - “Mikut të zëmres i lshohet shpija”.
- 617. Mikut i lshohet kryet e vendit, po kje në shpi si edhë po kje në kuvend burrash, porsé në kuvend nuk kà zâ.Gruaja e mikut rri në krye të vendit, ndërmjet garisë së shtëpisë.
- 619. Si të hîjë miku në shpi, të kà là detyren.
- 620. Po të hîni miku në shpi, gjak me të pasë, do t’i thuejsh: “Mirë sè erdhe!”
- 621. Miku do të perciellet deri kû të lypë me e percjellë.
- 622. Miku, edhë pse xën kryet e vendit në shpi a kûdo, kurr s’prîn, por do t’i prijsh.
- 634. Buka të nderon, porsé të qet edhë në pûne⁸¹.

Mikpritja e malësorit, është sa madhështore, po aq është dhe emocionuese, kur mendon se zoti i shtëpisë dhe pse mund të jetë i varfer, sillet si një gentelman i vërtetë, duke e ndarë dhe kafshatën e fundit të bukës me mikun, e pret dhe e nderon me bukë, krypë e zemër, madje dhe e merr në mbrojtje. Këtë lloj mikpritje të rrallë, bota e ka njohur në Odisean e Homerit, por dhe në shtëpitë e malesorëve shqiptarë, që e kanë ruajtur dhe e kanë konsoliduar mikpritjen në një traditë hyjnore. Mikpritja e

⁸⁰Shtjefen Gjeçovi, Kanuni I Leke Dukagjinit, Shtëpia Botuese Reklama, Tirane, 2014, fq.6

⁸¹Shtjefen Gjeçovi, Kanuni I Leke Dukagjinit, Shtëpia Botuese Reklama, Tirane, 2014, fq. 63.

mikut e sanksionuar në kanunet tona, shpreh personalitetin kulturor, botën e gjerë shpirtërore, fisnikërinë, humanizmin, ndjenjat e respektit e të solidaritetit, qëndrimin kavaleresk dhe mistik të malësorëve shqiptarë. Duke i ofruar mikut: bukë – krypë – e zemër, i zoti i shtëpisë dhe pjestarët e familjes, marrin dhe bekimin e Zotit, kësaj shtëpie e tyre shenjtërohet. I zoti i shtëpisë (kryefamiljari) i a transmeton mikut këtë atmosferë hyjnore, me mirësjelljen, me urimin dhe me fjalët e përzemerta: “Mirëserdhe në shtëpinë time: bukë, krypë e zemër” dhe vazhdon urimin solemn: “I falemnderës zotit, që të drejtoj në shtëpinë time”. Këto përshëndetje të zotit të shtëpisë, me urimet e mirseardhjes e të mikpritjes, nga ana tjetër gjejnë korespondentin e vet nga ana e mikut, i cili i përgjigjet me të njëjtën mënyrë fisnike dhe me kulturë, duke e falenderuar mikpritësin, po me shprehje hyjnore: “Mire se të gjeta dhe qoftë e levdume kjo shtëpi që më bujt”. Kjo përgjigje e mikut, krijon një atmosferë respekti reciprok, madje shtëpia, që hap derën dhe e bujt mikun, është një bekim e fat për të zotin e shtëpisë dhe për të gjithë pjestarët e familjes, që impenjohen për ta nderuar, respektuar e për t’i krijuar konfortin e duhur për gjatë gjithë kohës që do të jetë bujtës në shtëpinë e tyre. Miku, për sa kohë është bujtës e në hijen e shtëpisë së tij, si dhe kur kalon në rrugët e fshatit i shoqëruar me të zotin e shtëpisë, me një grua, me një djalë, ose vajzë të familjes, është në mbrojtje e në besë të zotit të shtëpisë, mbrohet nga çdo rrezik eventual, si nga përqëshja, fyerja, ose nga gjakmarrja, si sanksionohet në nyjën 97, ne paragrafët në vazhdim:

- 623. Miku perciellet edhë me një fini, po kje djalë a vajzë, gjithnji si një burrë a grue.
- 626. Si t’i prish mikut, çdo dhunë fi bajë kuej ky, lypet mbë ty.
- 628. Kanûja urdhnon të perciellet miku sà mos t’a gjejë ndo’i pûnë e ligë, e mos ti bajë kuej ndo’i dâm me bukë t’ande.
- 632. Kanû âsht prà, qi t’i prihet mikut, sepsé xêhet sè nuk din rrugë e nuk din a do të ndeshet në mik, a ne armik.
- 633. Do t’i prîjsh, pse jé rojsi i mikut, si me i a largue rrezikun, si edhë me e ndalë prej pûnevet të keqia.
- 637. Nderen e dhûnen do t’a dajshë me mikun e të damtuemin do t’a ndreqish.
- 639. Sikurse ké detyrë me lypë mikun e prém ashtû jé në detyrë me dhânë arsye, në prek kend mikun në bukë tande.
- 641. Veç një gacë me t’a lypë kush të dera per me kallë çibukun dhe e ngau kush, të pritët mik.
- 642. Po të rà ndore kush, edhë tuj t’a xânë vetem êmnin: “Jam miku i njatij” edhë pa të pasë kênë kurr të dera, po e ngau kush, të jét mik në derë e ftyra t’u vrugnue.
- 643. Po t’a vûni kush mikun në lojë a t’a shau, ti do t’a mkâmbish nderen e mikut me rrezik të jetës s’atë.
- 644. Po i u pré kujt miku, kanûja i kà lânë dy udhë: a të fiket, a të koritet.
- 645. Atij, qi i u pré miku, çdo send do ti jepet me dorë të mâjtë e nen gju, deri sa t’a paguej mikun⁸².

Sipas Kanunit, miku bëhet pjestar i pandashëm i familjes bujtëse. Këtë privilegj, miku e shpreh duke deklaruar: “Jam ne besë të zotit të shtëpisë” (duke shqiptuar emrin e mbiemrin e të zotit të shtëpisë që e ka bujt), ç’ka do të thotë, se ai është nën mbrojtjen e tij e nuk mund të pësojë hakmarrje gjakmarrje nga askush. Nëse miku bie në pritën e një gjakësi, armiku i tij nuk mund të hakmerret, sapo dëgjon “Se ëshë e besë së filanit...” dhe ky veprim i shpëton jetën. Në të gjitha kanunet shqiptare, nuk përdoret kurrë fjala i huaj, mik i huaj, udhëtar i huaj, pra nuk ekziston mik i huaj, apo vendas, përkundrazi figura e mikut asht unike, pavarësisht ngakombësia, përkatësia etnike e shoqërore, besimi fetar, në se është i varfër, apo i pasur, punëtor, fshatar, nëpunës, apo funksionar. Kulturën e mikpritjes shqiptare e kanë përshkruar dhe lartësuar si virtyt shumë udhëtare e kronista të huaj, që e kanë përjetuar personalisht e kanë mbetur të mrekulluar, duke e përkufizuar pa rezerva, si vlerë unikale e kulturës shqiptare. Ndërmjet tyre vlen të rikujtoj kronistin e famshëm turk E. Çelebia, që udhëtoj në trojet shqiptare gjatë viteve 1623 – 1670; e në kronikat e tij shkruan: “... në të gjithë Perandorinë Otomane, nuk kam parë mikepritje kaq të ngrohtë dhe humane, sa në shtëpitë e shqiptareve” e më tej shkruan “mikpritja është një vlerë etike e kulturore tipike albanese”. Mikpritja kanunore është bërë

⁸²Shtjefen Gjeçovi, Kanuni I Leke Dukagjinit, Shtëpia Botuese Reklama, Tirane, 2014, fq. 63.

proverbiale, sidomos për trajtimin e personave që vuajnë, me vështirësi fizike, për personat që kërkojnë ndihmë, për ata që kërcënohen, persekutohen e përndiqen, në veçanti mikpritja shqiptare u shqua në mbrojtjen e jetës dhe të drejtave të hebrenjve që jetonin në Shqipëri. Si theksuam më sipër, miku ka imunitet, është i mbrojtur nga autoriteti i zotit të shtëpisë. Kush ofendon mikun, kush shkel mbi nderin e shtëpisë mikpritëse, sipas kanunit ka dhunuar ligjet e rregullat e mikpritjes, ka dhunuar “të drejtat e mikut”, madje faji i tij është edhe me i madh, pasi kështu ofendon Hyjet (perënditë) e për rrjedhojë perënditë zemërohen dhe hakmerren kundër fajtorëve. Kush refuzon të strehojë udhëtarin – mik, që troket në derë, kryen krim të rëndë e të ndëshkueshëm, parashikohet në librin e 8, nyja 97, madje ky faj është i rëndë e nuk falet, si shprehet në dy paragrafet në vazhdim, ku falet gjithçka, por nuk falet kurrë fyerja e mikut:

- 649. Me gojë të kanunit: baba, vllau e deri kushrinja e dalun fare falen, porsë fyerja e mikut nuk falet.
- 650. Per mik të prëm rrallë s'et epet besa; ndermjetsija epet sà të m'arrin e t'apin, në hifët puna në të ndrequn. Ndonese miku është përfaqësuesi – ambasadori, kuptohet se nuk ka rëndësi në se paraqet apo jo “leter-kredenciale” dhe pse është i panjohur, pasi mjafton fjala e nderit i prezantuar, si pjestar i një familje tjetër, për ta trajtuar si mik. Megjithatë, miku mbetet i pandarë me njerezit e shtëpisë bujtëse⁸³;

Në rast se dy familje janë në konflikt gjakmarrje dhe rastësisht vrasësi hynë në shtëpinë e të vrarit e kërkon strehim (pavarësisht në se e di, apo nuk e di se është shtëpia e të vrarit), ai nuk rrezikon, përkundrazi është në mbrojtje të kësaj familje, madje merr pjesë dhe në funeralin e atij që kishte vrarë e të nesërmen shoqërohet jashtë “hijes së shtëpisë” e të shkojë në rrugën, që e çon në shtëpinë e tij (nyja 97).

Konkluzione

Një nga sfidat, me të cilat ndeshet shoqëria dhe shteti shqiptar në kete dekadë është edhe fenomeni i gjakmarrjes dhe hakmarrjes, zakoni i trashëguar nga e kaluara e lashtë, i papajtueshëm me parimet e shoqërisë së qytetëruar dhe të shtetit të të drejtës. Ajo sjell pasoja shoqërore të rënda, me marrjen e jetës së njerëzve, me ngujimin e mjaft familjeve, duke i rrënuar ekonomikisht dhe duke i shpëputur nga jeta politike-shoqërore, si dhe duke lënë fëmijët pa shkollë.

Kanuni është enciklopedia shqiptare që lidhet me jetën e njeriut që para se ai të lind dhe mbase ai të ketë vdekur dhe nuk ka shkencë dhe disiplinë shkencore që të rrokë një tërësi problemesh si Kanuni. Kanuni është e drejta shqiptare, është institucion shqiptar, historia institucionale, por dhe “idea e formuluar”. Ai është mendja dhe shpirti i shqiptareve, i ngjizur në shekuj në traditën gojore, i ruajtur, i mbrojtur me fanatizëm dhe i transmetuar si një mesazh, i cili duhet kuptuar, zbërthyer dhe përvetësuar në mënyrën si është formuluar dhe transmetuar, pa u ndryshuar në formë dhe në përmbajtje. Kanuni është tradita juridike e lidhur ngushtësisht me historinë e Shqipërisë, me identitetin e popullit tonë, me krenarinë e të qenit shqiptar dhe të origjinës sonë së lashtë pellazgo-ilire.

Kanuni i Lekë Dukagjinit nuk është vetëm tërësia e normave të së drejtës zakonore por më tepër vepër që përmban “Palcën etnike të kombit shqiptar dhe të kulturës së tij” dhe “Cilësia e tij ka bërë që nga amza e tij të rritet një lëtersi etnike shqiptare”. Kanuni mund të shënohet si vijim i monumentalizmit tradicional të vlerave etnodalluese të popullit shqiptar. Kanuni i Lekë Dukagjinit ose Kanuni i Maleve, veprimin dhe zbatimin e kishte në malet e Veriut. Malet e kanë pasur të lidhur fort jetën e tyre me Kanunin e Maleve. Malet mbanin çdo peshë të normave dhe neneve të veprimit të tij. Malet janë fryma e Kanunit, pasi askush me shumë se malet e veriut nuk kanë mbajtur aq shumë të fshehta dhe mistere, askush më shumë se malet nuk ka parë të vdekur nga gryka e pushkës për të marrë gjak, askush më shumë se këto male të veriut nuk kanë parë të vriten bij nënash në zbatim të neneve të kanunit.

⁸³Shtjefen Gjeçovi, Kanuni i Leke Dukagjinit, Shtëpia Botuese Reklama, Tirane, 2014, fq. 63.

Literatura

1. Muhamet **Pirraku** “*Lëvizja Gjithëpopullore Shqiptare për Faljen e Gjaqeve 1990-1992*”, Instituti I Historise, Prishtinë, 2000;
2. Ismet **Elezi** “*Vrasjet për hakmarrje e për gjakmarrje në Shqipëri*”, Tiranë Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, 2002;
3. Anton **Çeta** “*Pajtimi i gjaqeve: 1990-1991*”, Instituti Albanologjik Prishtinë 1999;
4. Gjon **Keka** “*Anton Çeta dhe filozofia e pajtimit të gjaqeve*”, Tiranë ,bot art, 2015;
5. Klotilda **Gërmau** “*Gjakmarrja - nga plagët e shoqërisë sonë*”; Univers Tiranë, 2006;
6. Ismet **Elezi** “*Edhe një herë për gjakmarrjen: (masat parandaluese që duhet të ndërmerren)*”,Univers Tiranë, 2006;
7. Engkantina **Nasi** “*Gjakmarrja - të gjejmë forcën të falim dhe të lëmë shtetin të gjykojë: takim i Komitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar me përfaqësues të shoqërisë civile dhe mediave për problemin e gjakmarrjes*”, bot art Tiranë, 2006;
8. Mentor **Kika** “*Mesjeta jonë dhe drejtësia moderne: (gjakmarrja, problemet sociale të shkaktuara prej saj)*”, Revistë e Institutit të Sociologjisë Tiranë, 2006;fq.11.
9. Gjin **Marku** “*Gjakmarrja dhe strategjia e misionarëve*”,Metropoll Shkodër, 2009;
10. Gjergj **Fishta** “*Gjakmarrja: zbatim i ligjit apo akt barbar?*”, Mapo Nr.94,Tiranë, 2010;fq.23.
11. Don Lush **Gjergji** “*Anton Çetta - efektet e pajtimit të gjaqeve*”, Sesionin shkencor për “Anton Çetën” Dega e Folklorit në Institutin Albanologjik të Prishtinës në Prishtinë Nr.11, 2011;fq.16-17.
12. Pandeli **Koçi** “*Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës: konferencë kombëtare: 11-12 dhjetor 2001*”, Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës : konferencë kombëtare : 11-12 dhjetor 2001 Tiranë : Luarasi, 2002,fq.136.
13. Rexhep **Gashi**& Ismet **Salihu**, “*Politika ndëshkimore ndaj delikteve të gjakut në Kosovë gjatë periudhës 1980-1989*”, Universiteti I Prishtinës Prishtinë, 2003;
14. Bardhok **Sulejmani** “*Pesha e Faljes*”, Mirdita Tiranë, 2004;
15. Ismet **Elezi**& Pandeli **Koçi** “*Ndërmjetësimi për pajtim në konfliktet penale*”, Tiranë, Fondacioni "Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Gjaqeve", 2004;fq.231-233.

MJETET E SË DREJTËS SË KONKURENCËS, MBROJTJA E SAJ DHE ZBATIMI NË SEKTORIN E TURIZMIT NË VENDET E BALLKANIT PERENDIMOR :PËRVOJA E SHQIPËRISË ME FQINJËT E SAJ JO-ANTARE TË BE.

Armand FEZOLLI

Lektor i Dr.Tregtare

Fakulteti i Shkencave Juridiko-Politike

Universiteti « A.Moisiu »

Durrës

armandafezolli@yahoo.de

Para vendeve të Ballkanit Perëndimor, jo-anëtare të BE-së ku bëjnë pjesë Shqipëria, Mali I Zi, Kosova, FYRO Maqedonisë, Bosnje-Hercegovina, Serbia, por pse jo edhe Kroacia, (megjithëse kjo së fundmi tashmë është anëtare në BE), po shtrohet si domosdoshmëri dita-ditës se vetëm me një treg unik turistik (dhe jo vetëm atë) në rajon mund të bëhen tërheqës për të thithur turistë nga e gjithë bota. Të gjitha vendet e përmendura më sipër flasin me bukuritë e tyre natyrore dhe të pothuaj të paceshura, me trashëgiminë e tyre kulturore, agroturistike dhe kulinare, me folklorin, etnografinë dhe artizanatin, por edhe me shumë elementë të tjerë që e bëjnë tepër tërheqës turizmin në këto vende, si një shërbim tërësisht për tu integruar të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky do të ishte një nga mjetet më të mira për tu lehtësuar, thjeshtësuar dhe shpejtuar atyre procesin e gjatë dhe të « lodhshëm » të integritimit në BE. Ambasadorja e BE në Tiranë, Vllahutin (kroate) theksoi kohët e fundit se : « *Integrimi në BE do të vijë nga bashkëpunimi jo vetëm me BE, por edhe me njëri-tjetrin. Dera e anëtarësimit është e hapur dhe nuk keni kohë për të humbur. Vendet e Ballkanit I kanë të gjitha mundësitë për të bashkëpunuar ngushtësisht sipas modelit të shteteve të BeNeLux-it (Belgique-Nederland-Luxembourg), pa cënuar sovranitetin, por duke u mbështetur në tregje të pandashme si energjia, infrastruktura dhe turizmi* ».

Pikërisht mbi këtë të fundit shtrohet sfida jo vetëm e njehsimit të tregut rajonal turistik por edhe e ushtrimit të kontrollit mbi të, për krijimin e një tregu të përbashkët ballkanik, (pa kaluar ende në fazën e fundit të bashkimit doganor), sikurse u shpreh para do kohe edhe Kryeministri Zajev I Maqedonisë. Turizmi është një vision dhe si I tillë është e nevojshme kalimi në atë që njihet si koncepti I “Turizmit të Integruar dhe të Qëndrueshëm”. Ndaj dhe autorët e këtij punimi mendojnë se në këtë sfidë turizmi

shqiptar nuk duket se do të jete dhe nuk duhet të jetë I vetëm. Pikërisht përballjen me këto sfida përpiqet ti japë zgjidhje ky punim. Një nga këto sfida do të jetë që në hapat e para kontrolli mbi këtë treg turistik rajonal dhe këtu del si domosdoshmëri njehsimi I një të drejtë konkurence të rajonit dhe krijimi I një institucioni koordinator dhe kolegjal, selia e të cilit mund të zhvendoset me rotacion në kryeqytet e vendeve themeluese te tij. Por për të arritur në këtë zgjidhje do duhet të ekspozojmë se cilat janë të përmbashkëtat dhe diferencat e legjislacioneve të konkurrencës në këto vende. Nga këto vende, ende të pa-integruara, por që shquhen nga një popullsi dhe territor, I mjaftueshëm edhe për të qenë një treg I vetëm, (sikurse Serbia dhe BiH) mundet edhe ta përballojnë të vetëm këtë sfidë, ndërkohë që për vende si Shqipëria, Mali I Zi, Kosova dhe FYRO Maqedonisë, me pothuaj të njëjtat parametra të tregjeve turistike të kufizuara e të pamjaftueshme në thithjen e konsumatorëve të mëdhenj të turizmit, por nga ana tjetër edhe kufitarë në parqe dhe resorte turistike me njëri-tjetrin, zbatimi I Turizmit të Integruar kërkon integrimin e tureve ballkanike nëpër këto vende. Ndaj edhe krijimi I një tregu unik turistik dhe I një të drejte konkurence që të ushtrojë kontrollin mbi këtë treg është tashmë jo vetëm një domosdoshmëri, por edhe një problem I shtruar për zgjidhje. Por cila është aktualisht gjendja e legjislacionit të konkurrencë ne këto 4 vende me burime të kufizuara turistike:

Kuadri ligjor I së Drejtës së Konkurrencës në Shqipëri përbëhet nga Ligji 9121, datë 28.07.2003 “ Për Mbrojtjen e Konkurrencës” I ndryshuar disa herë dhe sidomos në mënyrë të konsiderueshme me ligjin 10317, datë 16.9.2010. Gjithsesi si fond bazë të tij mund të përmendim edhe :

- Zhvillimin dhe nevoja për një rritje ekonomike të qëndrueshme;
- Përballimin e sidave përballë proceseve të Botërorizimit, (paraprakisht rajonizimit);
- Përfshirjen e vendit/eve ne Bashkimin Evropian.

Ky sfond baze ka sherbyer edhe per te Drejten e Konkurences ne vendet e rajonit sidomos te atyre qe jane ne prag te antaresimit ne dhe integrimit ne BE, sikurse pervec Shqiperise edhe Maqedonia dhe Kosova.Serbia nuk e ka kaluar ende tërësisht në një organ krejtësisht të pavarur në vendimarrje, ndërsa Mali i Zi e ka vetëm në rrang departamenti këshillues në ministrinë e linjës që mbulon tregjet.

Nisur nga interpretim historik të temës së marrë në trajtim mund të shprehem se e Drejta e Konkurrencës ne Shqiperi i ka fillesat e saj ne vitin 1995, me ligjin 8044, por ky ligj nuk përcakton ndonjë institucion publik, mirfilltazi përgjegjës dhe të pavarur në vendimarrjet e tij si ruajtës të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si një e mirë publike në ndihmë dhe përkrahje të konsumatorit dhe të aktorëve të tregut. Ai thjesht ngarkonte një nga drejtoritë, e ministrisë së lëmisë së ekonomisë, të « pagëzuar » me emrin e « Konkurrencës », me vëzhgimin e konkurrencës në treg dhe raportimin më pas pranë ministrit epror të dukurive qe ajo mund të konstatonte. Ishte pra thjesht më tepër në rolin e një organi konsultativ për ministrin përkatës.

Përkundrazi ligji në fuqi, nr.9121 përcakton Autoritetin e Konkurrencës si «truproje » mbrojtëse të konkurrencës në treg. Pra do të thoshim se është në rolin e një « Serapizi », (perëndia mbrojtëse e tregjeve tek grekët e vjetër), për ekonomine shqiptare.

Ndër karakteristikat kryesore të këtij ligji do të nënvizonim:

*Hapësirën e veprimit ose fushëveprimin, si një ligj me veprim të përgjithshëm në të gjithë sektorët e ekonomisë;

*Marrëdhënie komplekse ndërmjet politikës së Konkurrencës dhe politikave të tjera ekonomike të tilla si p.sh. ato tregtare.

*Vlerësimi i konkurrencës si faktor nxitës i ekonomisë, e që shërben në frenimin e vendosjes së një “Diktature Tregu”

Sic theksuam edhe më lart organi administrativ që kujdeset si një “qen-roje” për konkurrencën është Autoriteti i Konkurrencës, kompetencat e të cilit dhe mënyrat e funksionimit të tij jepen në nenet 18-31 të ligjit “organik” të cilin po e shtjellojmë në këtë punim. Ai shërben si një mjet administrativ për sigurimin, mbrojtjen dhe respektimin e Parimit të « Konkurrencës Efektive në Tregjet e Lira ».

Në vetvehte Autoriteti është një institucion administrative, publik, i pavarur në vendimmarrjet e tij dhe që përbëhet nga :

1. Struktura Vendimmarrëse-Komisioni i Konkurrencës. Ai është një strukturë kolegjiale 5 anëtarëshe e zgjedhur nga Kuvendi; dhe

2.Struktura ekzekutivo-zbatuese e tij Sekretariati.

Vendimet e Komisionit janë të ankimeshme vetëm gjyqësisht, por jo administrativisht në organet e prora të tij.

Autoriteti mund të nisë procedurat hetimore me nismën e tij në të gjitha rastet kur vëren se ka shkelje të dispozitave të ligjit në fjalë.

Nga aspekti i strukture organizative një element që duhet vlerësuar për rajonin është rasti i amendimeve që ju bëjnë para do kohësh edhe ligjit maqedonas të konkurrencës. Sipas amendimeve është parë me vend që brenda autoritetit të krijohet edhe një strukturë për mbarevajtjen e Procedurës për Kundërvajtje Administrative, i përbërë prej personash zyrtare të autorizuar nga Kryetari i Komisionit të Konkurrencës. Në këndvështrimin tim ky është një instrument që ndikon në rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së Komisioneve të konkurrencës dhe një përvije për të përfshirur edhe nga vende të rajonit tek të cilat vështirësitë e zbatimeve të konkurrencës shfaqin të njëjtat « simptoma ».

Veprimtaria e Autoritetit në zbatim të ligjit, 9121, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe në identifikimin e shkeljeve, ose kufizimeve të konkurrencës bazohet në shfaqjen e 3 dukurive të mëposhtme antikonkuruese:

*Marrëveshjet e Ndaluara, ose siç njihen sipas nocioneve të ndryshme të konkurrencës si Truste (vendet anglofone), ose Kartele në vendet gjermanike;

*Abuzimi me Pozitën Dominuese (individuale, ose kolektive);

*Përqëndrimet dhe kontrolli i tyre me synim zvogëlimin e rrezikut të krijimit të Pozitave Dominuese, me të cilat si pa e kuptuar edhe mund të abuzohet me to.

I.) Marrëveshjet e Ndaluara. Sa për historik element i parë është Akti Sherman, (me emrin e propozuesit të tij Xhon Sherman, ish senator i Ohajos, i vitit 1890), ose që njihet ndryshe si Deklarata e Uashingtonit. Ai propozoi përmes këtij akti ndëshkimin e marrëveshjeve cmim-fiksuese dhe tregndarëse në dëm të konkurrencës dhe të konsumatorëve. Pra siç shihet shkelja e parë kufizuese e cila

themeloi edhe të Drejtën e Konkurences janë Marrëveshjet e Ndaluar të tipit Trust, ose Kartel ndaj dhe shpesh institucionet e autoriteteve të konkurencës në botë janë themeluar si institucione Antitrust, ose Antikartel. Kuptohet më vonë edhe në ditët e sotme në varësi edhe nga specifika e vendit këtyre institucioneve ju janë veshur kompetenca edhe për luftimin e shkeljeve të tjera të mëvonshme të cilat kanë shërbyer edhe si bazë për krijimin e një disipline të re të së drejtës e cila me kalim kohës gradualisht u shkëput nga e Drejta Tregtare dhe u kristalizua si e Drejta e Konkurencës.

Po çfarë janë në vetvete e Marrëveshjet e Ndaluar (sikurse njihen në Francë me këtë emër), Trustet në SHBA, ose Kartelet në Gjermani? Janë ato marrëveshje të dëmshme hapura ose të fshehta, të formalizuara ose jo, të cilat kanë për pasojë kufizimin e konkurencës në « tregun perkates », përmes fiksimit të çmimeve, ndarjes së tregjeve të shitjes ose furnizimit me lende të para, zbatojnë kushte të jo të njëjta tregtare për transakcione të njëjta, si dhe që çojnë në kufizimin e prodhimit dhe shitjeve, zhvillimit teknik, investimit dhe të konkurences. Hasja e marrëveshjeve të këtij lloji sjell ndalimin e tyre nga ana e Autoritetit të Konkurencës (AK nën 4 I ligjit). Në varësi nga fushëveprimi i tyre marrëveshjet ndahen sipas disa kategorive. Kështu mund të përmendim Marrëveshjet Horizontale, ato Vertikale, ato me Rëndësi të Vogël (de Minimis), ato të Licencencës (Franchising) ndërsa nga mënyra e përjashtimit mund të ndahen Marrëveshje të përjashtuara Individualisht dhe ato të Përjashtuara me Rregullore në Kategori, ose në Bllok (Block exception). Marrëveshjet Horizontale janë ato të cilat veprojnë në të njëjtin nivel të tregut, të prodhimit përpunimit dhe shpërndarjes.

Marrëveshjet Vertikale lidhen ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në nivele të ndryshme të tregut me synim kryesisht vendosjen dhe fiksimin e çmimeve minimale.

Marrëveshjet me Rëndësi të Vogël (de Minimis) kategorizojnë ato marrëveshje të cilat nuk kufizojnë ndjeshëm konkurrencën për shkak të pjesës së vogël që zënë këto ndërmarrje të lidhura në marrëveshje të këtij lloji, pjesë që së bashku nuk shkojnë më shumë se 10-15% të tregut sipas potencës aktuale të ndërmarrjeve të lidhura në të tilla marrëveshje. E Drejta e konkurencës kuptohet që jep mundësitë e saj lidhur me përjashtimin e këtyre marrëveshjeve nga ndalimi dhe ndëshkimi dhe kjo parashikohet atëherë kur dëmi që mund të sjellin këto marrëveshje është tepër i vogël në krahasim me progresin teknologjik ose teknik zbatimi i këtyre marrëveshjeve dhe kur ky motiv mund të sjellë në një të ardhme të afërt përfitim të drejtëpërdrejtë për konsumatorët të cilët janë edhe përfituesit fundor të zbatimit të konkurencës. Përsa i përket ligjit kosovar të konkurences dhe konkretisht Ligjit Nr. 2004/36 Datë 08.09.2004 “Për Konkurrencën”, mund të themi se ai nuk përfshin qoftë de Minimis edhe ato me qëllim në vetvete *per se*.

Ndërkohë përjashtimi i kategorive të marrëveshjeve bëhet mbi bazën e akteve nënligjore të miratuara nga Autoriteti. Ndër këto mund të përmendim Marrëveshjet e Kërkim-Zhvillimit, ato të Specializimit, ato të Transfertave teknologjike etj. Identifikimi i individual i një marrëveshje në kategorinë e njëjës prej tyre të evidentuar më lart sjell përjashtimin automatikisht të tyre prej ndalimit dhe ndërkushtimit pa patur nevojën e lejes nga ana e Autoritetit sikurse zbatohet për marrëveshjet e përjashtuar individualisht prej Autoriteti sipas një njoftimi që do duhet të bëjnë ato atje paraprakisht.

II) Pozita Dominuese dhe Abuzimi me të. (Nenet 8-9 të ligjit). Paraprakisht përcaktohet si Pozitë Dominuese në treg aftësia e një ose disa ndërmarrjeve për të vepruar në mënyrë të pavarur nga ana e ofertës dhe/ose kërkesës në lidhje me sjelljen e pjesëmarrësve të tjerë të tregut (p.sh. konkurrentët, klientët dhe sidomos konsumatorëve) kryesisht në vënien e çmimeve. Për këtë do të duhet të merret në konsideratë një sërë faktorësh sikurse janë: Fuqia e Tregut (market power); pjesa e tregut e ndërmarrjes/ve në analizë, pengesat në hyrje, asimetria e tregut, fuqia kundërvepruese e blerësve, përqëndrimi i tregut, etj.

Nisur nga sa përkufizuam më sipër rezulton se Pozita Dominuese mund të jetë Individuale (1 ndërmarrje- monopol), ose kolektive(duopoli, ose oligopol). Gjithsesi ligji nuk e ndalon ekzistencën e Pozitës Dominuese të ndërmarrjeve, kjo për faktin kur ndërmarrja mund të mos jetë fajtores për gëzimin e kësaj pozite. Megjithatë tradicionalisht është gjykuar se Monopoli ose Oligopoli dashur pa dashur kanë çuar në kufizim të konkurrencës, ose minimizim të saj dhe si dukuri nuk sjellin ndonjë të mirë për tregun e zotëruar prej tyre, pra edhe për konsumatorin. Duke ju referuar disa prej korifejve të mendimit shtetformues, ose ekonomik botëror në vite po rradhis disa aforizma dhe thënie prej tyre. Adam Smithi në veprën e tij “Kërkimi mbi natyrën dhe shkaqet e Pasurimit të Kombeve” e njohur shkurt si “Pasuria e Kombeve” në 1776 do të shprehej:

”Monopoli është një armik i madh i administrimit të mirë”

Ndërkohë që 10 vjet më vonë Frederiku I Madh I Prusisë do të shprehej si vijon mbi joefektshmërinë e Monopolit: *“Në se hekuri dhe çeliku do të prodhoheshin në vend, kjo sigurisht është një gjë e mirë; por se unë nuk do të doja ti kisha si monopol, pasi ky sjell gjithmonë një mall të zakonshëm. Monopolisti nuk tregon asnjë zell dhe dashuri për punë të drejtë lidhur me detyrimin, sepse ai nuk ka askënd pranë që të matet dhe të konkurojë me të. Nga ky rrjedh fakti që ai neglizhon në punën e vet dhe si rezultat do të prodhojë mallrat ë këqija. Por pot ë qe so do të kishte dikë tjetër pranë që ta konkuronte, ky (monopolisti) do të detyrohej kështu prej pranisë së tjetrit në treg që të tregojë më tepër zell dh të prodhojë një mall më cilësor.”*

Nisur nga këto parakushte, sigurisht qënia në pozitë dominuese (ose Monopoliste) e një ndërmarrjeje e ngarkon atë me një përgjegjësi më të madhe në respektimin e konkurrencës sesa ndërmarrjet të cilat nuk e gëzojnë këtë pozitë. Kjo për shkak të fuqisë së tyre e cila në zbatimin e masave fitimprurëse mund të sjellin pasoja më të rënda për konsumatorët dhe konkurrencën. Kjo edhe për një arsye tjetër, pasi në këto lloj tregjesh ku evidentohen zotërime Mono-ose Oligopoliste dhe si rezultat i tyre konkurrenca nga natyra është më e dobët dhe për rrjedhojë do duhet të ndalohet cdo veprim që pengon më tej konkurrencën. Meqenëse ky prag kalohet lehtë dhe fare mirë edhe pa e ndjerë konkurrenca mund të shkelet mirfilltazi është gjykuar që të Abuzimi me Pozitën Dominuese që mund të zotërojnë ndërmarrjet të ndëshkohet nga ligji për shkak të pasojave që mund të sjellë mbi të.

Por cilat mund të përmenden si raste klasike abuzimi nga pozitat e një Pozite Dominuese? Mund të përmendim ndër të tjera si:

Lidhja e klientëve me një detyrim furnizimi ekskluziv për një mall të caktuar është abuzim me pozitën Dominuese sepse –Pengon klientin të zgjedhë lirisht burimet e furnizimit dhe i kushtëzon përzgjedhjen e tij, si dhe orientimin sipas ofertave më të leverdisshme; dhe –Pengon hyrjen në treg të prodhuesve të tjerë të këtij malli ose përjashton prodhuesit ekzistues. Por në këtë kuadër mund të përmenden edhe raste të tjera praktikash abusive në kurriz të konkurrencës sikurse janë Cmimet tepër të larta (excessive price), cmimet “grabitqare”(predatore), trajtimet diskriminuese me çmimet, etj.

Lidhur me ligjin e konkurrences ne Kosove shprehem se lidhur me kete nocion mungon perkufizimi I tij dhe po keshtu edhe per Abuzimin me Poziten Dominuese dhe qe shpresoj qe nje mangesi e tille te jete plotesuar ose te plotesohet ne te ardhmen pasi perben nje domosdoshmeri.

III)Përqëndrimet dhe Kontrolli i tyre. (Nenet 10-13; etj) Lidhur me këtë institute të së drejtës Konkurrencës do të kishim shtjellimin e Përqëndrimit në vetvehte. Themi se jemi para një rasti të tillë

kur kemi të bëjmë me raste jo mbledhëse dhe jo vetëm kur edhe vetëm njëri prej tyre mund të konsiderohet si përqëndrim dhe konkretisht:

-1.Bashkime juridike dhe faktike të dy, ose më shumë ndërmarrjeve Brenda të njëjtit treg përkatës dhe sidomos së të njëjtit (Treg Perkates) Zonë Gjeografike;

-2.Përfitim i kontrollit mbi 1 ose më shumë ndërmarrje nga ana e një ndërmarrje tjetër tashmë pjesmarëse në tregun përkatës;

-3.Krijimi I një ndërmarrje të re Përbashkët e tipit *joint venture* si rezultat I kontributit të dy ose më shumë ndërmarrjeve të tjera;

Këto lloje përqëndrimesh mund ti hasim në formën e Shkrirjeve, bashkimeve, me perthithje ose jo.

Arsyeja se përse ligji kërkon domosdoshmërisht mbajtjen nën kontroll të përqëndrimeve lidhet me faktin se Shkrirjet (fusionet) bashkimet faktike, ose juridike mund të cojnë indirekt (jodrejtëpërdrejtë), ose/dhe rrezikojnë të cojnë në forcimin e pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve me prirje drejt monopolizimit të tregut, i cili sikurse theksuam edhe më lart jo vetëm sjell një dobësim të konkurrencës në treg, por edhe rrit mundësinë e abuzimit me këtë pozitë, e cila përbën një shkelje të drejtëpërdrejtë të parimeve të konkurrencës. Në këtë pikë do desha të sjell në vëmendje të lexuesve edhe një shprehje kuptim plote prej Sër Xhon Hiksit në librin e tij të vitit 1935 “Teoria e Monopolit” ku ndër të tjera shprehet:

“Më e mira e përfitimit nga një Monopol është vetëm një jetë vegjetuese”.

Ne kete kuader desha te ve perseri ne dukje faktin e mungeses se nocionit te perqendrimeve dhe kontrollit mbi to ne ligjin kosovar te konkurences, per me teper edhe formen e fusioneve e kane parashikuar ne kuader te marreveshjeve te ndaluara gje qe nuk klasifikohen ne kuader te perqendrimeve ashtu si eshte vendosur fusion ne ligjin e konkurences te Shqiperise.

Gjithsesi duke ju kthyer trajtimit te nocionit te perqendrimit themi duhet qartësuar se përse është i nevojshëm kontrolli i përqëndrimeve natyrshëm do duhet të kalohet se nga ç’kufi do duhet nisë ai që quhet Pragu i Kontrollit të një Përqëndrim. Për këtë është parë e arsyeshme dhe përvoja e ka treguar ky prag do duhet të ulet vazhdimisht në mënyrë që të arrihet një përputhje dhe mbrojtje sa më e mirë e tregjeve nga ana e këtyre bashkimeve. Ne kete aspekt mund te konstatojme se ka pasur nje proces ne rrugen jo te duhur, ne kendveshtimin tim, ne legjislacionin maqedonas ku me amendimet qe I jane bere ligjit para ca kohesh verehet nje ngritje e ketij pragu qe do te sjelle per pasoje nje moskontroll ten je kategorie te caktuar perqendrimesh duke mundesuar rritjen e shkalles se kufizimeve te konkurences ne tregun perkates.

Kur rasti I Shqiperise ka ecur ne kahjen e duhur. Aktualisht nisur nga nevojat e vendit për një kontroll sa me të mirë të përqëndrimeve mendryshimet që I janë bërë ligjit aktual është gjykuar që xhiroja e ndërmarrjeve që përqëndrohen nisë që nga masa prej 50 milione Euro në tregun ndërkombëtar dhe në tregun e brendshëm prej 2-4 milionë Euro në tregun e brendshëm. Po kështu është vendosur një zgjatje e fatit të njoftimit të përqëndrimit nga 1 javë në 1 muaj nga dita e nënshkrimit përfundimtar të kontratës së përqëndrimit ku afati nis nga nënshkrimi I fundit si rezultat I qarkullimit të kontratës përqëndruese. Kurse llogaritja e xhiros do të merret për bazë nisur viti parardhës I para viti të linëshkrimit të kontratës. Detyrimi për njoftim në Autoritet lidhet me faktin e vlerësimit nga ky I

fundit të shkallës së prekjës së konkurrencës nga ana e përqëndrimit të këtyre ndërmarrjeve. Kuptohet për ndërmarrjet të cilat nuk sjellin ndonjë rrezik për konkurrencën Autoriteti mund të lejojë kryerjen e përqëndrimit ose lejin e tij me kushte dhe detyrime të cilat minimizojnë rrezikun që mund të sjellë përqëndrimi. Në këtë pikëpamje ligji ka përcaktuar edhe rastet se kur përqëndrimi lejohet I kushtëzuar dhe cfarë masash e kushtëzojnë atë, si dhe periudhën brenda së cilës do duhet të implementohen këto kushte.

Dispozitat e ligjit përcaktojnë se kur lejohen përqëndrimet e kushtëzuara dhe masat korigjuese që do duhen ti jepen ndërmarrjeve.

Këto masa paraprake mund të jenë të formës: -strukturale;

-detyrime kushtëzuese për të vepruar në një mënyrë të caktuar.

Qëllimi I marrjes së këtyre masave është eliminimi I rrezikut të krijimit ose forcimit të një pozite dominuese.

Masat duhet të jenë proporcionale me pasojat negative që sjell operacioni I përqëndrimit. Pjesmarrja e ndërmarrjeve në procesin e zgjedhjes së masave korigjuese garantohet nga ligji.

Arsyeja thelbësore pse vendosen këto masa është se një zgjidhje e negociuar zbatohet më mirë nga ndërmarrjet.

IV) Procedurat administrative. Këto procedura përfshijnë gjithë mënyrat e veprimit të monitorimeve dhe fazave hetimore në rastet e vlerësimit të provave mbi shkeljet, ose jo të konkurrencës, si dhe dhëniet e Autorizimeve me kushtë dhe detyrimeve, të përkohshme dhe përfundimtare mbi lejin ose ndalimin e Përqendrimeve dhe përjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimi, koncepte të cilat në I cekëm përkritazi dhe më lart.

Procedurat administrative zbatohen mbi bazën e dispozitave që parasheh ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe në mungesë të tyre zbatohen edhe procedurat e Kodit të Procedurave Administrative të Shqipërisë. Përveç fazës monitoruese për cdo treg, e cila është një detyrë e vazhdueshme e Autoritetit ky I fundit ndërmerr edhe procedura hetimore të cilat në vetvete ndahen sipas tre fazave të hetimit.

Nisma hetimore mund të vijë si rezultat I kërkesës nga organet e tjera të administratës, me kërkesë të të tretëve, ose edhe kryesisht cka nënkupton nismën e vet institucionit për hapjen e hetimeve.

Ligji përcakton këto faza të hetimit:

1) **Procedura e Hetimit në një Sektor të Ekonomisë**, (neni 41 I ligjit) brenda të cilit mund të përfshihen edhe më shumë se një treg.

2) **Procedura e Hetimit Paraprak**, (neni 42) e cila parasheh të drejtën e hapjes së një hetimi, kur tashmë tregu dhe ndërmarrja/et, të cilat dyshohen se me veprimet, ose mosveprimet e tyre kanë cënuar ose kufizuar konkurrencën. Përfshirja dhe vendosja e ndërmarrjes/ve nën një hetim paracakton detyrimin e tyre për vënien në gatishmëri ndaj cdo kërkesë që mund ti adresohet nga ana e Autoritetit, gjë që nuk është e detyrueshme në fazën e monitorimit të tregut, e cila përmbillet kryesisht vetëm mbi bazën e të dhënave të marra nga të tretë, ose lehtësisht të gjendshmë, ose të marrura nga të dhënat

publike të hedhura për informim nga ana e institucioneve shtetërore. Në Fazën Paraprake të Hetimit një rol parësor merr pala e tretë, e cila bën kallëzimin e shkeljes së dyshuar, I cili gëzon të drejtën e ruajtjes së anonimatit të tij sa herë që vet ankuesi e gjykon këtë fakt të arsyeshëm. Kjo nënkupton që me paraqitjen e një ankese nga ana e një subjekti, (përgjashtuar rastin kur ankesa është për shkelje të dyshuara, të cilat të cilat që në fillim të herës dhe sipas deklarimeve të vetë ankuesit, rezulton që të jetë jashtë juridiksionit dhe kompetencës lëndore të Autoriteti të Konkurencës, I bazuar në punën e tij në Ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurencës”) Autoriteti në vetvehte është faktikisht I detyruar që të hapë një hetim mbi ndërmarrjen dhe në tregun objekt-ankese. Kjo është ndofta arsyeja kryesore përse ligjvënësi e ka paraparë si të panevojshme, që për hapjen e kësaj faze hetimore, të kërkohej detyrimisht dhe gjithmonë vendimmarrja e Komisionit të Konkurencës, duke u mjaftuar vetëm me një shprehje vullneti të tij ndaj nismës së Sekretariatit. Në këtë fazë të hetimit palëve object-hetimi, por edhe jo vetëm atyre nuk u njihet e drejta e konsultimit me brendinë e dosjes hetimore. Kjo masë shërben për të eliminuar dhe zvogëluar pambarimisht mundësinë palëve të aluduar si shkelëse, për të manipuluar provat dhe “gjurmët” e shkeljeve që mund të kenë kryer, për mos dekonspiruar elementët e hetimit, si dhe për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave që përmban dosja hetimore.

3) **Procedura e Hetimit të Thelluar**, (neni 43) është faza më e rëndësishme e hetimit dhe “preludi” I rezultateve të tij. Kalimi në këtë fazë presupozon që tashmë janë identifikuar qartazi shenja të kufizimit të konkurencës. Përfundimet e kësaj faze do të duhen të hidhen në formën e Raporti, cili hartohet nga Grupi përkatës I Punës, I cili ka kryer hetimin në të gjitha hallkat procedurale të tij. Gjithsesi Raporti përfundimtar mbetet vepër e Sekretariatit dhe do duhet të paraqitet Komisionit nga Sekretari i Përgjithshëm, si titullari administrativ I Sekretariatit. Gjatë punës hetimore mund të ndodhë që tregu të ketë nevojë emergjente për ndërhyrje administrative nga ana e Autoritetit, atëherë në këtë rast ky I fundit mund të urdhërojë edhe marrjen dhe vendosjen e një regjimi masash të përkohshme, me synim ndalimin e përkeqësimit të gjëndjes së konkurencës në treg dhe eliminimin, ose shmangien e dëmeve të riparueshme në një kohë më të mëvonshme.

Komisioni pasi shqyrton raportin, që efektivisht identifikon pronocimin e njëres palë që në këtë rast është ajo e Sekretariatit, ka për detyrim, përpara vendimmarrjes së tij, për një gjykim sa më të plotë dhe më objektiv, si dhe për të respektuar Parimin e Barazisë së palëve në një shqyrtim administrativ, tu japë mundësinë palëve të hetuar dhe të prekura nga përfundimet e Raportit për tu dëgjuar dhe për të shprehur kundërgargumentat e tyre ndaj raportit. Më pas ai me shumicë votash, në funksion të bindjes së brendshme, të krijuar nga ballafaqimi I provave dhe fakteve, do të vendosë mbi pranimin (tërësisht ose pjesërisht) të rezultateve hetimore, mospranimin e raportit dhe/ose mbylljen e hetimit. Në rastet e pranimit, ose mospranimit të përfundimeve të Raportit, por kur kjo konvergjon me një shkelje të konkurencës në treg, të identifikuar kjo e fundit, ose nga raport’hartuesit, ose nga vetë Komisioni, ky vendos sanksione kryesisht në formën e gjobave të ndryshme të parashikuara në ligj. Në të kundërt kur vetë përfundimet e raportit kovergojnë me gjykimin e Komisionit, për mosekzistencën e fajtorit mes të hetuarve dhe ardhjen e kufizimeve të konkurencës nga faktorë jashtë fushëveprimit të ligjit, atëherë Komisioni merr vendimeve përmes të cilave synon të këshillojë dhe tu rekomandojë institucionet/ve e tjera publike masat që duhet të ndërmerren për shëndoshjen dhe përmirësimin e situatës së konkurueshmërisë në treg. Gjithsesi Komisioni ruan të drejtën e tij për tërhequr, ose ndryshuar dispozitivin e vendimit të tij mbi hetimin dhe rifillimin e këtij të fundit, sa herë që konstaton ndryshim të fakteve/ të dhënave të vendimmarrjes.

Edhe **procedurat për autorizimin** ose jo të **përqëndrimeve**, si dhe të **përgjashtimit nga ndalimi të marrëveshjeve** kategorizohen në rradhën e procedurave administrative.

Edhe Procedurat e Autorizimit të përqëndrimeve, megjithëse nuk kërkojnë nevojën e një hetimi, përseri pothuaj u përmbahen atyre fazave kryesore të hetimit sikurse përmendëm më lart, pra atë Paraprake dhe të Thelluar. Pas ezaurimit të këtyre fazave Autoriteti mund të vendosë ose Autorizimin (e Përkohshëm, ose Përfundimtar), ose Ndalimin e përqëndrimit. Ndërmjet këtyre mund të lëvrohet edhe autorizimi I përqëndrimit me kushte dhe detyrime, të cilat në rast mospërmbyshjeje mund të prapsojnë vendimin e Komisionit për autorizim. Në këtë aspekt do desha të evidentoja nevojën e futjes së një “shtylle” të tillë edhe në ligjin kosovar të Konkurencës, madje do desha të sugjeroja vendosjen e një pragu të xhiros vjetore të ngjashëm me atë të ligjit maqedonas, I cili fillimisht ishte në masën e 5 Milion Eurove dhe me amendimet e para 3 vjetëve u dyfishua me 10 Milion Eurove. Gjithsesi edhe në këtë masë është një shifër e cila I lejon autoritetit maqedonas të ushtrojë një kontrollë në nivele të konsiderueshme të përqëndrimeve deri në këto nivele. Ndërsa krahasuar me ligjin e Shqipërisë dhe popullatën e saj në nivelin e 50 Milion Eurove ky I fundit është shumë e lartë. Njehsimi I parametrave të përqëndrimeve në këtë rast do të vlente së tepërmi edhe për një kontroll më të mirë të atyre që njihen si Përqëndrime ndërkuftare (Cross-Border’s Mergers). Të njëjtën gjë do sugjeroja edhe për elementët e Abuzimit me Pozitën Dominuese ku mungojnë ato që njihen si “çmime grabitqare” (predatory pricing). Ky element mungon në të dy ligjet dhe do të ishte më se nevojshme ripërfshirja në këtë legjislacion specifik.

Si përfundim mund të themi se rritja e konkurencës dhe vënia në zbatim e saj kërkojnë:

*Bashkëpunim të ngushtë ndërmjet hartuesvë dhe zbatuesve të politikave publike të vendeve jo-anëtare të BE, të rajonit;

*Njehsimin e legjislacionit në fushën e konkurencës;

*Mbështetje institucionale nga « aktorët » që veprojnë në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të vendit ; si dhe

*Një masë e mirë në këtë rast do të ishte hartimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit dypalëshe dhe rajonale.

Kjo do të sillte më afër krijimit të një qendre rajonale koordinuese të konkurencës në Ballkan. Kjo mund të materializohet edhe në kuadër të pjesmarrjes së vendeve tona në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë, ose sic njihet CEFTA. Kemi parasysh këtu faktin që me anëtarësimin e Malit të Zi tashmë edhe në OB Tregtisë, por edhe qënien e Shqipërisë anëtare të OB Turizmit (madje edhe me pjesmarrje me një nga Zv/Kryetarët e saj) krijimi i një qendre rajonale rotative të kontrollit të konkurencës në tregjet e 4 shteteve të Ballkanit Perëndimore, ose të paktën për kontrollin e përqëndrimeve turistike ndërkuftare (cross-border mergers kontroll) të “Beneluksit” të Ballkanit Perëndimor do të conte drejt vendosjes së rregullave të përafërta paranëtarësuese në BE dhe pse jo edhe anëtarësimin në bllok të këtyre vendeve në BE duke ua lehtësuar mbështetjen ideatorëve austriakë të këtij bashkimi të përkrahur fuqimisht edhe nga Kancelarja e RFGJ.

RËNDËSIA E KRIJIMIT TË SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHËNDETSORE NË KOSOVË

Ma.Ph.D. Haqif Arifi, -
Universiteti i Tetovës,,tetovë
aqif_1960@hotmail.com
Prof.Dr.Naser Raimi,
-Universiteti i Tetovës,,tetovë
n_raimi@hotmail.com

Abstrakti

Meqenëse fondet ekzistuese dhe metodat e financimit të shëndetësisë publike aktualisht nuk mund të plotësojnë dhe t'iu përgjigjen nevojave në rritje e sipër, në këtë punim do të ofrojmë modele efikase të implementimit të sistemit të sigurimeve shëndetësore duke reflektuar nevojën e rritjes së nivelit të shpenzimeve në sektorin publik shëndetësor për te ofruar mbrojtje nga rreziqet financiare për familjet/individët, duke zvogëluar pagesat që financohen nga xhepat e pacientëve, drejtpërdrejtë për shërbime.

Në këtë hulumtim pra do të trajtohet nevoja për fillimin e zbatimit të sistemit të sigurimeve shëndetësore në Kosovë. Rëndësia e rritjes së financimit të sistemit shëndetësor në Kosovë dhe analiza e një sistemi të sigurimeve shëndetësore që do të mund të aplikohet në Kosovë, që paraqitet si detyrë kryesore e këtij hulumtimi bazohet në të dhënat relevante, të cilat dëshmojnë për nevojat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës për të siguruar shërbime shëndetësore efikase dhe profesionale.

Fjalët kyqe: Financimi i shëndetësisë, sigurimet shëndetësore, primi i sigurimeve, Fondi i Sigurimeve shëndetësore

1.HYRJE

1.1. Në përgjithësi mbi sigurimin shëndetësor

Në esencë, një sistem i sigurimit shëndetësor është një sistem financimi i sektorit shëndetësor dhe shërbimeve shëndetësore që duhet t'i plotësojë nevojat shëndetësore të popullatës. Ekzistojnë dy komponentë kryesorë të sistemit të financimit shëndetësor⁸⁴. Së pari, sistemi i sigurimit shëndetësor i përcakton burimet e financimit, i mbledh/akumulon dhe i menaxhon ato. E dyta, fondet e mbledhura

⁸⁴ Dobnikar B. Sector Wide Approach in Health: Feasibility Study and Mapping " Analysis of Health Sector Legal Framework Report." Projekt nga fondet e BE-së i implementuar nga EPTISA 2010, fq. 68.

përdoren për t'i blerë shërbimet që i plotësojnë nevojat shëndetësore të popullatës. Ky është një sistem që vazhdimisht ka nevojë për përpunjen dhe baraspeshën e nevojave të popullatës, me fondet të cilat janë në dispozicion për blerjen e shërbimeve.

Duhet të kemi parasysh faktin se nevojat shëndetësore janë të pakufizuara ndërsa burimet financiare janë gjithmonë të kufizuara. Kjo tregon se një skemë e sigurimit shëndetësor kurrë s'mund të jetë e përkryer. Kjo vlen për Kosovën e madje edhe për shumicën e vendeve të zhvilluara në botë. Suksesi i sistemit të sigurimit shëndetësor arrihet duke gjetur një baraspeshë sa më të mirë të këtyre dy anëve (nevojave dhe fondeve).

Baraspesha e cila i mbulon nevojat më të gjera dhe më të rëndësishme të popullatës, me fondet në dispozicion është një situatë ideale. Njëra nga "zhurmat" që pengojnë rregullimin e kësaj baraspeshe ideale është ndikimi i konfliktit të interesit që vjen nga pjesëmarrësit e ndryshëm në sistemin e sigurimit shëndetësor. Disa nga palët kyçe janë: qytetarët, grupet e pacientëve dhe shoqëria, profesionistët shëndetësorë dhe organizatat që përfaqësojnë ata, Ministria e Shëndetësisë, Fondi për Sigurimin Shëndetësor, spitalet, etj. Të gjithë kanë interesa të caktuara. Këto shpesh mund të jenë konkurrenca e madje në konflikt njëra me tjetrën.

Për të parandaluar ndikimin negativ mbi baraspeshën ideale të një sistemi shëndetësor, sistemi duhet të rregullojë sjelljet e të gjithë pjesëmarrësve në skemën e sigurimit shëndetësor. Një sistem i sigurimit shëndetësor duhet të definojë dhe zhvillojë një varg mekanizmesh që e rregullojnë baraspeshën në mes të nevojave dhe fondeve në dispozicion. Mekanizma të tillë do t'i mundësojnë demokracisë (procesin e vendimmarrjes ku marrin pjesë qytetarët dhe palët e interesuara) të rregullojë këtë baraspeshë të interesave. Disa nga këta mekanizma janë: përkufizimi i pakos themelore të kujdesit, çmimorja e shërbimeve, pagesa e premiumit të sigurimit, përcaktimi i ndarjes së kostos për shërbime, kontraktimi i institucioneve dhe kështu me radhë.

Pakoja themelore e kujdesit e përcakton listën e kushteve dhe shërbimeve shëndetësore që mbulohen nga fondet e sigurimit shëndetësor. Çmimorja e shërbimeve e përkufizon çmimin për secilin shërbim të ofruar nga institucionet e kujdesit shëndetësor. Përcaktimi i shumës për ndarjen e shpenzimeve që mund të marrë forma të ndryshme, do të parandalojë shfrytëzimin e tepërt të shërbimeve dhe në këtë mënyrë t'i kursejë fondet për shfrytëzimin më të mirë nga njerëzit që kanë nevoja për shërbime.

Rastet që e ilustronin këtë më së miri janë reformat e zhvillimit të sistemeve të sigurimit shëndetësor në Maqedoni dhe Kroaci. Pas ndarjes me Jugosllavinë, ishte e nevojshme më shumë se një dekadë të rindërtohet një sistem i sigurimit nga një sistem që veç ekzistonte. Procesi është në vazhdim e sipër. Në vendet si Zelanda e Re, SHBA-të Britania e Madhe ky proces ka zgjatur vite të tëra.

Të gjitha këto skema, ku një sigures i vetëm është kontraktor i aq dhënësve të shërbimit, sa të mbulohet e gjithë popullata e një vendi të caktuar, njihen si sistemi i pagesit të vetëm të shërbimit shëndetësor. Ofrimi i shërbimeve në këtë rast mund të bëhet si nga ofrues privatë dhe ata publikë⁸⁵.

Ndërsa sot, edhe pse kanë kaluar mbi dhjetë vite nga shpallje e pavarësisë, Kosova ende nuk ka një skemë ekzakte të sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe ato shëndetësore në veçanti.

Në vitin 2007, është përpiluar ligji për sistemin e sigurimit shëndetësor, i cili ka synuar që të sigurojë fondin nga të vjelja e tatimeve në të ardhurat personale. Më vonë, me arsyetimin se kjo metodë nuk mund të siguron mjete të mjaftueshme për jetësimin e skemës për sigurime shëndetësore,

⁸⁵Saltman, R.B., Bussw, R. dhe Figueras, J. "Social Health Insurance systems in Western Europe", Shtator 2004, fq. 361.

ky projekt ligj është kthyer në rishqyrtim. Lidhur me krijimin e fondit për sigurime shëndetësore janë përfolur shuma të ndryshme me të cilat mund të funksionalizoheshin këto sigurime.

Në vitin 2013, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Sigurimet Shëndetësore në Kosovë (2013/04-L-249)⁸⁶ me qëllim të sigurimit të qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelore shëndetësore, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor, nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor. Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, dhe financimin e sistemit publik të sigurimeve shëndetësore; si dhe të drejtat dhe obligimet e palëve të përfshira⁸⁷.

2. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i punimit është që të shpërfaq problematikat që shkakton mungesa e një sistemi të sigurimeve shëndetësore dhe vështirësitë për qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore. Trajton efektet e mungesës së sigurimeve shëndetësore në raport me të drejtat e njeriut në përgjithësi, e veçanërisht efektet ndaj shtresave të caktuara, si familjet/personat që jetojnë nën asistencë sociale, pensionistët, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës.

3.Parashtrimi i hipotezës së hulumtimit

H₁ “Zbatimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore do të ndikonte në rritjen e financimit dhe të cilësisë së shërbimeve shëndetësore në Kosovë”.

Kjo është hipoteza që ne presim të vërtetojmë gjatë këtij studimi dhe kjo mbështetur në përpunimin e raporteve financiare të bankave komerciale të Kosovës, analizës së raporteve të BQK-së, Ligjit për sistemin e sigurimit shëndetësor, literaturës ndërkombëtare të kësaj fushe dhe ne baze të rezultateve të përpunuara të marrura gjat hulumtimit empirik.

4. Metoetodologjia e hulumtimit shkencor

Qasja jonë metodologjike do të fokusohet në aplikimin e metodave bashkëkohore që zbatohen në shkencat shoqërore siç janë: metoda komparative (krahasuese), metoda deskriptive, metoda historike, metoda e analizës dhe metoda e modeleve përmes së cilave do të trajtojmë modelet e ndryshme mbi formën e ndërtimit të sistemeve të sigurimeve shëndetësore. Elaborimi ynë do të përqendrohet në analizën e shpenzimeve buxhetore për sektorin e shëndetësisë dhe gjetjen e mundësive për format e financimit dhe përmirësimit të të hyrave në mënyrë që ndërtimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore të jetë i plotë, pa ngarkesë të theksuar buxhetore dhe të ndikoj në përmirësimin e gjendjes në këtë sektor.

⁸⁶Ligji nr. 04/L -249 “për Sigurimin Shëndetësor”, Prishtinë, Prill 2014.

⁸⁷ Pjesë nga publikimi në linkun <https://www.rks-gov.net/sq-AL/Qytetaret/Shendetesia/Pages/SigurimetShendetesore.aspx>

5. Rëndësia e krijimit të sistemit të Sigurimeve Shëndetësore në Kosovë

5.1. Krijimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore në Kosovë

Rregullimi ligjor i financimit të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm të sektorit shëndetësor si dhe krijimi i Fondit për Sigurime Shëndetësore, duke përfshirë dhe bazën ligjore të sistemit të sigurimeve shëndetësore të banorëve të Republikës së Kosovës, janë elemente bazike në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të qytetarëve dhe institucioneve për mbrojtjen dhe kujdesin shëndetësor, rehabilitimin dhe mbrojtjen financiare nga shpenzimet për kujdes shëndetësor themelor. Me krijimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore do të ndërrohet rrënjësisht sistemi shëndetësor dhe shërbimet do të jenë më të mira ndaj atyre që e bëjnë pagesën e tij.

Në esencë ajo që duhet gjithsesi të sigurohet është që shërbimet pa pagesë të garantohen për qytetarët nën asistencë, të varfërit, personat me aftësi të kufizuara, të gjithë ata që nuk kanë mundësi t'i mbulojnë shpenzimet si pensionistët, invalidët etj, ata duhet të marrin shërbime pa pagesë, dhe tërë buxheti i shëndetësisë duhet të shkojë për këtë kategori.

Megjithatë përkundër të gjitha vështirësive dhe sfidave eventuale, hapi më i rëndësishëm do të ishte përgatitja e bazës legislative për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Dokumentet ligjore duhet t'i përkufizojnë mandatet dhe përgjegjësitë specifike të organizatës dhe mënyrën e mbikëqyrjes së institucionit⁸⁸. Po ashtu duhet të parashikohet që organizimi dhe menaxhimi i Fondit për Sigurime Shëndetësore kërkon një kohë parapërgatitjeje me mjete teknike dhe administratë kompetente. Sa për ilustrim vendeve si: Estonia, Kirgistani e Kroacia, nga aprovimi i Ligjit për sigurime deri në fillimin e implementimit në praktikë iu deshën 2 deri 6 vite.

Fondi për Sigurime Shëndetësore do të kishte për obligim që të zbatojë politikat e zhvillimit dhe të përparimit të kujdesit shëndetësor, të sigurojë parimet e realizimit të të drejtave të siguruarve dhe kujdeset për realizimin e këtyre të drejtave, të ofrojë shërbime profesionale për realizimin e të drejtave nga sigurimi shëndetësor i obligueshëm; të planifikojë mjetet për sigurimin shëndetësor të obligueshëm etj.

5.2. Çështje me rëndësi të financimit të shëndetësisë dhe të sigurimit shëndetësor

Ligji për sigurim shëndetësor i cili që disa vite është trajtuar dhe shtyrë ka për qëllim “sigurimin dhe përmirësimin e qasjes së qytetarëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve më kualitative shëndetësore, nëpërmjet rregullimit të sistemit publik të sigurimeve shëndetësore⁸⁹. Por, me gjithë rëndësinë që e ka trajtimi në tërësi i këtij ligji, për punimin tonë rëndësia e ndikimit financiar të ligjit mbi sigurime shëndetësore, paraqet thelbin e prognozës mbi funksionalitetin dhe efikasitetin e sistemit të sigurimeve shëndetësore. Është tejet e rëndësishme që sfida financiare të shqyrtohet në mënyrë të veçantë, pasi që efekti financiar është qenësor për ekzistimin e sigurimeve shëndetësore.

Tabela 1. Të hyrat në Fond nga numri i përgjithshëm i popullsisë që supozohet të paguajë premiumin prej 5 euro në muaj

⁸⁸ Studim për Sigurimin Shëndetësor “Analizë krahasimore e skemave të sigurimit shëndetësor në Evropën Juglindore”, Raport i rezultateve, 29 qershor 2009, fq. 25.

⁸⁹ Ligji Nr. 04/L -249, “Për Sigurimin Shëndetësor”, Prishtinë Prill 2014.

	Numri	Premiumi mujor	Premiumi vjetor	Të hyrat vjetore	Të hyrat mujore
Numri i përgjithshëm i popullsisë	1,733,827	5.00	60.00	104,032,320	8,699,360

Burimi: ASK dhe llogaritja personale

Tabela 2. Të hyrat në Fond nga të punësuarit

Kategoritë e popullsisë	Numri	Premiumi mujor	Premiumi vjetor	Numri mesatar i anëtarëve të familjes	Të hyrat vjetore	Të hyrat mujore
Të punësuarit	224,000	5.00	60.00	5,8	77,952,000	6,496,000

Burimi: MPMS dhe llogaritja personale

Në tabelën 1, kemi paraqitur numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës, që do të duhej të paraqiste optimumin e kapacitetit të pagesave për sigurime shëndetësore. Kështu që, duke u bazuar sipas indikatorëve të parashtruar në kalkulime për lartësinë e premiumit që thuhet se do të jetë afërsisht 5 euro për muaj për çdo anëtarë të familjes, në rast se do të shumëzojmë numrin e përgjithshëm të popullsisë me këtë shumë, del se optimumi i kapacitetit financiar i Fondit mund të jetë 104,032,320 euro, që në të ardhura mujore paraqet shumën prej 8,669,360 euro.

Gjithashtu, nga rezultati i statistikave nga procesi i fundit i regjistrimit të popullsisë, del se në bazë të ekonomive të regjistruara familjare, numri mesatar i anëtarëve të këtyre ekonomive është 5.8 anëtarë për familje. Në tabelën 2, kemi paraqitur numrin e të punësuarve sipas statistikave të përpunuara nga ASK-ja⁹⁰.

Nga kjo del se optimumi i grumbullimit të premiumit për sigurime shëndetësore nga të punësuarit dhe familjet e tyre është 77,952,000 euro, me të hyrat mujore prej 6,496,000 euro. Kjo shumë paraqet 78% të pagesës maksimale që mund ta grumbullojë Fondi nga kontributet e të punësuarve, në rast se kalkulojmë se për një person premiumi vjetor do të jetë 60 euro, dhe se në rast të kësaj të punësuarit janë kryefamiljar që kanë në mbajtje 5.8 anëtarë të familjes.

Nga ky kalkulim del se me këtë kapacitet do të mund të mbuloreshin 1,299,200 banorë. Në tabelën pasuese (tabela 3), do të paraqesim në mënyrë të veçantë kontributin e të punësuarve në sektorin privat dhe atë publik, sipas të dhënave të disponueshme.

Tabela 3. Kontributi në Fond nga të punësuarit në sektorin privat dhe atë publik

⁹⁰Agjencia e Statistikave të Kosovës, modifikimi i fundit 13 Tetor 2012, <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/>.

Kategoritë e popullsisë	Numri	Premiumi mujor €	Premiumi vjetor €	Anëtarët e familjes (mesatarja)	Të hyrat vjetore €	Të hyrat mujore €
Të punësuarit në sektorin privat	156,624	5,00	60,00	5,8	54,505,152	4,542,096
Të punësuarit në sektorin publik	77,376	5,00	60,00	5,8	26,926,848	2,243,904

Shihet se kapaciteti i pagesës nga personat e punësuar, në aspektin kuantitativ në sektorin privat është afërsisht 100% më i lartë se sa në sektorin publik, ngase edhe numri i të punësuarve në sektorin privat është 100% më i lartë sesa në atë publik. Nga kjo shihet se, në sferën ku tregu i punës me shumë vështirësi të madhe rregullohet me legjislacionin në fuqi, nga se prania e informalitetit është në masë të madhe, në aspektin e grumbullimit të mjeteve për sigurime shëndetësore do të paraqes problemin më të madh të grumbullimit të këtyre mjeteve.

5.3. Ndikimi i Sigurimeve Shëndetësore në buxhet dhe në ekonominë e vendit

Sipas dispozitave të Ligjit për Sigurime Shëndetësore, implementimi dhe funksionalizimi i Sigurimeve Shëndetësore kalon përmes dy fazave: faza e parë (faza e tranzicionit) ku financimi në një përqindje të caktuar duhet të jetë nga Buxheti i Kosovës si dhe nga burimet tjera. Gjatë kësaj faze Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Financave obligohen të përgatisin infrastrukturën ligjore dhe kushtet tjera për fillimin e punës së Fondit. E tëra kjo duhet të merr një afat prej tre vjetësh. Ndërsa faza e dytë parasheh që Sigurimin shëndetësor të obligueshëm ta zbatoj Fondi.

Në studimin e Bankës Botërore, sigurimi shëndetësor social përmes tatimeve në paga është treguar si i papërshtatshëm edhe pse qeveria e Kosovës ka insistuar në atë opsion. Çështja kryesore lidhur me këtë është se baza e të hyrave sipas sigurimit të financuar nga tatimi në paga është e kufizuar në një sektor të vogël formal dhe me mundësi të niveleve të larta të shmangies së kontributeve. Kosova ka një sektor shumë të vogël formal. Shmangja e pagesës së kontributeve pritet të jetë e lartë në Kosovë, që do të thotë se sigurimi shëndetësor social i financuar nga tatimet në paga ka shumë gjasa të mos rezultojë në të hyra shtesë për sektorin shëndetësor⁹¹.

Nga hulumtimi i kryer erdhëm në përfundim se zbatimi i sistemit të sigurimit shëndetësor dhe krijimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore do të ndihmojnë në rritjen e fondeve në dispozicion për shëndetësi, të krijojnë bashkimin efikas të trajtimit të rreziqeve për të siguruar mbrojtje financiare dhe qasje të barabartë në kujdes shëndetësor, si dhe të balancohen stimuj nëpërmjet mekanizmave të pagesës së ofruesve për të përmirësuar ofrimin e kujdesit shëndetësor.

⁹¹Studim për Sigurimi Shëndetësor – raport studimor i cituar fq. 27.

6. Përfundi dhe Rekomandimet

- Qeveria e Kosovës duhet të ketë vizion të qartë rreth asaj se çfarë sigurimi shëndetësor do ishte më i përshtatshëm si në aspektin organizativ dhe financiar.
- Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet të miratojnë bazën ligjore për Fondin e sigurimeve shëndetësore,
- Përdorimi i burimeve tjera financiare përmes taksave direkte dhe indirekte në disa produkte si duhani, alkooli të destinuara kryesisht për shëndetësinë mund të shërbenin si burime shtesë për rritjen e financimit.
- Së fundi, politika e ardhshme për sigurimin shëndetësor në Kosovë duhet të përmbush standardet ndërkombëtare të mishëruara në Konventat dhe Rekomandimet përkatëse të ONP-së dhe gjithashtu Direktivat e Bashkimit Europian.

Kosova është ndër vendet e rralla evropiane që nuk ka fillaur zbatimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore dhe rrjedhimisht nuk ka etabluar fond të sigurimeve publike shëndetësore. Kjo ka ndodhur si rezultat i shumë faktorëve objektiv, por është evidente edhe mungesa e vullnetit politik për ta trajtuar me seriozitet këtë çështje të ndjeshme.

Njëri nga problemet kryesore në hartimin dhe implementimin e sistemit të sigurimit shëndetësor në Kosovë është mungesa e njohurive lidhur me atë se çfarë sistemi mund të sigurojë një baraspeshë ideale dhe si do të duket rregullimi i sjelljeve të pjesëmarrësve. Kjo e ka pamundësuar dhe vonuar progresin e reformës së sistemit shëndetësor të Kosovës

Nga ajo që shqyrtuam në këtë punim mund të thëmi se Kosova ende është larg ndërtimit të sistemit të sigurimit shëndetësor që do ti përmbushte standardet ndërkombëtare të mishëruara në Konventat dhe Rekomandimet përkatëse të ONP-së dhe gjithashtu Direktivat e Bashkimit Evropian.

7. Referencat

Agjencia e Statistikave të Kosovës “Vlerësim – popullsia e Kosovës 2014”, Prishtinë, Qershor 2015, fq. 8.

Agjencia e Statistikave të Kosovës “Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës”, Prishtinë 2015, fq. 29.

Percival dhe Sondorp, “Case study of health sector reform in Kosovo” Conflict and Health, 2010, fq. 3.

Ligji nr. 04/L-125 “Për shëndetësi”, Prishtinë Dhjetor 2012, neni 15

Burimi: ASK dhe llogaritja personale

Burimi: MPMS dhe llogaritja personale

Ligji Nr. 04/L -249, “Për Sigurimin Shëndetësor”, Prishtinë Prill 2014.

LEGJISLACIONI PËR KONKURENCËN NË REPUBLIKEN E KOSOVËS

Jurist i diplomuar Milot Blakaj,

Qendra Kerkimore Zhvillimore PEJA

Jurist idiplomuar Fatos Halitaj,

QendraKerkimore Zhvillimore PEJA

Hyrje

Republika e Kosovës është shteti më i ri në botë dhe në Evropën Juglindore. Si e tillë ajo ka një histori interesante të shtet –formimit si në planin ekonomik po ashtu edhe të legjislacionit. Bazuar në ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit, konsiderohet vendi i fundit që po aplikon parimet e ekonomisë së lirë të tregut brenda sistemin politik. Njëra ndër çështjet me komplekse dhe sfiduese për rregullimin juridik dhe zbatimin e politikave konkrete ekonomike konsiderohet të jetë rregullimi i mekanizmave të tregut mbi baza të njëkonkurrence të mirëfilltë. Konkurrenca është një dukuri komplekse ekonomike, që manifestohet dhe e karakterizon, fuqizon dhe i jep një përmbajtje të veçantë ekonomisë së lirë të tregut. Në Kosovë subjektet e caktuara ekonomike (ndërmarrjet) në një mënyrë apo tjetër orvatën që të përfitojnë sa më shumë blerës apo territore shitëse, duke krijuar kështu sa më shumë që është e mundur fitim, shitje sa më të mëdha në sasi si dhe ndarje sa më të madhe të tregut dhe këtë nganjëherë nuk e bëjnë në mënyrë të rregullt. Sjelljet dhe veprimet jolojale në treg jo vetëm që e dëmtojnë imazhin por rrezikojnë zhvillimin harmonik ekonomik dhe procesin e anëtarësimit të vendit në Union Evropian.

Mbi këtë kuptim, duke ju referuar posaçërisht të dhënave statistikore lidhur me numrin dhe niveli i bizneseve, produkti i brendshëm dhe treguesve të tjerë ekonomik, vendi ynë paraqet një shembull interesant për angazhimin institucioneve shtetërore për hartimin dhe implementimin e politikave të rregullimit të konkurrencës në një ekonomi të vogël dhe me një shkallë relativisht të lartë informaliteti dhe kompletimit të legjislacionit në përputhje me standardet e Unionit Evropian. Ky punim është fokusuar që të trajtojë legjislacioni që e rregullon dhe e mbron konkurrencën në

territorin e Republikës së Kosovës duke i analizuar këtë edhe me të drejtën e konkurrencës dhe me politikat e konkurrencës në UE.

Konkurrenca dhe ekonomia e Republikës së Kosovës

Republika e Kosovës është duke kaluar nëpër një proces të tranzicioni atipik për shkak të një të kaluar tepër problematike. Pas vitit 1999 respektivisht pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2007, ekonomia e vendit tonë, si asnjëherë më parë, po ballafaqohet me një dinamikë të zhvillimit dhe integritit të tregjeve të saja por, në anën tjetër edhe me paraqitjen e formave të ndryshme të konkurrencës jolojale. Këto forma dhe niveli i lartë i pasigurisë së të bërit biznes gjithnjë e më të shumë paraqesin një situatë të paqarta ekonomike e cila kërkon jo vetëm qasje preventive profesionale por edhe angazhim serioz dhe të fortë institucional. Kriza ekonomike në kohë të fundit ka tronditur besimin në tregjet më të njohura konkurruese dhe seriozisht ka i ka sfiduar në politikat e deritashme të konkurrencës. Gjendja e tillë dhe "paniku" për humbje ka rezultuar me situatë të paqartë të perspektivës biznesore dhe me ngushtimin e hapësirave për një konkurrencë të lirë dhe të ndershme. Me konkurrencën jolojale tregjet gjithmonë e më shumë po dëmtohen duke lënë hapësira të ndryshme për manipulime dhe keqpërdorime, duke dëmtuar jo vetëm tregjet dhe pjesëmarrësit në të por edhe vetë ekonominë e vendit. Përveç formave të evidentuara të konkurrencës jo lojale po del se edhe ekonomia joformale është problematike duke i shndërruar në "punëdhënësin" kryesor në vend. Në një treg ku si subjektet biznesore hyjnë dhe dalin lirshëm, si shitësit poashtu dhe blerësit nuk mund të ndikojnë në çmimet, si dhe produktet apo shërbimet që shiten në treg janë të ngjashëm aq sa nuk ka rëndësi se tek cili shitës blihen, ky është ai treg me një konkurrencë të lirë, ku blerësi është i lirë të vendos se ku dhe çfarë të blejë. Liberalizimi i tregut dhe krijimi i mundësive për depërtime, rritja e produktivitetit, mbrojtja e konkurrencës dhe rritja e saj, janë disa nga objektiva me rëndësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të shtetit të Kosovës. Realizimi i këtyre objektivave imponon nevojën që bartësit e vendimmarrjeve të krijojnë politika të tilla ekonomike të përshtatura me legjislacion adekuat, të cilat do ndikojnë në rritje ekonomike përmes tregut konkurrues në një anë dhe në anën tjetër të eliminojnë sjelljet të cilat dëmtojnë tregun e lirë. Politikat të tilla do të kenë efekte të shumëfishta pozitive për ekonominë e shtetit, bizneset dhe konsumatorin në veçanti. Politika e konkurrencës dhe mbrojtja e saj zënë vend mjaft të rëndësishëm në politikat ekonomike të shteteve të zhvilluara dhe se për nga rëndësia e tyre kanë tretman të veçantë. Kjo rëndësi shtohet aq me tepër sot në kohën e krizës globale ekonomike dhe recesionit të saj. Tek ne mbrojtja e konkurrencës nga veprimet e ndryshme abuzive si dhe krijimi i tregut të mirëfilltë janë detyrime shtetërore - institucionale që kemi ndaj vetvetes dhe UE -së. Ekonomia e Kosovës është në konsolidim dhe natyrisht vet procesi i tranzicionit, krijon hapësirë për veprime të këtyra që dëmtojnë konkurrencën e lirë. Tregu kosovar është një treg relativisht i vogël, dhe përqendrimet e aktiviteteve tregtare në duar të pak lojtarëve ndodhin mjaft më lehtë se në tregjet e mëdha dhe pikërisht këto kanë një ndikim të madh në konsumatorin final. Kjo imponon nevojën e funksionimit të duhur të mekanizmave rregullues të tregut nga ana e shtetit.

E drejta konkurrencës

Zanafilla e lashtë zhvillimore e së drejtës së konkurrencës, daton që nga koha e perandorisë romake. Praktikrat biznesore të pjesëmarrësve në treg edhe monitoroheshin, edhe sanksionoheshin sipas nevojës⁹². Që nga shekulli XX, e drejta e konkurrencës u bë çështje globale. Deri më tani janë zhvilluar dhe afirmuar disa sisteme të së drejtës së konkurrencës.⁹³ Për t'i ushtruar dhe realizuar punët, aktivitetet dhe veprimtaritë e tyre për të cilat janë formuar dhe regjistruar pranë organit kompetent; për ti ushtruar synimet, qëllimet dhe interesat e tyre për fitim, organizatat e ndryshme biznesore, në cilësi të subjekteve të caktuara biznesore, paraqiten në tregun e lirë. Në atë treg ku pa pengesë dhe me korrektësi sublime duhet të plasohen vlerat, produktet dhe kapitalet, respektivisht zhvillohen marrëdhëniet diverse biznesore, në të cilat subjektet marrin pjesë duke zhvilluar operacione dhe aktivitete të shumta biznesore. Në marrëdhëniet e krijuara biznesore dhe me aktivitetet biznesore të subjekteve gjegjëse në tregun e lirë duhet të gjallërojnë dhe zotërojnë sistemi i vlerave, cilësisë dhe korrektësisë- ndershmërisë. Duhet mëtutje të zhvillohet një garë e drejtë, e barabartë, reale, e ndershme dhe e shëndoshë që quhet konkurrencë e lirë, e drejtë dhe lojale e cila në doktrinë është zhvilluar, elaboruar dhe ngritur në nivel të një disipline të veçantë relevante- në të drejtën e konkurrencës. E drejta e konkurrencës është tërësi e rregullave juridike e të tjera të sjelljes së operatorëve (subjekteve të së drejtës) në treg, të cilat i nxjerrin institucionet shtetërore, me qëllim të krijimit të një klime, kushteve, mundësive, rrethanave dhe ambientit të përshtatshëm juridik, për inkorporimin e modelit të tillë i cili i përfshinë të drejtën antikartelore; antitrustore; të drejtën e konkurrencës së ndaluar dhe të drejtën e luftimit dhe pengimit të konkurrencës jolojale.⁹⁴ E drejta e konkurrencës përveç që është degë e rëndësishme e sistemit juridik të vendit ajo në jetën bashkëkohore paraqitet edhe si mekanizëm rregullatorë e cila në planin material merret me 1. Luftimin e monopoleve, 2. marrëveshjeve të palejuara (katrelet) dhe 3. keqpërdorimin e pozitës dominante. Në vendete zhvilluara fushë e mbrojtjes së konkurrencës është e rregulluar me akte ligjore të veçanta të cilat sigurojnë për agjencitë respektivisht autoritete e caktuara kompetenca për mbrojtjen efikase të konkurrencës. Këto institucione marrin përgjegjësinë që të ushtojnë funksionet e tyre nëpërmjet procedurave legale.⁹⁵

E drejta e kosovare e konkurrencës, kryesisht është e rregulluar me Ligji për mbrojtjen e konkurrencës⁹⁶ dhe aktet tjera nënligjore për konkurrencën. Ky legjislacion ka për qëllim që të rregullojë masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg duke përfshirë kompetencat dhe organizimin e Autoritetit për mbrojtjen e konkurrencës si dhe procedurat e zbatimit të këtij akti ligjor.⁹⁷ Ky ligj në planin formal - juridik garanton dhe siguron e zhvillimit dinamik, stabil dhe intensiv të një ekonomie të qëndrueshme dhe perspektive të tregut e Republikës së Kosovë. Ligji në mënyrë shprehimore i ndalon të gjitha ato veprime, akte dhe aktivitete, të cilat e kufizojnë, shtypin,

⁹² Shih më gjerësisht për këtë: "Competition Law- Wikipedia, the free encyclopedia,

⁹³ D Milkotin & të tjetër "Evropsko tržišno pravo" Zagreb 2006, fq. 54

⁹⁴ Pravna Enciklopedija, BG. SA., 1979, fq. 563.

⁹⁵ D Milkotin & të tjetër "Evropsko tržišno pravo" Zagreb 2006, fq. 55

⁹⁶ Ligji për mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L - 229

⁹⁷ Ligji për mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L - 299, Qëllimi i ligjit, neni 1

pengojnë ose e çrregullojnë konkurrencën e lirë e të ndershme të subjekteve biznesore në treg.⁹⁸ Duke bërë fjalë për konkurrencë , ligji me dispozita të veçanta e në mënyrë taksative i rregullon dhe përcakton ndalesat kryesore për subjektet biznesore, lidhur me kufizimet e caktuara në planin e konkurrencës. Ndalesat kanë të bëjnë me marrëveshjet, vendimet dhe /ose praktikatat e bashkërenduara të subjekteve biznesore të caktuara, të cilat kanë për qëllim. Me ligjin në fjalë përcaktohet e drejtpërdrejtë ose të tërthortë çështja e çmimit shitës ose blerës, apo përcaktimin e çfarëdo afati, apo kushti tjetër në tregti ose biznes; Kufizimin ose kontrollimin e prodhimit, tregut, zhvillimin teknik - teknologjik ose investimet; Kufizimin, ndarjen ose pjesëmarrjen në treg ose në një apo më shumë burime të furnizimit; Zbatimin e kushteve të ndryshme për transaksione të ngjashme me ndërmarrje të tjera, duke i vendosur ato në një pozitë të papëlqyeshme konkurruese; Kushtëzimin, që lidhja e kontratës të varet nga palët të tjera kontraktuese, përmes kushteve të tjera plotësuese, që për nga natyra e saj dhe praktikës së zakonshme biznesore, nuk kanë lidhmëni me objektivin e kontratës së tillë. Marrëveshjet ose vendimet e tilla të ndaluara, janë të pavlershme dhe të pazbatueshme.⁹⁹Ligji në trajtim bën edhe ndalimin e ashtuquajtur marrëveshjeve themelor që kufizojnë lirinë e palëve, për caktimin e çmimeve dhe kushteve në transaksionet me palë të treta-marrëveshjet vertikale. Marrëveshjet që lidhen midis ndërmarrjeve përkitazi me mallra dhe/ose shërbime e të cilat ndikojnë në treg brenda Kosovës, janë të ndaluara, për aq sa ato marrëveshje e kufizojnë lirinë e palës për vendosje të çmimeve, në ngarkim të palëve të treta.¹⁰⁰

Marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve prodhuese ose shërbyese; të cilat vendosin ndaj njëres palë kufizim të lirisë së shfrytëzimit të mallrave; kufizim të lirisë së blerjes ose të shitjes së mallrave ose të ofrimit të shërbimeve të tjera nga ose për palët e treta; kufizimin e lirisë së shitjes së mallrave të furnizuara palëve të treta; ose krijimin e një obligimi për blerjen e mallrave ose të shërbimeve, të cilat për nga karakteri i tyre ose praktika e zakonshme komerciale-biznesore, nuk kanë të bëjnë me objektin themelor të marrëveshjes në fjalë, ndalohen, nëse kufizimet dhe /ose detyrimet e tilla, dukshëm e dëmtojnë tregun.¹⁰¹ Ligji i Kosovës për mbrojtjen e konkurrencës ndalon edhe marrëveshjet- biznesore, gjegjësisht marrëveshjen për shitjen ose licencimin e të drejtave të pronësisë industriale apo të sekretit afarist, nëse në një masë të caktuar- të konsiderueshme (MB) ato vendosin kufizime ndaj veprimtarive ekonomike të blerësit ose të licencë-marrësit e që, nuk kanë të bëjnë me shfrytëzimin ose mbrojtjen e të drejtave përkatëse ose të sekretit.¹⁰² Ligji me dispozita të caktuara lejon marrëveshje për çështje të caktuara në mes të subjekteve biznesore ose më mirë të thuhet i përjashton marrëveshjet e caktuara nga ndalimi, në rastet kur dy ose më shumë ndërmarrje në marrëveshje, përbëjnë ose janë pjesë përbërëse e një tërësie (njësie) të vetme ekonomike, ani që ndërmarrjet në fjalë, nga aspekti ligjor janë të ndryshme. Edhe marrëveshjet në mes të ndërmarrjes amë dhe degëve të saj ose të të dy degëve të një ndërmarrjeje të përbashkët- amë, nuk iu nënshtrohen ndalimeve sipas këtij ligji. Po ashtu, një marrëveshje e caktuar, që ka për qëllim të ndikojë, në shkrirjen e dy ndërmarrjeve, përjashtohet nga ndalimi.

Autoriteti i Konkurrencës në Republikën e Kosovës , sipas ligjit, mund ta përjashtojë një marrëveshje nga ndalimi, nëse ajo ka të bëjë me zbatimin e njëjtë dhe të njëjlojshëm të standardeve ose të kushteve biznesore nën kushte të parapara me ligj. Autoriteti i Konkurrencës në Republikën e Kosovës , mund të përjashtojë nga ndalimi edhe marrëveshjet për specializim; për racionalizim dhe marrëveshjet të tjera, të caktuara.¹⁰³

Ligji më tutje në mënyrë të shkoqitur dhe taksative e ndalon shpërdorimin e pozitës dominuese, nga një ose më shumë ndërmarrje në treg. Një subjekt biznesor, mund të ketë pozitë dominuese në treg, nëse ka pjesëmarrje më të madhe se 40% në një treg; nëse nuk i nënshtrohet

⁹⁸Ligji për mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L - 299,

⁹⁹Ligji për mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L - 299 Kreu II, III, IV dhe V.

¹⁰⁰ LMK - i cituar neni 4

¹⁰¹ LMK i cituar neni 6

¹⁰²LMK icituarmësipër

¹⁰³ LMK, neni 9 që irregullon procedurat e Aplikimit dhe Lejimit të përjashtimeve

konkurrencës së vërtetë dhe të shëndoshë ose nëse ka fuqi superiore në treg, në krahasim me konkurrentët e tij ekzistues- aktual, real dhe potencial.¹⁰⁴

Ligji ynë për konkurrencën po ashtu i rregullon edhe çështjet relevante ekonomike e biznesore që kanë të bëjnë me: ndalimin e diskriminimit ; bojkotimeve; rekomandimeve dhe të praktikave të tjera kufizuese.¹⁰⁵ (me më detaje shih n. 16, 17, 18 dhe 19. të Ligjit të Kosovës për konkurrencën fq. 10-12 të tekstit të ligjit në fjalë). Është hap i qëlluar i mirë e i rëndësishëm nxjerrja e ligjit të Kosovës për konkurrencë. Ky është një fillim i mirë dhe i domosdoshëm për të zënë hapin, sa më parë, me trendët zhvillimore ekonomike- biznesore në rajon dhe më gjerë, por nuk është i mjaftueshëm. Hapi tjetër vijues i domosdoshëm është që të gjitha institucionet kompetente dhe përgjegjëse, të bëjnë maksimumin e mundshëm për ta përkrahur dhe fuqizuar maksimalisht zbatimin e plotë dhe korrekt të ligjit në trajtim. Hapi i dytë është krijimi i mirëfilltë dhe i avancuar i politikave kontamporeneve të mbrojtjes së konkurrencës së lirë, të ndershme dhe lojale në Kosovë. Hapi i tretë po aq relevant dhe i ngutshëm është novelimi i ligjit ekzistues, ngase ashtu siç është ka mjaftë shumë mangësi, lëshime, inkoseguenca kolizive dhe paqartësi; gjë që shkakton probleme interpretimi dhe zbatimi praktik- për të gjithë kompetentët dhe përgjegjësit ligjor.

E drejta e konkurrencës në Unionin Evropian

Fillet e para zhvillimore të kësaj të drejte, datojnë nga vitit 1957., kur 6 (gjashtë) shtete euro - perëndimore do ta nënshkruajnë Traktatin e Unionit Evropian, ndryshe të quajtur- traktati i Romës. Bashkësia fillimtarë evropiane, pas gjysmë shekulli, do rritet dhe ngritet në një treg dhe bashkim (union) të mirëfilltë evropian me mbi gjysmë miliardi konsumatorë, respektivisht qytetarë. Traktati në fjalë, konkurrencën e shëndoshë e sheh si një element qenësor, në krijimin e tregut të lirë; nga kontrolli, dominimi dhe abuzimet tjera.¹⁰⁶ Sipas dispozitave të nenit 81. të traktatit të Romës, të cilat kanë të bëjnë me kartelet dhe marrëveshjet restriktive vertikale, ndahen:” të gjitha marrëveshjet, vendimet e ndërmarrjeve dhe asociacioneve, si dhe praktikave të dëmshme, të cilat mund të prekin, godasin dhe dëmtojnë marrëdhëniet biznesore në mes të shteteve anëtare dhe të cilat do ta kenë, si objekt të tyre ose si efekt; prevencionin, restriksionin ose çrregullimin e konkurrencës, brendapërbrenda tregut të përgjithshëm Neni 81 (1) i traktatit të Romës bën fjalë për thelbin dhe pjesët esenciale të praktikave restriktive, siç janë fiksimi i çmimeve, ndarja e tregut, ndërsa neni 81 (2) flet për nulitetin e marrëveshje të dëmshme. Neni 82 i traktatit të Romës merret me trajtimin e monopoleve, përkatësisht të subjekteve biznesore, të cilat krijojnë dhe imponojnë pozitë dominuese në treg; më pas për hir të realizimit të interesave të tyre dhe fitimit sa më të madh e keqpërdorin atë pozitë të tyre. Për dallim nga e drejta antitrustore amerikane, e drejta e konkurrencës e Bashkimit evropian, nuk është aplikuar për të dënuar subjektet biznesore me pozitë dominuese në treg, por iu ka imponuar atyre sjellje të përshtatshme dhe përgjegjësi të veçantë si ndaj tregut të lirë e konkurrencës, ashtu edhe ndaj konsumatorëve dhe partnerëve.¹⁰⁷

¹⁰⁴ Dispozitat e neneve 10; 11, 12 dhe 14. të LMK, për më shumë shih në tekstin të ligjit.

¹⁰⁵ Ligji për mbrojtjen e konkurrencës Nr. 03/L - 229

¹⁰⁶ Shih më gjerësisht për këtë nenin 3 (g) dhe 4 (1) të Traktatit të Bashkësisë evropiane-Traktatit të Romës.

¹⁰⁷ Mlikoton&tëjtjetër " Europskotržišnopravo" Zagreb 2006, fq 54 - 55

Mbrojtja subjekteve ekonomike nga konkurrenca jolojale sipas normave shoqërore – zakonore

Zakonet tregtare ndërkombëtare janë "rregulla të pashkruara" që përdoren në marrëdhënie afariste ndërmjet partnerëve në tregtinë e jashtme dhe në marrëdhënie ekonomike ndërkombëtare, në përgjithësi. Zakonet tregtare, sikur rregulla për rregullimin e marrëdhënieve të pjesëmarrësve në tregtinë e jashtme, nuk janë të miratuara nga ana e pushtetit shtetëror ligjdhënës, institucione juridike ose disa të tjera, por rrjedhin nga praktika shumëvjeçare e punës të tregjeve ndërkombëtare, me sjellje stihike të qëndrueshme të njerëzve. Por, me kalimin e kohës, ajo si dhe është modifikuar nëpërmjet formimit të kuptimeve të caktuara për sjellje korrekte ose jo korrekte të njerëzve në raste të njëjta shoqërore. pastaj sjellja korrekte ka kaluar në shprehje dhe është pranuar moralisht, në realitet i zakonshëm, sjellje normale, sjellje që llogariten të obligueshme. Ashtu është krijuar vetëdija shoqërore se çdo sjellje ndryshe është në kundërshtim me moralin e qeverisë në shoqëri. Në atë mënyrë, kah praktika shumëvjeçare janë ndërtuar zakonet afariste të mira, të cilat në bazën e vet e kanë moralin tregtar dhe afariste të pjesëmarrësve në tregti dhe në punime afariste, në përgjithësi.¹⁰⁸

Përveç tjerash, në zakonet tregtare marrin pjesë: nderi, lojaliteti me konkurrencën, dhënia e të dhënave të vërteta për vete dhe për pjesëmarrësit tjerë në këmbimet tregtare, respektimi i fjalës së dhënë, mos tradhtimi i fshehtësive afariste të rëndësishme për interesat e partnerit, realizimi i detyrave të marra nga kontrata etj. Norma e rëndomtë nderi është në normat morale në përgjithësi, kurse në kuadër të zakoneve të mira afariste nga ajo kuptohet se sjellja me të cilën secili nga partnerët afarist juridik jep të dhënat e sakta për vete dhe për firmën e vet;

- ✓ për llojin, sasinë, cilësitë dhe kualiteti i mallit që është lëndë për shitblerje;
- ✓ i respekton afatet e marrëveshjes për dorëzim-porositje të mallit dhe të pagesës;
- ✓ nuk e bëjnë në dyshim partnerin e vet;
- ✓ në tërësi e respekton fjalën e dhënë dhe konsekuent përmbahet ndaj premtimeve që i ka dhënë etj.

Me zakonet tregtare rreptësisht dënohet praktika jo lojale e konkurrencës në tregun ndërkombëtar, si dhe lëndimi i autoritetit të ndërmarrjes dhe vendi në fitimin me tregtinë e jashtme. Nga konkurrenca jo lojale në tregun ndërkombëtar nënkuptohen në veçanti këta aktivitete të subjektivit të tregtisë së jashtme të caktuara; reklama jo lojale kur nxjerrën publikisht; jo të vërteta për mallin ose shërbimet që punon ndërmarrja e vet ose për ndonjë ndërmarrje tjetër, kurse për qëllim të gjejë interes për vete; shenja të rrejshme për prejardhjen e mallit; nxjerrja e informacioneve të rrejshme për ndërmarrjen e vet ose ndonjë ndërmarrje tjetër; keqpërdorimi i shenjave mbrojtëse tregtare për ndërmarrjen e vet apo të huajën; lëndimi apo shfrytëzimi i fshehtësive afariste dhe të ngjashme. Si lëndim i autoritetit në punën e jashtme tregtare nënkuptohet secila sjellje në kundërshtim me zakonet e mira afariste, e cila nxitë ose mund të nxisë lëndime më të rënda të obligimeve të marrëveshjes. Në rast të mosrespektimit të normave të lartpërmendura dhe zakoneve tjera, përdoren sanksionime të

¹⁰⁸Krasniqi Dr. Armand "E drejtë biznesore ndërkombëtare - leksione për vitin 2013 / 2014, Fakulteti Ekonomik Prishtinë

ndryshme; përqeshje publike, bojkoti, shpallje publike e emrit dhe të firmës të atij që sillet në kundërshtim me normat morale afariste, shpallje e ashtuquajtur "lista të zeza"; dënimi nga ana e gjyqeve të nderit të odave dhe asociacioneve të tjera afariste etj.¹⁰⁹

Mbrojtja subjekteve ekonomike nga konkurrenca jolojale sipas normave të moralit

Përgjegjësia sociale ne biznese në mënyrë konkrete për angazhim të një konkurrencë të mirëfilltë do të thotë të marrësh përgjegjësi personale për veprimet dhe impaktin që biznesi ka në shoqëri, do të thotë të ndihmosh në zgjidhje të nevojave të njerëzve”, është një kontribut në zhvillimin e burimeve natyrore e kapitalit human, si shtesë e të fokusuarit jo vetëm tek fitimi”, një teori etike ose ideologjike që tregon se si një njësi (qeveri, korporatë, biznes ose individ) ka përgjegjësi ndaj shoqërisë, e cila karakterizohet nga të qenurit vullnetar, jo me imponim, ne ndryshim nga përgjegjësitë ligjore, dhe lidhet me përfshirjen e secilit ne ndihmën që mund të japë ne komunitet, jo vetëm nga ana materiale por edhe me mbështetjen morale që mund të ofrojmë përta i përket sigurimit të mjedisit të qëndrueshëm, barazisë, mbështetjes së njerëzve dhe mbrojtjen mjedisore.

Përgjegjësia sociale ne biznes është kontribut aktiv dhe vullnetar i bizneseve, me qëllim përmirësimin e kushteve sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe po ashtu përmirësimin e pozitës së tyre konkurruese. Kompania, e cila ka përgjegjësi sociale, ndërton besueshmërinë e saj, pasuron imazhin e kompanisë, e bën brendin/markën e saj më të fuqishme, kontribuon në përfitimin e ndjeshëm afatgjatë, duke kontribuar edhe në:

- ✓ Performancë të përmirësuar financiare.
- ✓ Ngre moralin, angazhimin dhe performancën e të punësuarve në kompaninë tuaj
- ✓ Zhvillon shkathhtësitë e të punësuarve.
- ✓ E bën imazhin e kompanisë më të fuqishme.
- ✓ Tërheq investitorë të rinj.
- ✓ Ngre besueshmërinë dhe preferencën e klientit.

Rregullat qeveritare dhe ndërgjegjësimi i publikut janë dy faktorë thelbësor që kanë shkaktuar rritje të përgjegjësisë sociale. Por përveç faktorëve të jashtëm ekzistojnë dhe ndikime prej faktorëve të brendshëm ndër të cilët dy janë me kryesoret : – sjellja etike, – mënyra e qëndrimit të menaxhimit të organizatës.

Mbrojtja subjekteve ekonomike nga konkurrenca jolojale sipas Konventave bilaterale dhe multilaterale ndërkombëtare

Konventat ndërkombëtare janë instrumentet më të rëndësishme juridike të cilat në planin bilateral ose multilateral i rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve të ndryshme që të ndërmarrin aksione të përbashkëta që të mbrohen nga format e caktuara të konkurrencës jolojale. Ndër aktet më të njohura që kanë bërë histori dhe kanë krijuar praktika të mirë juridike - ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së konkurrencës konsiderohen marrëveshjet bilaterale në mes të SHBA - ve me Kanadanë,¹¹⁰ Australinë,¹¹¹ Gjermaninë¹¹² dhe më UE¹¹³ - në të cilat kanë krijuar mundësitë e

¹⁰⁹ Po aty

¹¹⁰ Memorandum of Understanding Between the Government of Canada and the Government of the United States of America as to Notification, Consultation and Cooperation with Respect to the Application of National Antitrust Laws (1984).

¹¹¹ Agreement Between the Government of the United States of America and the Government of Australia Relating to Cooperation on Antitrust Matters (1982).

bashkëpunimit në mes të organeve dhe autoriteteve përgjegjëse posaçërisht në forma të notifikimit dhe konsultimit me qëllim të mbrojtjes së konkurrencës në rastet kur ndikimi i legjislacionit të caktuar mund të ketë ndikim të madh në interesin e partnerit tjetër. Këto modele marrëveshjeje kanë qenë baza e modelit për bashkëpunimi dhe kooperim që e ka lansuar OECD - ea.¹¹⁴

Vendet të cilat karakterizohen për marrëdhënie të veçanta e solidare ekonomike dhe politike, me së shpeshti të një regjioni, në mesin e shumë marrëdhënieve tjera, çështjen e mbrojtjes së konkurrencës e rregullojnë nëpërmjet të marrëveshjeve të posaçme juridike - ndërkombëtare. Në këtë grup hyjnë vendet e UE- së, dhe NAFTA.

Më sipër kemi potencuar se baza e të drejtës së konkurrencës në UE daton nga vitet e pesëdhjetë të Shekullit të kaluar duke i dhënë një vend të merituar çështjeve të trajtimit dhe luftimit me serioz të sjelljeve antikonkurrese në tregun unik. Politikat dhe e drejta e konkurrencës e UE -së në kuadër të marrëveshjeve për të mbrojtur konkurrencën jolojale bazohet në tri parime bazë të cilat duhet të i arrijnë tri qëllime themelore e që janë: qëllimi politikë, qëllimi ekonomik dhe qëllimi moral i natyrës sociale.

Qëllimi i parë i sipërshënuar është bazuar në ndërtimin e tregut të përbashkët në mes të shteteve anëtare. Për të realizuar këtë vendet anëtare bartin një pjesë të sovranitet të vet në bashkësi duke i thelluar edhe më shumë lidhjet institucionale në sferën ekonomie. Qëllimi i dytë del nga interpretimi telelogjik dhe sistematik të të drejtës komunitare. Mbi bazën e këtij interpretimi mund të nxjerrët përfundimi që qëllimi i të drejtës së konkurrencës së bashkësisë evropiane nuk është vetëm efikasiteti i konkurrencës e cila mund të krijohet nëpërmjet të rritjes së produktivitetit por edhe në zgjerimin sa më të madh të efikasitetit ekonomik e cila krijohet nga rritja e zhvillimit ekonomik, rritja e punësimit, etj, si në nivelin e prodhimit ashtu edhe të shpenzimeve. Ekzistimi i qëllimit të tretë që bazohet në aspektin e moralitetit dhe natyrës sociale mund të interpretohet si kërkesë e sinqertë për kujdes që subjekteve ekonomike që duhet të kenë si ndaj legjislacionit komunitar ashtu edhe ndaj qytetarëve të bashkësisë evropiane.

Tentativat për rregullimin e konkurrencës në sferën multilaterale

Tentativat e para për të rregulluar çështjen e mbrojtjes nga konkurrenca i hasim në Kartën e Havanës (The Havana Charter) e cila i parapriu krijimit të GATT - it. Kjo kartë përmban një seri rregullash të sjelljes në biznes të cilat do të duhej që të administroheshin nga Organizata Botërore e Tregtisë. Megjithatë, kjo tërësi rregullash nuk është zbatuar asnjëherë pikërisht nga fakti se shumë shtete nën ndikimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i kanë shkelur ato më arsyetimin se ato përbëjnë rrezik dhe shkelje të sovranitetit shtetëror.¹¹⁵

Shtetet e Bashkuara, Kanadajadhedisa vende të tjeratëKëshilli Ekonomik -Socialtë Kombeve të Bashkuaranë vitin 1953 kishinpërgatiturnjë projekt-marrëveshjembazën e të cilës është tentuar që tërekomandohetkrijimii njëAgjencie Ndërkombëtareme qëllim tëkoordinimit,përgatitës, shqyrtimitdherekomandimit ma masaveqë do të duhej ndërmarrnë lidhjeme ankesat

¹¹²Agreement Between the Government of the United States of America and the Government of the Federal Republic of Germany Relating to Mutual Cooperation Regarding Restrictive Business Practices (1976).

¹¹³ Agreement Between the Commission of the European Communities and the Government of the United States of America Regarding the Application of their Competition Laws (1991)

¹¹⁴Organization of Economic Cooperation and Development, Revised Recommendation of the Council Concerning Co-operation between Member Countries on Restrictive Business Practices Affecting International Trade (1986).

¹¹⁵Olivier Long, Law and its Limits in the GATT Multilateral Trade System, Graham and Trotman-Martinus Nijhoff, London, 1987, p. 1.

përsjelljakufizuesetë biznesit nëtregtinë botërore. Pesë vjet më vonë GATT, në rastin e Norvegjisë kishte formuar një komision që është menduar për të studiuar Afatet dhe mënyranë të cilën ajo mund të veprojnë rastin e biznesit kufizues në kuadër të zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare. Megjithatë, këto përpjekjetë hershme për të arritur një marrëveshje shumëpalëshe në këtë fushë nuk ka ofruar asnjë rezultat praktikë.¹¹⁶

Për zhvillimin e konkurrencës në nivel ndërkombëtar UNCTAD (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim) kanë rëndësi të madhe. Përfshirja e punës së UNCTAD-it në këtë fushë është rezultat i dështimit të themelimit të Organizatës Botërore të Tregtisë në fund të dyzetat mandatit të cilit ishte e lidhur mesjelljen kufizuesetë biznesit. Kjo çështje pastaj u përpoq të zgjidhej nga GATT, por pa shumë sukses, për shkak të shqetësimeve që kanë qenë në anën tjetër - në lidhjetarifatave dhe çështjet tradicionale të tregtisë.

Në vitin 1979 shënon mbledhjen Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Sjellja restriktive - kufizues të sjelljes në tregti (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Praktikë të kufizues të Tregtisë) e cila është karakterizuar për punën e një grupi për negociimin e tëparimeve dhe rregullave përbashkëpunim në mënyrë që të kontrollojë dhe kufizojë sjelljet praktike të tregtisë. Kjo tërësi e parimeve miratohet në Rezolutën e Asamblesë Gjenerale të KB -së nr. 35/63 me 05 dhjetor 1980. Këto parime në përgjithësi paraqesin një "Kodeks të sjelljes së mirë më mes të shteteve" Kjo rezolutë dhe aktiviteti i pak më i vonshëm i UNCTAD - it ka arritur që t'i nxisë shtetet që të reformojnë dhe plotësojnë sistemin e vet juridik me ligje të cilat e rregullojnë sferën e mbrojtjes së konkurrencës dhe që këto ligje dhe rregulla t'i realizojnë në bazë të parimeve të shteteve më përvojë në këtë fushë dhe brenda mundësive nën asistencën e tyre teknike.¹¹⁷

Kuadri ligjor dhe renditja e tij për mbrojtjen e konkurrencës në Republikën e Kosovës

Liberalizimi i tregut dhe krijimi i mundësive për hyrje në treg, rritja e produktivitetit, mbrojtja e konkurrencës dhe rritja e saj, janë disa nga objektiva me rëndësi për zhvillim të qëndrueshme ekonomik të shtetit të Kosovës. Realizimi i këtyre objektivave imponon nevojën që bartësit e vendimmarrjeve të krijojnë politika të tilla ekonomike të përshtatura me legjislacionin adekuat, të cilat do ndikojnë në rritje ekonomike përmes tregut konkurrues në një anë dhe në anën tjetër të eliminojnë sjelljet të cilat dëmtojnë tregun e lire. Politikat të tilla do të kenë efekte të shumëfishta pozitive për ekonominë e shtetit, bizneset dhe konsumatorin në veçanti.¹¹⁸ Ashtu edhe siç është potencuar më sipër historia e konkurrencës dhe mbrojtja e saj daton që nga kohërat e lashta. Shembuj të cilët e kanë rregulluar çështjen e konkurrencës i gjejmë para dy mileniumeve, në Romen e lashtë. Në shekullin e 18 janë bërë studime formale mbi konkurrencën me të cilat janë mbuluar fushat të cilat kanë përfshirë "praktikat e ndaluara", 'ligjin për monopole' shkatërrimin e tregut' e tjera. Në mesjetë, në Angli për herë të parë legjislacioni për kontrollimin e monopoleve dhe praktikave kufizuese ishin vënë në zbatim. Sot ligjet moderne për konkurrencë fillojnë me legjislacionin e SHBA-ve me aktin e

¹¹⁶George N. Addy, "International Coordination of Competition Policy", in Kantzenbach et al. (eds.), Competition Policy ..., op. fq. 292.

¹¹⁷United Nations Conference on Trade and Development, The Set of Multilaterally Agreed Equitable Principles and Rules for the Control of Restrictive Business Practices, United Nations, Gjenevë, 1981.

¹¹⁸ Marrë në <https://ak.rks-gov.net/?cid=1,16,17> me datën 03.04.2014 nga autori Mr.sc. Gani Asllani - Anëtar i Autoritetit kosovar të konkurrencës

Shermanit të vitit 1890 dhe plotësimet e aktin të Claytonit të vitit 1914. Tek në mbrojtja e Konkurrencës nga veprimet e ndryshme abuzive si dhe krijimi i tregu të mirëfilltë janë obligime të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndaj Bashkësisë Evropiane. Ekonomia e Kosovës është në konsolidim dhe natyrisht vet procesi i tranzicionit, privatizimit dhe krijimi i institucioneve të reja krijojnë hapësirë për veprime të këtu që dëmtojnë konkurrencën e lirë. Tregu kosovar është një treg relativisht i vogël, dhe përqendrimet e aktiviteteve tregtare në duar të pak lojtarëve ndodhin mjaft me lehtë se në tregjet e mëdha dhe pikërisht këto kanë një ndikim të madh në konsumatorin final. Kjo imponon nevojën e funksionimit të duhur të mekanizmave rregullues të tregut nga ana e shtetit. Fushat më të ndryshme ku bëhet cenimi i konkurrencës janë të pranishme në: sektorin e teknologjisë së komunikimit, transport, sektorin e sigurimeve, energjetike, farmaceutike, media, prokurim, import të naftës, sektorin e bankave dhe shërbimeve financiare e tjera dhe për këtë arsye ndihet nevoja e bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht bashkëpunimi me rregullatorët ekonomik është më se i domosdoshëm.¹¹⁹ Duke pasur parasysh zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe eliminimin e implikimit negativ të konkurrencës së pandershme, si dhe duke e njohur nevojën për harmonizimin dhe rregullimin e praktikave të ndryshme konkurruese në Kosovë, me kërkesat e Bashkësisë Evropiane, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Konkurrencën qysh në vitin 2004, ndërsa në nëntor të vitit 2009 ka themeluar Komisionin Kosovë të Konkurrencës si organ rregullativ të pavarur dhe përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Me këtë veprim bërë institucionalizimi i politikës së konkurrencës në vendin tonë. Ky ligj ka si qëllim të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të tregut në Kosovë, duke ndaluar veprimet që e kufizojnë tregun, e çrregullojnë atë apo me veprime të ndryshme abuzojnë më të. Veprime të tilla çrregulluese mund të shkaktohen përmes, karteleve dhe marrëveshjeve të tjera të fshehta, përqendrimeve të ndërmarrjeve dhe abuzimit me pozitën e tyre dominuese. Nga kjo që u përmend mund të konkludohet se krijimi i konkurrencës së lirë, luftimi i dukurive devijues në treg është një sfidë e madhe që shtrohet para Komisionit Kosovë të Konkurrencës dhe zbatuesve të ligjeve në Republikën e Kosovës, me qëllim që ekonomia e tregut dhe ligjet e saj të vihen në zbatim dhe të funksionojnë ashtu si duhet për të gjeneruar investime, punësim dhe mirëqenie për qytetarët e Kosovës.¹²⁰ Aktualisht konkurrenca në vendin tonë rregullohet respektivisht mbrohet më Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L - 229¹²¹ dhe me katër (4) akte nënligjore të cilat mbi bazën e ligjit në fjalë i rregullojnë Formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit;¹²² Kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve më vlerë më të vogël;¹²³ Për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve;¹²⁴ dhe mbi Kriteret për lirimin ose Uljen e masës administrative.¹²⁵

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës (2004 - 2010)

Në kuadër të trajtimit të kësaj çështjeje duhet vlerësuar së për herë të parë me 8 shtator 2004 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për konkurrencën.¹²⁶ Ky akt ligjor jo vetëm që paraqet aktin e parë formal - juridik për të rregulluar konkurrencën në territorin e Kosovës por është konsideruar edhe

¹¹⁹Po aty

¹²⁰Po aty

¹²¹ Ligji për mbrojtjen e konkurrencës Nr.03/L - 229 I shpallur në gazetën zyrtare viti V nr. 88/ 25 Nëntor 2010

¹²² Udhëzimi Administrativ për formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit - shih në <https://ak.rks-gov.net/?cid=1,20>

¹²³ Udhëzimi Administrativ për kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve më vlerë më të vogël - shih në <https://ak.rks-gov.net/?cid=1,20>

¹²⁴ Udhëzimi Administrativ për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve - shih në <https://ak.rks-gov.net/?cid=1,20>

¹²⁵ Udhëzimi Administrativ kriteret për lirimin ose Uljen e masës administrative- shih në <https://ak.rks-gov.net/?cid=1,20>

¹²⁶ Ligji për konkurrencën Nr. 2004/36

shprehje e singertë e institucioneve të atëhershme të ashtu quajtura "të përkohshme" për ta përfaruar legjislacionin vendor me atë të Unionit Evropian.

Qëllimi i këtij ligji është fokusuar që të siguroj zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme të tregut në Kosovë duke ndaluar veprimet që e kufizojnë, shtypin ose çrregullojnë konkurrencën dhe i cili do të vlen për të gjitha ndërmarrjet e angazhuara në aktivitete ekonomike brenda, ose që kanë ndikim ekonomik brenda, territorit të Kosovës me përjashtim të mos zbatimit të tij për marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës.¹²⁷

Duke ju referuar këtij ligji, kryesisht ndalesave kryesore në kreun një (1) të tij potencohet se: citoj ... *"Marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve, vendimi i një shoqate të ndërmarrjeve ose një praktikë e bashkërenduar e ndërmarrjeve është e ndaluar nëse (i) mund të ndikon në tregtinë brenda Kosovës, (ii) ka për qëllim të saj ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në parandalimin, kufizimin ose çrregullim e konkurrencës në Kosovë, dhe (iii) zbatohet ose ka për qëllim të zbatohet në Kosovë. Ndalimi nga neni 3.1 vlen njëjloj për të gjitha marrëveshjet, vendimet dhe praktikën, qoftë ato të shkruara apo jo"*...mbarim citati.¹²⁸ Në kuadër të saj përcaktohen fushat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të zbatimit, kufizimet, kontrollet, lidhjet e kontratave etj.,

Ligji në fjalë në kreun e dytë ka rregulluar përjashtimet dhe lirimet që kanë pasur të bëjnë me Marrëveshjet e përjashtuara; Përjashtimi për marrëveshjet mbi zbatimin e njëjlojshëm të standardeve ose kushteve biznesore; Përjashtimi i marrëveshjeve për specializim; Përjashtimi për marrëveshjet për racionalizim; Përjashtimi i marrëveshjeve tjera të caktuara; Aplikimi dhe lejimi i përjashtimit. Në Pjesën e tretë (3) që i dedikohet marrëveshjeve vertikale përcaktohet ndalimi themelor në marrëveshje që kufizojnë lirinë e palëve për caktimin e çmimeve dhe kushteve në transaksionet me palët të treta; Kontrollimi i shpërdorimit të transaksioneve ekskluzive tregtare; Marrëveshjet mbi pronën intelektuale dhe sekretin afaristë. Pjesa e katërt (4) lidhur me shpërdorimin e pozitës dominuese ka sanksionuar; Ndalimin e pozitës dominuese, konstatimin e pozitës dominuese; Konstatimin e shpërdorimit të pozitës dominuese. Kreu dy (2) i ligjit në fjalë ka përcaktuar edhe praktikën tjera të cilat kanë mundësi që të dëmtojnë tregun andaj është Ndaluar diskriminimi dhe ndalimi i pengimit të padrejtë; Ndalimi i bojkotimeve dhe praktikave tjera kufizuese; Ndalimi i rekomandimeve dhe Rekomandimet jodetyruese të çmimeve për produktet e markës.¹²⁹

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës në fuqi në Republikën e Kosovës

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, me 17 shkurt 2008, institucionet tona ndërmarrin një sërë hapash për të përmirësuar me urgjencë praktikën e imponuara nga UNMIK - u, duke shënuar një dinamik të shpejtë dhe rrënjësore në kuadër të sistemit të legjislacionit, qeverisjes dhe gjyqësisë. Pikërisht në këtë funksion Kuvendi i Republikës së Kosovës, bazuar në kompetencat kushtetuese me datë 07. tetor 2010 e Miraton Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229. Me këtë akt fillimisht e shfuqizuar Ligjin për konkurrencën¹³⁰ me qëllim që tani nën ndikimin e rrethanave të reja të siguroj zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së tregut të Kosovës duke ndaluar në mënyrë

¹²⁷ Ligji për konkurrencën Nr. 2004/36, neni 1

¹²⁸ Ligji për konkurrencën Nr. 2004/36, neni 3

¹²⁹ Për më shumë shih në ligjin Ligji për konkurrencën Nr. 2004/36, nga neni 13 deri në nenin 19

¹³⁰ Ligji për mbrojtjen e konkurrencës nr. 03/L - 229, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës - Prishtinë viti V / nr. 88/25 nëntor 2012 neni 69 - Dispozitat shfuqizuese ku thuhet se me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për konkurrencën me nr. 2004/36 si dhe të gjitha aktet nënligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

shumë më cilësore dhe efikase veprimet që kufizojnë, shtypin ose ç'rregullojnë konkurrencën. Me këtë ligj tani janë përcaktuar rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencat, organizimi i Autoritetit për mbrojtjen e konkurrencës si dhe procedurat në zbatim të këtij ligji. Ky ligj zbatohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet, në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë territorit të Kosovës, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë. Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës siguron një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg duke u mbështetur në tre shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës lidhur me; Marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve; Abuzimin me pozitën dominuese dhe; Bashkimet ose përqendrimit e ndërmarrjeve.

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës në Republikën e Kosovës në planin formal - juridik është krijuar mbi bazën e parimeve më të avancuar ndërkombëtare dhe dispozita e tij përmbajnë i përmbajnë postulatet më të larta të cilat i promovojnë edhe vendet e UE - së. Këto postulate konstatohen që në qëllimin e këtij akti duke i përcaktuar rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencat, organizimi i Autoritetit për mbrojtjen e konkurrencës si dhe procedurat në zbatim të këtij ligji.¹³¹ Cilësia e tij mund të konstatohet menjëherë edhe sa i përket fushës së zbatimit për faktin se i dedikohet një të të gjitha formave të parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet, në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë territorit të Kosovës, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.¹³²

Kreu i dytë (II) i cili ju dedikohet marrëveshjeve të ndërmarrjeve më saktësisht i sanksionin ato veprime ose mosveprime të cilat i konsideron marrëveshje të ndaluara. Andaj, këtu këto marrëveshje të ndaluara konsiderohen ato ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marruara në mes të shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që: caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi; kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit; zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurruese; kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.¹³³

Kreu i tretë (III) ligji në fjalë i rregullon përjashtimet dhe lejimet që mund të reflektohen të marrëveshjet horizontale në mes të subjekteve ekonomike duke lejuar që një marrëveshje e cila si objekt të vetin ka racionalizimin ose specializimin e veprimtarisë ekonomike, kërkimin dhe zhvillimin e produkteve ose proceseve, blerjen ose shitjen e përbashkët të produkteve nga një burim i vetëm, nën kushte dhe rrethana të caktuara kanë mundësi që të përjashtohen nga ndalimi i përcaktuar me nenin 4 të këtij ligji. Këto marrëveshja duhet të arsyetohen për shkak të efikasitetit ekonomik duke i plotësuar një seri kushtesh të cilat janë dhënë.¹³⁴

Kreu i katërt (IV) i referohet çështjeve të abuzimit me pozitën dominuese dhe praktikave kufizuese. Në kuadër të saj përcaktohet dhe sanksionohet qartë: Konstatimi i pozitës dominuese kur ndërmarrja qoftë në cilësi të furnizuesit ose blerësit për lloje të caktuara të mallrave ose shërbimeve nuk i nënshtrohet konkurrencës së lirë në treg; Abuzimin me pozitën dominuese, Vendimin për konstatimin e Keqpërdorimit të pozitës dominuese.¹³⁵

¹³¹Ligji për mbrojtjen e konkurrencës (më tutje LMK) nr. 03/L - 229 neni 1

¹³²LMK, neni 2

¹³³ LMK - marrëveshjet e ndaluara Neni 4

¹³⁴ LMK- Përjashtimi i marrëveshjeve horizontale neni 5

¹³⁵LMK - Abuzimi me pozitë dominuese dhe praktikave kufizuese nga neni 10 deri në nenin 12

Kreu u pestë (V) rregullon aspektet e përqendrimeve duke dhënë përcaktuar se me këtë termë nënkuptohet situata si rezultat i bashkimit ose aneksimit ndërmarrja bashkohet me ndërmarrjen amë dhe krijohet aso situatë kur ndërmarrjet e nuk e humbin subjektivitetin juridik por në planin ekonomik bëhen të varura; Përqendrimet e ndaluara konsiderohen rastet kur me anë të këtij procesi dëmtohet ndjeshëm konkurrenca, posaçërisht në qoftë se një përqendrim i tillë ka si pasojë forcimin e pozitës dominuese ekzistuese ose krijimin e një pozite të re dominuese; Detyrimin për njoftimin e realizimit të përqendrimit; të hyrat e përgjithshme kreditore të institucioneve tjera financiare; Njoftimin për qëllimin e realizimit të përqendrimit; Përmbytjen e njoftimit për realizimin e përqendrimit; Procedurat e vlerësimit për lejimin e përqendrimit; Vërtetimi për lejimin e përqendrimit dhe Vendimi për vlerësimin e përqendrimit; Shfuqizimin dhe Ndryshimin e Vendimit mbi përqendrimin; Masat për realizimin e paligjshëm të përqendrimit.¹³⁶

Ky akt ligjor, përveç atyre të potencuar më sipër, rregullon edhe mekanizmat që kanë të bëjnë me dhënien e mendimit profesional nga ana e Autoritetit të Konkurrencës në rast kur kërkohet nga ana e Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, të organeve qendrore të administratës publike, personave juridikë që kanë autoritet publik dhe organeve lokale. Mendimi i autoritetit ka të bëjë me pajtueshmërinë e ligjeve ekzistuese dhe rregullave tjera më ligjin në fjalë. Po ashtu, ku funksion shtrihet edhe në dhënien e mendimeve profesionale për praktikën legjislative dhe politikat e konkurrencës në vend.¹³⁷ Kreu i shtatë (VII) e ka rregulluar themelimin, funksionin dhe organizimin e Autoritetit të Konkurrencës në Republikën e Kosovës. Në kuadër të këtij autoriteti ekziston edhe Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës në cilësi të një organi kolegjal; Kushtet se si dhe kush mund të jetë anëtar i Komisionit të Konkurrencës; Shkarkimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit; Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit; Mënyrën e vendim - marrjes; Administratën e Autoritetit, Organizmin, Detyrat dhe Përgjegjësitë; dhe Konfliktin e interesit.¹³⁸ Kreu i tetë (VIII) rregullon zhvillimin e procedurave nga ana e Autoritetit; Kreu i nëntë (IX) nëpërmjet ka përcaktuar dispozita ndëshkues; Kreu i dhjetë (X) bashkëpunimin me organet tjera dhe mbrojtjen gjyqësore; Kreun e njëmbëdhjetë (XI) përmbarimin e masave ndëshkimore dhe mënyrat e parashkrimit dhe në Kreun e XII dispozitat kalimtare.¹³⁹

PËRFUNDIMET

Sistemi ekonomik në Republikën e Kosovës është kategori kushtetuese, sipas së cilës sistemi ekonomik bazohet parimet e ekonomisë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Garantimi i këtij parimi kushtetutës realizohet edhe nëpërmjet Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës” nëpërmjet institucionit përgjegjës i njohur si Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Ky institucion publik funksionon jo vetëm në zbatim të ligjit dhe të politikës së konkurrencës , por edhe të normave dhe praktikave më të mira të administratës publike dhe të së drejtës evropiane të konkurrencës.

Vendi ynë është duke kaluar nëpër një proces të tranzicioni atipik për shkak të një të kaluarë të ndërlikuar shoqërore - politike. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2007, ekonomia e vendit tonë, si asnjëherë më parë, po ballafaqohet me një dinamikë të zhvillimit dhe integritit të tregjeve të saja por, në anën tjetër edhe me paraqitjen e formave të ndryshme të konkurrencës jolojale. Këto forma dhe niveli i lartë i pasigurisë së të bërit biznes gjithnjë e më të shumë paraqesin një situatë të paqarta ekonomike e cila kërkon jo vetëm qasje preventive profesionale por edhe angazhim serioz dhe të fortë institucional. Konkurrenca është një dukuri ekonomike, që i referohet një gjendjeje të tillë të një

¹³⁶ LMK - Përqendrimi i ndërmarrjeve nga neni 13 deri të neni 22.

¹³⁷ LMK - neni 23

¹³⁸ LMK - Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni i konkurrencës nga neni 24 deri të neni 31.

¹³⁹ Për më shumë shih në LMK

ekonomie të lirë tregu, ku ndërmarrjet respektivisht shoqëritë e biznesit, në mënyrë të pavarur, përpiqen të përfitojnë sa më shumë blerës me qëllim që të arrijnë objektivat e tyre, siç janë: maksimizimi i fitimit, i shitjeve, ndarja e tregut, etj.. Konkurrenca krijon një mjedis ekonomik ku subjektet biznesore mund të veprojnë lirisht në arritjen e këtyre objektivave, ndërsa konsumatorët, nga ana e tyre, përfitojnë nga çmimet e vendosura në bazë të bashkëveprimit mes forcave të kërkesës dhe atyre të ofertës. E drejta e konkurrencës është tërësi e rregullave juridike e të tjera të sjelljes së operatorëve (subjekteve të së drejtës) në treg, të cilat i nxjerrin institucionet shtetërore, me qëllim të krijimit të një klime, kushteve, mundësive, rrethanave dhe ambientit të përshtatshëm juridik, për inkuorimin e modelit të tillë i cili i përfshinë të drejtën antikartelore; antitrustore; të drejtën e konkurrencës së ndaluar dhe të drejtën e luftimit dhe pengimit të konkurrencës jolojale

E drejta kosovare e konkurrencës është vendosur për të mbrojtur konkurrencën e lirë në mes ndërmarrjeve në treg. Konkurrenca e lirë ka rëndësi vendimtare për të gjithë shtetet, ekonomia e të cilëve bazohen në parimin e tregut të lirë, ku shpërndarja e mjeteve është rezultat i raporteve të ofertës dhe kërkesës në treg, kurse jo pasojë e masave me të cilat shteti intervenon në raportet në mes ndërmarrjeve. Zbatimi i rregullave të konkurrencës ka për qëllim vendosjen e një tregu, ku ndërmarrjet marrin pjesë në mënyrë të barabartë dhe në kushte të njëjta, kurse pozita e tyre në treg së pari të vlerësohet në bazë të cilësisë së prodhimeve përkatësisht shërbimeve të cilat i ofrojnë. Në këtë kuptim, detyrë e së drejtës së konkurrencës është të ndalojë aktivitetet dhe praktikën e herë pas herë afariste në treg, të cilat disa ndërmarrje mund t'i sjellin në pozitë të cilat në mënyrë të pa drejtë është më e volitshme në krahasim me ndërmarrjet e tjera, e me këtë të cenon konkurrencën e lirë në mes ndërmarrjeve. Është potencuar se termi konkurrencë është term latin "Concurrentia", që do të thotë garë, garim, konkurrim, partneritet. Varësisht nga kushtet, rrethanat, ambienti dhe sjelljet e aktorëve pjesëmarrës në treg, konkurrenca, mund të jetë e plotë, jo e plotë dhe monopoliste. Fillet e para zhvillimore të së drejtës së konkurrencës në UE, datojnë nga viti 1957., kur gjashtë shtete euro - perëndimore do ta nënshkruajnë Traktatin e Unionit Evropian, ndryshe të quajtur - traktati i Romës. Bashkësia fillimtare evropiane, pas gjysmë shekulli, do rritet dhe ngritet në një treg dhe bashkim (union) të mirëfillt evropian me mbi gjysmë miliardi konsumatorë, respektivisht qytetarë. Traktati në fjalë, konkurrencën e shëndoshë e shih si një element qendësor, në krijimin e tregut të lirë; nga kontrolli, dominimi dhe abuzimet tjera. Sipas dispozitave të nenit 81. të traktatit të Romës, të cilat kanë të bëjnë me kartelet dhe marrëveshjet restriktive vertikale, ndahen:” të gjitha marrëveshjet, vendimet e ndërmarrjeve dhe asociacioneve, si dhe praktikave të dëmshme, të cilat mund të prekin, godasin dhe dëmtojnë marrëdhëniet biznesore në mes të shteteve anëtare dhe të cilat do ta kenë, si objekt të tyre ose si efekt. Dinamika zhvillimit të së drejtës dhe politikave të konkurrencës në UE ndahet në gjatë etapë të rëndësishme.

LITERATURA

1. Azizi Prof.dr. A "Bashkimi Evropian - E drejta, institucionet dhe politikat, Tetovë 2010
2. Besarovic V. Pravoindustrijskesvojineiautorskopravo, BG., NIO Poslovnapolitika,
3. Bektashi Prof. dr. M “Ekonomia”, Prishtinë, 2011.
4. Bektashi Prof.dr. M & Gaxaferri N. “Ekonomia” Prishtinë 2009.
5. Hetemi Prof. Dr. M, "Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut" Prishtinë, 2005.
6. Hetemi Prof. Dr. M. "E drejta ndërkombëtare afariste" Prishtinë, 2007
7. FjalorthterminologjikikonkurrencësibotuarngaAutoritetiiKonkurrencësëRepublikësëShqipërisë
8. Letessier J&tërtjerët "Evropaekonomikedhe e ardhmja e saj" Tiranë 2008,
9. Diana D. "Politikat e Bashkimit Evropian" Tiranë 2010
10. Milkotin D & të tjetër "Evropsko tržišno pravo" Zagreb 2006

11. David R. "L'arbitrage dans le Commerce International" Paris, 1982.
12. R. David, Uvod u privatno pravo Engleske, Beograd, 1960.
13. Saleh S., "Commercial arbitration in the Arab Midle East", London, 1984.
14. Triva S., "Građansko procesno pravo" Zagreb, 1983.
15. Varadi T., "Međunarodno privredno pravo", Budimpešta, 1997.
16. Pierre Le Mire "E drejta e Unionit Evropian dhe Politikat e Përbashkëta" Shkup 2006
17. Fouchard V., "L'arbitrage International Commercial", Paris, 196523.
18. Vinter V., Trgovački zakon, Osijek, 1912.
19. Wajdenfeld W & Wessels V" Evropaprej A deri ne ZH" Prishtinë 2004
20. Grondov Z., "Tregtia jugosllave në ekonomi të tregut" 1989.
21. Markušić Ž., "Međunarodna trgovina – teorija i politika", "Privredno finansijski vodič", Beograd, 1979
22. Gautron C. J., "E drejta evropiane" Shkup 2006.
23. Jarrosson Ch., La notion d'arbitrage, Paris 1987
24. Ndreca M., Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Prishtinë 1986.

Ligje

- I.** Kodi Penal i Kosovës 04/L-082
- II.** Ligji për konkurrencën Nr. 2004/36
- III.** Ligji për mbrojtjen e konkurrencës, nr. 03/L -229
- IV.** Ligji për ndihmë shtetërore Nr. 04/L - 024
- V.** Ligji për Vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L - 040
- VI.** Kodi doganor dhe i akcizave i Kosovës Nr.03/L - 109

MBROJTJA JURIDIKE E TËDREJTËS SË AUTORIT

Prof. Ass. Dr. Orhan M. Çeku
Kolegji "Pjetër Budi" - Prishtinë

MSc. Amet Shabani, PhD kandidat

MSc. Kastriot Dermaku, PhD kandidat
Këshilli i Sigurisë së Kosovës

Abstrakt

Në këtë punim është analizuar rregullimi juridik i mbrojtjes së të drejtës së autorit sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës. Për të pasur një pasqyrë gjithëpërfshirëse, në punim është analizuar edhe kuadri ndërkombëtar i mbrojtjes juridike të këtij instituti juridik - si dhe e drejta e Unionit Evropian.

Nga niveli i mbrojtjes së të drejtës së autorit, varet se çfarë shoqërie jemi, çfarë vlerash dhe parimesh përfaqësojmë. E drejta e autorit përbën integritetin shoqërisë dhe funksionimin e shtetit modern.

Duke qenë institut juridik civil, e drejta e autorit hyn në grupin e degëve të së drejtës private. Kjo është e kuptueshme duke marrë parasysh karakterin e normave juridike me të cilat rregullohet. Punimi është fokusuar në studimin analitik të doktrinës juridike dhe ligjet kryesore me të cilat rregullohet ky institut juridik në Republikën e Kosovës. Në punim është trajtuar domosdoshmëria e përmbushjes së obligimeve të marra nga Kosova me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit në lidhje me të drejtat e autorit. Qëllimi i këtij punimi është sensibilizimi i opinionit shkencor dhe institucioneve kompetente në vendin tonë lidhur me vëllimin e mbrojtjes së të drejtave të autorit në funksion të përmirësimit të situatës në terren.

Punimin e kemi shtjelluar duke marrë për bazë fazat e procesit të hulumtimit dhe metodat kryesore të studimit të cilat përdoren në shkencat juridike në përgjithësi.

Fjalë kyçe: E drejta e autorit, pronësi intelektuale, legjislacion, mbrojtje juridike, instrumente ndërkombëtare, etj.

I. Hyrje

E drejta e autorit hyn në grupin e degëve të së drejtës më pak të studiuar në vendin tonë. E drejta e autorit bën pjesë në të "*drejtën e pronësisë intelektuale*". Prona intelektuale përfshin gjitha krijimet e trurit të njeriut. Krijimet e trurit të njeriut mbrohen me ligjet e pronës intelektuale. Prona intelektuale është e ndarë në të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura, në njërin anë, dhe prona

industriale në anën tjetër.¹⁴⁰ Pronësia Intelektuale (PI) i referohet krijimeve mendore: shpikjeve, veprave letrare dhe artistike, simboleve, emrave, imazheve, dizajneve të përdorura në afarizëm¹⁴¹. Në teorinë juridike E drejta e pronësisë intelektuale ndahet: 1. Në të drejtën e pronësisë industriale dhe 2. Në të drejtën e autorit.

Në përgjithësi e drejta e pronës intelektuale i referohet produkteve të shpirtit njerëzor të cilat i takojnë shpikësit apo pronarit të tyre. “Prona intelektuale është një pronë jo materiale, por që ka shumë karakteristika të ngjashme me pronën reale. Kështu, prona intelektuale është një aset që mund të shitet, blihet, licencohet, shkëmbehet etj, si ç’do pronë tjetër. Gjithashtu, pronari i pronës intelektuale ka të drejtë që të ndalojë veprimet e paautorizuara në lidhje me pronën etij. Dallimi më i rëndësishëm midis pronës intelektuale dhe formave të tjera të pronave është se prona intelektuale, duke qenë imateriale nuk mundet të përcaktohet nëpërmjet parametrave fizikë. Ligjet për pronësinë intelektuale kanë për qëllim të mbrojnë krijuesit dhe prodhuesit e tjerë të pronës intelektuale duke u dhënë atyre të drejta të kufizuara në kohë për të kontrolluar përdorimin e pronës së tyre. Prona intelektuale mbrohet mbibaza kombëtare, prandaj objekti i mbrojtjes dhe kërkesat, që duhen përmbushur për t’u garantuar mbrojtja, variojnë nga një shtet në tjetrin. Megjithatë, ka një prirje për harmonizimin e ligjeve kombëtare.”¹⁴² “Kjo vihet re në numrin e konsiderueshëm të marrëveshjeve ndërkombëtare, që janë hartuar për mbrojtjen e pronësisë intelektuale.”¹⁴³

E drejta e autorit si lëmi e veçantë përfshin krijimtarinë e autorit e cila krijohet në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit. Autori, personi fizik i cili me krijimtarinë shpirtërore dhe intelektuale të tij, për krijimet e të cilit arrijnë formën e caktuar ligjore, e cila gëzon mbrojtje ligjore dhe si e tillë përbëhet nga krijimi origjinal në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit.¹⁴⁴ E drejta e autorit është e drejta ekskluzive e kopjimit të një veprë krijuese ose për të lejuar dikë të bëjë diçka të atillë, kjo lejueshmëri varet nga normat ligjore mbi të drejtat e autorit. Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të, vepër artistike është çdo krijim origjinal, intelektual i një personi fizik, i materializuar pavarësisht nga forma a mënyra e të shprehurit, që ka për qëllim të prekë ndjesitë e njeriut. Për të drejtën e autorit, mund të themi se kjo e fundit është një prerogativë që i atribuohet autorit të veprës (shkrime, konferenca, vepra dramatike, koreografike, fonografike etj). E drejta e autorit përmban në vetvete një të drejtë fitimprurëse dhe një të drejtë morale.¹⁴⁵

Autorët e punimeve letrare, shkencore dhe artistike dhe të tjera fusha të krijimtarisë kanë të drejtën ekskluzive për të përdorur ose për të autorizuar të tjerët të përdorin veprat e tyre. E drejtë e tillë e autorit, si dhe sistemi i instrumenteve ligjore që mbrojnë një të drejtë të tillë quhet e drejta e autorit.¹⁴⁶ E drejta e autorit aplikohet te të gjitha veprat origjinale letrare, shkencore dhe artistike. Këto përfshijnë: librat, muzikën, skulpturat, pikturat, fotografitë, filmat, programet radio-televizive, programet kompjuterike. Pra e drejta e autorit përfshihet edhe te subjektet etjera, në të cilën përfshihen regjistrimi i tingujve (të tilla si regjistrimet, kasetat dhe kompakt disqet) performancat e interpretuesve dhe sinjalet e komunikimit.¹⁴⁷ Drejta e Autorit i jep të drejta ekskluzive autorit të veprës së mbrojtur, përjashtimisht duke marrë parasysh kufizimet e parapara ligjore. Çdo here, kur një person

¹⁴⁰ Organizata Botërore e Pronës Intelektuale, 2007: “Mësoni nga e kaluara, krijoni ardhmërinë artet dhe të drejtat e autorit”, përkthyer në gjuhën shqipe nga Oda Ekonomike Amerikane në Maqedoni, Ambasada e SHBA-ve në Maqedoni dhe Enti Shtetëror për të Drejta Industriale i Republikës së Maqedonisë, fq. 16

¹⁴¹ Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale (WIPO): <http://www.wipo.int/about-ip/en/>

¹⁴² Uarda Albunesa: “E drejta e autorit në legjislacionin shqiptarë dhe atë evropian – përjasja mes tyre”, Disertacion Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, fq. 47

¹⁴³ Elina Koçi, “Pronësia Intelektuale”, Tiranë, 2006, Erik, faqe 13.

¹⁴⁴ Abdulla Aliu, E Drejta e Autorit, Prishtinë 2014, fq. 11 - 12.

¹⁴⁵ Gabriel De Broglie: Le droit d’auteur et l’internet, Rapport du groupe de travail de l’Académie des sciences morales et politiques, Paris, 2000.

¹⁴⁶ Available at :<http://www.dziv.hr/en/intellectual-property-protection/copyright/>

¹⁴⁷ Raymond Guillien dhe Jean Vincent: Lexique des termes juridiques, Toulouse, 2007

i caktuar, përveç autorit të veprës së mbrojtur, dëshiron të përdor veprën e mbrojtur të autorit, është i obliguar të kërkojë leje nga autori për përdorimin e veprës.¹⁴⁸

Në bazë të Konventës së Bernës, një ndër konventat kryesore ndërkombëtare për të drejtën e autorit, vepra e autorit konsiderohet vepra letrare dhe artistike, që përfshin prodhim të domenet shkencor, letrar dhe artistik, në çfarëdo forme të shprehjes.¹⁴⁹

II. E Drejta e Autorit sipas Legjislacionit në Kosovë

E drejta e autorit hyn grupin e të drejtave të pronësisë intelektuale në përgjithësi. E parë kështu, e drejta e autorit hyn në grupin e të drejtave kushtetuese në Republikën e Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parasheh të drejtën e pronësisë intelektuale në kapitullin e lirive dhe të drejtave të themelore. Sipas Kushtetutës:

“1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose për interesin publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.”¹⁵⁰

Republika e Kosovës ka një bazë të mirë juridike në përgjithësi. Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës i plotësojnë standardet minimale bashkëkohore. Në këtë kuptim duhet parë edhe legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave të autorit. Në vitin 2006 nga Kuvendi i Kosovës ishte miratuar Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta Ligji Nr. 2004/45. Ky ligj ishte nënshkruar nga PSSP¹⁵¹ dhe ishte shpallur në gazetën zyrtare nr. 11, 1 prill, 2007¹⁵². E drejta e autorit në Kosovë u rregullua me këtë ligj deri me më hyrjen në fuqi të ligjit të ri Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta-Ligji Nr. 04/L-065¹⁵³. E drejta e autorit përgjithësisht rregullohet nga këto ligje:

- Ligji Nr. 04/L-065 Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 27 / 30 Nëntor 2011, Prishtinë);
- Ligji Nr. 2009/03-L-170 për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale,
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës; dhe
- Ligji mbi Inspektoratin e Tregut.

1. Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta- Ligji Nr. 04/L-065

Në nenin e parë të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta-Ligji Nr. 04/L-065 përcaktohet qëllimi dhe objekti i rregullimit juridik të tij:

¹⁴⁸ Valon Kashtanjeva: “Veprat e Autorit dhe Kushtet e Mbrojtjes”, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Kosova Mbronë Autorin, Prill, 2013, Fq. 13

¹⁴⁹ Shih Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare e Artistike, Neni 2.

¹⁵⁰ Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 46 (mbrojtja e pronës)

¹⁵¹ Përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

¹⁵² Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë : Viti II / NR. 11 / 01 Prill 2007

¹⁵³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 27 / 30 Nëntor 2011, Prishtinë

- “të drejtat e autorit që, në bazë të pronës intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit, në vijim e drejta e autorit;
- të drejtat që, në bazë të pronës intelektuale, janë të përafërta me të drejtat e autorit, në vijim të drejtat e përafërta, u takojnë:
 - interpretuesve përkitazi me interpretimet e tyre;
 - prodhuesve të fonogrameve përkitazi me fonogramet e tyre;
 - producentëve të filmit përkitazi me videogramet e tyre;
 - shërbyesit medial Audiovizuel përkitazi me transmetimet e tyre;
 - prodhuesve të bazave të të dhënave përkitazi me bazat e tyre të të dhënave;
 - botuesve përkitazi me botimet e tyre;
 - administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta;
 - mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta;
 - zbatimin e këtij ligji ndaj personave të huaj.¹⁵⁴

Me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta janë parashikuar masat administrative, mbrojtja juridiko civile, të cilat zbatohen konform me rregullat e procedurës administrative dhe gjyqësore. Kapitulli XI, përkatësisht nën kreu B i këtij ligji parasheh dispozitat për mbrojtjen gjyqësore në rast të shkeljes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta. Në bazë të nenit 177 personit të cilit i është shkelur e drejta mund të kërkojë mbrojtjen dhe gjithashtu kompensimin në bazë të rregullave.¹⁵⁵

“Personi, të cilit i janë shkelur të drejtat që mbrohen me këtë ligj, mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij dhe zhdëmtim përkatës në varësi me shkeljen. Mbrojtje e njëjtë e të drejtave mund të kërkojë edhe kur është i dukshëm rreziku i shkeljes së të drejtave të mbrojtura me këtë ligj. Mbrojtja e parashikuar nga dispozitat tjera ligjore mbetet e paprekur.”¹⁵⁶

2. Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale Ligji Nr. 03/L – 170

Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale Ligji Nr. 03/L – 170 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 29 dhjetor 2009 dhe është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 64 / 01 Shkurt 2010.

“Ky ligj rregullon procedurat për veprim nga Dogana për mallrat të cilat janë të dyshimta për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale në situatat kur mallrat janë: Të deklaruara për lirim për qarkullim të lirë, eksport ose ri-eksport në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave;. Gjetur gjatë kontrollit të mallrave duke hyrë ose duke dalë nga territori i Doganave të Republikës së Kosovës, të vendosura nën procedurën e transitit, procedurat e magazinimit Doganor, procedurave të përpunimit të brendshëm, përpunimi nën mbikëqyrjen Doganore, importit të përkohshëm, të vendosur në zonë të lirë, në depo të lirë doganore në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave. Ky ligj po ashtu përcakton masat për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale që merren nga Dogana kur mallrat që i referohen paragrafit 1 të këtij neni janë gjetur se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale.”¹⁵⁷

Ligji vënë theksin në mbrojtjen doganore të pronësisë intelektuale dhe parasheh rolin e Doganës së Kosovës në këtë fushë. Ligji është në korrelacion me zhvillimet bashkëkohore në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale duke inkorporuar edhe shërbimet doganore në funksion të mbrojtjes së kësaj fushe të rëndësishme. Në këtë kuptim Republika e Kosovës ka miratuar këtë ligj duke u bazuar në parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë pjesë e së cilës sot është Marrëveshja për masat doganore për të drejtat e pronësisë intelektuale TRIPS.

¹⁵⁴Ligji Nr. 04/L-065 Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave tjera të Përafërta, neni 1

¹⁵⁵Ibid

¹⁵⁶Ligji Nr. 04/L-065, mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, neni 177

¹⁵⁷Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale Ligji Nr. 03/L – 170, neni 1

Bazuar në nenin 4 të ligjit 03-L/170/2010, Masat Doganore për Mbrojtje të Pronësisë Intelektuale dhe Udhëzimit Administrativ 07/2010, për zbatimin e Ligjit 03-L/170/2010, përcaktohen procedurat e parashtrimit të kërkesës për veprim se, kush mund të parashtroj një kërkesë për veprim nga Dogana, taksat lidhur me procedimin e kërkesës për veprim, cilat informata duhet të përmbaj kërkesa për veprim. Kërkesa për masat doganore parashtrohet pranë autoriteteve Doganore, konkretisht Sektorit për të Drejtat e Pronësisë intelektuale, për të ndërmarr veprimet doganore për mallrat që cenojnë një të drejtë të pronësisë intelektuale.¹⁵⁸

3.Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta është organ administrativ i themeluar me rregulloren e Qeverisë së Kosovës Nr. 01/2010, në Qershor të vitit 2010. Zyra vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe veprimtarinë e saj e ushtron, në bazë të ligjit.

Veprimtaria themelore e Zyrës përfshin:

- dhënien e lejes shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave;
- marrjen e lejes së dhënë Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave në rast të mos përmbushjes së kriterëve të parapara me ligj; -
- mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe aktiviteteve të shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave;
- promovimin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për dhënien e informatave të duhura autorëve, bartësve të të drejtave dhe opinionit të gjerë lidhur me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta; -
- përcjelljen e legjislacionit ndërkombëtar dhe dhënien e rekomandimeve përkitazi me fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.¹⁵⁹

Zyrabashkëpunon me institucionet vendore, të cilat kanë kompetenca në fushën e të drejtës së autorit. Në këtë aspekt, duhet përmendur bashkëpunime Doganën e Kosovës, Inspektoratin e Tregut, Zyrën për Pronësi Industriale, dhe Policinë Kosovës. Me qëllim të forcimit të bashkëpunimit dhe me rekomandim të Komisionit Evropian, janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi me institucionet përmendura më lartë.

IV.Masat Ndëshkimore për Shkeljen e të Drejtave të Autorit

Masat ndëshkimore për shkeljen e të drejtës së autorit parashihen me disa ligje: Ligjin për të drejta e autorit dhe të drejtat tjera të përafërta Ligji Nr . 04/L-065, me Kodin Penal të Kosovës dhe Ligjin për inspektoratin e tregut.

Ligjin për të drejta e autorit dhe të drejtat tjera të përafërta i parasheh masat ndëshkimore në kreun e 12. Në kuadër të këtij kapitulli janë 6 nene të cilat parashohin shkallë të ndryshme të ndëshkimeve në rast të shkeljeve të të drejtave të autorit. E veçanta e dënimeve të cilat parashihen me këtë ligj është se janë dënime me karakter të kundërvajtjes dhe ndëshkimi për këto vepra të kundërligjshme parashihet me gjobë.

Neni 190 i parasheh këto masa ndëshkimore: “Me gjobë prej dymijë (2.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dënohet personi juridik, nëse në kuadër të veprimtarisë së vet ose në biznes me të tjerët, shfrytëzon pa leje veprën e autorit ose lëndën nga të drejtat e përafërta. Me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro dënohet personi përgjegjës i personit juridik kur kryen kundërvajtjen e përmendur në paragrafin 1. të këtij neni.”

Në grupin e dytë, përkatësisht neni 191 parashihen këto masa ndëshkimore: “1. Me gjobë prej pesëmijë (5.000) deri në njëzetepesëmijë (25.000) Euro dënohet për kundërvajtje çdo person juridik, nëse në kuadër të veprimtarisë ose bashkëpunimit të biznesit:

1.1. kryen cilindo veprim të shmangies të masave efektive teknologjike të mbrojtjes;

1.2. kryen veprimin e heqjes apo të ndryshimit të informacionit elektronik të realizimit të të drejtave.

¹⁵⁸ Dogana e Kosovës, Doracak Për Zbatimin e Legjislacionit në Fushën e të Drejtës së Pronësisë Intelektuale, fq. 9

¹⁵⁹Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, në fuqi nga dhjetori i vitit 2012, neni 171

2. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri pesëmijë (5.000) Euro dënohet personi i cili kryen kundërvajtjen e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 192 i parasheh këto masa ndëshkimore: “1. Me gjobë prej jo më pak se pesëqind (500) deri njëzetepesëmijë (25.000) Euro dënohet për kundërvajtje çdo person juridik:

1.1. që nuk i dorëzon shoqatës kolektive kompetente informacionin lidhur me llojet dhe numrin e pajisjeve të shitura ose të importuara për fiksime vizuale ose të zërit, pajisjet fotokopjuese, transmetuesit bosh të zërit apo të imazhit, si dhe informacionin mbi fotokopjet e shitura të cilat janë të nevojshme për llogaritjen e kompensimit të veçantë;

1.2. që nuk i dorëzon shoqatës kolektive kompetente raporte ose informacione apo programe në mënyrën dhe afatet, siç është përcaktuar nga ky ligj, të rëndësishme për llogaritjene kompensimit të veçantë;

2. Me gjobë prej jo më së paku se njëmijë (1.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro dënohet personi që kryen kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Në nenin 193 bëjnë pjesë këto dënime:

1. Me gjobë prej së paku katërmijë (4.000) deri në njëzetmijë (20.000) Euro, dënohet për kundërvajtje Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave, nëse:

1.1. nuk mban apo në mënyrë neglizhente operon me të dhënat dhe kontabilitetin;

1.2. nuk ia përcjellë bartësit të të drejtës të ardhurat që i takojnë nga kompensimet e mbledhura prej shfrytëzuesve të lëndëve të mbrojtura;

1.3. nuk e zbaton kërkesën për auditimin e veprimtarisë financiare nga ana auditorëve të pavarur;

1.4. nuk i kryen detyrimet ndaj Zyrës ose nuk i zbaton masat që kjo Zyrë i ka urdhëruar për mënjanimin e parregullsive në punë.

2. Me gjobë prej jo më pak se njëmijë (1.000) deri pesëmijë (5.000) Euro, dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni edhe personi përgjegjës i Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave.

Ligji parasheh shprehimisht se “Gjësendet e përfituara me kryerjen e kundërvajtjeve nga nenet e lartcekura konfiskohen”. Procedura për kundërvajtje fillon me kërkesën e organit të inspektimit, policisë, palës së dëmtuar, Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave ose të Zyrës.

Në grupin e dytë të ndëshkimeve bëjnë pjesë veprat penale të parapara me Kodin Penal të Kosovës – Kodi Nr. 04/L-082. Kodi parasheh dy grupe të veprave penale të cilat kanë për qëllim ndëshkimin e autorëve të shkeljeve të të drejtës autoriale. Kodi ka paraparë masa mjaft të rrepta ndëshkimore për shkeljen e të drejtave të autorit. Në grupin e parë **“Cenimi i të drejtave të autorit” bëjnë pjesë këto vepra penale**. Në grupin e dytë të veprave penale bëjnë pjesë: **“Shmangia e masave teknologjike”**.

Inspektorati i Tregut në Republikën e Kosovës është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, sigurinë e produkteve në treg po ashtu dhe për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme në treg.

Inspektorët monitorojnë zbatimin e ligjit dhe janë përgjegjës për marrjen e masave administrative në rastmospërmbyllje të detyrimeve ligjore nga subjektet përdorues. Sipas të ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut kompetencë e inspektoratit përveç të tjerash njihet edhe mbrojtja e të drejtave të autorit¹⁶⁰.

Bartësi i së drejtës së autorit ka të drejtë të kërkojë nga inspektorati i tregut, inspektimin e tregut dhe në rast se dyshon që drejta e tij është shkelur ai mund të kërkojë nga inspektorati konfiskimin dhe largimin nga tregumallrave të cilat shkelin të drejtën e autorit. Atëherë kur vërtetohet që mallrat janë pirate dhe qëndrimii tyre në treg dëmton ekonominë legale, inspektoratitka të drejtë të bëjë asgjësimin e tyre.¹⁶¹

V. Standardet Ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Intelektuale

E drejta e autorit trajtohet edhe në doktrinën, e cila merr në mbrojtje të drejtat themelore të njeriut. Në të gjitha materialet e përmendura, është vënë theksi në rregullimin juridik të kësaj fushe,

¹⁶⁰Ligji për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut Neni 9 p.1.10

¹⁶¹Zbatimi i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Kosova Mbron Autorin, Prill, 2013, Fq. 12

mjaft të rëndësishme. Vlen të përmendet Deklarata e Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, e cila konsiderohet si një dokument irëndësishëm ndërkombëtar, i përfshirë pas Luftës së Dytë Botërore, e deklaruar me 1 Dhjetor 1948, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe e miratuar nga 48 shtete të ndryshme të botës anëtare të hershme të OKB-së. Kjo deklaratë e përgjithshme nuk formon vetëm një lloj besimi kolektiv, nëvlerat supreme të personit njerëzor, por në planin juridik formon një lloj baze për të përcaktuar të drejtat, të cilat më parë ishin konsideruar, më tepër, objekt i ligjit moral.¹⁶²

Konventat më të njohura të kësaj fushe janë Konventën që themelon Organizatën Botërore për Pronësi Intelektuale e vitit 1970 dhe Konventën e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike të vitit 1886.

Të një rëndësie të madhe krahas konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtës së autorit është edhe legjislacioni i Unionit Evropian.

Sipas të drejtës së Unionit Evropian, rregullimi normativ i të drejtës së autorit, si proces, u ndërmor me qëllim harmonizimin e ligjeve të ndryshme kombëtare të Shteteve anëtare, të cilët e rregullonin në mënyra të ndryshme këtë të drejtë.¹⁶³

Një iniciativë për harmonizimin e kuadrit ligjor në këtë fushë, nga ana e Bashkimit evropian, u ndërmor kryesisht për disa arsye:

E para: E drejta e autorit është pjesë përbërëse e të drejtës së pronësisë intelektuale për të cilën kemi folur në fillim të këtij punimi, e cila është vlerësuar si e një rëndësie të madhe në Unionin Evropian, në kuadër të rregullimit normativ të shtyllës së parë (Tregu i Përbashkët) të Bashkimit Evropian. Kështu qërregullimi i të drejtës së autorit në kuadër të rregullimit të së drejtës së pronësisë intelektuale ishte i pashmangshëm për Unionin Evropian.

E dyta: Shtetet anëtare e kishin rregulluar këtë të drejtë me norma juridike kombëtare, përpara hyrjes në fuqi të traktateve të Komunitetit Evropian e më pas edhe të traktateve për krijimin e modifikimin e Unionit Evropian, dhe shtetet anëtare prezantoheshin me legjislacione të ndryshme në këtë fushë. Kuadri ligjor kombëtar i Shteteve anëtare në këtë fushë, për më tepër, ishte ngritur në nivel ndërkombëtar nëpërmjet traktateve ndërkombëtare¹³⁹, të nënshkruara prej tyre, përpara anëtarësimit të tyre në Komunitet e Bashkim Evropian.¹⁶⁴

E treta: E drejta e Bashkimit evropian ka prioritet (supremaci) mbi të drejtën e shteteve anëtare, çka çonte në konflikt ndërmjet detyrimeve të mara nga ana e shteteve në kuadër të traktateve ndërkombëtare me ato të ndërmarra në kuadër të Komunitetit dhe Bashkimit Evropian.

Unioni Evropian, ka miratuar numër të caktuar direktivash në fushën e të drejtës së autorit. Direktivat janë akte institucionale të detyrueshme për shtetet anëtare. Direktivat e Unionit Evropian në fushën e të drejtës së autorit kanë çuadrecht modifikimit të legjislacioneve kombëtare mbi rregullimin dhe mbrojtjen ekësaj të drejte.

Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e të drejtës së autorit janë të shumta ndër të cilat mund të përmendim: fillimisht direktivat e para të ndërmarra në kuadër të Komunitetit Ekonomik Evropian (KEE) janë: direktiva 91/250 e KEE, “Mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike” e vitit 1991 e pasuar nga direktiva 93/98 të KEE, “Mbi afatin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të”, e vitit 1993. Me pas një numër i madh direktivash që dolën, pas rregullimit normativ të të drejtës së autorit, në kuadër të shfaqjes së ndershme të tyre por edhe të të drejtave të lidhura me to.

Për sa i përket të drejtës së autorit, legjislacioni ekzistues i referohet dispozitave ligjore evropiane (“*Acquis communautaire*”¹⁶⁵) të mëposhtme:

¹⁶²Uarda Albunesa: “E drejta e autorit në legjislacionin shqiptarë dhe atë evropian – përfaqja mes tyre”, Disertacion Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, fq. 121

¹⁶³Uarda Albunesa: “E drejta e autorit në legjislacionin shqiptarë dhe atë evropian – përfaqja mes tyre”, Disertacion Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, fq. 118

¹⁶⁴Berne Convention for the Protection of Literary and Artistic Works (Paris 1971), TRIPS-(Trade Related Intellectual Property Rights) on WTO, WIPO-Performances and Phonograms Treaty (WPPT- 1996) and Copyright Treaty (1996), etc.

¹⁶⁵ Është tërësia e të drejtave dhe e detyrimeve të përbashkëta që i bashkon të gjitha Shtetet Anëtare në Bashkimin Evropian. *Acquis communautaire* ndryshohet vazhdimisht.

-Direktiva 93/83/KEE date 27 shtator 1993 “Për koordinimin e rregullave për të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të që zbatohen në transmetimetsatelitore dhe ritransmetimet kablllore. Direktiva 2001/84/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit date 27 shtator 2001 “Përtë drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një veprë arti origjinale”. Direktiva 2006/115/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006 “Për të drejtën e qirasë dhe huazimit si dhe për disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale” (version i kodifikuar i 92/100/KEE). Direktiva 2006/116/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006 “Për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të” (version i kodifikuar i 93/98/KE). Direktiva 96/9/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit date 11 mars 1996 “Përmbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave”. Direktiva 2009/24/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit date 23 prill 2009 “Përmbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike”.

Kosova si shtet i ri ka filluar procesin e integritimit në Unionin Evropian me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (këtu e tutje MSA). Në prill të vitit 2016, hyri në fuqi MSA-ja ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe Kosovës. Kjo është marrëdhënia jonë e parë kontraktuale dhe një hap i rëndësishëm për Kosovën në rrugën e saj për në BE. Kjo është e arriturë madhe për Kosovën në aspiratën për anëtarësim në BE.

Neni 77 i MSA-së shprehimisht përcakton obligimin e Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale

1. Në bazë të këtij Neni dhe Shtojcës VII, Palët konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si dhe zbatimit të të drejtave të pronës intelektuale, industriale dhe tregtare.
2. Kosova do të marrë masat e nevojshme në mënyrë që të garantojë, jo më vonë se pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, një nivel të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të ngjashme me ato që ekzistojnë në BE, duke përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.
3. Kosova merr përsipër që t'i përmbahet konventave shumëpalëshe mbi të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të referuara në Shtojcën VII. KSA-ja mund të vendosë të detyroj Kosovën që t'i përmbahet Konventave të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.¹⁶⁶

Në shtojcën e VII-të të MSA-së janë të renditura konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të cilat Kosova duhet tu përmbahet në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale.

VI. Përfundimi

Nga ajo çka shtjelluam deri me tani vërejtëm se Republika e Kosovës ka një legjislacion të mirë për mbrojtjen e të drejtës së autorit. Në Republikën e Kosovës e drejta e autorit mbrohet Kushtetutë dhe ligje. Prej ligjeve veçojmë Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat tjera të përfaqësuara, Ligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë intelektuale, Kodi Penal i Kosovës, Ligji për Inspektoratin e Tregut. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parasheh të drejtën e pronësisë në kapitullin e lirive dhe të drejtave të themelore si për të dëshmuar përkushtimin e shtetit tonë për këtë fushë. Ligjet në përgjithësi janë në korelacion me standardet ndërkombëtare dhe me të drejtën e Unionit Evropian. Nënshkrimi i MSA me Unionin Evropian e ka futur në obligime Kosovën që në tërësi të ndërmerr të gjitha veprimet për harmonizimin e plotë të legjislacionit në këtë fushë.

Edhe përkundër faktit se legjislacioni është mjaft i kompletuar në fushën e të drejtës së autorit, zbatimi i ligjeve nuk është në nivelin e kënaqshëm. Piratëria është forma themelore në të cilën kryhen shkeljet e të drejtave autoriale. Dukuria negative e piratërisë dhe formave tjera të shkeljes së të drejtës së autorit duhet luftuar fuqishëm jo vetëm për faktin se kërkohet në proceset integruese për Unionin Evropian, por për ndërtuar një shoqëri dhe shtet me integritet dhe me vlera.

Literatura

Albunesa, Uarda: “E drejta e autorit në legjislacionin shqiptarë dhe atë evropian – përfaqësja mes tyre”, Disertacion Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë,

¹⁶⁶ Marrëveshja e Stabilizim Asocimit BE vs Kosovë, neni 77

Aliu, Abdulla, E Drejta e Autorit, Prishtinë 2014,

Brogie, Gabriel De: Le droit d’auteur et l’internet, Rapport du groupe de travail de l’Académie des sciences morales et politiques, Paris, 2000.

Guillien, Raymond dhe Vincent, Jean: Lexique des termes juridiques, Toulouse, 2007

Kashtanjeva, Valon, “Veprat e Autorit dhe Kushtet e Mbrojtjes”, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Kosova Mbronë Autorin, Prill, 2013,

Koçi, Elina, “Pronësia Intelektuale”, Tiranë, 2006, Erik,

Organizata Botërore e Pronës Intelektuale, 2007: “Mësoni nga e kaluara, krijoni ardhmërinë artet dhe të drejtat e autorit”, përkthyer në gjuhën shqipe nga Oda Ekonomike Amerikane në Maqedoni, Ambasada e SHBA-ve në Maqedoni dhe Enti Shtetëror për të Drejta Industriale i Republikës së Maqedonisë,

Dogana e Kosovës, Doracak Për Zbatimin e Legjislacionit në Fushën e së Drejtës së Pronësisë Intelektuale

Zbatimi i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Kosova Mbron Autorin, Prill, 2013,

Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare e Artistike,

Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë : Viti II / NR. 11 / 01 Prill 2007

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 27 / 30 Nëntor 2011, Prishtinë

Ligji Nr. 04/L-065 Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave tjera të Përafërta,

Ligji për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale Ligji Nr. 03/L – 170,

Ligji për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut

Berne Convention for the Protection of Literary and Artistic Works (Paris 1971), TRIPS-(Trade Related Intellectual Property Rights) on WTO, WIPO-Performances and Phonograms Treaty (WPPT-1996) and Copyright Treaty (1996),

Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit BE vs Kosovë,

„ADRIATIC CHARTER„-THE ROLE CONTRIBUTION FOR SECURITY AND POLITICAL STABILITY IN THE WESTERNBALKAN

Qani NUHIU

University of Tetovo, Faculty of Law

e-mail: qani.nuhIU@unite.edu.mk

Abstract

The issue of security and political stability in the Western Balkan since the beginning of the political crisis and armed conflicts in the territory of the former Yugoslavia has been and remains a topic of debate and decision-making at the highest political and institutional forums of states and organizations more powerful international, but also regional ones. It has also been a permanent topic of discussion and debate in both academic and professional circles.

The purpose of this paper is to explore the role and impact of the "Adriatic Charter" as a regional political organization founded by the Western Balkan countries along with the United States of America and the contribution that this organization has given to the security and political stability of this region and the contribution that this organization has given to the security and political stability of this region.

The main issues that the study focuses on are the PURPOSE of establishing the "Adriatic Charter", the ROLE in maintaining security and political stability and the CONTRIBUTION that it has given and is giving for membership of the Western Balkan states in NATO.

Then the possible challenges that await this organization (mostly political) in the future and ultimately it's own perspective as such.

Key words: "Adriatic Charter", Western Balkan, security, political stability, membership, NATO.

Hyrje

Perspektiva dhe domosdoshmëria e antarësimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor në NATO ishin sfida me të cilat ballafaqohej Ballkani Perëndimor në ruajtjen afatgjate të paqës e sigurisë pas konflikteve të armatosura të viteve të 90-ta. Opcioni më i sigurtë për stabilitetin dhe sigurinë afatgjate ishte antarësimi i këtyre shteteve në NATO. Mirëpo vështirësi paraqisnin dy faktorë të pamohueshëm. E para ishte përgatitja e pamjaftueshme tekniko-ushtarake dhe tjetra brishtësia politike shteteve të Ballkanit Perëndimor e cila diçka të tillë e vështirësonte, kurse procesi i antarësimit ishte “në garë me kohën”¹⁶⁷. Prandaj u pa e nevojshme që të krijohet një “instrument” ose mekanizëm që do të bënte përgatitjen e shteteve të Ballkanit Perëndimor për antarësim në NATO.

QËLLIMI i këtij studimi është që të hulumtojë rolin dhe ndikimin “Kartës së Adriatikut” si organizatë politike rajonale, e themeluar nga shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe kontributin që kjo organizatë ka dhënë për sigurinë dhe stabilitetin politik të këtij rajoni.

Çështjet kryesore në të cilat fokusohet studimi në fjalë janë: çështja e sigurisë dhe stabilitetit politik në Ballkanin perëndimor, qëllimi i themelimit dhe themelimi i “Kartës së Adriatikut”, roli në ruajtjen e sigurisë dhe të stabilitetit politik, Kontributi i “Kartës së Adriatikut” për antarësimin e shteteve aëtar të saj në NATO, kontributi i “Kartës së Adriatikut” për sigurinë dhe stabilitetin politik të Ballkanit perëndimor, sfidat dhe perspektiva e “Kartës së Adriatikut”.

Si METODË E HULUMTIMIT për studimin në fjalë është përdorur METODA E ANALIZËS SË DOKUMENTEVE, literaturës dhe materialeve arkivore, që drejtpërdrejtë kanë të bëjë me “Kartën e Adriatikut” si dhe trajtimin e çështjeve të krizës së sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

1.Çështja e sigurisë dhe stabilitetit politik në Ballkanin Perëndimor

Ballkani Perëndimor gjatë gjithë historisë së tij gjithmonë ka qenë një rajon i trazuar dhe jostabil politikisht dhe i përcjellur me kriza të sigurisë e konflikte të armatosura.

Edhe në kohën më të re, pra, nga fillimi i viteve të 90-ta, gjegjësisht nga fillimi i krizës politike dhe konflikteve të armatosura në hapësirat e ish Jugosllavisë çështja e sigurisë dhe stabilitetit politik në Ballkanin Perëndimor në mënyrë permanente ka qenë dhe akoma është temë e debatit dhe preokupimit e vendimmarrjes në forumet më të larta politike e institucionale të shteteve dhe organizatave më të fuqishme ndërkombëtare, por edhe atyre rajonale. Por gjithashtu, kjo problematikë politike dhe sigurisë, gjithashtu ka qenë temë e përhershme e shqyrtimit shkencor e politik edhe në qarqet akademike e profesionale në trajtimin profesional e shkencor.

Në praktikën e veprimit politike dhe të garantimit të sigurisë në mes shteteve dhe të sigurisë ndërkombëtare “Shtetet punojnë së bashku, duke ndjekur rregulla që ata i përpunojnë vetë, për të drejtuar ndërveprimet e tyre. Shtetet i respektojnë domosdoshmërisht këto rregulla. Me kalimin e kohës, këto rregulla më të qëndrueshme dhe rreth tyre ngrihen institucione”.¹⁶⁸ Pastaj shtetet janë më të lira dhe më komod në veprimin dhe bashkëpunimin e tyre në korniza të po atyre rregullave që vetë paraprakisht i kanë caktuar. “Ata veprojnë në këtë mënyrë për shkak të interesit të vet; duke

¹⁶⁷ Shkaku i rritja së ndikimit rus në Ballkan.

¹⁶⁸ Joshua S.Goldstein “MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE”, Shtëpia Botuese DITURIA, 2003, Tiranë, fq. 281;

rregulluar veprimet e tyre ndërkombëtare nëpërmjet institucioneve e rregullave e duke shmangur në këtë mënyrë përfundimet e kushtueshme, të shoqëruara me prishjen e bashkëpunimit, mund të arrihen përfitime të mëdha ”.¹⁶⁹

Prandaj duke u ndjekur këtë logjikë dhe mënyrë të veprimit në marrëdhëniet ndërkombëtare, nga tri shtete të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Maqedonia dhe Kroacia) në partneritet me SHBA-të, u konkludua se është e nevojshme që të themelohet Asociacioni rajonal politik i shteteve i quajtur “Karta e Adriatikut” (A3), me synimin kryesor të antarësimit të tyre në **NATO (North Atlantic Treaty Organization)**. Sepse siguria dhe stabiliteti politik i shteteve të Ballkanit Perëndimor në mënyrë më efikase mund të ruhet dhe të garantohet me më tepër sukses vetëm me antarësim në Aleancën Veriatlantike (NATO).

2. Themelimi i “Kartës së Adriatikut” dhe synimi kryesor i saj

Për këtë qëllim u shfrytëzua përvoja paraprake e tre shteteve balltike (**Estonia, Lituania dhe Letonia**), grupi i shteteve i njohur si “**Grupi i Vilnosit**”, të cilat në vitin 1998, poashtu nën sponzorimin e SHBA-së e kishin filluar bashkëpunimin rajonal, me qëllim të shkëmbimit të përvojave në mes tyre t’i shpejtojnë reformat në lëminë e mbrojtjes, ta përmirësojnë stabilitetin në rajon dhe si qëllim final kishin t’a shpejtojnë hyrjen në **NATO**.

Në këtë aspekt edhe “Vendet e të ashtuquajturit Ballkani Perëndimor: Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, si vende anëtare të partneritetit për paqe (PfP) dhe të Këshillit Euroatlantik të Partneritetit (EAPC), pas Samitit të Pragës të vitit 2002, vendosën të ndiqnin të njëjtën rrugë që ndoqën në mënyrë të suksesshme vendet Baltike”¹⁷⁰ të lartpërmendura.

Edhe “Karta e Adriatikut, një iniciativë në frymën e Kartës SHBA-Baltike 1998, u propozua bashkërisht nga Presidentët e Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë tek Presidenti Bush në Samitin e NATO-s në Pragë në nëntor 2002. Presidenti Bush e mirëpriti iniciativën e Adriatikut si një kontribut të fortë ndaj vizionit të tij për një Europë të tërë, të lirë dhe në paqe. Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia së bashku e hartuan Kartën. Sekretari i Shtetit Colin Powell do të nënshkruajë Kartën së bashku me kolegët e tij, ministrat e jashtëm Meta, Mitreva dhe Picula, në Tiranë, Shqipëri, 2 maj 2003”.¹⁷¹

Emri zyrtar i të cilës është “**Karta e partneritetit ndërmjet Maqedonisë, Shqipërisë, Kroacisë dhe SHBA-së**”.¹⁷²

Me rastin e themelimit të “Kartës së Adriatikut” nga u lëshua Fletë Informacioni nga Zyra e Zëdhënësit të Departamentit të Shtetit në Washington DC, më datë 2 maj 2003.¹⁷³

¹⁶⁹ Po aty;

¹⁷⁰ Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë; Për më tepër shih në:

<http://www.mod.gov.al/index.php/politikat-e-sigurise/organizmat-nderkombetare-dhe-rajonale/39-karta-e-adriatikut-a-5>

¹⁷¹ U.S. DEPARTMENT OF STATE, ARCHIVE; Për më tepër shih në:

<https://2001-2009.state.gov/r/pa/prs/ps/2003/20153.htm>

¹⁷² Ministria e mbrojtjes e Republikës së Kroacisë; Për më tepër shih në:

<https://www.morh.hr/en/agendacrm/a5/240-crm2015/agenda/12143-crm-2015-za-web-hrvatski.html>

¹⁷³ U.S. DEPARTMENT OF STATE, ARCHIVE; Shih në:

<https://20012009.state.gov/r/pa/prs/ps/2003/20153.htm>

“Karta e Adriatikut”:

-Ndërton mbi arritjet e Samitit të Pragës të NATO-s duke përforcuar mbështetjen e vazhdueshme të SHBA për "Dyer të Hapura" të Aleancës, duke nënvizuar synimin e integritetit të plotë përfundimtar të Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë në NATO dhe në institucionet e tjera euroatlantike.

-Thekson përkushtimin e Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë për të forcuar përpjekjet e tyre individuale dhe bashkëpunuese për të intensifikuar dhe nxitur reformat e brendshme që rrisin sigurinë, prosperitetin dhe stabilitetin e rajonit.

-Evidenton arritjet e jashtëzakonshme të arritura tashmë nga Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia në rrugën e integritetit euroatlantik, përcakton fushat e fokusit të vazhdueshëm dhe përsërit qëllimin e Shteteve të Bashkuara për të vazhduar me ndihmën e vendeve në zbatimin e reformave të nevojshme. Gjithashtu vë në dukje se çdo vend aspirant do të vlerësohet individualisht për progresin e tij drejt përmbushjes së standardeve për anëtarësim në organet euroatlantike.

-Riafirmon angazhimin e përbashkët politik të partive për të forcuar institucionet demokratike, shoqërinë civile, sundimin e ligjit, ekonominë e tregut dhe ushtritë e pajtueshme me NATO; për të luftuar korrupsionin dhe krimin; dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë qytetare për të gjithë individët në Shqipëri, Kroaci, Maqedoni dhe vendet e tjera të Evropës Juglindore.

-Thekson bashkëpunimin e ngushtë dypalësh, rajonal dhe multilateral, të mbrojtjes dhe të bashkëpunimit ekonomik midis partnerëve dhe fqinjëve të tyre, duke përfituar nga të gjitha vendet e Evropës Juglindore duke rritur stabilitetin dhe përsheptuar integritetin e rajonit në institucionet evropiane dhe transatlantike.

-Parasheh krijimin e Komisionit të Partneritetit, në një nivel të lartë të përfaqësimit, që do të mbledhë dy herë në vit ose më shpesh, sipas nevojës, për të shqyrtuar progresin e arritur drejt përmbushjes së objektivave të Kartës. (Mbledhja e parë e Komisionit të Partneritetit nuk është caktuar.)¹⁷⁴

Qëllimi strategjik “Bashkëpunimi ndërmjet tre vendeve aspirantë për t’u anëtarësuar në NATO, së bashku me SHBA si pjesë e Kartës së A-3, kishte një synim të vetëm: futjen e vendeve aspirantë në NATO”.¹⁷⁵

Nuk ka dilemë se Krijimi i grupit të A-3, është pjesë e vizionit për të integruar tërë rajonin në Aleancën e NATO, kuptohet pasi të ishin plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e kërkuara nga vetë Aleanca Veriatlantike. Në procesin e pranimit të vendeve të A-3 në Aleancë, SHBA si një partner strategjik dhe vende të tjera anëtare të NATO si këshillues specialë, realizuan një mbështetje të

¹⁷⁴U.S.DEPARTMENT OF STATE,ARCHIVE; Për më tepër shih në: <https://2001-2009.state.gov/r/pa/prs/ps/2003/20153.htm>

¹⁷⁵Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë; Për më tepër shih në: <http://www.mod.gov.al/index.php/politikat-e-sigurise/organizmat-nderkombetare-dhe-rajonale/39-karta-e-adriatikut-a-5>

rëndësishme për të promovuar këtë formë të re efektive të bashkëpunimit midis vendeve anëtare të “Kartës së Adriatikut”.

2.1. Anëtarët themelues dhe zgjerimi i “Kartës së Adriatikut” me antëtarë tjerë aktual

Në kuadër të “Kartës së Adriatikut” ka dy lloje anëtarësh: **shtetet themeluese- anëtare** (Shqipëria, Maqedonia dhe Krocia) dhe shtetet e pranuar më vonë (Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi).

-Anëtarët aktual janë: Anëtare aktuale janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kroacia, Maqedonia, përderisa Kosova, Serbia dhe Slovenia kanë status të vëzhguesit.¹⁷⁶

Pranimi i shteteve të reja u bë gjatë takimit të ministrave të Jashtëm të OSBE-së zhvilluar në Helsinki (Finlandë), në datë 4 dhjetor 2008, ku Mali i Zi dhe Bosnje-Hercegovina (BiH) iu bashkuan zyrtarisht “Kartës së Adriatikut”, duke shndërruar nga “A-3” në iniciativën “A-5”.

Pra, në 2008 edhe Bosnja e Hercegovina, zyrtarisht u bashkua me “Kartën e Adriatikut”, ndërkajq Serbia pranoi statusin e vëzhguesit. Gjithashtu që nga viti 2008, emri jozyrtar i Kartës është ndryshuar nga A-3 në A-5, duke simbolizuar numrin e vendeve anëtare.

3. Roli dhe kontributi i “Kartës së Adriatikut” në ruajtjen e sigurisë dhe të stabilitetit politik të Ballkanit Perëndimor

“Karta e Adriatikut” dhe anëtarësimi në NATO, pra, përveç që kërkonte stimulimin dhe përshejtimin e reformave të filluara në ushtritë e tre shteteve anëtare, kërkonte edhe reforma demokratike, liri politike, respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave të minoriteteve, angazhimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut ndërkufitar, armëve të shkatërrimit në masë, etj.

Duhet theksuar se “Karta e Adriatikut” nuk vendosi detyrime të veçanta për të tri vendet anëtare, por vetëm kushte të përgjithshme, të cilat ishin standarde të zakonshme vlefshme për të gjitha vendet anëtare të NATO-s.

Lidhur me vlerësimin për progresin, edhe në përmbledhjen hyrëse të “Kartës së Adriatikut”, është theksuar se progresi i të tre vendeve anëtare do të vlerësohej bazuar në arritjet e tyre individuale.

Në mënyrë që të forcohej dhe dinamizohej bashkëpunimi ndërmjet vendeve të “Kartës së Adriatiku” dhe SHBA, nën drejtimin e niveleve të larta adekuate shtetërore (ministër, zëvendësministër i Punëve të Jashtme), u formua një komision partneriteti. Ky Komisioni kishte për detyrë të mblidhej dy herë në vit, por sipas nevojave edhe më shpesh, në një nga qytetet e vendeve nënshkruese të Kartës A3. Ndërsa synimi kryesor ishte marrja në konsideratë e realizimit të aktiviteteve dhe planifikimi i obligimeve dhe aktiviteteve të ardhshme.

“Duke synuar implementimin cilësor të detyrimeve që rridhnin nga ‘Karta e Adriatikut’, u vendos që drejtimi i iniciativës së përbashkët të realizohej nëpërmjet një **sistem rotacioni gjashtë mujor**. Bashkëpunimi ndërmjet vendeve aspirante u zhvillua në nivele dhe fusha të ndryshme brenda A-3. Ishin të shumta institucionet që u përfshinë në këtë proces, ku mund të përmendim: Presidentët e

¹⁷⁶ N1 Regionalna Televizija; Për më tepër shih në: <http://rs.n1info.com/a288092/Svet/Region/Samit-Americko-jadranske-povelje.html>

Shteteve, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shefat e Shtabeve, Komanda, Drejtori, etj”.¹⁷⁷

Krahas institucioneve shtetërore, edhe shumë organizata joqeveritare u angazhuan dhe u përfshinë në këtë proces, me qëllim të sigurimit e mbështetjes së opinionit publik për antarësimin fillimisht të tre shteteve anëtarë të “Kartës së Adriatikut”, por edhe integrimin e tërë rajonit në NATO.

“Karta përfaqëson një partneritet strategjik midis vendeve anëtare që pranojnë interesa të përbashkëta, të tilla si forcimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërmjet shteteve anëtare dhe vendeve të tjera në rajon, me qëllim sigurimin e sigurisë dhe integritetit të plotë në politikën evropiane dhe transatlantike, ekonomike, të sigurisë dhe të mbrojtjes”.¹⁷⁸

“Karta e Adriatikut” si një iniciativë gjithëpërfshirëse e karakterit rajonale që është, afirmon angazhimin e shteteve anëtare për forcimin e përpjekjeve të tyre individuale dhe kolektive për nxitjen e bashkëpunimit me qëllim për të intensifikuar reformat e brendshme që rrisin sigurinë, prosperitetin, stabilitetin dhe mirëqenjen e rajonit.

4. Kontributi i “Kartës së Adriatikut” për antarësimin e shteteve anëtare të saj në NATO

Duhet potencuar kontributin në të kaluarën dhe që akoma është duke dhënë për përparësitë e gjithmbarëshme për antarësimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor në NATO.

Fillimisht bashkëpunimi në kuader të “Kartës së Adriatikut” (e njohur edhe si “A-3”) kishte për qëllim të promovonte dhe fuqizonte në radhë të parë bashkëpunimin rajonal dhe sigurinë, por edhe të shtonte ndërveprimin dhe adoptimin e standardeve, nëpërmjet stërvitjeve të përbashkëta dhe aktiviteteve të bashkëpunimit të njësive respektive.

5. Aktivitetet dhe rezultatet e deritanishme të “Kartës së Adriatikut”

Shtetët anëtarë kanë bashkëpunuar intensivisht në mes tyre dhe si rezultat i këtij bashkëpunimi janë realizuar një numër i madh aktivitetesh, takimesh, stërvitjesh apo ngritje ekipesh të përbashkëta, të cilat synojnë ngritjen e kapaciteteve ushtarake të vendeve pjesëmarrëse, me qëllim arritjen e standardeve të cilat bëjnë të mundur jo vetëm antarësimin në NATO, por edhe dhënien e kontributeve të përbashkëta në misionet ndërkombëtare ushtarake apo civile. Disa prej projekteve më domethënëse të kësaj iniciative janë:

-Ekipi i përbashkët mjekësor

Projekti më domethënës brenda kornizës së ‘Kartës së Adriatikut’ është formimi i një ekipi të përbashkët mjekësor të vendeve të A-3, për t’u përfshirë në misionin ISAF në Afganistan, në Aeroportin Ndërkombëtar të Kabulit, por edhe në të gjithë zonën e operacioneve të ISAF.

-Stërvitje të përbashkëta

“ADRIATIC PHIBLEX 04 – ENGEENEREX”, në Kroaci dhe “EAGLE SAR 04”, në Shqipëri. “ADRIATIC EAGLE 06”, “EAGLE SAR 06”, “ADRIATIC EAGLE 07”, “LOGEX-07”, “MACEDONIAN FLASH-2” dhe “BOVILLA 07”.

¹⁷⁷ Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë; Për më tepër shih në:

<http://www.mod.gov.al/index.php/politikat-e-sigurise/organizmat-nderkombetare-dhe-rajonale/39-karta-e-adriatikut-a-5>

¹⁷⁸ Ministarstvo odbrane Republike Hrvatske; <https://www.morh.hr/en/agendacrm/a5/240-crm2015/agenda/12143-crm-2015-za-web-hrvatski.html>

-Qendra rajonale për Marrëdhëniet Publike dhe Trajnimin në Maqedoni
Kjo qendër u hap në 15 nëntor të vitit 2005 në Maqedoni si rezultat i një bashkëpunimi të jashtëzakonshëm ndërmjet MM të Maqedonisë dhe Konfederatës Zvicerane. Qëllimi bazë i krijimit të kësaj qendre ishte trajnimi në mënyrë intensive dhe edukimi i personelit të MM dhe FA përkatëse të Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë në fushën e marrëdhënieve publike, duke synuar: ruajtjen e paqes nëpërmjet bashkëpunimit rajonal, familjarizimi me standardet e PfP, shkëmbimi dhe ndarja e eksperiencave pozitive me instruktorët zviceranë.

-Kolegji Rajonal i Mbrojtjes: Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes në Tiranë
Iniciativa në fjalë në fushën edukative synon të rrisë dhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit, nëpërmjet çështjeve të sigurisë dhe politikave të mbrojtjes. Kursi u siguron pjesëmarrësve mundësinë e promovimit në vendet e tyre të punës. Si kurrikula referuese në këtë kurs, shërbejnë materiale të Qendrës Europiane të studimeve të Sigurisë ‘George C. Marshall’, Kolegjit të NATO në Romë, Kolegjit Baltik të Mbrojtjes, Kolegjit të Luftës së SHBA, etj.

• Integrimi në strukturat Euroatlantike

Rezultati më domethënës i kësaj iniciative, që prej krijimit të saj, ka qenë padyshim anëtarësimi i Kroacisë dhe Shqipërisë në NATO, në prill të 2009, pas ftesës së marrë në Samitin e Bukureshtit në vitin 2008.

Angazhimi aktual

Gjatë këtyre viteve të ekzistencës së A-5 dinamika e aktiviteteve ka qenë e lartë. Përveç angazhimeve të mëparshme, që kanë rrjedhur nga formati A-3, vendet anëtare të A-5 janë përpjekur të mbajnë në nivele të larta bashkëpunimin. Kështu, me propozim të palës kroate, është në proces angazhimi i vendeve të ‘Kartës së Adriatikut’ (A-5) me ekipe trajnuese dhe monitoruese në Afganistan. (NTM, OMLT, POMLT).¹⁷⁹

Më 1 prill 2009 në anëtarësi të NATO-s u pranuan Shqipëria dhe Kroacia. Që ishte edhe zgjerimi i parafundit.

Në fund duhet theksuar edhe pranimin e **Malit të Zi në NATO në datë 5 qershor 2017**, që paraqet edhe zgjerimin më të ri të Aleancës Veriatlantike.

Që të tri zgjerimet e fundit të NATO-s, pra, pranimi i Shqipërisë, Kroacisë dhe Malit të Zi paraqesin kontribut të drejtpërdrejtë të “Kartës së Adriatikut” (Të gjitha këto shtete anëtare të “Kartës së Adriatikut”). Maqedonia priet që të jetë anëtarja e ardhëshme e NATO-s.¹⁸⁰

6.Sfidat dhe perspektiva e “Kartës së Adriatikut”

“Karta e Adriatikut” pa asnjë dyshim se ka dhënë kontribut të madh e të pazëvendësueshëm për antarësimin e Shqipërisë, Kroacisë, si dhe përgatitjen e Maqedonisë për antarësim, e më pastaj edhe për antarësimin e Malit të Zi në NATO. Gjithashtu është duke kontribuar edhe në përgatitjen e

¹⁷⁹Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë; Për më tepër shih në:

<http://www.mod.gov.al/index.php/politikat-e-sigurise/organizmat-nderkombetare-dhe-rajonale/39-karta-e-adriatikut-a-5>

¹⁸⁰Republika e Maqedonisë pritet të antarësohet në NATO pasi zgjidhjes së kontestit për emrin me Republikë e Greqisë.

Bosnjë e Hercegovinës¹⁸¹. Mirëpo duhet cekur edhe sfidat dhe dilemat e mundëshme që e presin këtë organizatë (kryesisht të karakterit politik) në të ardhmen, e në fund edhe vetë perspektiva e saj si e tillë.

“Karta e Adriatikut” (që fillimisht ishte “A3”), më pastaj me antarësimin e Malit të Zi dhe Bosnjë e Hercegovinës u shëndërrua në “A5”.

Parashtrohet pyteja, në momentin kur do ta kryejë misionin e vet themelor që tani ia ka caktuar vetëvetes, e që është antarësimi i plotë në NATO i vetë shteteve anëtare të Kartës së Adriatikut, a do transformohet në ndonjë organizatë tjetër dhe me mision tjetër conform me kërkesat e sfidat e kohës dhe si e tillë do të vazhdojë ta jep kontributin e vet apo do do pushojë së egzistuari si e tillë (si organizatë politike rajonale). Kjo gjithsesi paraqet një nga sfidat për të cilën “Karta e Adriatikut” duhet të jepë përgjigje në të ardhmen.

Përfundimi

Nga e gjithë kjo që është theksuar më lartë arrijmë në përfundim se “Karta e Adriatikut”:

a) Në të kaluarën ka pasur, e do të ketë edhe në të ardhmen rol shumë të rëndësishëm për antarësim në NATO të të gjitha shteteve pretendente (kandidate) të Ballkanit Perëndimor si dhe përfundimin me sukses të procesit të antarësimit të këtyre vendeve;

b) Do të shërbejë si model me përvojë mjaft pozitive për përgatitjen e rajoneve tjera për integritet dhe antarësime në organizata ndërkombëtare;

c) Inkurajon integritet e bashkëpunime të llojeve të ndryshme regjionale;

d) Nxiti dhe ndihmon në avancimin e proceseve demokratike në përgjithësi, pasi vetë shtetet anëtare bashkëpunojnë shkëlqyeshëm në mes veti (në Kuadër të Kartës së Atlantikut-A5) për reforma të përgjithshme demokratike, të drejtat e njeriut, reforma ekonomike, kriminaliteti dhe korrupsioni, siguria regjionale dhe shumë çështje tjera;

e) Në të ardhmen patjetër duhet zgjidhur sfida e llojit egzistencial e vetë “Kartës së Adriatikut”, nëse do të pushojë së egzistuari, si diçka e cila e ka përmbushur me sukses të plotë misionin dhe qëllimin e saj apo do të evoluojë dhe reformohet në koncept e në veprime duke u përshatur me sfidat dhe nevojat e kohës lidhur me ardhmërinë e Ballkanit Perëndimor.

f) Nevoja e egzistimit mund të mbështetet në ballafaqimin me: sfidat e mundëshme të ardhëshme, bashkëpunimi më i ngushtë sipas nevojave e vështirësive bazuar në interesat e përbashkëta të shteteve anëtare;

g) Mbrojta e mundëshme nga rreziqe të mundëshme të karakterit të sigurisë rajonale e më gjërë; dhe

¹⁸¹Bosnja e Hercegovina ka mospajtim të brendshëm politik të karakterit ndëretnik lidhur me përshpejtimin e antarësimit në NATO.

h) Si mekanizëm politik rajonal me përvojën tashmë të fituar e mjaft pozitive, do të mund të ishte mjaft i dobishëm e i nevojshëm edhe pas përfundimit të anatarësimit të të gjitha shteteve pretendente në NATO.

Referencat:

-Joshua S.Goldstein “MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE”, Shtëpia Botuese DITURIA, 2003, Tiranë.

-JOSEPH ROTHSCHILD “Europa Lindore Qendrore midis dy luftërave botërore”, Shtëpia Botuese DITURIA, 2004, Tiranë.

-Henry Kissinger “DIPLOMACIA”, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1999, Tiranë.

-“NATO’s relations with the European Union”, Topics:North Atlantic Treaty Organization (dt. 09-Apr-2009). Mund të gjendet në web lokacionin:https://www.nato.int/summit2009/topics_en/21-nato-eu_strategic_partnership.html

-U.S.DEPARTMENT OF STATE,ARCHIVE; Për më tepër shih në:<https://2001-2009.state.gov/r/pa/prs/ps/2003/20153.htm>

-Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë; Për më tepër shih në:
<http://www.mod.gov.al/index.php/politikat-e-sigurise/organizmat-nderkombetare-dhe-rajonale/39-karta-e-adriatikut-a-5>

- Ministry of Defense, Republic of Macedonia: “ OUR WAY TO NATO ”, pages 38-39; Për më tepër shih në: http://morm.gov.mk/wp-content/uploads/our_way_to_NATO.pdf

-Ministria e mbrojtjes e Republikës së Kroacisë; Për më tepër shih në:
<https://www.morh.hr/en/agendacrm/a5/240-crm2015/agenda/12143-crm-2015-za-ëeb-hrvatski.html>

-Ministria e mbrojtjes e Republikës së Malit të Zi; Për më tepër shih në:
http://www.mod.gov.me/rubrike/Reginalne_inicijative/134976/Americko-jadranska-povelja-A5.html

COPENHAGEN CRITERIA AS CONDITIONS FOR MEMBERSHIP IN THE EUROPEAN UNION (EU)

Qani NUHIU

University of Tetova, Faculty of Law

e-mail: qani.nuhIU@unite.edu.mk

Abstract

In this text will be analyzed based criteria and conditions for membership in the European Union. After the fall of dictatorships and establishing postulates for building of democracy in many countries of Central, Eastern and Southeastern Europe, in the early nineties of the last century, membership in the European Union for these countries emerged from one-party dictatorships, remained only alternative for the development and progres. Thats why EU membership was the main agenda and primary task for most of these countries. But membership in the European Union require comprehensive and deep reforms in all segments of these societies, ie states. Then the leadership of the European Union saw the great interest for EU membership, and set the basic requirements to meet these countries for full membership of the European Union.

European Council in 1993 set the main criteria that present conditions (qua non condition) for membership in the European Union. These are the criteria in the field of a political, legal and economic and meant:

- **Political criteria;** stability of institutions which ensure democracy, the rule of law, respect for human rights and protection of minorities;
- **Economic criterion;** existence of market economy function, able to cope with competitive pressure and market forces within the Union.
- **Legal criteria;** the ability to take the obligations stemming from membership, including the union's commitment to the goals of political, economic and monetary union; and

Appointment of the Copenhagen Criteria has result as effective as it has served as a guideline for the reform of state policies contenders for membership. All these criteria later were part of agreements that the European Union has concluded with candidate countries for membership.

Keywords: Copenhagen Criteria, European Union, the conditions for membership, membership, reforms, democracy, the market economy.

Hyrje

Ndryshimet rrënjësore politike dhe shoqërore në rrënimin e diktaturave komuniste, të cilat deri në fillim të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, kishin sunduar në mënyrë më jodemokratike me shtetet dhe popujt e tyre, bënë që këto popuj, tashmë në kushte dhe rrethana krejtësisht të ndryshme shoqërore, politike dhe ekonomike pas rrënimit të këtyre diktaturave të hartojnë platforma dhe koncepte politike për bashkangjitje Unionit të shteteve demokratike Evropës.

Pra, pas shembjes së diktaturave dhe vëndosjes së postulateve politike kryesore për ndërtiminin e demokracisë në shumë shtete të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore dhe antarësimin në Unionin Evropian i këtyre shteteve të dalura nga diktaturat njëpartiake, mbeti e vetmja alternativë për zhvillim e progres.

Prandaj edhe antarësimi në UE u bë agjendë kryesore dhe detyrë primare për shumicën e këtyre shteteve. Mirëpo antarësimi në Unionin Evropian kërkonte reforma gjithëpërfshirëse e të thella në të gjitha segmentet e këtyre shoqërive e shteteve.

1. Idetë e para për Bashkimin Evropian

Ideja dhe aspirata për një Evropë të bashkuar është e mjaft e vjetër. Ëndërrat për Bashkimin Evropian datojnë që nga koha e **Romës Antike**, botërore dhe në fillim të Luftës së Ftohtë.

Një periudhë të gjatë kohore Ideja për Evropë të bashkuar ka qenë vetëm një ëndërr e filozofëve dhe mendimtarëve të kohës.

Viktor Hygo, në shekullin e XIX, ka paralajmëruar një bashkim paqësor të “Shteteve të Bashkuara të Evropës”.¹⁸²

Por Ajo u bë realitet vetëm pas vitit 1945, gjegjësisht pas përfundimit të Luftës së Dytë botërore dhe në fillim të Luftës së Ftohtë.

Nga tragjeditë, gërmadhat dhe shkatërrimet e Luftës së Dytë botërore u shfaq një shpresë e re, me qëllim që t’u japin fund urrejtjeve në mes të kombeve, rivaliteteve luftënxitëse dhe ndërtimin e një paqe stabile e të përhershme.

Procesi integritit evropian si dhe politikat e përbashkëta mes vendeve të Evropës perëndimore, tashmë edhe të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore deri tek koncepti, forma e organizimit institucional, udhëheqjes së politikave dhe të shtrirjes gjeografike.

Pas rënies së regjimeve komuniste, në mënyrë të përshpejtuar dhe dramatike ndryshoi gjithçka. Filluan edhe shtete që vetëm disa vite më parë i takonin Bllokut Lindor dhe Paktit të Varshavës qartë të përcaktohen për antarësim në UE (atëherë BE).

¹⁸² Paskal Fonten “Evropa në 12 leksione”; Botues Zyra botimeve të Komuniteteve Evropiane, Luksemburg, 2004, fq.1;

Antarësimi i shumë shteteve tashmë nuk ishte utopi, por perspektivë e qartë, reale dhe e realizueshme.

“Mes viteve 1945 dhe 1950, disa burrshtetas guximtarë, përfshirë këtu **Konrad Adenauer, Winston Churchill, Alcide de Gasperi dhe Robert Schuman** kishin për qëllim që t’i bindin popujt e tyre që të hyjnë në një epokë të re”.¹⁸³

Por konkretisht kryeministri britanik **Winston Churchill** ishte i pari që ofroi zgjidhje në fjalimin e tij të mbajtur më 19 shtator 1946 në Cyrih.¹⁸⁴

Pas disa viteve **Robert Schuman** (*ministër francez i punëve të jashtme*), i inspiruar nga një ide fillimisht të krijuar nga **Zhan Monnet**, më 9 maj 1950 propozoi formimin e Komunitetit Evropian për Thëngjill dhe Çelik (ECSC).

Traktati i Parisit që formoi BETHÇ (1951), e cila hyri në fuqi në vitin 1952, si projekt ndërqeveritar i themeluar nga gjashtë shtete (Gjermania Federale, Franca, Italia, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu).

Në vitin 1957 me **Traktatin e Romës**, u formuan Bashkësia Ekonomike Evropiane (EEC) dhe Bashkësia Evropiane për Energji Nukleare (EURATOM).

Lidhur me Idenë për Evropën e Bashkuar **Zhan Monnet** thotë: “Njerëzit i pranojnë ndryshimet vetëm në kohë nevojë, kurse nevojën njerëzit e vërejnë vetëm në kohë krize”.¹⁸⁵

Pastaj **Zhan Monnet** vazhdon “Kur në një sistem statistikor mbillni farën e ideve të reja, askush nuk di se ku do të ndalet ajo lëvizje”.¹⁸⁶

2. Ndryshimet historike në Evropën lindore dhe juglindore gjatë viteve të 90-ta

2.1. Shtetet ish-diktatoriale drejtë UE-së

Pas shembjes së diktaturave monopartiake në shtetet ish komuniste dhe vëndosjes së **postulateve kryesore** për ndërtimin e demokracisë në shumë shtete të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore në fillim të viteve të nëntëdhjeta (90-ta) të shekullit të kaluar, antarësimi në Unionin Evropian (UE) për këto shtete të dalura nga diktaturat e egra njëpartiake, mbeti e vetmja alternativë për ardhmëri, zhvillim e progress të mirëfilltë.

Prandaj edhe antarësimi në UE u shëndërrua në **agjendë kryesore dhe detyrë primare** e orientim strategjik për shumicën e këtyre shteteve.

Mirëpo antarësimi në Unionin Evropian (UE) kërkonte reforma gjithpërfshirëse e të thella në të gjitha segmente e këtyre shoqërive, gjegjësisht shteteve, ngase është shumë e qartë se sistemet nga të cilat kishin dalë të shkatërruara tërësisht nuk kishin pothuajse asgjë të përbashkët me sistemin dhe principet demokratike të shteteve evropiane.

¹⁸³ Paskal Fonten “Evropa në 12 leksione”; Botues Zyra botimeve të Komuniteteve Evropiane, Luksemburg, 2004, fq.1;

¹⁸⁴ Blerim Reka, Ylber Sela “Hyrje në Unionin Evropian”, fq.12; Tetovë, 2011;

¹⁸⁵ Zhan MONNET “Evropa, shtëpia jonë e përbashkët”, Shkup, maj 2007, fq.11;

¹⁸⁶ Po aty, fq.12;

3.Kushtet dhe kriteret për antarësim të shteteve në Unionin Evropian (UE)

Pas shembjes së diktaturave komuniste dhe vëndosjes së postulateve kryesore për ndërtiminin e demokracisë në shumë shtete të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, në fillim të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, antarësimin në Unionin Evropian për këto shtete të dalura nga diktaturat njëpartiake, mbeti e vetmja alternativë për zhvillim e progres. Prandaj edhe antarësimi në UE u bë agjendë kryesore dhe detyrë primare për shumicën e këtyre shteteve. Mirëpo antarësimi në Unionin Evropian kërkonte reforma gjithpërfshirëse e të thella në të gjitha segmentet e këtyre shoqërive gjegjësisht shteteve.

Udhëheqësia a atëherëshme e Unionit Evropian duke e parë interesimin dhe vullnetin e madh politik për vëndosjen e rendit demokratik dhe antarësim në UE, si dhe dëshirën për t'u ofruar pespektivë më të mirë këyre shteteve vendosi dërsa nga ana tjetër ishin sisteme që kishin një realitet kresjstësht tjetër nga ai që tashmë me shumë sukses funksiononte në shtetet e Unionit Evropian (atëherë Bashkësia Evropiane-BE), i vendosi kriteret bazë të domosdoshme që duhej t'i plotësonin këto shtete për antarësim të plotë të Unionin Evropian.

4.Kriteret e Kopenhagës

Kriteret e Hagës paraqisnin platformë për reformin të tërësishëm dhe rrënjësor të shteteve të ish bllokut komunist dhe ato u caktuan qartë, pasi ishte e nevojshme që këto shtete (*ish diktatura*) të mund të formulonin politikat e tyre proevropiane dhe demokratike dhe njëkohësisht t'i zbatonin ato dhe në këtë aspekt nuk kishte më dilema se çka duhej bërë që të antarësoheshin në UE.

Pra, u pa qartë së Bashkësinë Evropiane e priste një punë kolosale historike për ngërthimin e këtyre shteteve ish-komuniste nën ombrellën e saj.

Dhe “Rruga drejt këtij zgjërimit të veçantë fillon në vitin 1989, me rënien e Murit të Berlinit dhe të shtuquaturës **perde të hekurt**. UE reagoi shpejt dhe formoi programin për asistencë financiare “PHARE”, të disajnuar për t'i ndërtuar demokracitë e reja të rindërtojnë ekonomitë e tyre dhe për të inkurajuar reforma politike.

Në Kopenhagë, më 22 qershor të vitit 1993, Këshilli Evropian për herë të parë deklaroi se **“shtetet kandidate në Evropën Qendrore dhe Lindore që shfaqin dëshirë për antarësi, do të pranohen në Unionin Evropian”**¹⁸⁷

Njëkohësisht, Këshilli Evropian përcaktoi **tre kriteriume kryesore** që duhet t'i plotësojnë shtetet kandidate para se ata të mundën t'i bashkangjiten UE ¹⁸⁸.

Momenti historik i vetë caktimit të Kriereve të Kopenhagës flet se ata (kriteret) u caktuan pas rrënies së diktaturave komuniste.

Këshilli Evropian në vitin 1993 i caktoi kriteret kryesore, që njëherit paraqisnin edhe kushte të domosdoshme (**condition qua non**) për antarësim në Unionin Evropian.

¹⁸⁷ Paskal Fonten “Evropa në 12 leksione Zyra e botimeve pubike të Komuniteteve Evropiane, 2004, fq.12;

¹⁸⁸ Po aty;

Në momentin kur u caktuan kriteret e Kopenhagës BE kishte **dymbëdhjetë anëtarë** (Antarësimet e fundit ishin bërë më 1 janar 1986, ku ishin antarësuar Spanja dhe Portugalia).¹⁸⁹

4.1. Çka nënkuptonin dhe cilët janë kriteret e Kopenhagës?

Këshilli evropian në vitin 1993 i caktoi kriteret kryesore, që njëherit paraqisnin edhe kushte (*condition qua non*) për antarësim në Unionin Evropian. Këto janë kritere të natyrës politike, ligjore e ekonomike dhe nënkuptonin:

- kriteret **politike**-stabilitet të institucioneve të cilat e sigurojnë demokracinë, sundimin e së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e pakicave;

- kriteret **ligjore**-aftësinë për të marrë obligimet që burojnë nga antarësimi, duke e përfshirë edhe përkushtimin për qëllimet e unionit politik, ekonomik dhe monetar; dhe
-kriteri **ekonomik**-egzistimi i ekonomisë funksionale të tregut, të aftë që të ballafaqohet me presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut përbrenda Unionit.

Përveç kriterëve të Kopenhagës që tashmë paraqisnin bazamentin e platformave politike për reformimin e shteteve dhe institucioneve të tyre, në vitin 1995 këtyre kriterëve iu bashkangjiti edhe kriteri i katërt, i ashtuquajtur **Kriteri i Madridit**, e ai është **kriteri administrativ**. i cili nënkupton dhe përfshin **KAPACITETIN ADMINISTRATIV** të një shteti për të implementuar të Drejtën dhe politikat e Unionit Evropian¹⁹⁰..

“Kjo do të thotë së shtetet kandidatë duhet të miratojnë një korpus të gjërë të ligjeve të UE, të njohura me termin *acquis communautaire*.¹⁹¹

Arsyeja pse ishin të nevojshme të caktohen kriteret për antarësim të shteteve në UE, të njohura si Kriteret e Kopenhagës dhe pse u caktuan ishte politike, pasi nevojitej që këto shtete pasi dilnin nga diktaturat nevojiteshin reforma gjithëpërfshirëse dhe të thella.

Këto kritere shërbenin si **standard** dhe **orientues** se nga duhej të lëviznin politikat publike evropiane të këtyre shteteve, prandaj edhe u caktuan.

4.2. Roli, ndikimi dhe efektet e Kriterëve të Kopenhagës për antarësimin e shteteve në Unionin Evropian (UE)

4.2.1. Roli i Kriterëve të Kopenhagës

Roli dhe potenciali i Kriterëve të Kopenhagës për reformimin, progresin dhe antarësimin e shteteve në fazat e ardhëshme në UE.

Caktimi i kriterëve të Kopenhagës dhe vetë kriteret kanë rezultuar mjaft efektiv dhe të suksesshëm, pasi ka shërbyer si udhërrëfyes për politikat reformatore të shteteve pretendente për antarësim.

¹⁸⁹ Po aty, fq.59;

¹⁹⁰ Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela “INSTITUCIONET DHE POLITIKAT E UNIONIT EVROPIAN”, Tetovë, 2010; fq.170;

¹⁹¹ Paskal Fonten “Evropa në 12 leksione”, Zyra e botimeve publike të Komuniteteve Evropiane, Luksembur, 2004, fq. 12;

Duhet në veçanti potencuar se të gjitha këto kritere kanë qenë **pjesë e standardeve të marrëveshjeve** për asocim që Unioni Evropian i ka lidhur me shtetet kandidatë për antarësim.

4.2.2.Efektet e miratimit dhe të zbatimit të Kritereve të Kopenhagës

Caktimi i Kritereve të Kopenhagës ka rezultuar si mjaft efektiv, pasi ka shërbyer si udhërrëfyes për politikat reformatore të shteteve pretendente për antarësim. Te gjitha keto kritere me vone kane qenë pjese e marreveshjeve që Unioni Evropian ka lidhur me shtetet kandidate per antaresim.

Efektet e miratimit dhe të zbatimit të Kritereve të Kopenhagës nga ana e Unionit Evropian dhe shteteve pretendente-kandidate gjatë rrugëtimit të tyre për antarësim kanë qenë të shumëfishta, si në aspektin **politik e normativ** ashtu edhe në atë **praktik**. Këto mund të numërohen si efekte më të mëdha:

-e para: Këto kritere ishin bazë për formulimin (ndërtimin) e politikave publike të Unionit Evropian;

-e dyta: Kanë qenë dhe janë bazë për ndërtimin e Sistemit qeverisës të Unionit Evropian, gjegjësisht bazë për ndërtimin e Sistemit politik të UE-së (Të traktateve të UE-së), ose kushtimisht thënë të Kushtetutës së UE-së dhe për ngritjen e të gjithë infrastrukturës normative të UE-së;

-e treta: Gjithashtu edhe bazë për ndërtimin e marrëdhënieve në mes të shteteve anëtare të UE-së, por edhe në mes të UE-së me shtetet tjera jashta UE-së,*p.sh.* për lidhjen e të gjitha marrëveshjeve në mes të UE-së dhe shteteve kandidate për Asocim e më vonë edhe për Stabilizim-Asocim ose në ndërtimin e marrëdhënieve të Partneritetit; *dhe*

-e katërta: Këto kritere janë marrë si inspirim, frymëzim dhe standard për integrimet tjera rajonale që janë duke nodhur nëpër botë. Si *p.sh.* Unioni Euro-Azi, Unionin Afrikan, qe sipas parashikimeve është projektuar të rumbullaksohet në vitin 2068.

-e pesta: Këto kritere ishin kushtet e domosdoshme dhe pjesë e domosdoshme e të gjitha marrëveshjeve asociuese të UE-së me shtetet pretendente-kandidate e më vonë edhe anëtare;

-e gjashta: Kanë qenë shtyje e madhe dhe **nxitës kryesor i reformave të shteteve** kandidate, anëtare potenciale dhe të anëtareve të reja.

5. Politikat e antarësimit në UE

Antarësimi i ndonjë shteti asnjëherë nuk ka qenë ndonjë vendim thjesht teknik, por edhe politik, i bazuar në dy parametra kyç:

1.Prioritetet gjeopolitike të UE-së; dhe

2.Interesat e shteteve anëtare të UE-së.¹⁹²

-UE-ja me disa vende zhvillonte marrëdhëniet e **partneriteteve strategjike (SP)**;

¹⁹² -Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela "INSTITUCIONET DHE POLITIKAT E UNIONIT EVROPIAN" Tetovë, 2010; fq.139;

-UE-ja me disa vende zhvillonte marrëdhëniet e *fqinjësisë evropiane (ENP)*; dhe

-UE-ja me disa vende zhvillonte politikën e zgjerimit të UE-së (*EU enlargement*);

1.Unioni për Mesdheun;

2.Unioni për Detin e Zi;

3.Partneriteti me Lindjen.

5.1.Fazat e antarësimit në UE sipas Kritereve të Kopenhagës

Anëtarësimi në UE ndahet disa faza dhe dallojmë këto ndarje:

-E para: Sipas kritereve që duhej t'i plotësonin ndahet në:

-Faza e parë: Deri në përcaktimin e Kritereve të Kopenhagës Unioni Evropian ka pasur 12 anëtarë (antarësimet e fundit janë më 1 janar 1986); dhe

Faza e dytë: Pas përcaktimit të kritereve të Kopenhagës (më 1993, antarësimet e para u bënë më 1 janar 1995; Austria, Finlanda dhe Suedia i Bashkohen UE, që tashmë kishte 15 anëtarë).

5.2.Ballkani Perëndimor-Procesi Stabilizim-Asocimit

Kriteret e Kopenhagës kanë shërbyer edhe për përgatitjen e shteteve të Ballkanit Perëndimor për përgatitjen në antarësimin e tyre në UE. Duke u bazuar pikërisht në:

1.kriterin politik;

2.kriterin ekonomik;

3.kriterin ligjor; dhe

4. kriteri administrativ.

Në Zagreb në Samitin UE-Ballkani Perëndimor (2000), shtetet e rajonit dhe UE u pajtuan të ecin përpara me procesin e **STABILIZIM-ASOCIMIT si mjet** për ta përgatitur rajonin për **reforma të qëndrueshme**.

-Gurthemeli për një obligim afatgjatë të UE-së është Marrëveshja për **stabilizim dhe asocim**.

-**Marrëveshjet për Stabilizim dhe Asocim** janë modeluar sipas Marrëveshjeve të Evropës të nënshkruara në vitet e 90-ta me dhjetë shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Deri më sot janë nënshkruar me Maqedoninë, Kroacinë, Shqipërinë, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova (nëntor 2015).

6.Të gjitha sfidat dhe krizat e Unionit Evropian (UE)

Nuk ka dilemë se Unioni Evropian që nga gjeneza e themelimit e deri tani ka hasur edhe në kriza dhe sfida të ndryshme, por më të rëndësishme janë këto:

-1950-Ka dështuar përpjekja e formimit të forcave Evropiane të mbrojtjes (ushtisë, për shkak të vetos së Francës);

-1960-Franca u tërhoq nga institucionet në Bruksel për shkak të problemeve me bujqësinë;

-1970-Periudha e “eurozonës”-stagnimi i forcimit të BEE-së, ngadalsimi i procesit të integritetit;

-1980-Britania në prag të përjashtimit nga BE-ja për shkak të refuzimit që të paguajë paratë në buxhetin e përbashkët;

-1990-Recesioni i fuqishëm e kishte përfshirë Evropën, një numër anëtarësh e lëshon Sistemin Monetar Evropian;

-2005-Shumë shtete në referendume e kanë refuzuar miratimin e Kushtetutës së UE-së;

-2008-Fillimi i krizës së “euro-zonës”, e cila ka zgjatur gjer në vitin 2015 dhe marrëveshjes me Greqinë;

-2015-UE-ja nuk gjen përgjigje për afër 1 milion refugjatë nga Lindja e Afërt e përfshirë në luftë; dhe

-2016-BREXIT-i-Pas Fitore e forcave euroskeptike në vitin 2015, Paralajmërimi i referedumit për 2017, ndoshta edhe më herët. Më dt. 09 nëntor 2015 ka dorëzuar propozim ndryshimet në UE). *Brexit 2016* (23 qershor 2016) kur qytetarët e Britanisë së Madhe nëpërmjet të deklarimit politik (referedumit vendosën që ta lëshojnë Unionin Evropian (EU).

“Britania e Madhe në referendum më 23 qershor ka vendosue që ta lëshojë Unionin Evropian (për të dalë 52% , për të mbetë anëtare 48%). Për dalje nga EU kanë votuar Anglia (53,4%) dhe Velsi (52,5%), përdërsa për mbetje kanë votuar Skocia (62%), Irlanda Veriore (55,8%)”.¹⁹³

Është filluar procedura më aktivizimin e nenit 50 të Traktatit të Lisbonës për dalje nga Unioni Evropian i Britanisë së Madhe.¹⁹⁴

“Qeveria e Britanisë së Madhe ka paralajmëruar se deri te Brexit-i do të vijë më datë 29 mars 2019 në ora 23:00, sipas kohës lokale, kurse këto të dhëna precize do të futen në amandament të projekt-ligjit për dalje”.¹⁹⁵

¹⁹³ Shih në: <http://www.vreme.com/cms/view.php?id=1395472>

¹⁹⁴ Shih në: <http://www.europarl.europa.eu/news/hr/headlines/priorities/brexit>

¹⁹⁵ Shih në: <https://dnevnik.hr/vijesti/svijet/brexit-odredjen-datum-izlaska-velike-britanije-iz-europske-unije---495643.html> dt. 10 stu 2017;

7. Sistemi i qeverisjes i Unionit Evropian

Mund të konstatojmë se Sistemi i qeverisjes i Unionit Evropian i karakterizohet nga:

- Është **fenomen bashkëkohor i qeverisjes mbinacionale**;
- Sistemi i qeverisjes në Unionin Evropian është në **procesin e globalizimit**;
- UE është sistem i **komplikuar në më shumë nivele**;
- Modeli **mbinacional dhe ndërqeveritar i qeverisjes si konkurues**;
- Politika e kooperimit** me shtetetve anëtare është një ndër postulatet kyçe të udhëheqjes ë politikve të UE-së;
- Metoda intenzive të bashkëpunimit ndërqeveritare; dhe**
- Ushtrohen **Politika publike postsovrane të udhëheqjes me Unionin Evropian.**

8. Efektet përfundimtare të antarësimit në UE

1.“**Bashkimi politik i Evropës**-Ajo ishte dhe mbeti instrumenti kyç gjeopolitik i Unionit Evropian që e mundësoi ribashkimin evropian dhe zëvendësimin e sekamave të Luftës së Ftohtë: **Lindje-Perëndim, apo ato të tipit: “Evropa e vjetër-Evropa e re me një Evropë Unike”** ;

2.Me kushtëzimin e shteteve që aspirojnë anëtarësimin në UE, ajo edhe i transformoi ato nga shoqëri postautoritare e diktatoriale (Greqia, Spanja dhe Portugalia); nga shoqëri postkomuniste (shtetet anëtare nga Evropa Qendrore dhe Lindore); dhe nga shoqëri poskonfliktuale (Qipro) në shoqëri demokratike”.¹⁹⁶ Rrënimi i diktaturave, regjimeve autoritare dhe huntave ushtarake.

Përsëri kthehemi tek **Zhan Mone** i cili suksesin e Unionit Evropian si shumë të rëndësishme kur shprehet se cili është qëllimi: *“Ne nuk i bashkojmë shtetet, ne i bashkojmë njerëzit”* (Uashington, 30 prill 1952).¹⁹⁷

Ai e sheh si **imperativ** suksesin e Bashkimit Evropian: *“Shtetet e Bashkuara të Evropës nuk janë vetëm shpresë e madhe, por një domosdoshmëeri urgjente e epokës sonë, sepse ato sigurojnë zhvillimin e të gjithë popujve të Evropës, paqën dhe respektin reciprok midis tyre”* (Fjalime, Strazbur, 30 nëntor 1954)¹⁹⁸

Përfundim

Si përfundim për Kriteret e Kopenhagës mund të thuhet se ato:

-**e para:** Ishin nxitës dhe faktor që ndihmuan në formulimin e politikave dhe reformave të shteteve anëtare ose kandidate aktuale;

¹⁹⁶ Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela “INSTITUCIONET DHE POLITIKAT E UNIONIT EVROPIAN”, Tetovë, 2010; fq.146;

¹⁹⁷ Zhan MONE “Evropa, shtëpia jonë e përbashkët”, Shkup, maj 2007;fq.56;

¹⁹⁸ Zhan MONE “Evropa, shtëpia jonë e përbashkët”, Shkup, maj 2007;fq.57;

-e **dyta**: Të gjitha këto kritere kanë qenë në mënyre eksplicite apo implicite pjesë e marrëveshjeve asociuese; *dhe*

-e **treta**: Këto Kritere kishin për detyrë përgatitjen e shteteve teknikisht dhe politikisht për antarësim.

Referencat:

-Klaus-Dieter Borçard, Profesor “ABC-ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian”, Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, 2010;

-Jurgen Habermas “PERËDIMI I PËRÇARË”, Sh.Botuese ASDRENI, Shkup, 2005;

-Jurgen Habermas “KRIZA E UNIONIT EVROPIAN NË DRITËN E NJË KONSTITUCIONALLZMI TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE”(Një ese mbi kushtetutën Evropiane), Sh.Botuese ASDRENI, Shkup, 2013;

-Zhan MONE “Evropa, shtëpia jonë e përbashkët”, Shkup, maj 2007;

-Blerim Reka, Ylber Sela “Нурје нѐ Unionin Evropian”, fq.12; Tetovë, 2011;

-Карен Ј. Олтер “ВОСПОСТАВУВАЊЕ НА СУПЕРМАТИЈАТА НА ЕВРОПСКОТО ПРАВО”, Издавач Арс Ламина ДОО, Скопје 2012;

-Blerim Reka, Ylber Sela “HYRJE NË TË DREJTËN E UNIONIT EVROPIAN”, Tetovë, 2011;

-Paskal Fonten “Evropa në 12 leksione”;Botues Zyra botimeve të Komunitete Evropiane, Luksemburg, 2004;

-Davantage d’unité et de diversité; Luxembourg; Office des publications officielles des Communautés européennes, 2003;

-Tax policy in the European Union; Luxembourg, Office for Official Publications of the European Communities, 2000<

Shih në: <http://www.vreme.com/cms/view.php?id=1395472>

Shih në: <http://www.europarl.europa.eu/news/hr/headlines/priorities/brexit>

Shih në: <https://dnevnik.hr/vijesti/svijet/brexit-odredjen-datum-izlaska-velike-britanije-iz-europske-unije---495643.html> dt. 10 stu 2017;

MEDIA IN MACEDONIA AND PRIVACY PROTECTION

Dashmir Idrizi PhD

The University of Tetovo- Faculty of Law-Journalism

dashmir.idrizi@unite.edu.mk

Abstract

Privacy is one of the fundamental rights guaranteed with Universal Declaration of Human Rights and European Convention of Human Rights. However the right of privacy in a democratic society should be balanced by the freedom of speech. In reality, it is very difficult to evaluate how to achieve a balance, because it is not easy to determine these two concepts.

In many countries, privacy is protected by constitution, with a general Law and sometimes with specific Laws which covers special areas. Here in Macedonia these Laws exist but they are not respected.

But here in Macedonia some media have violated the right of privacy and they have hurt the right of private life. Therefore, this violation should be eliminated by any condition.

The Republic of Macedonia is one of the main aspirant countries for EU membership, and claims that it has brought these laws but unfortunately the realization of these laws is lacking.

Such a violation of the free editorial word in the Republic of Macedonia has almost been present during the last 10 years, when former Prime Minister Nikola Gruevski was in power.

This was observed with the closure of independent A1 television, namely on November 25, 2010, the first attack on the most watched television in independent Macedonia, A1 Television.

Key words: Privacy, Medias, Law, freedom of speech, right,.

HYRJE

Në shumë vende të Botës, privatësia mbrohet me kushtetutë, me një Ligj të përgjithshëm dhe ndonjëherë me ligje të veçanta që mbulojnë fusha të veçanta. Një Ligj të tillë mendoj se çdo shtet që pretendon se është demokratik në mbarë botën e ka ndër ligjet e para të miratuara me kushtetutë, por mendojë se janë shumë shtete të cilat nuk e respektojnë një gjë të tillë.

Ndër ta është edhe Maqedonia e cila gjendet në pikën strategjike ku gërshetohen rrugët e Evropës Juglindore dhe është një shtet i cili ndër ligjet e para në kushtetutën e këtij vendi e ka miratuar një ligj të tillë, ku liria e shprehjes dhe privatësia mbrohen me ligj por, fatkeqësisht nuk respektohen.

Kjo ishte më e theksuar veçanarisht gjatë dekadës së fundit kur me pushtetin në Maqedoni udhëhiqte Nikolla Gruevski i cili njëherit ishte edhe kryetari i partisë më të madhe në pushtet VMRO.

Si rezultat i këtij pushteti mbeten të uzurpuara disa medime të vendit, ato që nuk pranonin “reformat” e dirigjuara nga pushteti u mbyllën tërësisht, sikur të mos mjaftonte me kaq pati edhe gazetar të vrarë, të burgosur, raste këto të cilat jemi munduar që ti shtjellojmë në temën Mediumet dhe mbrojtja e privatësisë.

Mediumet dhe Mbrojtja e privatësisë

Republika e Maqedonisë e cila konsiderohet si qendër e Evropës Juglindore që nga shpallja e pavarësisë dmth. me aprovimin e kushtetutës aktuale, më 17 nëntor të vitit 1991¹⁹⁹, në këtë shtet me ligj është mundur që përpos Servisit publik Radio Televizioni i Maqedonisë përmes së cilit veprojnë redaksi të të gjitha nacionaliteteve të cilat jetojnë dhe veprojnë në këtë shtet, të mundësohet të veprojnë edhe medime të tjera në të gjitha gjuhët e vendit.

Por fatkeqësisht veprimtaria radiodifuzive e këtij shteti është pothuajse nën kontrollin e plotë të politikës ditore, që do të thotë se liria e shprehjes në këtë vënd është e cunguar.

Privatësia është një e drejtë themelore e njeriut e garantuar me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, ushtrimi i të drejtës së privatësisë, në një shoqëri demokratike duhet të jetë i balancuar me ushtrimin e lirisë së shprehjes ose të drejtën e publikut për të marrë informacion²⁰⁰. Në realitet është shumë e vështirë të vlerësohet se si të arrihet një ekuilibër, sepse nuk është e lehtë të përcaktohen dy koncepte.

“Në shumë vende, privatësia mbrohet me kushtetutë, me një Ligj të përgjithshëm dhe ndonjëherë me ligje të veçanta që mbulojnë fusha të veçanta. Në rregulloren e transmetimit, e drejta e privatësisë shpesh mbrohet vetëm si një parim themelor, pa hyrë në më shumë hollësi në aspekte të ndryshme të tij”.²⁰¹ Por mediat të cilat emetojnë program në Republikën e Maqedonisë ndodh që të lëndojnë rrëndë të drejtën e jetës private të një personi, kjo shpesh ka ndodhur, dhe po ndodh edhe gjatë ditëve në vijim nga ana e medimeve maqedone në drejtim të qytetarëve shqiptar. Madje ende pa u ngritur procedura penale nga organet gjegjëse të drejtësisë të RM-së, figurat politike

¹⁹⁹ Fatmire Lumani, *E Drejta Kushtetuese*, Tetovë 2014, faqe 97

²⁰⁰ Azizi.A., “Unioni Evropian: Institucionet, e drejta dhe politika, Tetovë-(2010). faq.136

²⁰¹ Т. Жанета - „Слобода на изразување, јавен интерес и медиумска регулација“-Shkup 2010, faq.81

maqedone madje edhe funksionar maqedon i etiketojnë qytetarët shqiptarë me llojë llojë epitetesh: teroriste, terosistë islamik, fundamentalist islam etj,etj,.

Mbrojtja e kësaj të drejte edhe pse është rregulluar me Ligj në Maqedoni por fatkeqësisht ajo nuk respektohet aspak, e veçanarishtë kur kemi të bëjmë me faktorin shqiptar.

Sipas Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është e definuar se kur autoritetet e justifikuara shtetërore kanë të drejtë të ndërhyjnë në të drejtën e privatësisë: nëse është në përputhje me ligjin, veçanarishtë gjatë proceseve demokratike dhe kur ka të bëjë me interesin e sigurisë kombëtare, sigurinë publike apo mirëqenien ekonomike të vendit, parandalimin e incidenteve ose krimit të organizuar dhe korupsionit, mbrojtjen e shëndetit dhe moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve".

Në shumë vendeve të Botës ky Nen vlen vetëm për ndërhyrjen e autoriteteve publike në të drejtën e privatësisë së qytetarëve, ndërsa për transmetuesit komercial vlejné kufizime më liberale. Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar, sa i përket Standardit të Bordit të Transmetimit ky shtet i është përshtatur parimeve të Nenit 8 transmetuesve:

Shkelja e privatësisë duhet patjetër të arsyetohet sipas interesit primar publik pas zbulimit të informacionit. Këtu bëjnë pjesë: zbulimi i krimit, ose zhvillimet joetike, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë publike, ndriçimi i deklaratave të rejshme nga individët apo organizatat ose dhënia e informacione shpjeguese për sjelljen joprofesionale të zyrës publike.

Kjo ndodhi në R.M me 29 maj të vitit 2013 kur u arrestua gazetari Tomislav Kezharovski i cili në një intervistë për televizionin kombëtar maqedonas "24 vesti" tregon ngjarjen kur forcat speciale hynë me forcë në shtëpinë e tij me qëllim për ta arrestuar atë përshkak se Kezharovski, kishte zbuluar identitetin e një dëshmitari të mbrojtur në rastin "Oreshe" si pasojë e së cilës ai u dënua me disa vite burg, prej të cilave i kaloi në paraburgim 1 vit e 9 muaj. Pas protestave të shumta të organizuara nga ana e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë Gjykata Apelit ia uli dënimin në dy vite burg.²⁰²

VLADO TANEVSKI, një gazetar maqedonas, i cili hyri në histori si një shembull i rrallë i një vrasësi serial nga radhët e forcës së shtatë, mori jetën e tij në një burg të Tetovës me 23.06.2008.

Lista Skopski "Utrinski vesnik", shkruan se Tanevski i cili ishte korrespondent nga Kërçova, u vra në një "kovë uji". Ai kreu vetëvrasje në një qeli të Burgut të Tetovës, ku e ndante edhe me tre të burgosur tjerë.

Sipas një deklarate nga policia maqedonase, asnjë dhunë nuk është kryer në paraburgim. Trupi i tij i vdekur u gjet atë mëngjes, dhe sipas disa informacioneve, koka e tij ishte zhytur në një enë me ujë.

Administrata e burgjeve maqedonase raportoi se Tanevski dyshohej se ishte i dyshuar në katër vrasje, të mbajtur në mënyrë të paramenduar në një qelizë në të cilën nuk do të ishte vetëm që të përpiqej të merrte jetën. shkruan "Utrinski vesnik" i datës 24.06.2008.Republika e Maqedonisë edhe pse është njëra ndër shtetet aspirante për antarësim në BE, dhe pretendon se i ka sjell këto ligje por fatkeqësisht realizimi në praktikë i tyre mungon.

²⁰² www.24vesti.com.mk

Shkelja e dinjitetit njerëzor

Neni 7.1 i Konventës Evropiane për Televizionin Ndërkufitar është themeluar pas një detyrimi për transmetuesit që transmetojnë shërbime programore televizive: "Të gjithë kompetentët e programeve, në mënyrën e prezantimit dhe përmbajtjes së tyre, duhet të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe të drejtat themelore të të tjerëve"²⁰³.

Gjithashtu, Neni 3 (e) i Direktivës së re për shërbime mediatike audiovizuale thotë: "Komunikimet Komerciale Audiovizuale nuk duhet të shkelin dinjitetin njerëzor dhe nuk duhet të përfshijë ose të nxisin urrejtje apo diskriminim në bazë të gjinisë, raciale, etnike ose kombëtare, përkatësisë së fesë apo besimit, aftësisë së kufizuar, moshës apo orientimit seksual."²⁰⁴

Në Ligjet të cilat rregullojnë veprimtarinë radiodifuzive pothuajse në të gjitha vendet e botës janë përfshirë dispozita të cilat kërkojnë që transmetuesit të mos dëmtojnë dinjitetin njerëzor, që shpesh shoqërohet me respektin për shijen dhe mirësjelljen e mirë. Megjithatë, rreth zbatimit në praktikë të kësaj rregulloreje ka shumë vështirësi sipas këtyre dispozitave ligjore, pasi koncepti i dinjitetit njerëzor është mjaft abstrakt dhe ligjet pothuajse kurrë nuk kanë shpjegime të sakta.²⁰⁵ Një problem tjetër është se ky koncept bie në sferën e moralit dhe normave morale, të cilat ndryshojnë shumë nga vendi në vend.

Prandaj, nuk ka standarde ndërkombëtare të cilat përfaqësojnë shije të mirë apo mirësjellje në program, por qëndrimet për këtë varen gjithmonë nga karakteristikat socio-kulturore të vendit.

Një faktor me ndikim në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor shpesh është reagimi i publikut ndaj disa ngjarjeve.

Në fushën e mbrojtjes së privatësisë theksuam se disa organe rregullatore gjatë një periudhë kohore janë më aktive në mbrojtjen e parimeve të përgjithshme të programimit, duke miratuar udhëzime për sjelljen e transmetuesve.

Një shembull i tillë është Britania e Madhe ku mbrojtja e dinjitetit njerëzor konsiderohet si një nga objektivat kryesor të qëllimit rregullatorë. Në vende të tjera, sërish, opinionet janë të ndara, pasi një praktikë e tillë konsiderohet se i drejton rregullatorët në një censurë "të butë" të politikës redaktoriale të transmetuesve. Kjo mund të ndodhë sidomos kur censura e shtetit ka kohë që është aplikuar në media.²⁰⁶

Një shkelje të tillë të fjalës së lirë redaktoriale në R. Maqedonisë pothuajse e kemi pasur prezente gjatë 10-vjetëshit të fundit, atëherë kur në pushtet ishte ish kryeministri Nikolla Gruevski.

²⁰³ Т. Жанета - „Слобода на изразување, јавен интерес и медиумска регулација”-Shkup 2010, faq.82

²⁰⁴ Т. Жанета - „Слобода на изразување, јавен интерес и медиумска регулација”-Shkup 2010, faq.83

²⁰⁵ <http://www.who.int/mediacentre/factsheets>

²⁰⁶ Д. Голдберг, Т. Просер и С. Берхулст, „Регулирање на Медиумите”-Скопје 2009, стр.18

Kjo u vërejtë me mbylljen e televizionit të pavarur A1 në vitin 2010, më saktësisht me 25 nëntor të vitit 2010 ndodhi sulmi i parë ndaj televizionit më të shikuar në Maqedoninë e pavarur, Televizioni A1. “Televizioni A1 u rrethua nga forcat policore, veturat dhe xhipat e policisë të kishin bllokuar televizionin, dhe të gjithë gazetarëve dhe kameramanëve bashkë me teknikën e Televizionit A1 iu ndalua lëvizja e lirë”.²⁰⁷

Kryeministri i atëhershëm, Nikolla Gruevski, ftoi të gjithë qytetarët e Maqedonisë, që informatat që vijnë nga Televizioni A1 si dhe gazetatat, “Vreme”, “Koha” dhe “Koha e Re”, të cilat botoheshin nga e njëjta kompani ti mernin me rezerve, apo të mos ju besonin fare.

Pushteti 10 vjeçar nuk ishte i kënaqur me kaq pasi arrestoi dhe i dënoi me disa dhjetëra vite burg udhëheqësinë e këtij mediumi Velia Ramkovski me bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë. I njëti pushtet në të njëjtën mënyrë vazhdoi edhe me tv.Alfa- televizion nacional maqedon, të cilit për 24 orë ia ndërroi komplet strukturën, duke filluar nga udhëheqësia, kryeredaktori, redaktorët e deri tek gazetarët ditor.

Pas këtyre rasteve regjimi gruevskian vazhdoi edhe më tej me eliminimin e “kundërshtarëve” dhe në një aksident trafiku të organizuar me 23 mars të vitit 2013 nëpër rrugët e Shkupit humbi jetën njëri ndër kundërshtarër e pushtetit të asaj kohe i cili ishte njëherit edhe kryeredaktori i javores në gjuhën maqedone “Fokus” Nikolla Mlladenov.²⁰⁸

Lirishtë mund të përfundojmë se në Maqedoni deri në vitin 2016 fjala e lirë dhe mediumet e lira kanë qenë vetëm ëndërr e jo realitet.

E drejta e fjalës dhe e korrigjimit

Kur nëpërmes të një emisioni apo show televiziv jepen të dhëna rreth akuzave të ngritura për punën joetike dhe joprofesionale si dhe dëmeve të shkaktuar një personi apo organizate, gjithsesi është normale që të kritikuarit ti jepet mundësia e duhur për të reaguar ndaj informatave të publikuara.

E drejta e fjalës apo e korrigjimit është një nga të drejtat themelore të përcaktuara në rregulloren audiovizuale evropiane. Sipas nenit 23²⁰⁹ të Direktivës për shërbimet mediale dhe audiovizuale në lidhje me të drejtën e shprehjes dhe korrigjimit është definuar si vijon: “çdo person fizik ose juridik, pavarësisht përkatësisë kombëtare të cilës i takon, cilat interesa legjitime mbron, më konkretisht pamjen apo emërin e tij, nëse është dëmtuar duke paraqitur fakte të pasakta në një transmetimi televiziv, duhet ti jepet mundësia që për të njëjtën të përgjigjet përmes mediumit ose përmes ndonjë instrumenti të përshtatshëm juridik.

Shtetet-anëtare duhet të sigurojnë qasjen e drejtë të realizimit të fjalës-mendimit dhe përmes ndonjë mjeti tjetër duhet të mos pengohet përmes imponimit të kërkesve të paarsyeshme. Përgjigja

²⁰⁷ www.A1.com.mk

²⁰⁸ www.focus.com.mk

²⁰⁹ Azizi.A., “Unioni Evropian: Institucionet, e drejta dhe politika, Tetovë-(2010). faq .48.

duhet të përcillet brenda një kohe të arsyeshme pas konfirmimit të kërkesës së paraqitur në kohë dhe në mënyrën e duhur për emetimin e të cilit ato kanë aplikuar."²¹⁰

Për të mundësuar ushtrimin efektiv të së drejtës së fjalës, rregullatori duhet të ketë autoritetin dhe të vlerësojë nëse është vendosur kërkesa e personit në fjalë dhe, nëse po, ta urdhërojë transmetuesin në kohë të përshtatshme që ti mundësojë personit në fjalë që në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme ta jep mendimin e tij përmes emisionit të caktuar. Zakonisht në vend që personi në fjalë të shfaqet në program, transmetuesi ta transmetojë deklaratën e tij -përgjigjen apo të korrigjuar.²¹¹

Por në Maqedoni ndodh e kundërta, e veçanarisht tek mediumet të cilat janë krah-përkrah pozitës.

Këtë do ta kisha argumentuar me tre raste të rrënda të cilat ndodhën në peridha të ndryshme kohore, por, kur në pushtet ndodhi e njëjta garniturë politike-qeveritare dhe e njëjta ministre për punë të Brendshme në Qeverinë e RM-së, Gordana Jankulovska.

Si në rastin e Brodecit-të Tetovës 2007, Smillkovci-2012-Shkup dhe rasti i Lagjes së Trimave në Kumanovë 2015, ku viktimat ishin kryesisht qytetarët shqiptar dhe Ministrja e Punëve të Brendshme e RM Gordana Jankulovska ende pa filluar proceset gjyqësore akuzonte qytetarët shqiptar si terroristë, fundamentalistë islamik e kështu me radhë e kjo përcillej nëpër mediumet e vendit sikur të ishte ashtu.

A në fakt (pa mos hyrë në detaje) pas disa vitesh të njëjtit që akuzoheshin për terrorizëm, pas maltretimeve dhe dënimeve me burg madje edhe të përjetshëm lëshohen në liri.

Rasti i fundit ishte me 6 të akuzuarit e rastit "MONSTRA" liqeni i Smillkovës ku u vranë pesë djem të rri maqedonas dhe pushteti i dënoi 6 qytetar shqiptar prej të cilëve 2 në mungesë me burg të përjetshëm, dhe të njëjtit gjatë muajit dhjetor të vitit 2017 u shpallën të pafajshëm.

Kjo është Maqedonia, dhe ky është shteti ku respektohet, mbrohet dhe shkelet e drejta e lirisë së shprehjes.

Përfundim

Privatësia është një e drejtë themelore e njeriut e garantuar me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, ushtrimi i të drejtës së privatësisë, në një shoqëri demokratike duhet të jetë i balancuar me ushtrimin e lirisë së shprehjes ose të drejtën e publikut për të marrë informacion. Në realitet është shumë e vështirë të vlerësohet se si të arrihet një ekuilibër, sepse nuk është e lehtë të përcaktohen dy koncepte.

"Në shumë vende, privatësia mbrohet me kushtetutë, me një Ligj të përgjithshëm dhe ndonjëherë me ligje të veçanta që mbulojnë fusha të veçanta. Në rregulloren e transmetimit, e drejta për privatësinë shpesh mbrohet vetëm si një parim themelor, pa hyrë në më shumë hollësi në aspekte të ndryshme të tij".

Por mediat të cilat emetojnë program në Republikën e Maqedonisë ndodh që të lëndojnë rrëndë të drejtën e jetës private të një personi, kjo shpesh ka ndodhur, dhe po ndodh edhe gjatë ditëve në vijim nga ana e mediumeve maqedone në drejtim të qytetarëve shqiptar. Madje ende pa u ngritur procedura

²¹⁰ <http://www.who.int/mediacentre/factsheets>

²¹¹ Д. Голдберг, Т. Просер и С. Берхулст, „Регулирање на Медиумите“ - Скопје 2009, стр.81

penale nga organet gjegjëse të drejtësisë të RM-së, figurat politike maqedone madje edhe funksionar maqedon i etiketojne qytetarët shqiptarë me llojë llojë epitetesh: teroriste, terosistë islamik, fundamentalist islam etj,etj,.

Edhe pse të dhënat e fundit flasin se mediat në Maqedoni pas rrënjes së pushtetit të Gruevskit vitin e kaluar ka një ngritje të lehtë për dy vende sipas Freedom house (Organizatë botërore për kujdesin ndaj lirisë së mediave) por megjithatë kjo nuk është e mjaftueshme.

Literatura e shfrytëzuar

1. R. Mansell and E. Steinmueller MOBILIZING THE INFORMATION SOCIETY, Oxford University Press-(2000)
2. Г. Наумовски, М. Докманович-„ ПРАВО И ИНФОРМАТИЧКА ТЕХНОЛОГИЈА“- Скопје: Правен факултет „Јустиниан први“ Скопје 2008.
3. Joseph R. Dominick-“ Динамика на масовна комуникација во дигитални медиуми "- Универзитетот на Џорџија; Атина”-(2010).
4. Г. Томе - „Историја на новинарство“- Скопје, (2007).
5. Г. Томе- „Јавното информирање во Македонија“, „Студенски Збор“- Скопје, (1991).
6. Д. Голдберг, Т. Просер и С. Берхулст, „Регулирање на Медиумите “-Скопје 2009
7. Трпевска С., Слобода на изразување, јавен интерес и медиумска регулација“-Скопје, 2010.
8. Димишкова С. „Слобода на изразувањето и демократијата“: Скопје 2008.
9. www.A1.com.mk
10. www.focus.com.mk
11. <http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/Doc/DH-MM>
12. http://www.humanrightsinitiative.org/programes/ai/rti/articles/undp_rti_2006/anexs_backgr_ound_paper.pdf
13. http://www.osce.org/dokuments/rfm/2010/03/42898_en.pdf [5 Julu 2010]

DHUNA NDAJ FËMIJËVE –SI MENDOJNË TË RINJËTË.RASTI I STUDENTAVE TË EKONOMIKUT DHE TË SHKENCAVE SOCIALE NË USH.

Prof.dr. Sadije Bushati

Universiteti "L.Gurakuqi"Shkodër

Abstract

Despite the law on the protection of children and the work of various institutions and associations against violence against them, again there are cases of violence against children. These cases occur in families, schools or asylums, orphanages and dormitories. To find cases of domestic violence is generally more difficult; these emerge most when the man exercises violence against women and children and the woman decides to denounce him. Until recently it can be asserted that children, especially the disobedient boys, many parents and honor them, at least one, have practiced physical violence, or psychological, or both. The study seeks to know how the young generation, who will soon be a parent, reacts to this problem, namely, violence against children. For this purpose, a questionnaire was developed, distributed to some students of the Faculty of Economics and Social Work and Psychology. Questionnaire analysis was done with the programs SPSS and EXCEL and the results of 20-year students show that new families in democracy are sensitized to this problem, the violence exists little or much less condemned, whereas these 20 years old today all do not want to use violence against their children.

Fjalet kyce: Dhunë, dhunë ndaj fëmijëve; dhunë fizike, psikologjike, seksuale, ndëshkim.

Hyrje

Problemi i dhunës në familje dhe në veçanti, dhuna ndaj fëmijëve, që mund të ushtrohet kudo, në familje, shkolla, qendra residenciale, konvikte apo të tjera dhe që haset kudo në botë, në vende të zhvilluara ose jo është ndërkombëtarizuar, sidomos dhjetëvjeçarët e fundit. Organizata ndërkombëtare UNICEF (United National International Children's Emergency Fund, pra Fondi i Emërgjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët) është themeluar në [1946](#), fillimisht për të lehtësuar pasojat e luftës, por tani ai mbështet të drejtat e fëmijëve, mbledhjen e të dhënave dhe shpërndarjen e tyre si dhe ofron këshillim e mbështetje teknike për zhvillimin e politikave publike për fëmijët. Me qendër në [New York](#), UNICEF mbështet nga 150 qeveri kombëtare, operon me kontribute vullnetare nga qeveritë, nga disa fondacione, korporata, biznese dhe individë. Edhe vendi ynë është përfshirë që në vitin 1992 dhe si rezultat i ndihmës dhe bashkëpunimit, herë pas here janë marrë një sërë masash për uljen e shfaqjes së dhunës. Shoqatat e shumta, që veprojnë për këtë qëllim, në bashkëpunim kryesisht me UNICEF akoma rekomandojnë shtimin e masave dhe aktiviteteve në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

Në mënyrë që të ndiqet më mirë ky material, po paraqesim përcaktimet e koncepteve të mëposhtme:

Dhunë: Është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik (Sipas nenit 3/1 të ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”).

Dhunë ndaj fëmijëve: Është përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose i formave të tjera të forcës, qoftë me kërcënim ose aktuale, kundër fëmijës a grupit të fëmijëve, e cila rezulton apo ka shumë të ngjarë që të rezultojë në dëmtim, vdekje, dëmtim psikologjik, keq-zhvillim ose privim (Sipas nenit 3/b, të ligjit Nr.10 473, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”). [2]

Edhe sipas nenit 19 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, dhuna ndaj fëmijëve përfshin të gjitha format e dhunës fizike ose psikologjike, lëndimin dhe abuzimin, neglizhencën ose trajtimin neglizhues, keqtrajtimin ose shfrytëzimin përfshirë dhe abuzimin seksual.

Po japim edhe disa përcaktime të tjera, të shprehura më thjeshtë: Dhuna fizike – goditja me shpullë, me këmbë, grushtimi dhe forma të tjera të përdorimit të forcës. Dhuna seksuale – preket seksuale, ngacmimi seksual, keqpërdorimi seksual, dhunimi ose shfrytëzimi seksual në prostitucion ose pornografi dhe forma të tjera. Dhuna psikologjike – ofendimi, kërcënimi, poshtërimi, sharja, izolimi dhe forma të tjera. Neglizhenca – dështimi i një prindi ose kujdestari t’i sigurojë fëmijëve kujdesin dhe mbrojtjen që kanë nevojë, siç është streha, ushqimi, veshmbathja dhe kujdesi shëndetësor. Ajo përfshin edhe mos sigurimin e mbështetjes emocionale ose moskujdesi për shkollimin e një fëmije.

Në fakt, Shqipëria filloi të ratifikojë instrumentat kryesorë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, përfshirë dhe ato të të drejtave të fëmijëve, pas viteve 1990. Disa prej tyre janë Konventa europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (1953), Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijës (1989), Konventa Europiane “Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve” Strasburg (25.1.1996), Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (21.12.1965), Konventa kundër torturës dhe mizorive të tjera, ndëshkimeve çnjerëzore dhe trajtimin poshtërues (1984), si dhe Konventa e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në birësimet jashtë vendit (1986).

“Për ta përshtatur legjislacionin e brendshëm shqiptar me këto instrumente ndërkombëtarë janë miratuar, krahas dokumenteve themelore ligjore (Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Penal, Kodit të Familjes etj) edhe një sërë ligjesh dhe vendimesh të veçanta, që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë ose tërthor me përmirësimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre prej formave të ndryshme të dhunës”. [4]

Për dhunën ndaj fëmijëve është punuar nga institucione shtetërore, kryesisht nga Ministria e Punës dhe çështjeve sociale (me emërtime të ndryshme, sipas qeverive), në bashkëpunim me UNICEF dhe disa shoqata civile në vend. Për të evidentuar ekzistencën e dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkolla dhe konvikte e qendra rezidenciale të ndryshme të fëmijëve janë organizuar seminare e takime dhe janë lënë detyra e rekomandime për shtetin dhe organizatat jo qeveritare. Raste të dhunës dalin në dukje herë pas here, nga media e shkruar ose investigative:

- në klasë, kur vetë fëmijët i denoncojnë, pasi i rregjistrojnë me celularët e tyre;
- në kopshte, kur veprimet e dhunshme të kujdestarëve ndaj fëmijëve i denoncojnë prindërit, mbasi kanë konstatuar shenja dhune te fëmijët;
- në familje, kur dhuna denoncohet ose vetë nga fëmijët në polici ose te ALO 116, ose nga gratë që denoncojnë dhunën ndaj tyre dhe fëmijëve, të ushtruar nga partneri.

Disa të dhëna statistikore për dhunën ndaj fëmijëve

Dhuna ndaj fëmijëve konstatohet kudo, në vende të pasura e të varfëra, në perëndim e lindje; raste akoma më të rënda ndodhin në vende ku ka luftë ose mungesë të theksuar të demokracisë. Disa të dhëna nga UNICEF janë vërtet tronditëse, si:

- Njëzetë tri të katërtat e fëmijëve ndërmjet 2 - 4 vjeç, që janë gati 300 milion pësojnë dhunë psikologjike ose fizike në shtëpi.
- Gati 17 milion adoleshentë janë ngacmuar nga bashkëmoshatarët e vet.
- Një e katërta e fëmijëve nën 5 vjeç, që janë 176 milion jetojnë me nënën, që ka pësuar dhunë nga partneri. [13]
- Çdo vit, rreth 150 milionë fëmijë ose 14% e fëmijëve në planet janë viktimë e abuzimeve seksuale, 7% janë viktimë të manjakëve seksualë.
- Shtëpia është një vend i rrezikshëm për rreth 62 milionë vajza, të cilat martohen pa mbushur të 18-at dhe që më pas dhunohen edhe nga partnerët e tyre. Sipas një studimi të “Child sexual abuse in Europe” (Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Europë), vlerësohet se 10% deri në 20% e fëmijëve në Europë vazhdojnë të dhunohen seksualisht në fëmijëri.
- Ka më shumë se 1 milionë imazhe të 10-20 mijë fëmijëve të abuzuar seksualisht të postuara në internet. Pak nga këta fëmijë janë identifikuar. Shumica janë anonim, të braktisur dhe me shumë mundësi ende për t’u abuzuar.
- Ndërsa, sipas OMS, (Organizatës Botërore të Shëndetësisë), Italia e ka treguesin e abuzimeve e keqtrajtimeve 9,5 për 1000, pra 70/80 mijë raste në vit.[6]
- Nga një total prej 2210 raste, që kanë trokitur në linjën italiane 114, në periudhën nga 1 Janar 2015 deri 31 Janar 2016 kanë qënë 1068 raste dhune. Prej tyre, 26% janë raste të dhunës psikologjike, 25,3% dhunë fizike dhe gati 10% dhunë seksuale.[11]

Raporti studimor “Dhuna Kundër Fëmijëve në Shqipëri” i publikuar nga UNICEF në 2006 nxori përfundim se:

- Format më të shpeshta të dhunës fizike në shtëpi dhe në shkollë janë ato me goditje dhe përkatësisht një në dy fëmijë goditen në kokë e trup në shtëpi, ndërsa një në tre goditen në shkollë.

- Prindërit kanë bindjen se e përdorin dhunën, sepse “ia duan të mirën fëmijës, e bëjnë për edukim”, ndërsa shumë shpesh nënat pranojnë se përdorin dhunë, për të shkarkuar stresin e grumbulluar, ngaqë është e “mbytur” me punë.

-Format më të përhapura të dhunës psikologjike që përdoren në shtëpi të raportuara nga fëmijët janë: të bërtiturit (95.3%), mbajtja e mërisë (39.5%), kërcënimi me fjalë (39%), përdorimi i nofkave dhe i epiteteve të këqija (35.8%), kërcënimi me objekte (18%), kërcënimi me zhim (14%), kërcënimi me braktisje (6%). Në shkollë format më të përhapura të dhunës psikologjike janë: të bërtiturit (74.9%), kërcënimi me thirrjen e prindit (33%), kërcënimi me fjalë (31%), nofkat dhe epitete të këqija (24%), kërcënimi me zhim (23%), mëria (22.5%), kërcënimi me denoncim (19%), kërcënimi me rrahje (17%), kërcënimi me objekt (11%), kërcënimi me notë (11%), kërcënimi me përjashtim nga shkolla (10%).

-2/3 e fëmijëve dëgjojnë të bërtiturat e prindërve të tyre në shtëpi dhe një e treta e mësuesve u bërtet atyre në shkollë.

- Prindërit janë më të prirur se mësuesit ta përdorin mbajtjen e mërisë me fëmijët.

- Prindërit janë më të prirur semësuesit të përdorin nofka dhe epitete të tjera të këqija.

- Mësuesit janë më të prirur se prindërit t’i kërcënojnë me zhim si dhe t’i zbojnë nxënësit nga shkolla.

- Studimi zbuloi se ekziston një prirje që në shtresat e ulëta dhe më pak të arsimuara të shoqërisë të përdoret më shumë dhunë fizike, ndërsa në shtresat e mesme dhe më shumë të arsimuara ekziston prirja emospërdorimit të dhunës fizike, por e përdorimit të dhunës psikologjike.

-Fëmijët që shfrytëzohen për punë i nënshtrohen një dhune të shumëfishtë: dhunës familjare, dhunës së rivalëve që shesin në territore fqinje dhe që duan t'u rrëmbejnë klientelën, dhunës së kamerierëve të lokaleve të shumta, ku këta hyjnë për të shitur mallrat e tyre, dhunës së policëve, që patrullojnë në territoret, ku këta shesin.

-13.3% e fëmijëve të intervistuar ngacmohen seksualisht dhe 22.5% e tyre nga mësuesit. Nga statistikat zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë rezulton se nga viti 2002-2007 në vendin tonë kemi 222 autorë krimesh seksuale me viktime të mitur. Karakteristikë e autorëve pedofilë është fakti se kanë prirje për abuzime të rënda fizike ndaj viktimës, që shoqërohen me lëndime, plagosje deri në humbje jete” [8]

ALO 116, që nga viti 2009 është shërbim kombëtar i telefonisë për mbrojtjen e fëmijëve, që i asiston ata në momentet më të vështira të jetës. Në raportin e të dhënave të ALO 116 për periudhën 2009 - 2014 për dhunën e fëmijëve në Shqipëri, janë trajtuar 3643 çështje të dhunës 528 raste, që i referohen abuzimit fizik, 193 raste, që i referohen abuzimit emocional, 118 raste, që i referohen abuzimit seksual, neglizhim 178 raste, për probleme bulizmi dhe me mësuesit 968 raste dhe konsulta për probleme në familje 1703 raste.

Tematikat e telefonatave kanë qenë të ndryshme si: marrëdhënia me prindërit, problemet në shkollë, marrëdhënia me bashkëmoshatarët, probleme të duhanpirjes, marrëdhënia me partnerin etj.[9]

Jo vetëm në materialet e mësipërme, por edhe në punimet e tjerë pohohet se në Shqipëri dhuna pranohet si pjesë e traditës dhe kulturës së shoqërisë për të disiplinuar fëmijët për sjellje jo të mirë. Këtu ekziston ende mendësia dhe perceptimi se në familje babai ka një rol të padiskutueshëm dhe se fëmija duhet t'i bindet plotësisht. Gjithashtu shumë fëmijë të abuzuar nuk kërkojnë ndihmë, pasi ata e shikojnë dhunën si një fenomen normal dhe nuk e shohin veten si viktime të saj. [9]

Të qenët viktimë e dhunës apo edhe krimeve të ndryshme mund të ketë pasoja të rënda në jetën e çdo fëmije. Nga të dhënat e UNICEF-it rezulton se mesatarisht 6 në 10 fëmijë në vendet e rajonit përjetojnë një formë dhune në shtëpi, pasi prindërit tentojnë t'i mësojnë fëmijët, duke shfaqur një lloj sjellje agresive. Në vendin tonë kjo ndodh në 77% të rasteve.

Në internet ka një numër të konsiderueshëm punimesh të tilla, për ekzistencën e dhunës ndaj fëmijëve në rang kombëtar, të analizuar edhe për të gjitha rrethet dhe qytetet e vendit në veçanti, shumë të detajuara për llojet e dhunës, për ambjentin ku kryhet, për dhunuesit etj. Pasqyrimi i këtij fenomeni ka filluar që në vitet '90 dhe ka vazhduar të bëhet më i mprehtë vetëm mbas viteve 2000. Në ditët e sotme, studentët tanë universitarë, kanë lindur në demokraci dhe bëjnë pjesë në familje ku prindërit e tyre në vitet e ndryshmeve demokratike kanë qenë vetë rreth të njëzetave. Gjatë viteve në vazhdim, ata kanë marrë sado pak informacion mbi dëmet e dhunës ndaj fëmijëve dhe për të drejtat e këtyre të fundit. Idea e këtij punimi lindi për të verifikuar hipotezën nëse dhuna ndaj fëmijëve nuk është më në përmasat e mëparëshme në familjet tona dhe nëse të rinjtë universitarë do ta ushtrojnë atë. Për këtë studim, u përpilua një pyetësor dhe u shpërnda në Fakultetin Ekonomik dhe në Shkencat Sociale, në degët Psikologji e Punë Sociale.

Analiza e pyetësorëve

Nga 120 pyetësorë të shpërndarë, 70 në Fakultetin Ekonomik dhe 50 në Shkencat sociale, u përgjigjen 117 studentë, ndër ta 67 nga Ekonomiku dhe 50 nga Shkencat sociale. Analiza është kryer me anën e programeve SPSS dhe EXCEL. Studentët janë të viteve të para, të dyta, të treta dhe nga studimet master.

Prezenca e gjinisë mashkullore ka qenë relativisht e vogël, konkretisht ndër 117 studentët respondentë, janë vetëm 16 djem që përbëjnë vetëm 13,7% të pjesmarrësve.

Vendi ku banojnë tregohet në figurën1, i cili është mjaft përfaqësues nga disa zona; raporti qytet- fshat është gati 1 me 1, sepse disa nga përfaqësuesit e qyteteve larg Shkodrës e Lezhës dhe ata të Malit të Zi janë nga fshati. Respondentët nga fshatrat e Pukës dhe të Malësisë së Madhe janë përfshirë në fshat Shkodër, sepse bëjnë pjesë në Qarkun e Shkodrës.




Fig.1

Numri i familjarëve të respondentëve është treguar në figurën 2. Sic vërehet nga figura, numri 5 haset më shumë dhe tregon se familja ka në shumicën e rasteve dy prindërit me tre fëmijë ose një gjysh/e, prindërit dhe dy fëmijë. Familja me më shumë pjestarë (11) ka në përbërje prindërit, 6 fëmijë (4 vajza dhe dy djem), gjyshen dhe dy halla; të tjerat kanë numër të madh fëmijësh.:




Fig.2

Pyetjes “A keni patur raste të dhunës ju ose pjestarë të tjerë të familjes” i janë përgjigjur pozitivisht vetëm 10 persona ose vetëm 8.5%. E vërteta është se në fillim ishim nisur të aplikojmë pyetsorin vetëm në fakultetin Ekonomik. Ndër 67 respondentët verifikuam se vetëm 4 respondentë i ishin përgjigjur pozitivisht kësaj pyetje. Duke menduar se mund të ketë patur jo transparencë të studentët, menduam ta zgjerojmë aplikimin me studentët e Shkencave sociale, mbasi këta si të profilit, do të ishin më të hapur e të sqartë ndaj pyetjeve. Rezultati që i afërt: 6 përgjigje positive ndër 50. Kjo tregon atëherë, se vërtet në familjet shqiptare ka ndryshuar qëndrimi ndaj dhunës.

Të 10 respondentët pozitivë, janë 9 femra që e pohojnë dhunën; ajo është e tipit fizik, emocional, por edhe të dy tipet, fizik dhe emocional në 50% të rasteve. Shkaqet e dhunës janë: mosbindje ndaj

urdhërave jo logjike, arsye ekonomike, injorancë dhe vetëm një rast shkruan se shkaku është “qëllim edukativ”. Një rast tjetër është dhunë e vëllait dhe gruas së tij ndaj tre fëmijëve të tyre, të cilët jetojnë së bashku me prindërit e djalit dhe motrën dhe kjo e fundit është qëdëshmon dhunën.

Vetëm në një rast nuk ka ndërhyrje nga familjarët e tjerë kur kryhet dhuna; ajo kryhet në 8 raste (80%) nga babai, 4 herë nga babai dhe nëna, por edhe nga më të mëdhenjtë, motra apo vëllai, 2 herë.

Nga këta 10 persona, që e pranojnë ekzistencën e dhunës në familjet e tyre, 8 prej tyre japin përgjigjen JO pyetjes: “Si e parashikoni ju vehten, nesër prind, a do të përdorni dhunën ndaj fëmijëve?”, me opsione a) PO, sa herë ta meritojnë; b) PO, ndonjëherë kur ta bjen në majë të hundës; c) JO. Dy personat e tjerë japin si përgjigje opsionin b).

Për pyetjen e mësipërme, përgjigjet e të 117 respondentëve tregohen në figurën 3, ku shihet shumë qartë se shumica e studentëve, afër 90%, nuk do të përdorin dhunën ndaj fëmijëve të tyre:




Fig.3

Për të plotësuar qëndrimin e studentëve tanë nesër, kur në një të ardhme të afërt do të jenë prind, në pyetsor kemi vënë edhe disa pyetje të tjera, të cilat po i vendosim më poshtë së bashku me përgjigjet e dhëna nga respondentët tanë.

Pyetjes “Si duhet vepruar ndaj rasteve kur fëmija kërkon t’i plotësohet patjetër kërkesa, duke qarë e bërtitur” respondentët janë përgjegjur, (shih tabelen 1), shumica e tyre, 70 persona, fëmija duhet qetësuar me të mirë dhe pastaj duhet t’i shpjegohet arsyeja, pra duke përdorur vetëm metoda bindjeje. Pastaj 17 persona mendojnë t’i plotësohet kërkesa brenda mundësive; 10 persona mendojnë mos t’i plotësohet kërkesa, sepse mësohet keq dhe bile të denohet për veprimin p.sh. mos të shohë ndonjë program televiziv që i pëlqen ose ndonjë gjë tjetër të vogël; 9 të tjerë mendojnë që prindi duhet të gjejë mënyra ta habitin fëmijën me dicka tjetër që ta harrojë kërkesën e pastaj qetësisht t’i shpjegojë; vetëm 4 persona mendojnë ndonjë kombinim të rasteve të mësipërm.

Tab.1

	Frequency	Percent
0	7	6.0
te qetesohet e t'i shpjegohet	70	59.8
t'i plotesohet, po qe e mundur	17	14.5
te habitet me dicka tjeter	9	7.7
mosplotesim dhe denim i lehte	10	8.5

Tjeter	4	3.4
Total	117	100.0

Pyetjes “Si duhet vepruar kur fëmijët grinden midis tyre mbrenda familjes” kemi këto rezultate të paraqitura në tabelën 2:

Tab.2

	GRINDJA	
	Frequency	Percent
0	1	.9
Ndeshkim te dy	52	44.4
Ndeshkim fajtori	16	13.7
ta zgjidhin vete	9	7.7
Tjeter	39	33.3
Total	117	100.0

Pyetjes “ Si duhet vepruar kur fëmija yt po grindet dhe rrihet me një fëmijë tjetër të huaj”, me opsione a) ndëshkon fëmijën tënd; b) kërkon fajtorin që të ndëshkohet; c) merr me të mirë fëmijën tënd duke fajsuar tjetrin; d) padit tjetrin te prindi, duke iu ankuar; e) tjetër. Rezultatet tregohen në tabelën 3, ku shihet se 52 persona kanë dhënë përgjigje tjetër, ku përmbahet opsioni që të qetësohen të dy fëmijet me të mirë dhe duke komunikuar butësisht, të pajtohen për të qenë miq të mirë.

Tab.3

	RRAHJA	
	Frequency	Percent
Ndeshkon femijen tend	13	11.1
te ndeshkohet fajtori	29	24.8
pajton femijen tend	2	1.7
padit te prindi tjetrin	21	17.9
Tjeter	52	44.4
Total	117	100.0

Pyetjes “A duhen dalluar e ndarë fëmijët njëri i mamasë e tjetri i babait?”, vetëm 2 persona mendojnë se nuk ka ndonjë gjë të keqe, 115 vetë janë kundra.

Pyetjes “A duhet t’u shpallen fëmijëve dallimet reale të tyre, p.sh. ky është më i zgjuar, por dembel, ky është më i shkathët por grindavec, etj komentoni sipas mendimit tuaj”, rezultatet paraqiten në tabelën 4, ku sic shihet vetëm 10 persona përgjigjen PO dhe komentojnë se duke ditur aftësitë dhe defektet, do të përpiqen t’i zvoglojnë apo edhe t’i eliminojnë ata, ndërsa shumica e respondentëve, mendojnë që fëmijëve nuk duhet t’u përmendim mangësitë dhe shenojnë arsye të ndryshme si p.sh. u ulet vetvlerësimi; mund të ndihen inferiorë; mund të nxisë urrejtje; mund të nxisë xhelozë në mes fëmijëve; mund të pengojë zhvillimin e fëmijës, sepse rritet me idenë e defektit, etj., përkundrazi t’u evidentohen aftësitë.

Tab. 4

Aftesite dhe defektet	
PO	10
JO	97
Vetem aftesite	7
0	3
Total	117

Pyetjes “Si do ta dëshironit edukimin parashkollor të fëmijës”, ata u përgjigjen (tabela 5):

Tab. 5

Edukimi parashkollor	Frequency	Percent
me gjyshe dhe ne kopesht pa dreke	43	36.8
me dado dhe kopesht pa dreke	2	1.7
ne cerdhe e kopesht shtetror	24	20.5
ne cerdhe e kopesht privat	41	35.0
unevete dhe kopesht	5	4.3
Tjeter	2	1.7
Total	117	100.0

Pyetjes “Si do ta preferonit edukimin e fëmijës në shkollë, shtetror apo privat” 69 persona ose 59% janë përgjegjur shtetror.

PERFUNDIME

Përfundimet do të nxirren mbi bazën e përgjigjeve që kanë dhënë 117 studentët respondentë. Duhet pranuar sinqeriteti që karakterizon brezin e ri akoma student, nga njera anë, por edhe faktin se kur janë plotësuar pyetsorët, studentët kanë qenë në klasë, në gjendje qetësie dhe ndoshta, nuk kanë qenë të prirur “të padisin” familjen e kryesisht prindërit, dhunuesit kryesorë të fëmijëve. Gjithsesi, edhe duke hedhur këtë dyshim, del se studentët i quajnë fajtorë prindërit, që kanë ushtruar dhunë.

1. Në familjet ku prindërit janë afërsisht në moshat 40-60 vjeç ka përgjithsisht komunikim, mirëkuptim, prindërit nxisin fëmijët për përparim, duke u vënë në dukje vlerat e tyre, por edhe duke investuar për edukimin e rritjen e tyre pa probleme.
2. Numri i familjeve të studentëve të pyetur, ku ka dhunë fizike, emocionale apo të dyja rezulton këtu 8.5%, shifër jo e vogël, por duke parë te këto familje një dritë positive faktin që kanë dërguar për studime universitare të paktën një fëmijë, pra arsimdashës, shpresojmë të sensibilizohen e të heqin dorë nga dhuna.
3. Familjet ku ka dhunë janë 70% në fshat dhe me numër të madh fëmijësh ose pjestarësh në familje.
4. Babai është dhunuesi kryesor i fëmijëve në familje, i cili e ushtron dhunën në rastet e mosbindjes së urdhërave të tij dhe këto të fundit kanë shpesh shkaqe ekonomike e injorance. Pastaj vjen nëna, e cila e përdor dhunën, por shumë më të lehtë.

5. Dikur ndigjoje shpesh në biseda të çifteve se njëri fëmijë ishte i mamit e tjetri i babit, (më së shumti, djali ishte i babit e vajza e mamit). Respondentët tanë janë gadi të gjithë kundra kësaj ndarje; 115 ndër 117 persona mendojnë se nuk duhet bërë ndarja, e cila mund të ngulitet gjatë në mendjen e fëmijës se njëri prej prindërve dikur, nuk e ka dashur atë sa duhet.
6. Rreth 90% e studentëve nuk pranojnë që prindërit të vënë në dukje edhe të metat, së bashku me vlerat që ka fëmija. Ata mendojnë se fëmijës i ngulitet që ka atë dobësi dhe kjo do t'i lërë pasoja.
7. Shumë respondentë, rreth 40% pëlqejnë kopështin dhe shoqërimin me gjyshen në edukimin parashkollor të fëmijëve të tyre. Kjo është pohuar nga ekspertë sociologë, të cilët vlerësojnë fjalët e vyera të gjyshërve; edhe se ata kanë durim më të madh në marrëdhëniet me fëmijët, por ndonjëherë e teprtojnë me “llastimet” dhe plotësimin e kërkesave të fëmijëve. Natyrisht respondentët këtu e mendojnë vehten të punësuar, megjithatë 5 respondentë kanë shprehur se do të dëshironin ta rrisin dhe edukojnë vetë fëmijën deri në moshën e shkollës.
8. Edukimi shkollor preferohet më shumë shtetrori, në masën 59%. Ky rezultat ndikohet mendoj, ngaqë disa shkolla private kanë infrastrukturë të mirë, por nuk janë cilësore.

REKOMANDIME

1. Duke u njohur me materiale të ndryshme për këtë punim, jemi paisur ne vetë me informacione të reja dhe jemi ndërgjegjësuar edhe më shumë për disiplinimin pozitiv që duhet bërë me fëmijët. Prandaj rekomandoj të gjithë prindërit, por sidomos prindërit e ardhshëm, që të informohen me “Prindërimin pozitiv”, për të rritur fëmijë të shëndetshëm e pa probleme.
2. Prindërimi pozitiv i rekomandohet të dy prindërve, sepse është e pamundur të realizohet vetëm nga njëri prind, duke e kundërshtuar metodën tjetri. Edhe moshat e tjera, të rritur, duhet patjetër të informohen, me anën e programeve të ndryshme televizive e emisione të posaçme, sepse prindërit e moshave adoleshente apo edhe gjyshërit, duhet të jenë të ndërgjegjësuar për mënyrat e ndërhyrjeve në rastet e dhunës. Në familje duhet të mbizotërojë komunikimi me zë të ulur, me qetësi e durim, pa sharje e ofendime.
3. Të rritet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të pushtetit qendror, vendor dhe organizatave të shoqërisë civile për ofrimin e shërbimeve multidisiplinare për fëmijët.
4. Të gjenden mënyrat për informimin e prindërve të rinj për “Disiplinimin pozitiv të fëmijëve”, duke u bërë të qartë se ai nënkupton komunikim të qartë të pritjeve, të rregullave dhe të kufijve të tyre; ndërtimin e një marrëdhënie me respekt të ndërsjellë me fëmijën; rritjen e aftësive dhe të vetëbesimit të fëmijës për t’ia dalë mbanë në situata sfiduese; t’i mësohen fëmijës mirësjellja, jodhuna, vetërespekti, të drejtat njerëzore dhe respekti për të tjerët. Disiplinimi pozitiv nuk nënkupton prindërim tolerues; nuk nënkupton që të lihet fëmija të bëjë çfarëdo që dëshiron apo të ketë mungesën e rregullave, të kufijve apo ndëshkime alternative si me shuplakë apo goditje.[15]

REFERENCA

1. “Dhuna psikologjike ndaj fëmijëve”, Teuta Buçi /SHENJA/, www.keshilla.net › Këshilla për Prindër

2. “Divorci dhe zbatimi i parimit të interesit me të lartë të femijes”, Doktoratura e Florian Bejlerit, Qershor 2016, fq.30, 31 dhe neni I kushtetutes fq. 46-47
3. LIGJ Nr.10 347, datë 4.11.2010; “PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS”
4. “Dhuna kundër femijeve në Shqipëri”, Prof.Adem Tamo, Theodhori Karaj, 2006, fq.74,75,90.
5. “Dhuna ndaj femijeve në Shqipëri”, Raportit e dhenave të ALO 116 për periudhën 2009-2014, Tirane 2014
6. “Violenza e abusi sui bambini:oltre tremila vittime in Italia; di Maria Giovanna Faiella, Corriere della sera, 15.11.2016
7. [UNICEF: 77% e fëmijëve në Shqipëri dhunohen në familje | Historia Ime](http://historia-ime.com/.../unicef-77-e-femijeve-ne-shqiperi-dhunohen-ne...), historia-ime.com/.../unicef-77-e-femijeve-ne-shqiperi-dhunohen-ne... Jun 8, 2015
8. “Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 2013-2014” nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2014
9. “RAPORT TEMATIK DHE ANALITIK QERSHOR 2012” Belioza Çoku Menaxhere e Përgjithshme e ALO 116
10. “Dhuna tek fëmijët, psikologët: Pasoja të pariparueshme gjatë jetës”, [Sonila Isaku, 06-06-2017, afp.al/.../dhuna-tek-femijet-psikologet-pasoja-te-pariparueshme-gja...](http://sonila.isaku.com/06-06-2017/afp.al/.../dhuna-tek-femijet-psikologet-pasoja-te-pariparueshme-gja...)
11. [Maltrattamenti e abusi sui minori: i numeri - Repubblica.it](http://www.repubblica.it/.../maltrattamenti_sui_minori_tutti_gli_abusi-13...)www.repubblica.it/.../maltrattamenti_sui_minori_tutti_gli_abusi-13...
12. [Dhuna ndaj femijeve - Forumi Shqiptar, 17.10.2013](http://www.forumishqiptar.com/threads/151885-Dhuna-ndaj-femijeve)
www.forumishqiptar.com/threads/151885-Dhuna-ndaj-femijeve.
13. “La paura dell’orco: l’allarme dell’Unicef per la violenza sui bambini”, Daniele Erler, www.lastampa.it 1 novembre 2017.
14. “Ti ruajme femijet nga dhuna”, Raport i bashkëpunimit dyvjeçar mes Bashkimit Evropian dhe UNICEF –it për vendet Shqipëria, Bosnja –Hercegovina, Serbia dhe Turqia, Tiranë/Gjenevë/Bruksel, 12 Nëntor, 2013
http://www.unicef.org/ceecis/Insights2013_on_violence_against_children.pdf
15. “POSITIVE DISCIPLINE IN EVERYDAY PARENTING”, Joan E. Durrant, Ph.D. ISBN: 978-9937-2-9126-2, © Save the Children Sweden 2013, fq 16

